

## Edukata Islame

*Revistë shkencore, kulturore islame tremujore*

*Viti XXXVIII nr. 88 / 2009*

## Edukata Islame

**Revistë shkencore, kulturore islame tremujore**

Viti XXXVIII nr. 88 - 2009

*Botues:*

**Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës**

*Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84*

*Tel & fax: 038 / 224-024*

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

*Kryeredaktor:*

**Mr. Qemajl Morina**

qemajlmorina@hotmail.com

*Redaksia:*

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr. Pajazit Nushi,

Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahim, i,

Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë:*

**Hajrullah Hoxha**

*Lektor:*

Bislim Berisha

*Korrektor:*

Skender Rashiti

*Realizimi: Shtëpia Botuese*



*Redaktor teknik &*

*Operator kompjuterik:*

Nuhi Simnica

*Shtyp: Koha - Prishtinë*

Tirazhi: 1000

# Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore  
Viti XXXVIII nr. 88 / 2009

Prishtinë  
2009

## EDITORIAL

*Mr. Qemajl Morina*

## RUAJTJA E DISA DORËSHKRIMEVE TË VJETRA TË KUR'ANIT

Kur'ani është libër i Allahut të Madhërishëm, i zbritur Muhamedit a.s., në gjuhën arabe, gjatë një periudhe kohore prej 23 vjetëve. Kur'-ani është udhërrëfyes për të gjithë njerëzit që i besojnë fjalës së Zotit dhe që dëshirojnë të jetojnë me të. Ai është udhëzues për të gjithë ata, të cilët iu përmbahen këshillave dhe mësimëve të tij.

Myslimanët, janë vazhdimisht në shoqërimin e Kur'anit. E lexojnë atë e studiojnë në të gjitha kohët. Ata e përdorin atë në të gjitha lutjet e tyre. Thënë shkurt Kur'ani është pjesë e përditshmërisë së tyre, pjesë e jetës së tyre.

Jo vetëm kaq, por myslimanët e mësojnë përmendësh Kur'anin, që nga mosha më e re. Mund të thuhet se është libri më i mësuar përmendësh, jo vetëm nga arabët, të cilët e kanë më lehtë, sepse Kur'ani është në gjuhën e tyre amtare. Por, ai mësohet përmendësh, pa ndonjë vështirësi të theksuar edhe nga myslimanë tjerë që u përkasin popujve të ndryshëm të botës, të cilët nuk e flasin gjuhën arabe dhe nuk e kuptojnë atë. Ai është i rimuar, melodik, por nuk është poezi. Në të njëjtën kohë, nuk është edhe prozë. Në vete bashkon të dy këto dy gjini letrare, prozën dhe poezinë.

Për këtë interesimi për Kur'anin ka qenë i kahershëm. Është ruajtur me një fanatizëm të rrallë dhe është konsideruar pasuria më e çmuar e çdo individi. Në të gjitha periudhat historike, vlera e një myslimani është vlerësuar sa ai ka qenë njohës i mirë i Kur'anit dhe sa pjesë të tij ai ka zënë përmendësh. Kështu shohim se numri hafëzëve vazhdimisht ka qenë i madh dhe se ata kanë qenë pjesa më e respektuar e shoqërisë.

Që nga fillimi i Islamit e deri te gjysma e shekullit të XV-të, kur shpiket tipografia e shumonin mus-hafin duke e kopjuar. Megjithatë, edhe pas kësaj periudhe myslimanët vazhduan ta kopjonin mus-hafin me dorë duke menduar se kjo është metodë e vetme e duhur që duhej të veprohej me Kur'anin si libër i shenjtë i myslimanëve. Gjatë kopjimit, përpunimit dhe lidhjes së mus-hafit, artistët islamë kanë punuar bashkërisht dhe në mënyrë të koordinuar.

Me vite të tëra punohej në mënyrë individuale edhe ekipore në dekorimin dhe kopjimin e ajeteve kur'anore, me shkrimin “kufian”, “nes’h”, “thuluth” si dhe variante të ndryshme të nes’hit mameluk. Meqë shfaqja e qenieve të gjalla është e padëshirueshme në Islam, artistët islamë me tërë qenien e tyre iu rrekën kaligrafisë së shkrimit arab. Qëndrimi i këtillë ndaj artit figurativ rrjedh si pasojë e monoteizmit të pakompromis të Kur'anit dhe ndalesës së tij të idhujtarisë.

Gati të gjitha motivet dekorative në artin islam janë marrë nga bota bimore dhe figurat gjeometrike. Në kaligrafinë dhe zbukurimin e mus'hafit, artistët islamë kanë arritur rezultate të mëdha, për të cilat flet dhe dëshmon jo vetëm historia, por edhe arti. Mus'hafi i parë, i cili gjatë kohës së Othmanit r.a. është kopjuar në gjashtë ekzemplarë, u shkrua me shkrimin kufian.

Me këtë shkrim, Kur'ani është shkruar plot katër shekuj, derisa me zhvillimin e kaligrafisë arabe u shfaq shkrimi i ri, i ashtuquajtur i “nes’h”. Lindja e shkrimit “nes’h” paraqet një hap përpara në zhvillimin e kaligrafisë së shkrimit arab.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Dr. Jusuf Ramiq, Dorëshkrimet, botimi i tekstit arab dhe përkthimi i Kur'anit në gjuhë të ndryshme të botës.

Kur'ani ka qenë dhurata më e çmuar që dikush ka mundur t'i dhurojë dikujt. Andaj, në kohërat e mëhershme para se të zbulohet makina e shkrimit, Kur'ani është përshkruar me dorë, duke përdorur mjetet më të përsosura të artit të asaj kohe. Andaj, shumë dorëshkrime të vjetra të asaj kohe në të gjitha vendet ku jetojnë myslimanët ruhen edhe sot. Studimi i këtyre dorëshkrimeve tregon, se me çfarë përkushtimi dhe durimi të madh është bërë një punë e tillë.

Kësaj radhe do të sjellim tre shembuj apo modele të vjetra të përshkrimit të Kur'anit nga tre vende të ndryshme të botës, ku do të shihet përkushtimi i madh që i është kushtuar artit të kaliografisë së përshkrimit të Kur'anit dhe vlera e madhe që ka si thesar i kulturës materiale dhe shpirtërore islame.

### Kopje e Kur'anit e vjetër 1.300 vjet

Një audit nga qyteti Abha<sup>2</sup>, në jug të Arabisë Saudite vite më parë ka lajmëruar se ai posedon njërën prej dorëshkrimeve më të vjetra të Kur'anit të shenjtë. Në faqen e parë të Kur'anit shënohet data i përshkrimit të tij, që është viti 116 hixhri (734), do të thotë para afro 1.300 vjetëve. Muhamed bin Naser Al-Kadri, pronar i këtij dorëshkrimi të rrallë, thotë se këtë ekzemplar të Kur'anit e ka blerë para disa viteve nga një njeri i moshuar, për të cilin ka paguar një shumë parash tepër të lartë. Dorëshkrimi është i mbështjellë me lëkurë, me kaliografi islame. Kjo kopje është shkruar me shkrim arab i njohur si shkrimi kursiv “nesëh”.

Drejtori i Qendrës për Studime Arkeologjike në Abha, Anvar Muhamed Al-Halil e përshkruan dorëshkrimin e Kur'anit si “të bukur”. “Unë nuk mund të them saktësisht se kur është shkruar. Për ta vërtetuar një gjë të këtillë ne duhet të ekzaminojmë në Qendrën e specializuar” kishte deklaruar Anvari.

Sipas të dhënave të specialistëve, dorëshkrimi është shkruar në një letër të zakonshme dhe nuk ka ornamente.

Një numër i madh i dorëshkrimeve të vjetra të Kur'anit, në tërë botën, ruhet në biblioteka, arkiva apo muze. Në bibliotekën e Xhamisë së Madhe në Sana' (Jemen) gjendet një ekzemplar i Kur'anit që supozohet se është shkruar me dorën e Ali ibnu Abu Talibit, Zejd ibnu Thabitit dhe Selman al-Farisiut. Është i shkruar me shkrimin kufik, pa vokale. Kur'ani është në dy pjesë, secila pjesë ka nga 150 faqe.

Biblioteka e Meshhedit në Iran ka 11.000 dorëshkrime të Kur'anit, që paraqet koleksionin më të madh të dorëshkrimeve të këtij lloji në botë.

UNESCO ka kompletuar një CD me më shumë se 40 dorëshkrime të Kur'anit, të cilat datojnë nga shekulli i parë i hixhretit me shkrimin e hixhazit dhe atë kufik.

### Kur'ani më i vjetër te boshnjakët

Orientalisti i njohur boshnjak Mehmet Mujezinoviç<sup>3</sup> në një vizitë që i bënte Bjelo Poles, në vitin 1972 ka shkruar: “Gjatë një vizite që i kemi bërë fondit të monumenteve islame në Bijelo Pole, në mes tjerash kemi evidentuar një ekzemplar të një dorëshkrimi të Kur'anit, i cili i përket shekullit trembëdhjetë. Ky dorëshkrim është i formatit të vogël, ka dimensionin 10x13 cm. Është i shkruar në letër të hollë me ngjyrë të verdhë me shkrimin “nes'h”. Para titullit janë dy faqe të zbukuruara me ornamente persiane të mbështetura në një bazë të kaltër. Dy faqet tjera, ku gjenden titulli dhe tekstet, në fillimin e dy sureve janë të dekoruara dhe kanë shumë ngjyra. Titujt e sureve, janë të shkruara me shkrimin “kufian”. Faqet tjera me tekste janë të dekoruara me ari me vija të zeza e të holla. Dorëshkrimi është i lidhur me kopertina prej lëkure me zbukurime në mes të faqeve.

Në faqen e fundit të dorëshkrimit gjejmë këto shënime të përshkruesit: “Me falënderimin e Allahut dhe ndihmën e Tij ka përfunduar përshkrimin e këtij Mus-hafi. Muhamedi i biri i Muhamedit, i biri Shirazisë, në Mosul (Irak), gjatë vitit gjashtëqind e dyzet e shtatë (647). Falënderimi i takon Allahut, kurse paqja dhe bekimi Muhamedit dhe familjes së tij”.

<sup>2</sup> Haj & Umra, volume 59, Issue 9, November 2004, p. 8.

<sup>3</sup> Elif, islamske novine, Podgorica, 9 maj 2006, s.9.

Viti 647 hixhri, kur është bërë përshkrimi i Kur'anit, data e të cilit është e shkruar me fjalë dhe me numra i përgjigjet viti 1249 sipas erës së re. Andaj, ky dorëshkrim i Kur'anit me një vjetërsi prej 751 vjetësh mund të konsiderohet Kur'ani më i vjetër në këto hapësira, thotë Mujezinoviq.

### Kur'ani më i vjetër në Kosovë

Shqiptarët tradicionalisht kanë treguar interesim të madh për kulturën materiale dhe atë shpirtërore në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre. Ky entuziazëm nuk ka munguar edhe në periudhën islame. Kështu nëpër bibliotekat e xhamive, teqeve, bibliotekat personale janë ruajtur dorëshkrime të vjetra, të krijuara nga autorë autoktonë, apo të ardhura nga qendra të ndryshme të botës islame.<sup>4</sup>

Për fat të keq ky thesar, për shkak luftërave të shumta, pakujdesisë, por edhe në një fazë të caktuar të historisë sonë, për shkaqe ideologjike është dëmtuar dukshëm. Andaj, është mirë që tash e tutje t'i kushtohet një rëndësi e duhur këtij thesari të trashëgimisë sonë kulturore e fetare. Të mos konsiderohet vetëm pjesë e trashëgimisë sonë fetare, por thesar i trashëgimisë sonë kombëtare dhe nacionale. Sipas hulumtimeve të deritanishme, në Kosovë ekziston një numër i konsiderueshëm i dorëshkrimeve të Kur'anit. Ato ruhen në Bibliotekën Qendrore të dorëshkrimeve në Medresenë e Mesme "Alauddin" në Prishtinë, në Bibliotekën Kombëtare Universitare, në teqe të ndryshme si dhe në biblioteka familjare. Kopja më e vjetër është përshkrimi i vitit 711 h (1311) sipas erës së re. Përshkruesi është Mustafa bin Nasuh. Është i zbukuruar me ornamente, i shkruar me shkrimin "nesëh". Prej datës së përshkrimit të këtij dorëshkrimi të Kur'anit kanë kaluar 698 vite që për rrethanat tona nuk është një periudhë e shkurtër. Andaj, ia vlen që në këtë aspekt të investohet sa më shumë në të ardhmen.<sup>5</sup>

<sup>4</sup> Libra të rrallë, Bblioteka ndërkomunale Prizren, Prizren, 2006, fq.77.

<sup>5</sup> Katalag i dorëshkrimeve arabe në Kosovë, Biblioteka Kombëtare e Universitare e Kosovës, Prishtinë, 2008, fq.12.

Qemajl Morina

## THE PRESERVATION OF ANCIENT MANUSCRIPTS OF THE QUR'AN

### (Summary)

The Qur'an is the holy book of Islam, revealed to Prophet Muhammad, in Arabic, over a period of 23 years. The Qur'an is the book of divine guidance for all those who believe in the word of God and want to live with it. It is a divine guidance for all those who stick to his teachings.

Muslims are constantly accompanied by the Qur'an. They read and study the Qur'an all the time. They use it in all their prayers. In brief, the Qur'an is part of their lives.

كمال مورينا

## الحفاظ على بعض المخطوطات القديمة للقرآن الكريم

### (خلاصة البحث)

القرآن الكريم هو كتاب الله أنزل على سيدنا محمد (صلم) باللغة العربية خلال فترة زمنية استمرت 23 عاما. و القرآن الكريم جاء هداية لكافة الناس الذين يؤمنون به و يودون ان يعيشوا في ظله.

المسلمون باستمرار هم في صحبة القرآن الكريم. هم يقرأونه باستمرار صباحا و مساء لانه كتاب هداية و عبادة بالنسبة لهم. هم يستخدمونه في الصلوات الخمس و بقية العبادات. يمكن القول باختصار بانه جزء من حياتهم اليومية.

*James Pavlin*

## KELAMI SUNNIT DHE KONTRAVERSET TEOLOGJIKE

Çështja e kelamit është e gjerë dhe përfshin shumë tema. Në pajtim me këtë, përgjigjja ortodokse (besimdrejt) për kelamin është e ngarkuar dhe diversitive. Që të përqendrohemi në vetë thelbin e përgjigjes ortodokse, metodologjinë dhe synimet e tij, është i domosdoshëm fokusimi në disa çështje të mëdha kontestuese teologjike në Islam. Në përgjithësi, këto çështje kanë të bëjnë me natyrën e Zotit dhe cilësitë e Tij. Kjo temë inkadron nocionet sikur të Folurit e Zotit, që është e lidhur për besimin në jokrijueshmërinë e Kur'anit dhe vullnetit të Zotit, që është e lidhur për besimin në krijueshmërinë e botës. Pjesa e komplikuar e këtyre kundërthënieve është metodologjia me të cilën shpjegohet natyra e Zotit. *Mutekel-lim*-ët besojnë se ajetet e Kur'anit të cilat kanë të bëjnë me atributet e Zotit duhet të komentohen nëpërmjet argumentimit të bazuar në të dëshmuarit logjik. Ky qëndrim mori formën e përkrahjes së mohimit të realitetit të attributeve, sikur është rasti me mu'tezilitët, apo të mbrojtjes së domethënies së tyre të kufizuar, sikur që është rasti me esh'aritet. Në këtë kapitull do t'i përcjellim besimet e ndryshme lidhur me cilësitë e Zotit në mënyrë që

t'i kuptojmë problemet e ndryshme lidhur me kundërshtimet ndaj *kelamit* në shkollat e caktuara të mendimit ortodoks islam.

Dijetarët ortodoksë islamë, duke filluar me as'habët e Pejgamberit a.s., e kanë ruajtur besimin në qartësinë e Kur'anit të bazuar në ajetin e shtatë të sures së tretë. Ky ajete thotë se Kur'ani përmban ajete të qarta legjislative, të cilat besimtarët i pranojnë pa pyetje. Ajete, më tej, thotë se vetëm ata që kanë lajthitje në zemra dhe të cilët dëshirojnë kundërshtim përpiqen t'i komentojnë ato ajete alegorike. Nëse i vështrojmë qëndrimet e dijetarëve më të vjetër ortodoksë, do të shohim se të gjitha njoftimet në Kur'an dhe në hadithin autentik, të cilat kanë lidhje me atributet e Zotit, bëjnë pjesë në kategorinë e ajeteve të paqarta dhe alegorike. Ky besim që ka lidhje me cilësitë e Zotit është i shpjeguar me thënien e Imam Malik ibn Enesit (vd. 179/795) të cilën e shprehi si përgjigje në pyetjen për të qenit e Zotit në Fron. Tha se ngjitja e Zotit në Fron është mirë e njohur, por si ka ndodhur ajo, kjo nuk është e kuptueshme, dhe se besimi në të është detyrues kurse shtruarja e pyetjeve për këtë është novotari (al-Saqa 1988)<sup>1</sup>. Edhe pse Imam Maliku foli për të qenit e Zotit në Fron, pohimi i tij është i vlefshëm për të gjitha atributet e Zotit sikur që janë Të Folurit, Dija, Mëshira, Dashuria, Të Parit, Të Dëgjuarit ose cilat do të tjera të përmendura në Kur'an dhe hadith.

Njëra nga kundërthëniet më të hershme teologjike në Islam, e cila e ka formësuar bazën për zhvillimin e kelamit, i përket komentimit të cilësive të Zotit. Burimet myslimane e gjejnë këtë kundërshtim në kohën e Xha'd ibn Dirhemit dhe nxënësit të tij Xhehm ibn Safvanit (vd. 127/745) dhe Vasil ibn Atait (vd. 130/748). Në literaturën ortodokse pikërisht Xhehm ibn Safvani është parë si themelues i *kelamit*, kurse termi jo plotë i qartë i xhehmitëve lidhet për të gjitha shkollat të cilat e përdorin kelamin. Këto argumente të reja të hershme kyçin probleme të ndryshme sikur që janë biseda e Zotit me Musain a.s. dhe pozita e hazreti Aliut, Muaviut dhe pasuesve të tyre pas arbitrazhit në Betejën

<sup>1</sup> Ahmad Hijazi al-Saqa, In his introduction to Ibn Taymiyyah Sihhah usul madhhab ahl al-madinah (Cairo, 1988).

e Siffinit. Me kohën, këto argumente janë zhvilluar në diskutime teologjike të cilat i përkasin domethënies së *tewhidit* (Njësisë së Zotit dhe natyrës së attributeve të Tij, sikur edhe domethënies së *imanit* (besimit) dhe përkufizimit të besimtarit. Edhe pse shkaqet nuk janë krejt të qarta, nocionet *kelam* dhe *mutekel-limun* kishin të bënin me ata të cilët merren me çfarëdo forme të spekulimit që ka të bëjë me Atributet e Zotit.

Cytja kryesore për përdorimin e *kelamit* erdhi si ndikim i filozofisë greke dhe logjikës të cilat e gjetën vendin e tyre në mendimin mysliman. Meqenëse përdorimi i *kelamit* mori hov të fuqishëm gjatë sundimit të halifit abasit El-Me'munit (vd. 220/833), i cili haptazi i përkrahte mu'tezilitët, u shfaq kundërpërgjigje e fortë ndër dijetarët tradicionalistë i orientuar ndaj metodave të *kelamit*, por edhe ndaj shumë përfundimeve deri te të cilat erdhën *mutekel-limunët*.

Mu në krye të këtyre kundërpërgjigjeve në komentimin e ajeteve alegorike, të cilat dijetarët ortodoksë i shohin si mohim të attributeve të Zotit, qenë dijetarët e hadithit apo tradicionalistët, sikurse Imam Ahmed ibn Hanbeli (vd. 245/855) dhe Muhammed ibn Ismail Buhariu (vd. 256/870). Ibn Hanbeli ka prirë sulmin në pohimin e mu'tezilitëve se Kur'ani është i krijuar e jo atribut i amshueshëm i Zotit. Ibn Hanbeli është mbështetur në besimin se Zoti ka atributin e amshueshëm të folurit dhe se Kur'ani ka qenë pjesë e kësaj. Dëshmia e tij për këtë është ajeti në Kur'an, i cili thotë se Zoti ka folur me Musain. Argument i veçantë për të ka qenë se fjalët e Kur'anit të cilat njerëzit i shprehin apo i shkruajnë nuk janë të amshueshme por Kur'ani është pjesë e atributit të amshueshëm të folurit të Zotit. Këtë sulm tradicional mbi *mutekel-limunët* e ka vazhduar studenti i imam Ahmedit, Buhariu, i cili e hartoi përmbledhjen e haditheve, e cila konsiderohet më autentike në Islam.

Në shpjegimin e tij në librin e fundit të përmbledhjes së hadithit të Buhariut, e njohur si "Libri i *tewhidit*" (Kitab'ut-tewhid), Ibn Haxheri El-Askalani (vd. 852/1456) thotë se njëri prej synimeve bazore të këtij libri është përgënjeshtrimi i mu'tezilitëve me tubimin e thënieve autentike të Muhammedit a.s., të cilat kanë të bëjnë me atributet e

Zotit (El-Buharij, pa vit botimi; Ibn Haxheri, pa vit botimi)<sup>2</sup>. Së këndejmi, me shfrytëzimin e ajeteve kur'anore dhe të haditheve autentike, tradicionalistët kanë theksuar njëmendësinë e emrave dhe attributeve të Zotit pa pyetjen se si ekzistojnë ata tek Ai. Në këtë mënyrë është formuluar fotografia e plotë për natyrën e Zotit. Për shembull, është theksuar se Zoti ka Qenien (Dhat) dhe Unin (Nefs), se ka 99 emra të bukur, se është i lidhur me krijesat e Veta me veprim dhe me Fjalë, se i di të gjitha gjerat dhe e dëshiron çdo gjë që është futur në ekzistencë dhe se është jashtë të perceptuarit kurse mund të njihet vetëm me përshkrimin të cilin Ai e ka shpallur. Për tradicionalistët kjo është pranuar duke u bazuar në mospyetje mbi mënyrën e ekzistimit të attributeve të Zotit. Në përmasa të ndryshme, dijetarët myslimanë janë ngritur në mbrojtje të ortodoksisë dhe në këtë veprim shumë prej tyre kanë huazuar argumente pikërisht të *kelamit* dhe të filozofisë, në mënyrë që ta përkrahin (doktrinën) mbi njëmendësinë e attributeve hyjnore.

Një nga dëshmitë bazike që ka të bëjë me *kelamin* është korrektësia e logjikës si mjet për të arriturit e së vërtetës. Shembulli më i mirë i kësaj është debati i njohur i mbajtur, si transmetohet, në Bagdad në shekullin e IV-X të hershëm ndërmjet logjikut krishterë me emrin Ebu Bishr Metta ibn Junus (vd. 328/940) dhe filologut mysliman, i cili quhej Ebu Seid Es-Sirafi (vd. 368/979). Thelbi i kontraverses qëndron në çështjen se a është logjika mjet universal i të shprehurit apo vetëm instrument i kufizuar në gjuhën greke (Chejne, 1984; Margoliouth 1905).<sup>3</sup> Shumë tradicionalistë e përkrahin qëndrimin se logjika është produkt i gjuhës greke dhe se për të nuk ka vend në gjuhën arabe as që ka çfarëdo vlere për Islamin. Ky qëndrim ka mbërritur përfundimin skajor se logjika shpie në pafe. Është thënë se kushdo që merret me logjikë merret me herezi (*men tementeka tezendeka*). Nga ana tjetër, është formuar mendimi se logjika është instrument ose dituri e domosdoshme, e cila siguron rregulla të të menduarit korrekt dhe mund të përdoret në rrugën e arritjes të së vërtetës. Njëri ndër dijetarët që e ka

<sup>2</sup> Al-Bukhari, Sahih al-Bukhari, Arabic-English, 9, trans. Muhammad Muhsin Khan (Medina). Ibn Hajar, Fath al-bari, 13 (Beirut).

<sup>3</sup> Chejne (1984): 60. A translation of the debate appears in Margoliouth (1905).

përdorur logjikën si mjet të mbrojtjes së besimit ortodoks ishte Ibn Hazm El-Endelusi (vd. 456/1064). Edhe pse i konsideruar si dhahiri, për ç'arsye shumë seriozisht e kanë kritikuar dijetarët tjerë sunnitë, qëndrimet e Ibn Hazmit të cilat i përkasin zhvillimit të sekteve i kanë cituar shumë tradicionalistë. Për shembull, Ibn Haxheri thirret në vepërën e lavdishme të Ibn Hazmit *El-Fisal fi'l-milel ve'l-ehwa ve'n-nihal*, në hyrjen e tij në *Kitab'ut-tewhid* të Buhariut. Me rëndësi të veçantë për diskutimin tonë është fakti se Ibn Hazmi ka përkrahur mendimin e domosdoshmërisë së logjikës, por edhe rolin e saj nënshtrues në raport me Shpalljen.

E para, Ibn Hazmi pohon se “burimet e para të njohjes së gjithmbarshme njerëzore janë shqisat dhe intuitat e arsyes korrektësisht të shfrytëzuara, të bashkuara me perceptimin korrekt të gjuhës.” (Hourani, 1979).<sup>4</sup> Vetëm atëherë kur nxënësi është i aftë ta dijë çka është kjo dëshmia e qartë si kundërshti e argumentimit jokorrekt, ai apo ajo mund ta arrijnë “njëmendësinë e gjerave, dhe ... ta dallojnë gënjeshtren pa pikë dyshimi.” (Chejne, 1984).<sup>5</sup> Atëherë studenti mund të fillojë me mbrojtjen e pohimeve kur'anore pa kthim në argumentim që sillet në rreth. Ibn Hazmi mëson se personi duhet të besojë në Shpallje por edhe të jetë i gatshëm ta mbrojë në bazë të dëshmive bindëse dhe argumenteve të qarta. Por, që ta përkrahë këtë metodologji, Ibn Hazmi është dashur t'u përgjigjet kundërshtarëve të logjikës. I kundërshtuar nga argumenti se brezi më i vjetër i myslimanëve as nuk është marrë as që ka pasur nevojë për logjikë, Ibn Hazmi përgjigjet me pohimin se ata kanë pasur akses të drejtpërdrejtë në Shpallje dhe se besimi i tyre nuk ka qenë i shtrembëruar me doktrina jokorrekte. Ai e krahason përdorimin e logjikës me nevojën për librat e gramatikës dhe të leksikografisë. Kur gjuha arabe filloi të shtrembërohet, dijetarët shkruan libra në mënyrë që ta ruajnë pastërtinë. Ngjashëm, myslimanët e mëvonshëm kanë nevojë për logjikën që ta ruajnë të kuptuarit përkatës të Shpa-

lljes së Zotit për Pejgamberin a.s. Për këtë arsye për Ibn Hazmin logjika bëhet instrument i Shpalljes.

Detyra themelore e Ibn Hazmit ishte përgënjeshtrimi i asaj që e përjetonte si skajshmëri të filozofëve dhe mutekel-limunëve. Në këtë rast ka dashur të tregojë se logjika nuk mund ta zëvendësojë Shpalljen si mjet për arritjen e së vërtetës, por mund të përdoret vetëm si mjet për mbrojtjen e asaj që Zoti i dashur e ka shpallur. Ai këtë e arrin me theksimin e natyrës unike dhe të pakrahasueshme të Zotit dhe me refuzimin e çdo tentimi të përshkrimit Zotit të çdo përfundimi nga bota shqisore të fituara me anë të rrugës logjike. Për shembull, nëse dikush e përshkruan raportin ndërmjet shkaktit dhe pasojës si domosdoshmëri të bazuar në kundërimin e kësaj bote, këtë raport nuk mund ta aplikojë edhe mbi Zotin. Të pohohet diç e tillë do të thotë të shkatërrohet ideja e tewhidit, sepse shqiptimi i tillë konstituon domosdoshmërinë e raportit ndërmjet Zotit si Krijues dhe krijesave të Tij. Kjo po ashtu e lëndon lirinë e vullnetit të plotë të Zotit të bëjë si të dojë dhe kur të dojë. Për Ibn Hazmin ekziston humnera e pakalueshme ndërmjet asaj që ekziston në kohë si krijesë e Zotit dhe amshueshmërisë së Zotit. Ibn Hazmi sulmon metafizikën e përvetësuar të Aristotelit, të cilën e kanë mësuar filozofët myslimanë. Zoti në tërësi është i pakrahasueshëm me çdo gjë të krijuar. Së këndejmi, nuk mund të spekulohet për Zotin as t'i kundërvihemi të vërtetave të cilat ai i ka shpallur në Kur'an.

Problemi i dytë që ka të bëjë me atributet e Zotit është problemi i vullnetit të lirë. Ibn Hazmi sërish përdor logjikën në mënyrë që t'i mbrojë qëndrimet tradicionale. I kundërvihet pohimit mu'tezilit që vendimet morale dhe etike duhet të jenë të bazuara në arsye, qoftë edhe në dëm të pohimit kur'anor. Kjo do të thotë, nëse arsyeja imponon se vepra e caktuar është e mirë apo e keqe, ky përcaktim do të pranohet në tërësi si korrekte qoftë kjo edhe e kufizon veprimin e Zotit. Por, sipas Ibn Hazmit, kategoria e të mirës dhe së keqes, shpërblimit dhe ndëshkimit, nuk janë të domosdoshme dhe nuk e kufizojnë veprimin e Zotit. Po ashtu, Ibn Hazmi pohon se shpirti njerëzor emocional (nefs), i lënë vetvetes, do t'i kthehej së keqes dhe se nuk ka shpëtim nëse pa-

<sup>4</sup> Hourani (1979): 143.

<sup>5</sup> Chejne (1984): 64.



son vetëm arsyen pa ndihmën e Shpalljes. Së këndejmi, në kundërshtim me mësimin mu'tezilit, Ibn Hazmi mëson se njerëzia në tërësi ka nevojë për mëshirën e Zotit, në mënyrë që ta arrijë mirësjelljen dhe shpërblimin, kurse vetë arsyeja do të na linte në dyshim. Ibn Hazmi nuk heziton të pohojë se të gjitha gjerat, do të thotë, fati i çdo personi varet nga mëshira e Zotit. E refuzon doktrinën mu'tezilite mbi vullnetin e lirë të bazuar në komentimin e ajetit kur'anor, i cili thotë se e mira vjen nga Zoti kurse e keqja nga njeriu (6, 81). Ibn Hazmi thekson se Zoti së pari e ka theksuar se të gjitha gjerat vijnë nga Ai. Për këtë arsye çdo e keqe e cila na ndodh ka ardhur prej Tij, sepse "e meritojmë ndëshkimin për të keqen morale e cila sikur vjen prej nesh si subjekte të tij." (Hourani, 1979).<sup>6</sup> Veprimi i Zotit bazohet në Urtësinë dhe Drejtësinë e Tij, të cilat ne thjesht nuk mund t'i kuptojmë. Sa i përket natyrës të së mirës dhe së keqes Ibn Hazmi mëson pavarësinë e plotë të Zotit dhe të Vullnetit dhe Fuqisë së Tij në raport me të gjitha gjerat.

Ibn Hazmi ka tentuar ta përshkruajë dhe përkufizojë pozitën e njeriut në raport me atë që Zoti e ka shpallur dhe atë që njerëzia e ka menduar. Për të kjo është dashur të ndodhë me ndërmjetësimin e Islamit dhe logjikës. Theksimi i ndërvarësisë të të gjitha njohurive tregon besimin e tij në unitetin e të gjitha gjerave nën Vullnetin dhe Udhëzimin e Tij. Shpallja e Kur'anit dhe Sunneti i Muhammedit a.s. ofrojnë parimet e udhëzimit për besim dhe mirësjellje morale. Zoti na thotë kush është Ai, cili është synimi ynë dhe cilën rrugë duhet ta ndjekim në mënyrë që t'i kthehemi. Filozofia, d.t.th., studimi i botës së natyrës dhe të menduarit logjik, na ofron perceptimin e asaj që e ka krijuar Zoti dhe fuqive(?) racionale me të cilat ne shërbehemi. Megjithatë, Ibn Hazmi ka pasur akses refuzues ndaj të gjitha shkollave religjioze dhe filozofike të kohës së tij, që solli deri te vetmia e tij brenda bashkësisë së besimtarëve. Ndjekja e detyrueshme e medhhebit maliki në Andaluzi, bëri ndalimin e veprave dhe besimeve të tij. Për shkak të kësaj, lloji i sintetizmit drejt secilit ka synuar nuk ka mundur të sendërtohet derisa Gazaliu (vd. 505/1111) nuk i formuloi idetë e ngjashme

<sup>6</sup> Hourani (1979) 150.

brenda kufijve të së mundshmes në Islamin sunit. Megjithatë, kontributi i plotë i Ibn Hazmit në këtë lëvizje intelektuale është vlerësuar pak dhe meriton diç më shumë kujdes.

Për dallim nga Ibn Hazmi, i cili qe kufizuar në vendet perëndimore islame, Gazaliu qe dijetar ortodoks që veproi në zemrën politike dhe intelektuale të botës islame. Pas udhëtimit të gjatë shpirtëror dhe intelektual nëpër filozofi dhe ezoteri, Gazaliu më në fund pranoi dhe mbrojti ortodoksinë si e kuptoi rrjedha kryesore e esh'arizmit. Ndonëse jo aq fundamental në komentimin e attributeve të Zotit sikurse tradicionalistët, esh'aritët kanë mbrojtur njëmendësinë e cilësive hyjnore, pjesërisht nëpërmjet argumentimit filozofik. Së këndejmi, që ta mbrojtë ortodoksinë Gazaliu është detyruar t'i kundërshtojë filozofët myslimanë të cilët zhvilluan konceptin neoplatonik të Zotit si shkakun e parë nga i cili emanon universi.

Ngjashëm me Lëvizësin e Palëvizshëm të Aristotelit, shkakun i parë apo shkakun i pashkaktuar i filozofëve myslimanë është kuptuar si shpjegimi i vetëm logjik, në mënyrë që të shmanget regresioni i pafund shkakësor (kthimi i përherëshëm në shkakun e shkakut). Në pajtim me idenë e të përkryerit, Absolutit, i cili është shkakuar i të gjitha ekzistimeve, filozofët myslimanë zhvilluan përshkrimin e Zotit, i cili pajtohet me përkufizimet e ngurta filozofike të atij që Një duhet të jetë. Ky përkufizim i Një-shit filloi me El-Kindiun (vd. 259/873), i cili me nocionin I Vërteti i Vetmi (el-vâhid'ul-hakk) e ka quajtur Zotin. El-Kindiu thotë se I Vërteti i Vetmi nuk duron shumësi të çfarëdo lloji në ekzistimin e Tij dhe për këtë arsye është i pastër nga çdo atribut. Ekzistimi i Një-shit është i domosdoshëm kurse njëshmëria e Tij e përkryer është shkak i të gjitha ekzistimeve në këtë botë. El-Kindiu mëson se koha është e përkohshme dhe se të gjitha lëvizjet dhe koha janë shkakuar nga I Vetmi i Vërteti. (al-Kindi, 1953; Ivry 1974).<sup>7</sup> Ky qëndrim që shkon kah temporaliteti i botës është ndryshuar me argumentet e El-Farabiut (vd. 338/950), kontributi themelor i të cilit është

<sup>7</sup> Ya'qub ibn Ishaq al-Kindi, Fi al-falsafat al-ula, in Rasa'il al-Kindi al-falsafiyah, ed. M. A. Abu Ridah (Cairo 1953): 98-126; Ivry (1974).

teoria e emanacionit (fajd). (al-Farabi, 1985).<sup>8</sup> Ky hap mund të kuptohet si pranim edhe më i plotë i neoplatonizmit, të cilin e mësuan filozofët myslimanë. El-Farabiu Zotin e quan si Ekzistuesi i Parë (el-mewxhûd el-ewwel) ekzistimi i të cilit është i domosdoshëm dhe i paster nga mangësitë apo shumësitë. Ai e përvetëson skemën emanacioniste në të cilën Ekzistuesi i Parë e shkakton ekzistimin e jotruporit Të Dytë, i cili atëherë fillon të mendojë për ekzistimin e tij dhe për të parin. Kjo e emanon të Tretin, i cili vazhdon me procesin derisa ekzistimi i botës subluare nuk hyn në ekzistim. El-Farabiu ka shumë kujdes kur pohon se emanuimi i të Dytit dhe të të gjithëve që pasojnë, nuk i shton asgjë të Parit as që i mungon. Përfundimisht, Ibn Sinai më tej i konkretizon idetë filozofike për Zotin duke e quajtur Zotin si Domosdoshmëri të Ekzistencës (vâxhib'ul-vuxhûd) (Ibn Sina 1981; Hourani 1972).<sup>9</sup> Ibn Sinai Domosdoshmërinë e ekzistencës e vendos kundrejt Mundshmërisë së Ekzistencave (munkin'ul-vuxhud) që të tregojë se Domosdoshmëria e Ekzistencës duhet pa tjetër të jetë e pashkaktuar në mënyrë që të shmanget regresioni shkakësor i pafund. Krahësimit të zakonshëm aktual se Një nuk ka shumësi të çfarëdo lloji, Ibn Sinai më tej e kthjellon përshkrimin e Zotit duke folur se “cilësia e Tij është natyra e Tij individuale”. (Hourani 1972).<sup>10</sup> Ai thotë se nëse ekzistenca i Zotit nuk do të ishte Esenca e Tij e vetme e vërtetë, ekzistenca e Tij atëherë do të ishte aksidencë e shtuar njëmendësisë së Tij. Kjo i kundërvihet domosdoshmërisë së ekzistencës së Tij, sepse çdo aksidencë të shtuar njëmendësisë së Tij do të kishte nevojë për shkak. Ibn Sinai pastaj e ka zhvilluar teorinë e emanacionit të bazuar në konceptin e domosdoshmërisë së ekzistencës.

Gazaliu është dashur t'i kritikojë dhe përgënjeshtrojë këto përfundime të cilat i menduan filozofët. Në veprën e tij *Tehafut'ul-felasifeh* ai përpiket t'i mbrojë qëndrimet më ortodokse të esh'arizmit duke dëshmuar me demonstrim filozofik se si besimet e filozofëve nuk qenë të domosdoshme dhe në fakt shpesh kanë qenë kundërtëne. (Ka-

mali 1963; al-Ghazzali 1965).<sup>11</sup> Në kapitullin e parë mjaft të gjatë mbi çështjen e amshueshmërisë dhe temporalitetit të botës, Gazaliu ofron shumë shembuj dhe argumente që ta mbështesë qëndrimin se krijimi i botës në kohë është logjik dhe racional. Duke e konstatuar kriterin i cili duhet të përdoret për nocionet dhe përkufizimet të cilat kanë të bëjnë me diskutimin mbi natyrën e Zotit, argumenton se filozofët kanë mundësi të dëshmojnë moskorrektësinë e rivalëve të tyre, sepse nuk lëvizin brenda kufijve të premisave dhe aksiomave të miratuara. Kjo bëhet e qartë kur shohim përgënjeshttrimin e Ibn Sinait nga Gazaliu në çështjen e krijueshmërisë së botës në kohë.

Gazaliu e pranon domosdoshmërinë e Zotit si Shkaktarit të Parë, sepse regresioni i pafund shkakësor logjikisht është i pamundshëm. Megjithatë, thotë se Domosdoshmëria e ekzistencës së Zotit si Shkaktarit të Parë nuk do të thotë se funksioni i Tij i Shkaktarit të Parë është domosdoshmërisht e amshueshëm. Në vend të kësaj ai thotë se Zoti posedon Vullnetin hyjnor i cili është identik me Esencën e Tij. Me këtë vullnet Ai ka mundur ta iniciojë krijimin kurdo që ai të dëshirojë. Filozofët kritikojnë se vullneti dhe objekti i tij duhet domosdoshmërisht të ekzistojnë së bashku dhe se ndarja ndërmjet atij që dëshiron dhe ekzistencës së objektit të tij domosdoshmërisht kërkon vendosmëri të re të atij kush dëshiron e cila(i cili) i mundëson ta kyçë objektin në ekzistencë pikërisht në atë kohë konkrete. Në raport me Zotin kjo do të thotë se Ai nuk është i përkryer në Vullnetin e tij, por ka nevojë përtribute të reja, në mënyrë që ta arrijë atë që e dëshiron. Kjo, natyrisht, është krejtësisht e pamundur. Gazaliu thotë se filozofët janë joparimorë në përdorimin e përkufizimeve dhe nocioneve që kanë të bëjnë me natyrën e Zotit dhe shton se ata e barazojnë Vullnetin e Zotit me vullnetin njerëzor, sepse Zoti nuk mund të krahasohet me asgjë pikërisht në bazë të pohimeve të tyre. Si dëshmi ai e thekson diskutimin e tyre për Dijen e Zotit. Pohojnë se Zoti në Dijen e Tij i di universalitë, por pa ekzistimin e çfarëdo partikulare. Megjithatë, nëse dikush e krahason Dijen e Zotit me dijen njerëzore, duhet të thotë se te Zoti ek-

<sup>8</sup> Al-Farabi (1985): 89.

<sup>9</sup> Ibn Sina (1981): 16; Hourani (1972): 77.

<sup>10</sup> Hourani (1972): 78.

<sup>11</sup> Kamali (1963); Al-Ghazali (1965).

ziston shumësia sikur që ekziston te të gjithë njerëzit. Filozofët i shmangen kësaj analogjie duke thënë se Dija e Zotit nuk mund të kuptohet me nocionet e dijes në të krijuar në kohë. Gazaliu mëson se nëse Dija e Zotit është unike, ashtu duhet të jetë edhe Vullneti i Tij. (Kamali 1963).<sup>12</sup> Së këndejmi, duke e ndërruar fokusin e debatit, Gazaliu ka mundësi të tregojë vetëshkatërrimin e argumenteve të filozofëve.

Gazaliu vazhdon me këtë mënyrë të argumentimit lidhur me njohjen e Zotit të partikularive. Filozofët e mohojnë idenë se Zoti e di çdo send individual për dy arsye. E para, të njihet gjëja individuale do të thotë të përcillen kualitetet e saj të posaçme nëpërmjet shqisave. Meqenëse këto attribute nuk janë pjesë e Qenies së Zotit, Ai nuk mund t'i ndërrojë individualitetet. E dyta, rrjedha e njohjes së njohësit të së njohurës nënkupton shumësi në veprim dhe në njohjen e gjerave të njohura. Sërish, vetëm mund të thuhet se Zoti është Një, në Të cilin nuk ka më shumë dhanshmëri. Çdo paralajmërim se Zoti ka nevojë për diç për Ekzistimin e Tij nëpërmjet raportit të ndërvarur me diç tjetër që nuk është Ai, duhet të refuzohet. Për këtë arsye, teoria e Ibn Sinait për njohjen e Zotit të partikularive në vete ka probleme serioze për shkak të të cilave përpiqet të gjejë harmoni ndërmjet qëndrimeve filozofike dhe teologjike për këtë çështje. Ndoshta në tentim për t'i pajtuar teologët ortodoksë, Ibn Sinai përmend ajete kur'anore në mënyrë që të tregojë se Zoti i njeh të gjitha gjerat, madje edhe peshën e atomit. (Ibn Sina, 1960; Marmara 1962).<sup>13</sup> Megjithatë, ai këtë më përfërsisht e përcakton duke thënë se Zoti i njeh partikularitë "aq nëse ato janë universale" apo "në mënyrë universale". (Marmara, 1962).<sup>14</sup> Shpjegimi i tij të këtyre dy frazave është i bazuar në supozimin se Zoti është intelekt i pastër. Së këndejmi rrjedha epistemologjike që paraqitet te njerëzit jo vetëm që është i paaplikueshëm kundrejt Zotit por, në fakt, është krejtësisht i kundërt.

<sup>12</sup> Kamali (1963): 19-20.

<sup>13</sup> Ibn Sina (1960): 359; marmura (1962): 304; Qur'an, 10:61; 34: 3.

<sup>14</sup> Marmura (1962): 300.

Para se të fillojë ta kritikojë teorinë e Ibn Sinait, Gazaliu e përmbledh qëndrimin ortodoks në çështjen e natyrës së Zotit. Pohon se myslimanët e kuptojnë botën të krijuar në kohë, vetëm Zoti dhe atributet e Tij janë të amshueshme dhe se çdo gjë përveç Tij Ai i ka krijuar me Vullnetin e Vet. Për këtë arsye çdo gjë e domosdoshme është e njohur për Të sepse objekti i vullnetit duhet të jetë i njohur për atë kush dëshiron diçka. Kështu, kur njëherë është konfirmuar se Ai është Dëshirues i cili di, duhet të pranohet se Ai është (edhe) domosdoshmërisht i Gjalli, sepse çdo qenie e gjallë e di tjetrin përveç vetes. Në këtë mënyrë myslimanët e dinë se Zoti e di universin, sepse Ai e ka krijuar me Vullnetin e Tij. (Gazali 1965; Kamali 1963).<sup>15</sup> Filozofët nuk mund ta kenë sigurinë e tillë për shkak të besimit të tyre në amshueshmërinë e botës. Kështu Gazaliu i nxit të dëshmojnë se Zoti i njeh të tjerët përveç Vetes por me parimësinë e njëkohësishme në qëndrimet e tyre.

Në kritikën e tij drejtuar Ibn Sinait, Gazaliu përqendrohet në çështjen e Vullnetit dhe Dijes së Zotit. Pohon se nëse Ibn Sinai mbetet konsekuent në besimin e tij se Zoti nuk ka vullnet dhe se emanacioni është akt i domosdoshëm, atëherë duhet ta pranojë se Zoti nuk ka dije për tjetrin. Gazaliu e bazon pohimin e tij në argumentin se njohja e veprës është e domosdoshme vetëm në rastin e veprimit vullnetar. (Gazali 1965; Kamali 1963).<sup>16</sup> Për këtë, nëse dikush pohon se universi domosdoshmërisht emanon nga Zoti pa Vullnetin apo pa Zgjidhjen e Tij, sikur që drita vjen nga Dielli dhe nuk kërkon njohjen e veprës nga ana e Zotit. Gazaliu ngjashëm refuzon edhe këtë pohim për shkak se Dija e Zotit është Esenca e Zotit dhe ky është shkak i çdo gjëje që ekziston, kurse që nënkupton se Zoti e di pasojën shkaktar i së cilës është Ai. Sërish pohon se Ibn Sinai është jokonsekuent me besimet e filozofëve të tjerë dhe me atë që vetë e thotë për emanimin e universit. Për më tepër, edhe nëse do të pranohej se Zoti e di atë shkak i së cilës është Ai, të gjithë filozofët pajtohen se veprimi i Tij është një dhe se nga Ai vjen vetëm një, do të thotë, Inteligjenca e Parë. Çdo gjë

<sup>15</sup> Tahafut al-Falasifah, p. 198; Kamali,(1963): 143.

<sup>16</sup> Tahafut al-Falasifah, p. 200; Kamali,(1963): 164.

tjetër rrjedh nga Inteligjenca e Parë dhe vetëm tërthorazi vjen nga Zoti nëpërmjet ndërmjetësimit. Nuk është e domosdoshme që Zoti t'i njohë të tjerat përveç Inteligjencës së Parë. Nëse emanuimi është akt i domosdoshëm, atëherë nuk është e domosdoshme njohja e pasojave nga ana e Zotit. (Gazali 1965; Kamali 1963).<sup>17</sup> Madje edhe për veprimin vullnetar kërkohet dija vetëm për lëvizjen e parë dhe jo vetëm për pasojat e tërthorta. Sipas Gazaliut, të gjitha ekspozetë dhe dëshmitë të cilat i shprehën filozofët janë të bazuara në premisat e padëshmuara. Teoria e përgjithshme së pari duhet të përvetësohet dhe vetëm atëherë mund të shtrohen dëshmitë. Megjithatë, të gjitha nocionet qartë duhet të përcaktohen në mënyrë që ekspozetë të veprojnë. Logjika e brendshme e sistemit vetvetiu nuk është dëshmi e vlefshmërisë së sistemit. Filozofët myslimanë kanë përvetësuar teori dhe përkufizime të filozofëve grekë dhe pastaj i kanë vendosur besimet islame në suazën filozofike greke. Gazaliu ka pranuar parimet themelore të besimit ortodoks islam dhe pastaj ka treguar dhe këta parime nuk mund të kontestohen në mënyrë filozofike.

Ibn Hazmi dhe Gazaliu me vetëdije janë orvatur ta përdorin argumentimin logjik, në mënyrë që t'i mbrojnë besimet ortodokse. Në këtë rrjedh, ndërkaq, janë veçuar nga aksesit ortodoks i diskutimit mbi atributet e Zotit. Për dijetarët e hadithit, çështja ka qenë fundamentale: Shpallja është sipërore, arsyeja duhet t'i nënshtrohet. Në kundërshtim me argumentet e Gazaliut dhe të tjerëve, tradicionalistët kanë vazhduar të diskutojnë për miratimin e plotë të Shpalljes së Zotit pa shmangie për cilën do formë të kelamit. Megjithatë, edhe tradicionalistët kanë zhvilluar argumente shumë më komplekse në mënyrë që t'i përkrahin bindjet e tyre themelore në attribute pa pyetje mbi mënyrën e ekzistimit të tyre. Dy dijetarë të periudhës së mëvonshme klasike islame meritojnë kujdesin tonë për shkak të mbrojtjes së tyre këmbëngulëse të tradicionalizmit. Këta janë Muveffakuddin Ibn Kudame (vd.620/1223) dhe Tekijjudin Ibn Tejmiye (vd. 728/1328). Edhe pse të dytë i janë qasur çështjes së kelamit dhe attributeve të Zotit, në pajtim me prejar-

dhjen e tyre hanbelite, do të përqendrohemi në qëndrimet e tyre të veçanta në mënyrë që të fitojmë qëndrimin e përgjithshëm të besimit tradicionalist.

Në përgënjeshttrimin e tij të lavdishëm të *kelamit*, *Tahrim'un-nadhar fi kutubi ehl'il-kelam*, në gjuhën angleze i përkthyer me titullin *Kritika e teologjisë spekulative* (Censure of Speculative Theology), Ibn Kudame theksoi nëntë pika për shkak të cilave *kelami* duhet të eliminohet. (Ibn Kudame).<sup>18</sup> **E para** fillon me ajetin e shtatë të sures së tretë dhe pohon se Zoti e ndërlidh pasuesin e komentimit alegorik (te'vil) me ata të cilët kërkojnë fatkeqësi dhe lajthiten. Për këtë Zoti e ka ndaluar komentimin e tillë. Ibn Kudame këtë e kupton si ndalim të *kelamit*, sepse e ndërlidh *kelamin* me *te'vilin*. Në **pikën e dytë** vazhdon me këtë linjë të ndalimit duke pohuar se nëse është i lejuar të komentuarit alegorik, këtë do ta përcaktonte Pejgamberi. Por, është e njohur mirë se këtë mënyrë Pejgamberi nuk e ka përdorur kurrë dhe sikur të ishte e dobishme Pejgamberi do t'ua përmendte myslimanëve. Kjo ndalesë vazhdon edhe në **pikën e tretë**, në të cilën Ibn Kudame thekson se të devotshmit pararendës të ummetit myslimanë i kanë trajtuar këto ajete kur'anore pa komentim alegorik dhe pa ndarje të Zotit nga atributet e Tij. Kjo ka të bëjë me atë që sikur te'vili të kishte ndonjë dobi, as'habët e Pejgamberit sigurisht për këtë do të flisnin. Duke kërcyer në **pikën e pestë**, e cila ndërlidhet me këtë ndalesë të përgjithshme, duhet të theksojmë se Ibn Kudame pohon se si *kelami* paraqet futje të gjerave të reja në fe (bid'at) që është në kundërshtim me Sunetin e Pejgamberit. Këtu ai thekson disa hadithe të mirënjohura për mbetjen konsekuent në Sunetin e Pejgamberit a.s.. Në **pikat e tjera** Ibn Kudame përpiket t'i ofrojë shkaqet për këtë ndalesë të bazuar në ajetet e tjera të Kur'anit dhe në shembujt nga Suneti.

**Pika e katërt** e Ibn Kudames pohon se *kelami* është i njëjtë sikur edhe lënia e gjykimit në duar të Zotit në çështjet për të cilat komentuesi asgjë nuk di. Mutekel-limunët (apologjetët) assesi nuk mund të dinë ç' dëshiron Zoti me këto ajete. Qoftë gjuha edhe e pranon ndonjë

<sup>17</sup> Tahafut al-Falasifah, p. 201; Kamali,(1963): 147.

<sup>18</sup> Ibn Qudamah (1962): 20-23.

domethënie, kjo domosdoshmërisht nuk e kufizon ajetin vetëm në këtë interpretim. Së këndejmi komentuesi mund ta zgjedhë domethënien në të cilën Zoti nuk e ka synuar dhe, kështu, flet për Zotin nga mosdija, që Zoti e ndalon në suren e shtatë në ajetin 33. Në **pikën e gjashtë** të tij pohohet se komentimi alegorik është çmenduri e pastër dhe futje në çështjet që nuk kanë të bëjnë me njeriun që nuk ofrojnë kurrfarë dobie praktike. Sipas tij, myslimanët nuk kanë nevojë të mësojnë kuptimin e mirëfilltë të attributeve të Zotit, sepse kurrfarë drejtimi i veprimit as rregull ligji nuk varet prej tij. Zoti ka caktuar besimin në melekët, librat dhe pejgamberët e Tij, por hollësitë e tyre nuk janë të njohura. Prandaj, thjesht duhet të besojmë në atë që është shpallur (2, 136) dhe jo të bëhemi të pamatur dhe furacakë (38, 86). **Pika e shtatë** e Ibn Kuddames është e ngjashme, në kuptim të thotë se si është mendjemadhësi e pastër t'i lejosh vetes gënjeshtria për Zotin. Ai shpjegon se sikur komentimi alegorik të ishte i detyrueshëm, atëherë do të ishte e detyrueshme për çdo mysliman, qoftë dikush që nuk i njeh provat për këtë. Kështu njerëzit do të flisnin nga mosdija për atributet e Zotit, që e dimë se është e ndaluar. Insistimi i mutekel-limunëve në preokupim me kelam do të bënin që njerëzit të flasin nga mosdija. **Pika e tetë** e tij është se kelami është përdorimi i gjykimit të pavarur në bazë të burimeve (ixhtihadi) në çështjet e panjohura në Kur'an dhe Sunnet; kurse kjo nuk lejohet qoftë të ndodhë që dikush edhe të ketë të drejtë. Ibn Kuddame pohon se Ebu Bekri madje edhe ka refuzuar të komentojë nocionin e pijes në suren 80, 31, sepse nuk ka dëshiruar të thotë diçka për Librin e Zotit që nuk e ka ditur. Dhe në fund, në **pikën e nëntë**, Ibn Kuddame thekson se mutekel-limunët janë fajtorë që Zotit ia përshkruajnë atë që Ai vetes nuk ia ka përshkruar dhe Vetes t'ia mohojë atë që Vetes ia ka përshkruar. Ata e bëjnë këtë kur thonë se një atribut në fakt është diç tjetër. Për shembull, thonë se ngjitja (ngritja) (*istiva*) nuk do të thotë “ngritje mbi” (Fron, Arsh) por se në fakt do të thotë *Istivla* (të arrihet dominim, zotërim, mbi”).

Në këtë vështrim mbi argumentimin e Ibn Kuddames kundër *kelamit*, kemi parë mjaft mirë rezyminë e shkruar të kundërshtimit tradicionalist të mutekel-limunëve. Mund të kualifikohet si argument

negativ sepse përqendrohet në ndalesën e drejtpërdrejtë të kelamit pa të folurit e drejtpërdrejtë për atributet e Zotit. Në rastin e Ibn Tejmijes do të shohim se si ai i qaset diskutimit për atributet e Zotit nëpërmjet argumentimit pozitiv. Shpjegon se si atributet e Zotit janë kuptuar në mënyrë të rëndomtë brenda kufijve të gjuhës arabe dhe nëpërmjet udhëheqësit të Kur'anit dhe Sunnetit.

Ibn Tejmije fillon me postullatat themelore të cilat i ka vendosur Ibn Kuddame, por i kundron si të plota dhe të mjaftueshme për shpjegimin e natyrës së attributeve të Zotit. Ndërkaq, ai e kupton se Kur'ani dhe Sunneti përmbajnë çdo gjë që është e nevojshme për njohjen e Zotit dhe shpjegimin e cilësive të Tij - kuptueshëm dhe qartë, pa anim drejt çfarëdo argumentimi filozofik. Çështjen e cilësive të Zotit nuk e kundron si problem të veçantë teologjik, por më tepër e inkadron në aksesin e përgjithshëm të perceptimit të Kur'anit. Kështu e trajton këtë tematikë në trajtesën të quajtur *Mukaddimet'ut-tefsir* - Hyrje në komentimin e tefsirit) si problem i aplikimit të metodologjisë përkatëse të perceptimit të Kur'anit. (Ibn Tejmije, 1966).<sup>19</sup> Baza e aksesit të Ibn Tejmijes në tefsir të cilitdo ajet të Kur'anit është të drejtuarit e tij ajeteve dhe haditheve autentike. Duke e komentuar suren 16, 44, në të cilën Zoti thekson se Pejgamberi është dërguar në mënyrë që qartë t'u shpjegojë (tubejjin) njerëzve atë që është shpallur, Ibn Tejmije thekson se Pejgamberi i ka shpjeguar kuptimet e Kur'anit dhe nocionet në të. Kjo do të thotë, në mënyrë që ta përmbushë detyrën e tij të paralajmëruesit dhe pejgamberit, Muhammedi a.s. është dashur të sqarojë të gjitha kuptimet përkatëse dhe të lejuara të Kur'anit dhe të mos fshehë asnjë informacion. Së këndejmi nuk ka kurrfarë fshehtësie apo dije të fshehtë të cilat i posedon grupi i elitës sikurse janë filozofët. Në mënyrë që t'i shpjegojë atributet e Zotit, personi duhet t'i kthehet Kur'anit dhe perceptimit të gjuhës së tij.

Sipas mendimit të Ibn Tejmijes, gjëja e parë që duhet njohur është se Zoti përdor fjalët njëkuptimshme (sinonimet), që të shpjegojë diçka duke i dhënë kësaj emërtime të ndryshme. Në këtë mënyrë duhet kup-

<sup>19</sup> Ibn Taymiyyah (1966: 329-376).

tuar Emrat e Bukur të Allahut të përmendura në Kur'an. Sikur që ekzistojnë emra të ndryshëm për Pejgamberin edhe Kur'anin, ekzistojnë edhe emra të ndryshëm për emrin e Zotit, kjo nuk është në kundërshtim me lutjen duke thirrur një emër tjetër të Emrit të Tij. Si dëshmi e përmend suren 17, 110, në të cilën thuhet: *“Thuaj: “Thirrni Allahun ose thirrni të Gjithëmëshirshmin, me cilindo emër që ta thirrni ju Atë, Ai ka emrat më të bukur. ...”*. Ibn Tejmije përfundon nga kjo se çdo emër i Zotit tregon një dhe të njëjtën Qenie. Kjo do të thotë se cilindo emër që Zoti e përdor për Vetën në Kur'an ka të bëjë me Të. Pastaj pohon se çdo emër tregon në një atribut të kyçur në këtë Emër. Kështu, për shembull, emri “I Gjithëdijshmi” ka të bëjë me Qenien dhe Dijen, “I Gjithëmundshmi” me Qenësinë dhe Fuqinë, “I Gjithëmëshirshmi me Qenien dhe Mëshirën. Në këtë mënyrë Ibn Tejmije i ndërlidh të gjithë emrat e Zotit dhe atributet që i përkasin atyre për një të njëjtën esencë. Si kundërarargument ai thekson kundërthënien karakteristike (inherente) të atyre të cilët mohojnë se emrat e tij dëftojnë në atributet e Tij. Si shembull i përmend ata të cilët thonë se Zoti nuk jeton dhe se nuk është pa jetë. Kurse tash, duke anuar kah logjika, Ibn Tejmije pohon se ata mohojnë të dy nocionet (të asaj kundërthënie). Kështu, pohon ai, është çështje e domosdoshmërisë që çdo emër të lidhet me Qenien e Zotit dhe me një nga cilësitë e Tij.

Në mënyrë që këtë ta dëshmojë, Ibn Tejmije e përdor shembullin e dytë që të tregojë se si një esencë mund të ketë emra dhe cilësi të ndryshme. Shembulli i parë është i bazuar në suren 20, 124: *“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime ...”* (... وَمَنْ أَعْرَضَ عَنْ ذِكْرِي = ve men areda an dhikri...). Ibn Tejmije pohon se përkujtimi (dhikr) ka të bëjë ose me atë që Zoti e ka shpallur ose me atë që adhuresi e bën - namazi dhe duaja. Duke e marrë kontekstin e tërësishëm të ajetit, dhikri bëhet fjalë sinonime për Udhëzimin e Zotit dhe Shpalljen. Kështu qenie është çdo gjë që Zoti e ka shpallur edhe Emrat edhe Cilësitë edhe Përkujtimi edhe Udhëzimi. Me fjalë të tjera, Qenia e asaj që Zoti e ka shpallur mund të ketë lidhje me përkujtimin ndaj Zotit, Udhëzimin e Tij, Librin e Tij ose Fjalën e Tij; çdo nocion ka të bëjë me Qenien e një dhe të njëjtë.

Duke u kthyer drejtpërdrejt në çështjen e attributeve të Zotit, Ibn Tejmije thekson se kushdo që i shqyrton cilësitë individuale të emrave duhet ta kuptojë se ajo bën pjesë në kuadër të nocionit të emërimit konkret të gjerave do të thotë., Emrat e Zotit si “I Shenjti”, “Shpëtuesi” dhe “I Besueshmi” janë sinonime të nocionit “Zot”. Kurse sa i përket gjurmimit pas kuptimit të natyrës së atributit konkret, Ibn Tejmije mbështetet në metodat e tradicionalistëve. Duke u thirrur në as'habët e Pejgamberit dhe në brezin e parë të myslimanëve, thekson se askush nuk e ka shpjeguar ndonjë atribut duke dhënë shenjë në esencën e tij, qoftë ky edhe ndonjë atribut aspak i ngjashëm me tjetrin. Kështu “I Shenjti” është “Ai i cili fal” dhe “I Gjithëmëshirshmi”, respektivisht, ata janë një e njëjta gjë.

Në trajtesën e tij për atributet e Zotit Ibn Tejmije tenton të ofrojë thellësi më të madhe të shpjegimit të pikëpamjes tradicionaliste mbi natyrën e Zotit. Instrumenti themelor për këtë është gjuha arabe. Gjuhën arabe e kupton si mjet unik të Shpalljes dhe kështu të gjitha nuancat e saj duhet të kuptohen korrektësisht dhe qartë. Krahas gjuhës arabe, ajetet e Kur'anit duhet të lexohen dhe të kuptohen brenda potencialit (dhanësisë) të tyre natyror, d.t.th., Kur'ani duhet të komentohej me Kur'an. Shembujt, parabolat dhe përdorimet gjuhësore të Kur'anit duhet të verifikohen për shkak të rregullave dhe parimeve të tyre, të cilat, në të kundërtën, duhet të aplikohen në mënyrë të përpiktë dhe njëtrajtshme. Me këtë rrugë, Ibn Tejmije nuk refuzon mundësitë racionale të mendjes (akl) por atë ia nënshtron Shpalljes në mënyrë që ta shpjegojë.<sup>20</sup>

Përktheu:  
N. Ibrahim

<sup>20</sup> **Burimi:** S.H.Nasr & Oliver Leaman, History of Islamic Philosophy, I, Teheran, fq. 105-118. Përkthimi ynë është bërë sipas: A. Silajdzic, Rane skole kelama, Sarajevo, 2004, fq. 69-83, kurse është verifikuar dhe fusnotat janë shtuar sipas burimit në anglisht.

James Pavlin

## SUNNI KALAM AND THEOLOGICAL CONTROVERSIES

### (Summary)

The issue of kalam is extensive and encompasses many subject matters. Accordingly, the orthodox reaction to kalam is complex and varied. In order to focus on the heart of the orthodox reaction, its methodology and goals, we need to focus on some of the major theological controversies in Islam. In general, these revolve around the nature of God and His Attributes. This topic includes topic such as God's Speech, which relates to the belief in the uncreatedness of the Qur'an, and God's Will, which relates to the belief in the createdness of the world.

جيمس بافلين

## علم الكلام السني و الخلافات العقائدية

### (خلاصة البحث)

يعتبر علم الكلام موضوعا واسعا و متشعبا يحتوى على موضوعات متعددة. بناء عليه فان جواب أهل السلف عن الكلام جاء مختلفا. لذلك يجب ان يكون الرد على صلب جواب أهل السلف و اساليبهم و مقاصدهم بحيث يكون التركيز على امور خلافية عقدية في الاسلام. و يشمل هذا الموضوع على مفردات مثل كلام الله الذي لها علاقة بالايمان بعدم خلق القرآن و الذي لها صلة مباشرة بإيمان بخلق العالم.

## PORTRETE

*Nehat Krasnqi*

### **TAHIR EFENDI BOSHNIJAKU - GJAKOVA<sup>1</sup> (L. rreth vitit 1770 – vd. reth vitit 1850)**

Tahir efendiu, në letrat shqipe njihet me tre mbiemra: si Tahir Efendi Boshnjaku, Tahir Efendi Gjakova dhe Tahir efendiu i Madh. E mbiemëruan Boshnjaku, sepse lindi në Jeni Pazar (Tregu i Ri - Novi Pazar) ku popullsia shqiptare prej kohësh jetonte në fqinjësi me atë boshnjake; E mbiemëruan Gjakova, sepse aty e filloi karrierën profesionale dhe aty e kaloi jetën; E mbiemëruan dhe e cilësuan si Tahir Efendiu i Madh, në shenjë mirënjohje për veprën e madhe që la.

Mbështetur në të dhënat që i kemi nga pasardhësit e vajzes së Tahir efendiut, Halimes, del se ai është lindur rreth vitit 1770, në fshatin Llukare që ndodhet afro gjashtë kilometra në jug-perëndim të Jeni Pazarit. Banorët e këtij fshati iu përkasin dy familjeve të mëdha: të Saraçëve dhe të Pllojajve. Familja e Saraçëve, nga e cila rrjedh Tahir Efendiu është e fisit Kastrat<sup>2</sup>.

Pas mbarimit të studimeve në Stamboll, Tahir Efendiu filloi të punoj myderriz në Medresenë e Vogël të Gjakovës, e njohur në burime të shkruara osmane si Medrese-i xhedîd (Medreseja e Re). Ai që myderrizi i parë i kësaj medreseje, të ndërtuar rreth vitit 1807. Dome-thënë rreth njëqind vjet pas Medresesë së Madhe (Medrese-i atîk), e ndërtuar nga dera fisnike e Kurtpashëve – Kryezive të Gjakovës në vitin 1707 dhe e shquar për nga niveli i lartë intelektual i myderrizëve të sajë, që nga i pari Yveys Efendiu e këndej.

Tahir Efendiu, në Medresenë e Re e angazhoi si asistent të vetin njërin ndër studentët më të dalluar të tij. Edhe ai quhej Tahir dhe vinte nga i njëjti fshat, por nga familja e Pllojajve. Asistentit të vet Tahir Efendiu i dha për grua të bijën e madhe Halimen. Nga këta pastaj u lind Vejseli dhe një Tahir tjetër, i cili u lind pas vrasjes së të et, në rrethana të pandriçura në vitet 1838-39. Pasardhësit e tyre vazhdojnë të shtohen e të rriten edhe sot.

Datëlindja dhe datëvdekja e Tahir Efendi Gjakovës nuk është dokumentuar ende, por mbështetur në datat e përfundimit të veprave të tij, mund të thuhet me siguri të plotë se ai ka vepruar gjatë viteve 1810-1843. Prej vitit 1810 ka punuar mësimdhënës në Medresenë e Vogël, ndërsa brenda viteve 1832- 1843 ka shkruar veprat e veta.

Interesimi kërkimor shkencor për veprën e Tahir Efendi Gjakovës, ka nisë që në dekadën e tetë të shek. 19 atëherë kur ende kishte njerëz që e kishin njohur nga afër dhe që ruanin kujtime të freskëta për te. I pari që u interesua për Tahir Efendi Gjakovën, qe Jani Vreto (1822-1900). Vretoja qysh në vitin 1879 kishte shkruar: “Tahir efendiu, ma bëri të njohur në Stamboll një gjakovar që quhej Hysen efendi, duke më thënë se simbas gojëdhënës ai ishte një njeri i shenjtë dhe shkroi shqip me shkronja arabe këshilla fetare në shumë dorëshkrime, të ci-

<sup>1</sup> Të dhënat për jetën dhe veprën e Tahir efendi Gjakovës, që po botohen këtu, janë marrë nga kumtesa e autorit të këtij punimi, me titull Të dhëna të reja për jetën dhe veprën e Tahir Efendi Gjakovës. lexuar në Simpoziumi Ndërkombëtar “Gjashtë shekuj të Islamit ndër shqiptarë”, Prishtinë, 16-17.09.2006. Botohen për herë të parë.

<sup>2</sup> Informacione gojore me interes për vendlindjen dhe për pasardhësit e Tahir efendiut, kemi marrë nga zotrinjtë Haxhi Hysejn Zatriqi dhe vëllau i tij Prof. Dr. Ali Zatriqi, në

shtëpinë e Dr. Aliut, më 12 Maj 1992. Në shtëpinë e Dr. Aliut është rruajtur me shumë kujdes e dashuri autografia e Vehbijes së Tahir efendiut. Këtë dorëshkrim të vet autorit, Dr. Aliu, pat mirësinë të ia dhurojë Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, përmes meje, në vitin 2004. Tani ruhet në Koleksionin e Dorëshkrimeve, me nr. të signaturës D. SH. 700. Këta më kanë informuar se janë pasardhës të Tahir Efendiut, nga ana e vajzës së tij të madhe Halimes (l.rreth vitit 1808). I falënderoj për informacionet dhe për dorëshkrimin.



lët, pasi i lidhi mirë me dorën e vetë, ua dha miqve të tij nga një secilit. Tahiri, (do të jetë: Hyseni. N.K.) më tha se edhe vetë kishte një kopje në shtëpinë e tij në Gjakovë. Kur u largua me shërbim më udhëzoi ta kërkoja dorëshkrimin tek gjakovarë të tjerë që ndodheshin në Stamboll dhe më të vërtetë e gjeta tek një tjetër Tahir...”<sup>3</sup>

Emri i Tahir efendiut zgjoi interesim më të madh në opinionin shkencor dhe publik, pas botimit të veprës së tij “Vehbije” (Dhuratë) më 1907 në Sofje, të cilën e transkriptoi Ismail haxhi Tahir Gjakova, sekretar, këshilltar e bashkëpunëtor i Haxhi Zekës (1832-1902). Ky botim, megjithë mangësitë e gabimet që ka, i dha jehonë të mirë emrit të Tahir efendiut. Përveç gabimeve jo të pakta, që janë bërë në transkriptimin e veprës së cekur, në këtë botim edhe titulli i veprës është dhënë gabimisht: “Emni Vehbije”, gabim ky që është përsëritur më vonë edhe nga studiues të tjerë, që kanë zënë në gojë këtë vepër. Tahir efendi, qartë e thotë emrin e veprës, që në fillim të saj, me këto fjalë: “Emni: Vehbije. Vezni i kësaj oshtë kështu: Failatun-failatun-failat”.

Vepra e Tahir efendiut u gjet në fokus të interesimit të Lumo Skendos (alias Mid’hat Frashërit), hulumtues i pasionuar, shkencëtar erudit dhe njëri ndër bibliografët e parë dhe të mirëfilltë shqiptarë. Lumo Skendo në përshkrimin bibliografik që i bëri mevludit me titull: “Manzumet-yl-mevlud, fi efdalil-mevxhud bi lisani’l-arnaud (Vjersha e mevludit në gjuhën shqipe për qënien më të vlefshme)” ia konteston autorësinë e kësaj veprë Tahir Popovës, duke thënë: “Rrëfëhet se autor i këtij mevludi nuk është vërtet Tahir efendi Popova, por një Tahir efendi Jakova, i njohur në Kosovë me emrin Tahir efendi i Math; ky, thuhet se paska lënë disa shkrime shqip midis të cilëve edhe këtë mevlud, të cilin, duke e ndryshuar pakë, e ka botuar njëemërsi i tij prej Popove”<sup>4</sup>. Kujtojmë se ky deklaram publik i Mid’hat Frashërit, është një argument serioz, por jo edhe i vetmi, që vepra në fjalë të konsiderohet e Tahir efendiut të Madh. Si mbështesë për këtë kemi shfaqur

<sup>3</sup> Jani Vreto, Mendime mbi shkrimin e gjuhës shqipe, në Jani Vreto, Vepra të zgjedhura, Tiranë 1973, f. 263.

<sup>4</sup> “Dituria” nr. 1, Tiranë, 1926, f. 36-37.

më herët ca argumente<sup>5</sup>. Këtu mund të shtojmë dhe një; Në faqen 15 të këtij mevludi jo rastësisht është përdorë fjala “e mestiti”, në kuadër të bejteve “E mestiti këtë mevludin ni fakir // për rahmet Zotit kul-li shej’in kadir. Emni Muhamed-Tahir bin Halil // bani afv hem epu xhennet ja Xhelil”. Në vendlindjen e Tahir Popovës dhe në rrethinë fjala “me mestit” ka kuptimin me hedhë mazë dhe, rëndom, përdorët nga magjetoret për të shprehur veprimin që bëjnë pasi të kenë qitur petullën e fundit të flisë dhe para se ta kenë futur flinë nën saç.

Tahir Popova me këtë fjalë do të ketë synuar të shprehë një lloj redaktimi që mund t’i ketë bërë tekstit të mevludit, të shkruar më herët nga Tahir efendi i Madh.

Një vështrim kritik për “Vehbijen” e Tahir efendiut duke riprodhuar edhe disa pjesë të saj, ka botuar H. Kaleshi. Në këtë vështrim Kaleshi përveç të tjerash, shkruante: “Duke lexuar veprën e tij, vijmë në përfundim se ai ka qenë fort i ngritur, sepse mirë njihte traditën islame, të gjitha disiplinat fetare dhe metrikën arabe”<sup>6</sup>.

Kontribut të veçantë dhe të vlefshëm gjuhësor për “Vehbijen” e Tahir efendiut, gjithsesi ka dhënë prof. Idris Ajeti<sup>7</sup>.

Kontributin që ka dhënë Tahir efendi në pasurimin e gjuhës letrare shqipe me neologjizma e ka vlerësuar prof. Çabeji, duke thënë: “Do të përmendet që tahir Boshnjaku prej Gjakovë që më 1835 shtiu në përdorim disa fjalë si: mësues, nxanës, digues, dis, folës, kallxues, shtis, etj., si pështim, randim, rrënim, rrëzim, të cilat me të tjera rrugë u bënë pastaj pronë e leksikut abstrakt të gjuhës shqipe”<sup>8</sup>.

Gjurmuesit dhe studiuesit e veprës së Tahir Efendi Gjakovës kanë njohur vetëm tri vepra të këtij autori të shkruara në gjuhën shqipe me alfabet arabo-osman. Njëra është Vehbija, e shkruar në poezi dhe pro-

<sup>5</sup> Nehat Krasniqi, Mevludet në letërsinë shqipe me alfabet arab, në “Dituria islame”, nr. 30-31, Prishtinë, 1991, f. 26-27.

<sup>6</sup> Hasan Kaleši, Prilog poznavanja arbanaske književnosti is vremena Preporoda, në: Godišnjak, 1, Balkanološkog Instituta u Sarajevu, Sarajevo, 1956, f. 361.

<sup>7</sup> Idris Ajeti, Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shek. XIX, në: Studime gjuhësore II, Prishtinë, 1978.

<sup>8</sup> Eqrem Çabej, Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtëshkrimit të shqipes, në: Studime filologjike, 1, Tiranë 1973, f. 100.

zë, sipas shembullit të shumë veprave në letërsitë orientale islame, e përfunduar në vitin 1835, e transkriptuar dhe e botuar nga Ismail Haxhi Tahir Gjakova në Sofje më 1907 dhe e ribotuar me një studim kritik shkencor nga Profesor Idriz Ajeti më 1960. Vepra tjetër e Tahir Efendiut në gjuhën shqipe është Mevludi që e botoi me emrin e vet Tahir Popova (vd. 18 qershor 1949). Vepra e tretë e Tahir Gjakovës mban titullin “Tefsir-ul-ajat ‘ala lisan-il-arnaud” (Koment i ajeteve në gjuhën shqipe). Për këtë vepër në dorëshkrim, ka mbetur vetëm një shënim bibliografik i H. Kaleshit dhe informacioni i konfirmuar edhe nga Regjistri i librave dhe dorëshkrimeve të Bibliotekës së Vakëfit në Prishtinë<sup>9</sup>, se ai dorëshkrim ruhet në këtë bibliotekë me numrin e signatures 1238. Për fat të keq, kësaj veprë i kanë humbur gjurmët dhe përpjekjet tona për ta gjetur atë, deri tani nuk kanë dhënë rezultate. Sipas shënimit bibliografik të Kaleshit, dorëshkrimi ka 28 faqe të pa paginuara, është format xhepi dhe shtjellon problemin e gjakmarrjes dhe dëmin që sjell ajo.

Gjatë hulumtimeve në terren, kemi gjetur dhe identifikuar edhe katër vepra të panjohura të Tahir Efendi Gjakovës në dorëshkrim. Tri prej tyre janë në gjuhën osmane, kurse një në gjuhën arabe. Dy nga veprat që janë shkruar në gjuhën osmane, janë vepra poetike.

Vepra e parë që kemi gjetur, mban titullin “Kitab-i tenbihijet” (Libri i paralajmërimeve”. Është në gjuhën osmane, në prozë. Dorëshkrimi numron 51 faqe të formatit 16.5 x 11cm. Është shkruar me shkrimin nes’h të vokalizuar dhe është përfunduar nga autori më 7 janar të vitin 1837. Nuk është autografi, por kopje e një Mulla Ademit nga Gjakova, mbase nxënës i Tahir efendiut. Vepra është një lloj ferrëfenjësi (ilmihal) dhe iu dedikohet nxënësve respektivisht studentëve. Autori veprën e fillon me një sentencë në gjuhën shqipe: **‘Pa u hup nimeti, s’i dihet kimeti’**. Poashtu edhe përfundimi i veprës është bërë me fjalët shqipe: **‘Mos harro ti me thonë Tahir Efendija njeri mire u konë, Zotynë i boft rahmet përgjithmonë’**.

<sup>9</sup> Informacioni na ka ardhur nga z. Sadik Mehmeti, i cili edhe e ka gjetur këtë Regjistër (të prapiluar nga hfz. Bajram Agani), në Arkivin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, në Prishtinë

Kjo vepër, përveç rendësisë që ka si ferrëfenjësi i parë i këtij lloji që është shkruar deri sot nga një autor shqiptar, ka edhe rendësi të vacantë informuese për veprat tjera të këtij autori. Tahir efendiut në këtë vepër i përmend edhe dy vepra tjera poetike të tij. Ato janë “Hyda Rabbëm” (Perëndia është Zoti im) dhe “Hazine-i Din” (Thesari i Fesë)<sup>10</sup>. Po në këtë vepër, autori ynë duke përmendur pseudonimin e vet poetik “Zaifi”, na jep edhe një informacion tejet të rendësishëm për hulumtimin e mëtejshëm të veprimtarisë së tij letrare e shkencore. Të cekim këtu se këtë pseudonim, përveç Tahir Efendiut e kanë përdorë, sipas A. S. Levendit, të paktën edhe gjashtë poetë osmanë, që kanë jetuar dhe vepruar në Perandorinë Osmane<sup>11</sup>. Në këtë vepër Tahir efendiut i sugjeron lexuesve leximin e veprës së tij në gjuhën shqipe “Vehbije” dhe i bën një reklamë të mirë asaj, duke thënë: *“Po deshe shjarime më shumë se këto, kemi shkruar në Vehbijen tonë që është shqip. Po ta dinin njerëzit se ç’është vehbija ime, një flete të sajë do t’i jepnin dhjetë rubije, të tërës do t’i jepnin njëqind hajrije, mësuesit të sajë do ti jepnin një mahmudije”*<sup>12</sup>.

Vepra tjetër e Tahir Efendiut “Hyda Rabbëm” (Perëndia është Zoti im), është nga fusha e apologjetikës islame (akaid). Është në gjuhën osmane dhe numron 10 faqe. Vepra është shkruar në vargje për qëllime praktike didaktike. Është përfunduar së shkruari në vitin 1832. Kemi gjetur tri kopje të kësaj veprë por jo edhe autografinë e Tahir efendiut. Dy prej tyre, janë kopjuar nga Bajram Jusuf Doli, kurse njëra, nga Muhamed Tahir Jaka, që të dy nga Gjakova.

Nga vepra tjetër e Tahir Efendiut në gjuhën osmane, “Hazine-i Din” (Thesari i Fesë) kemi gjetur vetëm dy faqet e fillimit. Edhe kjo

<sup>10</sup> Këto të dhëna janë në fl. 17a të veprës “Libri i paralajmërimeve” së Tahir Efendiut në dorëshkrim. Të tri dorëshkrimet e Tahir Gjakovës në gjuhën osmane i kam përkthyer në gjuhën shqipe dhe shpresoj të botohen së shpejti.

<sup>11</sup> Ağâh Sırrı Levend, Türk Edebiyatı Tarihi, Ankara, 1984, f. 260, 265, 283, 289, 392.

<sup>12</sup> Dorëshkrimi “Libri i paralajmërimeve” fl. a/b. Autori ynë në veprën e tij gjuhës shqipe nuk i thotë arnavutça, siç quhej ajo në gjuhën osmane, por i thotë “shqip” (Bundan ziyade beyan istersen, shqip olan Vehbiyemizde yazdık). Këtë dashuri fanatike për gjuhën amtare, nuk e kemi hasur te ndonjë autor tjetër shqiptar që ka shkruar osmanisht. Ky, besoj, do të jetë i vetmi rast.

vepër është shkruar në vargje. Është me rendësi që këto dy faqe janë të shkruara nga dora e vet autorit (autografe). Këtë vepër autori ynë e fillon me këto vargje:

*“Beso im bir se xhahili<sup>13</sup> s’bëhet dëshmor as luftëtar  
Njeri fatzi gjithnjë mbetet injoranti n’këtë dynja.  
Njeriu xhahil është më i keq se sa shtaza që han bar  
Është armik i Qitapit<sup>14</sup> dhe i fesë n’këtë dynja.  
Xhahilin ti e ke armik edhe në qoftë baba yt  
Ndotës<sup>15</sup> i tokës veçse është xhahili n’këtë dynja”.*

Vepra e Tahir Efendiut në gjuhën arabe, nuk ka titull, por në bazë të lëndës që shtjellon mund të quhet Libër mbi namazin, sepse bën fjalë për gjithçka që lidhet me namazin. Dorëshkrimi ka 56 faqe të formatit 20x15 cm. Është shkruar në vitin 1843. Në disa faqe të këtij dorëshkrimi gjejmë shënime interlineare dhe marginale në gjuhën osmane.

Si përfundim mund të thuhet se Tahir Efendi Gjakova ka qenë shkrimtar dhe krijues poetik në gjuhën shqipe, osmane dhe arabe, neolog dhe lëvrues i dalluar i gjuhës shqipe, myderriz dhe dijetar me famë, përkthyes dhe ekzegjet selektiv i Kur’anit, skriptor dhe libërli-dhës, si dhe njëri nga veprimtarët më të mëdhenj dhe më mbresëlënës intelektual të gjysmës së parë të shek. XIX.

## KITÂB-I TENBÎHIJJET (“LIBRI I PARALAJMËRIMEVE”)

**“Pa u hup nimeti<sup>16</sup> s’i dihet kimeti<sup>17</sup>”**

*Bismil-Lahir-Rahmanir-Rahim<sup>18</sup>*

Përnderimi i qoftë Allahut të lartësuar dhe bekimi e shpëtimi i qoftë Muhamed Mustafasë si dhe familjes së tij pa mbarim. Pas kësaj:

Dije o i mençur, se njerëzit e kësaj kohe, jetën e pasosme ia kan dhënë kësaj jete, fenë ia kan dhënë parasë, diturinë ia kan dhënë rehatisë e argëtimit dhe për këtë jetë aq me zell po punojnë, sa që për namaz, që është shtyllë e fesë dhe për rregullat e tija, pa të cilat ndoshta nuk mund të jenë besimtarë, si dhe për tridhjetëtri urdhërat e besimit dhe të islamit, nuk iu ka mbetur kohë. Ato, madje i kanë bërë të huaja dhe të pavlefshme. Kështu që, unë i varfëri duke i parë njerëzit në këtë gjendje, me qëllim që t’i paralajmëroj të mençurit, për disa gjëra, fillova t’i çasem menjëherë tridhjetetë urdhërave të besimit dhe të islamit dhe disa çështjeve të namazit, në një mënyrë të shkurtër, të përshtatshme mësim-besimit të nxënësve. Allahu i Lartësuar qoftë i kënaqur me punën tonë dhe e bëftë ate të suksesshme, Amin!

**Paralajmërim:** Një mashkull apo një femër që, të paktën, nuk i din dhe nuk iu përmbahet tridhjetetë urdhërave, nuk është besimtar (besimtare) dhe mysliman (myslimane). Gjashtë, nga tridhjetetë urdhërat, quhen kushtet e besimit (imanit), kurse pesë nga ata, quhen kushtet e islamit. Të tjerët quhen kushtet e namazit.

<sup>13</sup> Xhâhil (ar.) = injorant.

<sup>14</sup> Qitâp (turq.) > Kitâb (ar.) = libër. Këtu është fjala për Lbrin hyjnor Kur’anin.

<sup>15</sup> Në këtë vend, autori ka përdorë një fjalë më të rëndë, të cilën e kemi zbutur për respekt ndaj autorit dhe ndaj lexuesit.

<sup>16</sup> Nimet - pasuri, begati.

<sup>17</sup> Kimet - vlerë. Kjo sentencë e shkruar shqip me shkronja arabo osmane ka kptimin: Pa humbur pasuria s’i dihet vlera.

<sup>18</sup> Në emër të Allahut, të Githëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

## PJESA E PARË

### Kushtet e besimit (Imanit)

**Kushti i parë** i besimit është **besimi në Allahun** (amentu bi'l-Lahi).

**Qëllimi:** Besoj në ekzistencën e Allahut të Lartësuar. Ai nuk ka fillim, nuk ka mbarim, nuk ka shoq, nuk ka shembull. Ka xhen-net, ka xhehen-nem, ka mëshirë, ka hidhërim, ka begati, ka llogaridhënie, ka libër (shenime për çdo punë të njeriut), ka shpërblim, ka ndëshkim. Çkado që dëshiron Ai bëhet, çka nuk dëshiron nuk bëhet. Ai nuk han, nuk pin. Ai sheh, por jo me sy. Ai flet, por jo me gjuhë. Ai dëgjon, por jo me vesh. Ai është i Gjithëmundësishëm për çdo gjë. Ai din çdo gjë, madje edhe atë që është në zemrën e njeriut. Nuk ka lindur nga dikush as nuk ka lindur dikend. Është larg nga dobia apo dëmi prej dikujt.

**Kushti i dytë** i besimit është **besimi në engjëjt** (ve melaiketih).

**Qëllimi:** Poashtu besoj në meleqët e Allahut të Lartësuar. Ata nuk hanë nuk pine, nuk flejnë. Ata nuk kanë gjini mashkullore apo femrore. Ata iu nënshtrohen urdhërave të Allahut të Lartësuar. Ata nuk i rrebelohen Allahut të Lartësuar sikurse njerëzit. Më kryesorët prej tyre dhe më të afërm të Allahut të Lartësuar janë Xhebraili, Mikaili, Israfil dhe Azraili.

**Kushti i tretë** është besimi në **librat hyjnore** (ve kutubih).

**Qëllimi:** Poashtu besoj në librat e Allahut të Lartësuar. Gjithsej janë njëqindekatër libra. Ato përmes Xhebrailit u janë dërguar pejgamberëve në tokë. Katër prej tyre janë libra të përmbledhura, ndërsa njëqind janë fletushka. Më i fundit nga të gjithë librat e zbritur është Kur'ani. Ai ka abroguar (shfuqizuar) disa dispozita të librave të zbritur më parë. Është i paprekshëm nga abrogimi dhe ndryshimi. Dispozitat e Kur'anit do të qëndrojnë deri në Ditën e kijametit.

**Kushti i katërt** është besimi në **të dërguarit e Allahut** (ve rusulih).

**Qëllimi:** Gjithashtu besoj në të dërguarit e Allahut të Lartësuar. I pari prej tyre është Ademi a.s. i fundit është Muhamedi a.s.v.s. Në mes të këtyre dyve kanë ardhur shumë të dërguar të Zotit. Numrin e tyre e din vetëm Allahu i Lartësuar. Më i nderuari nga të gjithë të dërguarit e Zotit është hazreti Muhamedi. Ai është pejgamberi im. Allahu i Lartësuar na bëftë nga robërit e Tij që do të qëndrojnë në fenë e Tij të përfunduar dhe nga ata që do të fitojnë ndërmjetësimin e Pejgamberit tonë te Allahu. Amin!

**Kushti i pestë** është besimi në **Ditën e Gjykimit** (ve'l-jevmi'l-ahiri).

**Qëllimi:** Poashtu besoj në Ditën e Kijametit. Domethënë, të gjithë të vdekurit do të ngjallën dhe do të ngriten nga varret. Patjetër do të shkojnë në vendin e Mahsherit (Gjykimit) që do të formohet pas ringjalljes. Për veprat e mira apo të këqija, që ka bërë mbarë njerëzimi gjatë pesëdhjetë mijë viteve, domosdo do të shpërblehen - ndëshkohen përpikërisht. Madje, kanë thenë se nëse i ke mbetur borgj dikuj një të gjashtë pjesë të dërhemit, do ta merr sevapin e shtatëqind namazeve të pranuar që i ke falur me xhemat. Poashtu Pejgamberi ynë a.s. ka thenë se në Ditën e kijametit, dashi pa brirë do të merr hak prej dashit me brirë. Allahu i Lartësuar, kundërshtarët e të këqinjëve, si unë dhe ti, i mbuloftë me thesarin e mëshirës së Tij dhe i bëftë të pastër nga duart (të pastër nga haku i huaj: N.K.), amin!

**Kushti i gjashtë** është besimi në **predestinimin e Allahut** (ve bi'l-kaderi hajrihi ve sherrihi min Allahi teal).

**Qëllimi:** Besoj gjithashtu se çdo gjë e idhtë apo e ëmbël (e keqe apo e mirë) e tanishme dhe e ardhme, çdo mundim apo gëzim që na ndodhë tani dhe në të ardhmen, si dhe çdo punë e mire apo e keqe që bëjmë tani dhe në të ardhmen, është me dijen, dëshirën, caktimin, shkrimin në Pllakën e ruajtur (levhi mahfuz) dhe me krijimin e Allahut të Lartësuar.

**Paralajmërim:** Një person, sado që ti din plotësisht dhe saktësisht këto gjashtë kushte, derisa të mos i respektoj, të mos iu nënshtrohet

dhe të mos i pranojë ato, nuk është besimtar. Poashtu, kanë thenë se nuk është besimtar edhe ai person i cili i din saktësisht këto gjashtë kushtet, por vetëm në njërën nga ato ka dyshim apo lëkundje, njërën prej tyre e mohon, si dhe ai i cili vetëm njërën nga ato e qet pas shpine (e anashkalon). Poashtu kanë thënë se mosdituria për këto dhe gabimi, nuk falen. Madje, nëse një person i respekton këto, iu nënshtrohet dhe i pranon aq sa është e nevojshme, por vetëm në njërën prej tyre është i padishëm ose nuk ka dije aq sa duhet, ai person, kan thënë (dijetarët:N.K.) se është i pabesim (qafir) ose mëkatar (fasik). Poashtu kan thënë se nëse një person i din saktësisht këto, por është (ndjehet) i sigurtë nga hidhërimi i Allahut të Lartësuar, ose përdor gjuhë fyese, ose është i pa kujdesshmëm ndaj pabesimit opo ndaj ndonjërës prej këtyre gjërave, nuk është besimtar. Kështu që në frymën e fundit për të dashur përfundim të bukur ai që nuk e përforcon besimin me vepra të mira, i dobësohet besimi i tij dhe, ruana Zot, në frymën e fundit, nuk është i sigurtë se shejtani nuk do ja çrrënjosë besimin e tij. Pra, o i mençur, shërbej fesë tënde. Për këto gjashtë kushtet, që janë themeli i fesë dhe baza e Islamit, merr nga ekspertë të veçantë, të paktën nga “Fikhu’l-ekber” i Ebu Hanifes. Nëse gjithnjë dëshiron përfundim të bukur, kjo u bëftë që Allahu xh.sh. me fisnikërinë e Tij na mbuloftë përfundimin e bukur mua dhe ty.

## PJESA E DYTË Kushtet e Islamit

**Kushti i parë** i islamit është **shqiptimi i dëshmisë** (kelime-i shehadet).

**Qëllimi:** Nëse një njeri me vetëdëshirë dhe me qëllim thotë: “Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut”, shiquar nga ana e jashtme e dëshmisë, ai njeri është besimtar, atij i jipet selam dhe kur të vdes i falet namazi i xhenazes. Por nëse nuk e thot me qëllim, me vetëdëshirë dhe me sinqeritet nga zemra dhe duke ia ditur domethënien, apo nëse e thotë, por nuk i din siç duhet gjërat e qarta nga feja e muhamedit a.s. apo nëse i din por nuk i respekton dhe nuk i nderon sa duhet gjërat që kërkojnë nderim dhe nuk i nënçmon gjërat që duhet nënçmuar, le të dihet se ai te Allahu nuk është besimtar dhe nëse, vdes në këtë gjendje, ruajna Zot, do të mbetet përgjithmonë në xhehenem. Allahu i Lartësuar na bëftë prej atyre që deri sa të jemi gjallë të jemi në shërbim të fesë dhe kur të vdesim ta përfundojmë jetën me besim, amin.

**Kushti e dytë** i islamit është **falja e pesë kohëve të namazit** (salat).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që të falim pesë kohët e namazit, me kohë, në qfardo gjendje që të jemi, duke i ditur dispozitat e tij.

**Paralajmërim:** Namazi është devocioni më i vlefshëm, shtyllë e fesë, tregues i besimit dhe devocioni më i famshëm i islamit. Prandaj, ai që nuk e fal namazin është mëkatar, disa madje kan thënë është pabesimtar. Gjithashtu kan thënë se ai që nuk e fal namazin është armik i Allahut të Lartësuar, sikurse edhe i pamoralshmi dhe vrasësi. Poashtu kan thënë se ai që nuk e fal namazin duhet të denohet me rrahje deri të gjakoset, disa kan thenë se duhet të burgoset, ca kan thënë se duhet të ekzekutohet. Allahu i Lartësuar ka thenë se nëse një njeri e fal namazin sipas konditave dhe sikur të më shihte mua, është i sigurtë nga ajo që frikësohet dhe e arrin atë që shpreson, kurse ai që fal na-

maz duke qenë shkujdesur dhe i painformuar për te, i nënshtrohet hidhërimit tim dhe shkatërrohet e poshtërohet.

**Kushti i tretë** i islamit është **dhënia e zeqatit** (zekat).

**Qëllimi:** Një njeri i mençur (normal) i moshës madhore i cili nuk ka borxh, apo pas dhënies së borxhit i mbesin 200 derhem argjend (641 gr.: N.K.) ose 20 miskal ari (91 gr.: N.K.) ose mall tregëtimi në vlerën e njëres nga këto të dyja, dhe ate e zotëron mbi një vit, është urdhër i Allahut të lartësuar, që nëse ka argjend, nga 200 derhemët 5 derhem, apo nëse ka ari nga 20 miskalët gjysëm miskali t'i jep të varfërve. Nëse dikush nuk e jep pasurinë që i takon t'a jep zeqat, është thenë se ajo pasuri do të kale në zjarrin e xhehnemit dhe me te do të digjet ai person, nga poshtë, nga të dy anët dhe nga shpina. Kan thenë se zeqati ndoshta është urë e islamit.

**Kushti i katërt** i islamit është **agjërimi i Ramazanit** (savm).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të lartësuar, që njeriu i mençur i moshës madhore, të cilin nuk e dëmton agjërimi, apo nuk është në udhëtim, apo femra që nuk është me menstruacione ose në lehoni, të agjëroj Ramazanin. Ate që e dëmton agjërimi, apo është në udhëtim, apo femra me menstruacione ose në lehoni, pasi që t'u kalojnë pengesat si: menstruacioni, lehonja, udhëtimi, apo dëmtimi, duhet ta kompenzojë agjërimin. Nëse nuk e kompenzon, para vdekjes e len me testament pagimin. Nëse nuk e bën këtë, është mëkatar. Ai që nuk dëmtohet nga agjërimi, ose ai që nuk është në udhëtim, ose femra që nuk është me menstruacione ose në lehoni, nëse me vetëdëshirë dhe qëllimisht e prish agjërimin, duhet ta plotëson dhe ta kompenzon (qefaret dhe kaza).

**Kushti i pestë** i islamit është **kryerja e haxhillëkut** (haxh).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të lartësuar, që të shkoj në Qabe dhe të bëj haxhin, çdo njëri i cili ka pasuri të mjaftueshme, që për vete të siguroj ushqimin, veshmbathjen, transportin dhe shpenzimet tjera,

si dhe të siguroj shpenzimet e nevojshme për ata që mbesin në shtëpi dhe ata që i ka në përkujdesje, derisa të kthehet nga Qabeja.

**Paralajmërim:** Këto janë pesë konditat e islamit. Domethënë ata që i punojnë apo i pranojnë këto mësimet të qarta, është sinjal se janë pjestarë të fesë së Muhamedit. Atyre iu jepet selam dhe kur të vdesin iu falet namazi i xhenazes. Përndryshe le të dihet se këto të dyja, besimi (imani) dhe islami, janë një, janë punë zemre e jo punë të këtyre pestave. Allahu i Lartësuar mua dhe ty, duke qenë në islam dhe në besim derisa të jemi gjallë, na e përfundoftë jetën, Amin!

Pastaj, dije ti o i mençur se çdonjëra nga këto pesë kondita, ka disa kushte dhe urdhëra, kështu që pa e ditur njërin prej tyre, ajo nuk është dije e saktë dhe e pranuar. Po ashtu dije se devocioni, sjellja e bukur dhe puna e mirë i pëforcojnë këto pesë konditat dhe i rrisin mirësitë (sevapet) tona. Pra, në pastë mirësi ke ti, të gjitha këto t'i mësosh dhe sipas tyre të punosh, sepse kan thënë se shpëtimi i besimit (imanit) të njeriut në frymën e funndit ( në çastin e vdekjes) dhe grada e tij në xhenet, do jetë sipas fuqisë dhe dobësisë (shkallës) së nxënies së tyre. Po ashtu kan thënë se prej çdo njeriu kërkohen gjëra të veçanta dhe pa i bërë ato nuk ka shpëtim të plotë. Gjithashtu, çdokush kërkon shërbim sipas pasurisë që ka, sipas moshës që ka, qoftë madje edhe për një ditë më i vjetër, sipas menqurisë, sipas prejardhjes (klasore) që ka dhe sipas postit që mban. Poashtu, nga njeriu kërkohet devocion i vazhdueshëm. Nëse dikush pas devocionit njëmij vjetësh, ndalet një orë, pa pasur nevojë, dëmi i asj ore kan thënë se është më shumë se dobia e devocionit njëmij vjeçar. Poashtu kan thënë se ikja nga një grimcë mëkati, është më e mirë se devocioni i mbarë njerëzisë. Po deshe skjarime më shumë se këto, kemi shkruar në Vehbijen tonë që është shqip. Po ta dinin njerëzit se ç'është Vehbija ime, një flete të sajë do t'i jepnin dhjetë rubije, të tërës do t'i jepnin njëqind hajrije, mësuesit të sajë do ti jepnin një mahmudije. O i mençur, këto pesë konditat e islamit, konditat dhe urdhërat e sejcilës prej tyre dhe dispozitat tjera të shëriatit, të cilave iu thonë Ilmihal, mësohen vetëm në librat si Mylteka e Halebiut, Tarikati Muhamedije, Shifa-i Sherif. Ta din që libra si këto të studiosh, ose të lexosh, ose të dëgjosh, ose do të shkatërohesh.

## PJESA E TRETË

### Konditat e namazit (Shartet)

Urdhërat e namazit janë dymbëdhjetë. Gjashtë prej tyre janë brënda namazit dhe ato quhen shtylla dhe gjashtë prej tyre janë jashtë namazit dhe quhen kondita.

**Kondita e parë** e namazit është **pastrimi ritual** (hades'ten taharet).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që njeriu i cili synon të fal namaz, nëse ka ujë dhe mund ta përdor, të lahet (të merr) gusëll, po qe e nevojshë dhe të merr abdest, po qe pa abdest. Nëse i duhet ta bëj pastrimin ritual, por nuk ka ujë ose nuk mund ta përdor ate, atëherë, për të falur namaz është i obliguar që të merr tejemum. Femra pas ndërprerjes së menstruacioneve dhe të lehonisë, duhet të lahet (të merr gusull).

**Kondita e dytë** e namazit është **pastrimi higjienik** (nexhas'ten taharet).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që trupin, rrobet dhe vendin ku falesh, t'i mbashë të pastërta nga nevojat, nga gjaku e gjërat e ngjashme, që dalin prej dy organeve të jashtme të trupit dhe prej vet trupit. Me një pakicë shumë të vogël ndytësire, është i lejuar namazi, por është i urryer.

**Kondita e tretë** e namazit është **veshja sipas rregullit** (setër avert).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të lartësuar që mëshkujt të mbulojnë pjesët e trupit nga kthiza e deri nën gjunj, kurse femrat përveç fytyrës, duarve dhe këmbëve nën nyjet, të mbulojnë të gjitha pjesët tjera të trupit. Kan thenë madje, se nuk është i lejueshëm namazi i një femre e cila në namaz ka të shpluar një të katërtën e njërës vesh.

**Kondita e katërt** e namazit është **të diturit e kohës** (vakti bilmek)

**Qëllimi:** Të diturit e kohës së sejcilit namaz dhe falja e çdo namazi në kohën e vet, është urdhër i Allahut të Lartësuar. Nëse falet para kohe, nuk është namaz, nëse falet pas kohe, është kompenzim (kaza) dhe shtyesi është mëkatar.

**Kondita e pestë** e namazit është **kthimi kah kibleja** (istikbali kible).

**Qëllimi:** Të diturit e kibblesë dhe kthimi kah kibleja është urdhër i Allahut të Lartësuar. Nëse nuk e din, duhet pyetur dikend afër teje nëse ka që e din. Nëse nuk ka, atëherë duhet ditur se cili drejtim i përgjigjet më së shumti kibblesë dhe në atë drejtim duhet kthyer.

**Kondita e gjashtë** e namazit është **vendosja** (nijjet).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që të hyhet në namaz vetëm për hirë të Tij. Nëse dikush fal namaz me paramendim se atij dikush do t'i jep diçka, apo do t'a don dikush ate, apo dikush do ta pëlqen ate, është e ndaluar (haram). Ai mbase është i pa besim (qafir), kan thënë disa dijetarë.

## PJESA E KATËRT

### Shtyllat e namazit (Ruknet)

**Shtylla e parë** e namazit është **tekbiri fillestar** (iftitah tekbir).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar, si për atë që falet vetëm, poashtu e dhe për atë që falet me imam, që në fillim të namazit të thotë All-llahu ekber ("Allahu është më i madhi"). Poashtu, le të dihet se, tekbiri fillestar është konditë e namazit, nuk është shtyllë e namazit, por me që ai është i domosdoshëm për të hyrë në namaz dhe për ta filluar ate, duke qenë pjesë e namazit është quajtur shtyllë.

**Shtylla e dytë** e namazit është **qëndrimi në këmbë** (kijam).

**Qëllimi:** Në namazet të cilat janë farz (urdhër detyrimor) dhe vaxhib (urdhër sygjërimor) është urdhër i Allahut të Lartësuar që namazi

të falet në këmbë, nëse ka mundësi qëndrimi. Madje, vetëm deri sa thuhet “Allahu ekber” të qëndroj në këmbë, nëse mundet. Nëse është ngritur në këmbë dhe më tepër se ç’është e nevojshme, sa bëhet tekbi-ri, nuk mund të qëndrojë në këmbë, ulet në vend dhe namazi gjithësesi është i plotë. Nëse nuk ka mundësi që të ngritet, është urdhër i Allahut të Lartësuar që të falet ulur. Nëse edhe ulur nuk mundet, është urdhër i Allahut të Lartësuar që të falet shtrirë. Është e papëlqyeshëm (mekruh) që namazi i teravive të falet ulur, pa pasur nevojë. Namazet tjera që janë synet dhe nafile nuk është mekruh të falen ulur. Sipas Ebu-Hanifes, syneti i sabahut kursesi nuk lejohet që të falet ulur, pa nevojë.

**Shtylla e tretë** e namazit është **leximi i Kur’anit** (kiraet).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar, që në namaz të këndohet Kur’an, aq sa është e lejuar. Por, le ta dij kënduesi i Kur’anit në namaz, se sasia e këndimit të urdhëruar nga Allahui Lartësuar (farz), sasia e këndimit të sygjëruar nga Ai (vaxhib) dhe sasia e këndimit të praktikuar nga Pejgamberi a.s. (synet), gjindeden në librin e Halebiut.

**Shtylla e katërt** e namazit është **përkulja** (ruku).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që në namaz të përkulemi me kokë dhe me shpinë. Përkulje e plotë është ajo, kur shpina e atij që falet, merr një pozitë aq të rrafshët, sa edhe sikur të vendosej mbi te një tepsi plotë me ujë, nuk do të derdhej. Sipas Ebu-Jusufit, është urdhër i Allahut të Lartësuar që në përkulje të qëndrohet aq kohë sa të shprehet një lartësim i Allahut xh.sh.(tesbih). Sipas të tjerëve (ekspertë të sheriatit), nuk është urdhër i Allahut të Lartësuar.

**Shtylla e pestë** e namazit është **lëshuarja e ballit përtokë** (suxhud).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që ballin dhe gishtri-njtë e njërës këmbë, t’i lëshojmë në tokë në drejtim të kiblesë. Është traditë e Pejgamberit a.s. që gishtërinjtë e të dy këmbëve te kthehen kah kibleja. Sipas Ebu-Jusufit është urdhër i Allahut të Lartësuar që

në sexhde të qëndrohet aq kohë sa të shprehet një lartësim i Allahut xh.sh. (tesbih). Sipas të tjerëve nuk është urdhër i Allahut të Lartësuar.

**Shtylla e gjashtë** e namazit është **ulja në fund** (ka’de-i ahire).

**Qëllimi:** Qëndrimi ulur në fud të namazit për aq kohë sa të këndojmë ettehijatin, është urdhër i Allahut të Lartësuar. Dhënia selam pas ettehijatit është sygjërim i Allahut të Lartësuar (vaxhib).

**Paralajmërim:** Këto dymbëdhjetë urdhërat e namazit, gjinden në librin e Halebiut. Por nuk kanë mbetur njerëz që dinë të shërbehen plotësisht me Halebinë. Sepse, gjërat po shkojnë ashtu që, nxënësit nuk po i dëgjojnë arsimtarët dhe po lexojnë çka po duan, si po duan dhe sa po duan.

**Përfitim:** Duke qenë e qartë thënia e dijetarëve të fesë (ylemasë) se devocionet mbështeten në urdhërat e Allahut xh.sh. (farze), në sygjërimet e Tij (vaxhibe) dhe në praktikën muhamedane (synnete) dhe nëse njëra prej këtyre është e mangët, devocioni është i papranueshëm ose i papëlqyeshëm (mekruh); - Po ashtu edhe thënia e Pejgamberit tonë a.s. “Gjumi i dijetarit është më i mirë se devocioni i injorantit”; - Po ashtu, përkritazi me këtë edhe thëniet e dijetarëve: “Fjalët e dijetarëve t’i studiosh, ose t’i lexosh, ose t’i dëgjosh, të katërt nuk ka, sepse do shkatërrosh” dhe “Sevapi i çdo devocioni është sipas diturisë, përkorisë, sinçeritetit dhe qëndrushmërisë së individit”. - Po ashtu edhe thënia e Pejgamberit a.s. “Dy rekat namaz nga dijetari i devotshëm janë më të mirë se devocioni i vazhdueshëm i tërë njerëzve”; Përkritazi me këtë janë edhe thënit tona: “Dashurija ndaj kësaj jete, aq na i ka marrur ment dhe na ka vërbuar, sa që asnjëra prej këtyre thënieve, nuk po na hyn në vesh” dhe “Dy bostana nuk rrinë nën një nësqetull”. Tanimë askush nuk po mundohet për ta njohur fenë tonë. Madje, duke qenë të qarta për ne, mundimet e mëdha të vdekjes dhe të varrit, ato nuk po na bien ndër mend. Arsimtarët (studiuesit) po studiojnë vetëm sa për të shti në dorë të mirat e kësaj jete, jo më shumë. Studentët, duke i parë në këtë gjendje arsimtarët, po studiojnë vetëm aq sa mos t’ju ikin nga dora të mirat e kësaj jete, dhe për këtë jetë, po hyjnë në çfardo



dere dhe po marrin nga çdokush, të lejuarën (hallall) qoftë, apo të palejuarën (haram). Po ashtu, për qëllime të kësaj jete, ata po tregojnë aq shumë dashuri ndaj të pasurve, sa që, madje edhe nderimin të cilin vet e meritojnë, po ua bëjnë atyre. Duke i parë studiuesit dhe studentët në këtë gjendje, injorantët iu kanë lëshuar dynjasë si ujë dhe duke marrë këshillat e tyre si sinjale të urrejtjes dhe të keqes, nuk po i dëgjojnë dhe nuk po i përmbahen atyre. Duke i parë këta në këtë gjendje, dijetarët po frigohen që ta flasin të vërtetën dhe janë bërë dyfytës (hipokrit) dhe të butë, sa që na kanë gjetur thëniet: “Peshku qelbet nga koka” dhe “Dijetari është kremi i botës”, sepse ilaqui i këtyre sëmundjeve që u kumtuan, ta din se janë këto: Të përkushtuarit (vetëm: N.K.) kësaj jete është budallaki; Dashuria për këtë jetë është filli i çdo mëkati. Kanë thënë se ai që është i dhënë pas qejfeve të kësaj jete është qen. Po ashtu kanë thënë se devocionit të injorantit nuk i bëhet nderim. - Dhe se padituria (injanca) është shëmtia më e madhe se çdo shëmti. - Dhe se gjysëm dijetari e prish fenë, dhe kanë thënë se ndoshta e keqja e tij është më e poshtër se e shejtanit. Po ashtu, të këqijat e njerëzve tregojnë se dijetarët janë të këqinjë. Kanë thënë se dijetari që nuk bën vepra të mira, me dituri, është sikur gomari, ndoshta sikur qeni që pason epshin.

### **PJESA E PESTË** **Urdhërat e abdestit** **(Farzet)**

Janë katër urdhëra të abdestit.

**Udhëri i parë** i abdestit është **larja e fytyrës**.

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që, një herë, të lajmë me ujë pjesën nga vendi ku përfundojnë qimet e kokës e deri nën mollëzën e fytyrës po ashtu dhe ndërmjet dy veshëve, të cilën e quajmë fytyrë. Është traditë muhamedane që fytyrën ta lajmë tri herë. Po ashtu është traditë muhamedane që tri herë ta shpëlajmë gojën dhe hundën.

**Urdhëri i dytë** i abdestit është **larja e krahëve**.

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që një herë të lajmë duart bashkë me brryla. Është traditë muhamedane që ti lajmë tri herë.

**Urdhëri i tretë** i abdestit është **fërkimi i kokës** (mes'h).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që një të katërtën e kokës t'a fërkojmë me dorë të lagur një herë.

**Urdhëri i katërt** i abdestit është **larja e këmbëve**.

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar<sup>19</sup> që një herë të lajmë këmbët me gjithë nyjet.

### **PJESA E GJASHTË** **Urdhërat e guslit** **(Farzet)**

Janë tre urdhëra të guslit. **Qëllimi:** Janë tre urdhëra të Allahut të Lartësuar përkitazi me larjen e personit që ka pollutuar apo femra që ka kryer menstruacionet ose lehoninë.

**Urdhëri i parë** i guslit është **shpëlarja e gojës** (madmada).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që një herë të marrim ujë në gojë dhe ta qojmë në çdo pjesë të gojës. Sipas disave ujin duhet lëvizur nëpër gojë. Shpëlarja më e mirë është kur bashkë me gojën e shpëlajmë dhe fytyrën (gargara). Është traditë muhamedane që këtë ta bëjmë tri herë.

**Urdhëri i dytë** i guslit është **shpëlarja e hundës** (istinshak).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që një herë të marrim ujë në hundë dhe ta qojmë në çdo pjesë të sajë. Shpëlarja më e mirë e hundës është kur tërhiqet uji me frymëmarrje deri në fund të thellësisë së kanaleve të hundës. Është traditë muhamedane që këtë ta bëjmë tri herë.

<sup>19</sup> Në kopjen e dorëshkrimit, gabimisht është shkruar fjala synnet, në vend që të shkruhej farz. Besojmë se është fjala për gabim të kopjuesit.

Shpëlarja e gojës dhe e hundës në abdest është traditë muhamedane, nuk është urdhër i Allahut të Lartësuar.

**Urdhëri i tretë** i guslit është **larja e tërë trupit**.

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që duke quar ujin në çdo pjesë të trupit, të lahemi një her. Të mos mbeten pa u larë: kthiza, lëkura midis qimevetë mjekrës apo rrënja e një qimeje, birat e vëthve të grave, mukoza e zgavrave të hundës si dhe asnjë vend, qoftë madje edhe sa maja e gjilpërës.

Përndryshe, të paktën pa u lagur këto që u përmendën, nuk lejohet namazi. Femrat nuk janë të urdhëruara nga Allahu i Lartësuar që të lagin pjesën e flokëve që i kanë të thurura gërshet, mjafton që të lagin pjesën themelore të tyre. Është traditë muhamedane që trupin ta pastrojmë tri herë.

## PJESA E SHTATË

### Urdhërat e pastrimit simbolik (tejemmum) (Farzet)

Janë tre urdhëra të pastrimit simbolik. **Qëllimi:** Ata të cilët janë të detyruar që të marrin abdest apo gusul, por nuk gjendet ujë, ose janë të smurë, ose nuk kanë mundësi ta përdorin ujin, për të falur namaz, janë të detyruar që të bëjnë pastrim simbolik me dhé, pastrim ky që i ka tre urdhëra të Allahut të Lartësuar.

**Urdhëri i parë** i pastrimit simbolik është **vendosja** (nijjeti) për të bërë pastrim simbolik (tejemmum).

**Qëllimi:** Është urdhër i Allahut të Lartësuar që të thuhet synimi i pastërtisë që bëjmë duke përdorë dheun për të falur namaz.

**Urdhëri i dytë** i pastrimit simbolik është që me të dy shuplakat e duarve, një her, t'i biem dheut, apo sendit që është nga dheu dhe me to të përfshimë dhe të fërkojmë fytyrën.

**Urdhëri i tretë** i pastrimit simbolik është që përsëri me të dy shuplakat e duarve, një her, t'i biem dheut, apo sendit që është nga dheu dhe me to të përfshimë dhe të fërkojmë krahët.

**Paralajmërim:** O i mençur! Të mos jesh i kënaqur me sasinë e shkrimit në këtë librin tonë të paralajmërimeve, sepse rregullat dhe mësim-besimi, që janë nevoja të fesë, vlejnë veçse në librat si: Halebij, Mylteka, Tarikati Muhammedijje, Shifa-i Sherif. Por, ta din se nuk ka mbetur njëri që din të shërbehet me to për të parashtruar, qoftë madje disa rregulla të mirëfillta të këtyre librave dhe, poashtu, nuk ka mbetur kush që këto t'i lexojë ose t'i dëgjojë. Posaçërisht, njerëzit e komunitetit tonë kanë braktisur plotësisht kuptimin e Kur'anit që është Tefsiri, shpirti i besimit dhe memzi që i lexojnë fjalët dhe rreshtat e tij. Nëse dëshiron më shumë sqarime që janë në pajtim me këto, kemi shkruar në komentin **Hyda Rabbëm**, pastaj në **Hazine-i Din**, pastaj në **Vehbijje** e cila është shqip. Le të dihet pra, se këto janë shkruar nga **“Zaif” Tahiri**.

\* \* \*

**Këtu** kemi dhënë përshkrimin e vendosjes (nijetit) turqisht për pesë kohët e namazit, poashtu, jemi përpjekur që shkurtimisht të përshkruajmë se si do të gjindesh në namaz, pastaj do lexosh librin Halebi(ut) dhe do falesh.

**Vendimi i namazit të sabahut bëhet kështu:** Vendosa që të fali synetin e namazit të sabahut, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber; Vendosa që të fali farzin e namazit të sabahut të sotëm, iu mbështeta imamit, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të drekës bëhet kështu:** Vendosa që të fali synetin e namazit të drekës, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber; Vendosa që të fali farzin e namazit të drekës së sotme, iu mbështeta imamit, All-llahu ekber; vendosa që të fali synetin e fundit të namazit të drekës, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të ikindisë bëhet kështu:** Vendosa që të fali synetin e namazit të ikindisë, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber;

Vendosa që të fali farzin e namazit të ikindisë së sotme, iu mbështeta imamit, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të akshamit bëhet kështu:** Vendosa që të fali farzin e namazit të akshamit të sontëm, iu mbështeta imamit, All-llahu ekber; Vendosa që të fali synetin e namazit të akshamit, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të jaciesë bëhet kështu:** Vendosa që të fali synetin e parë të namazit të jaciesë, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber; Vendosa që të fali farzin e namazit të jaciesë së sotme, iu mbështeta imamit, All-llahu ekber; Vendosa që të fali synetin e mbramë të namazit të jaciesë, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të vitrit bëhet kështu:** Vendosa që të fali namazin e vitrit të sontëm, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të xhymasë bëhet kështu:** Vendosa që të fali synetin e parë të namazit të xhymasë, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber; Vendosa që të fali farzin e namazit të xhymasë, iu mbështeta imamit, All-llahu ekber; vendosa që të fali synetin e fundit të namazit të xhymasë, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber; Vendosa që të fali farzin e drekës që ka ardhur dhe ende nuk e kam falur, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber; Vendosa që të fali synetin e kësaj kohe, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të teravisë bëhet kështu:** Vendosa që të fali namazin e teravisë, iu mbështeta imamit, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të bajramit bëhet kështu:** Vendosa që të fali namazin e bajramit, iu mbështeta imamit, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të kompezuar (kaza) bëhet kështu:** Vendosa që të fali me kompenzim namazin farz të sabahut të parë të mbetur, u drejtova kah kibleja, All-llahu ekber.

**Vendimi i namazit të xhenazes bëhet kështu:** Vendosa që të fali namazin për Allahun, lutjen për këtë të vdekur, iu mbështeta imamit, All-llahu ekber.

**Për çdo namaz shtesë (nafile), mjafton që të thuhet:** E vendosa që të fali namaz.

**Pas kësajë,** le të sqarojmë tani përshkrimin e namazit, por pa e ditur emrin e çdo gjëje që është në namaz, është vështirë që të bëhet përshkrimi i tij, prandaj le të fillojmë të sqarojmë emrat e çdo gjëje të namazit. Allahu na udhëzofte në sukses!

- Qëndrimi në këmbë quhet **kijam**.
- Thënia “All-llahu ekber” në hyrje të namazit, quhet **tahrim** dhe **iftitah tekbir**. Në rastet tjera, kjo quhet vetëm **tekbir**.
- Këndimit të “Subhaneke-All-ahumme” i thonë **thenâ (senâ)**.
- Këndimi i “Eudhu bi’l-lahi mine’sh-shejtani’r-raxhim”, quhet **teav-udh (teav-vuz)**.
- Këndimit të “Bismil-lahi’r-rahmani’r-rahim” i themi **besmele**.
- “El-hamdu li’l-lahi rab-bil alemin”, quhet **fatiha**.
- Pjesa e Kur’anit ndërmjet dy besmeleve, quhet **sure**.
- Pjesa e Kur’anit ndërmjet dy pikave quhet **ajet**.
- Këndimit të tre ajeteve i themi **kiraet**.
- Përkulja nga kijami, quhet **ruku’**.
- Shqiptimit të “Subhane rab-bije’l-adhim” i thonë **tesbih**.
- Të drejtuarit e trupit nga ruku’ja quhet **kavme**.
- Emri i “SemiAll-llahu limen hamiheh” është **tesmi’**.
- Emri i “Rab-bena leke’l-hamdu” është **tahmid**.
- Rënia për toke quhet **sexhde** apo **suxhud**.
- Shqiptimi i “Subhane rab-bij’el-a’la” quhet **tesbih**.
- Ulja pas sexhdes quhet **xhelse**.
- Dy sexhdet me të gjitha këto që u thane më lartë përbëjnë një **rekat**.
- Ulja në mes dhe në fund të namazit quhet **ku’ud** ose **ka’de**.
- Ulja e pare quhet **ka’de-i ula**, kurse ulja e mbramë quhet **ka’de-i ahire**.
- Këndimi i “Et-tehij-jatu li’l-lahi” quhet **tehij-jat** dhe **tesheh-hud**.
- Këndimit të “All-llahum-me sal-li ala Muham-medin” i themi **dua**ja e **salavatit (salavat duasi)** dhe **salavat**.
- Këndimit të “All-llahum-me in-na nesteinuke” i themi **dua**ja e **kunutit (kunut duasi)** dhe **kunut**.
- Të gjitha këto me **selam**, arabisht quhen **salat**, kurse turqisht quhen **namaz**.

## PJESA E TETË

### Përshkrimi i namazit

Pesoni që synon të hyn në namaz, së pari kthehet kah kibleja, pastaj e merr vendimin, dhe menjëher pas kësaj thotë “All-llahu ekber”. Nëse vendimi bëhet me gjithë zemër është më i vlefshëm. Është më e vlefshme që të trija këto: vendosja, ngritja e duarve dhe thënia “All-llahu ekber”, të bëhen së bashku dhe për një moment. Disa kanë thënë se është më e vlefshme që pas ngritjes në thirrjen për namaz (kamet) të thuhet “All-llahu ekber”, duke ngritur duart lartë, ashtu që shuplakat të jenë të kthyer kah kibleja dhe gishtat të jenë të shtrirë. Gishtat e mëdhenjë afrohen përballë laprave (të buta) të veshëve, sipas disave, i prekin ato. Pastaj me gishtin e madh dhe me gishtin e vogël të dorës së djathtë rrethohet nyja e dorës së majtë, kurse tre gishtat tjerë mbahen të shtrirë mbi krahun e majtë dhe kështu vendosen nën kthizë. Pastaj këndohet Subhaneke All-llahume, pastaj Eudhu bi’l-lahi, pastaj Besmele-ja, menjëherë pastaj Fatiha dhe pas Fatiha-s këndohet një sure. Pas këtyre shkohet në përkulje dhe sapo të fillohet me u përkulë, fillohet të thuhet “All-llahu ekber” dhe kur të arrihet përfundimisht në përkulje, përfundohet edhe kjo thënie. Në këmbë (kijam) dhe në përkulje (ruku’), nuk thuhet All-llahu ekber sepse është e papëlqyeshme (mekruh). Në përkulje, gishtat e duarve drejtohen dhe mbështeten fortë për gjunjët. Koka dhe shpina qëndrojnë në një pozitë aq të rrafshët, sa që edhe po të vëhej mbi to një tepsi e mbushur me ujë, nuk do derdhej. Pastaj tri herë thuhet “subhane rab-bij’el-adhim”, pastaj duke u kthyer në pozitën e qëndrimit drejt në këmbë, thuhet “semiall-llahu lîmen hamideh” dhe në të drejtuarit plotësisht thuhet “rab-bena leke’l-hamd”. Pasi që të qetësohen plotësisht gjymtyrët e trupit në këmbë, duke thenë “All-llahu ekber” shkohet në sexhde. Është veprim i papëlqyer te Allahu i Lartësuar (mekruh) që të thuhet “All-llahu ekber” para se të fillohet të shkohet në sexhde, apo pas rënies në sexhde. Po ashtu është veprim i papëlqyer, të mbajturit me duar pa nevojë, duke shkuar në sexhde. Fillimisht vëhen gjunjët në tokë, pastaj gishtat e duarve

dhe menjëher pastaj, ndërmjet dy duarve, vëhet koka, ashtu që edhe nëse do pikonte nga veshët nga pikë uji, do të duhej të binte në mes të duarve. Sexhde bëhet me ball të çveshur (të pambuluar). Sexhde nuk bëhet mbi sendin me të cilin e kë të mbështjellur kokën, sepse është veprim i papëlqyer (mekruh). Sexhde bëhet me ball dhe me hundë. Është e papëlqyeshme që të bëhet sexhde vetëm me ball. Në sexhde gishtat e këmbëve mbahen përballë kibbles. Kanë thënë se namazi është i palejueshëm nëse nga dy prej gishtave të këmbëve lëshohen, respektivisht nese nga tre prej tyre vendosen kah kibleja. Vetëm nga njëri gisht i këmbëve nëse lëshohet është e papëlqyeshme. Sipas traditës muhamedane, në sexhde nuk ngriten barku dhe kofshët, poashtu edhe krahët nuk qiten anash. Në sexhde thuhet tri here “subhane rab-bi’el-a’la” dhe pastaj, duke thenë “All-llahu ekber”, shkohet në ulje (xhelse). Sapo të qetësohen gjymtyrët, duke thenë “All-llahu ekber” shkohet në sexhden e dytë. Kur të kryhet sexhdeja, ngritemi për reqatin e dytë, pa i mbështetur duart për toke, pa nevojë. Lidhen duart dhe menjëherë këndohet besmele-ja, pastaj Fatiha, pastaj një sure. Pas këtyre shkohet në ruku, pastaj në kavme dhe menjëher pastaj shkohet në sexhde. Pasi që të kryhet sexhdeja e dytë e reqatit të dytë, ulesh mbi këmbën e majtë duke mbatur të këthyer kah kibleja gishtat e këmbës së djathtë. Duart i vën mbi gjunjë duke i zgjatur gishtat barabar me gjunjët. Tani këndon tehi-j-jatin. Në uljen e parë kendo vetëm tehi-j-jatin, mos këndo salavatet. Pasi që të ngritemi për të falur reqatet e mbetura, në namazet farz, këndohet vetëm besmeleja dhe Fatiha, sureja dhe eudhu-ja nuk këndohen. Në namazet syn-net, në namazet nafîle dhe në namazin e vitrit, në çdo reqat pas fatihas këndohet një sure. Në namazin e vitrit, në reqatin e tretë, pas këndimit të sures, ngriten duart si në fillim të namazit, dhe pasi që të thuhet “All-llahu ekber”, dhe menjëher pastaj lidhen duart dhe këndohet dua-ja e kunutit. Te sejcili namaz, në uljen e fundit, pas tesheh-hud-it, këndohet salavati - dua-ja. Më pastaj jepet selam, së pari në anën e djathtë e mandej në të majtën. Madje, salami që jepet në të dy anët, bëhet nijet që t’u jepet me leqëve që janë pranë nesh dhe iu jepet atyre. Imami e bën nijet që t’u jep selam me leqëve që i janë mbështetur dhe që janë përballë tij, poashtu

edhe atyre njerëzve që janë falur me te, qofshin madje dy veta. Nëse janë në të djathtë të imanit, e ban nijet në të djathtë, nëse janë në të majtë të tij e ban nijet në të majtë. Nëse je imam e bën nijet që t'u jep selam njerëzve dhe melekëve që i ke në anën e djathtë, poashtu njerëzve dhe melekëve që ke në anën e majtë dhe iu jep selam.

Le të dihet se përsioni që falet me imam, nuk këndon eudhu-besmelen, fatihan dhe suren, po ashtu nuk thotë “semiall-llahu limen hamideh”, ndërsa gjërat tjera i këndon. Le të dinë, poashtu, ata që janë të denjë të falin namaz, se kur janë duke qëndruar në këmbë, sytë i mbanë në vendin e sexhdes, kur janë në përkulje, sytë i mbanë në këmbët e veta, kur janë në sexhde sytë i mbajnë në dy anët e hundës dhe kur janë të ulur, sytë i mbanë në prehër. Këto janë domosdoshmëri të përkorisë.

**Paralajmërim:** Namazi i femrave, në ca vende, dallon nga namazi i mashkujve. Së pari, me rastin e marrjes së tekbitit fillestar, femrat i ngrenë duart deri te mjekra; - Duart e lidhura i vënë mbi gjoksa; - Në të përkulur (ruku'), kokën dhe supet i çojnë pak më poshtë se prapanica, po ashtu me gishtat e duarve nuk i shtrëngojnë gjunjët por i vënë pak më lartë nga gjunjët. Gjithashtu, në sexhde krahët i mbajnë të përpjekur për ijet. Barkun dhe kofshët i mbajnë të përpjekura. Po ashtu me krahë prekin token. Ato në qëndrimin ulur, këmbët i kthejnë kah ana e djathtë dhe ulën në kofshën e majtë.

Pastaj, le të dihet se në uljen e parë të namazeve synet, katër reقاتshe, të ikindisë dhe të jacisë, pas këndimit të tehi-jatit, këndohen edhe salavatet, gjithashtu edhe kur të ngritemi për ti falur dy reقاتet e mbetura, këndohet subhaneke dhe eudhu, sikurse në reقاتin e parë. Po ashtu, është e dëshirueshme (mustehab) që në reقاتin e parë të synetit të sabahut, pas fatihas të këndohet sureja “Kul ja ej-juhe'l-kafirune” dhe në reقاتin e dytë, të këndohet sureja “Kul huvall-llahu ehad”.

Le të dihet se përsioni që fal namaz të xhenazes, qoftë imam apo xhemat, pas tekbitit të parë, këndon subhaneke-n, pas tekbitit të dytë, këndon salavatet, pas tekbitit të tretë, këndon duanë e xhenazes dhe pas tekbitit të katërt, njeriu i pjekur, bën tekbit, dhe ai që i është mbë-

shtetur imanit, kur të jep selam imami, menjëher jep selam. Përveç tekbitit, nuk këndohet asgjë, pa u ngritur xhenazeja.

**Paralajmërim:** O i mençur! Dije ti se kushtet e namazit, madhështia e tij, vlera e atij që e fal, ndëshkimi i atij që nuk e fal, mjerimi i atij që e falë ndonjëherë, gabimi i atij që e falë me mangësi, sevapi e atij që e fal me xhemat dhe dëmi i atij që nuk e fal me xhemat namazin, janë shpjeguar plotësisht dhe hollësisht në librat: Halebij, Sherhi Kebir, Muad-dili salat dhe të ngjashme me këto.

Letë dihet se në vitin 1252 H./ 1836 ka hedhur themelet injoranca. Madje edhe diturinë e fesë e ka pëfshirë turpi. Këshilla e fesë është marrë sinjal i të keqes. Injoranti i pavlerë me të ngjashmin ka arritur famë. Mirëfolësi është denoncuar prej mirësisë. Nxënësi po i bën shpifje mësuesit të tij. Duke u pëlqyer vetvetja, këshilla është bërë e papranueshme. Disa po bëjnë tregëti duke shitur Kuranin. Duke ikur nga kuptimi tij (Kur'anit), janë dhënë pas kënaqësisë dhe argëtimit. Sejcili djal po nënçmon botëkuptimet e babës. Sejcila grua është bërë pushtet i burrit; -Janë armiqësuar dhe po ia hanë mishrat njëri tjetrit.) Kënaqu me kaq dhe dije se heshtja është shpëtim. Kush më këndon rahmet, Zoti ia largoftë zahmetin. Falemnderi Zotit që më mësoi mirësi, libri im i **Paralajmërimeve** përfundoi. **“Mos harro ti me tho:n Tahir Efendija njeri mi:r u ko:n, Zotyn i boft rahmet përgjithmo:n”.**

U pëfundua me ndihmën e Zotit - mbret i bëmirisë, më 29 Ramazan të vitit 1252 H/ 1836.

Nehat Krasniqi

## TAHIR EFENDI BOSHNIJAKU – GJAKOVA (1770-1850)

### (Summary)

Tahir Efendi is also known as Tahir Efendi Boshnjaku, Tahir Efendi Gjakova and Tahir Efendi the Great. He was called Boshnjaku because he was born in Yeni Pazar (Novi Pazar). He was called Gjakova because he lived there (he began his professional career there). He was called the Great as a sign of respect for his work.

According to his daughter, he was born around 1770 in the village of Llukare some 6 km. to the south-west of Yeni Pazar. The villagers of Llukare were members of the Saraçi and Pllojaj families. The Saraçi family is part of the Kastrati clan.

نهاد كراسنيشي

## طاهر افندى بوشنياكو – جاكوفا

(1770-1850)

### (خلاصة البحث)

طاهر افندى معروف في التراث الالباني بالقاب ثلاثة: طاهر افندى بوشنياكو و طاهر افندى جاكوفا و طاهر افندى الكبير. لقب ببوشنياكو لأنه ولد بمدينة "بيني بازار" (السوق الجديدة) حيث عاش الالبان بجوار البوشنيك و لقب "بجاكوفا" لأنه بدأ ممارسة مهنته بمدينة جاكوفا و قضى حياته فيها و لقبوه بطاهر أفند "الكبير" احتراماً لعمله الكبير الذي ترك وراءه.

بناء على المعلومات التي قدموها لنا ورثة إبنة طاهر افندى، حليمه يظهر انه من مواليد 1770 بقرية "لوكاره" التي تقع على مسافة 6 كيلومترات في جنوب الغرب من مدينة يني بازار. و ينتمى سكان هذه القرية إلى عائلتين كبيرتين و هما، عائلة "ساراج" و عائلة "بلوفغه" و عائلة "ساراج" التي ينتمى اليها طاهر افندى تتبع قبيلة "كاستراتي".

## TRASHËGIMI

**Abdullah Rexhepi**

### LETËRSIA MISTIKE ISLAME DHE MEVLANA RUMIU

Misticizmi është njëri ndër manifestimet më madhështore të mendimit dhe prirjes dhe gjithashtu është përsosje e të menduarit dhe perceptuarit njerëzor. Në literaturën islame nuk ka ujdj lidhur me domethënien e fjalës sufi dhe, në përgjithësi, autorët nuk janë në një mendje as për ligjshmërinë e saj në Islam. Ata që e përdorin këtë fjalë në kuptimin pozitiv, e lidhin me një diapazon të gjerë idesh dhe konceptesh që kishin të bënin me arritjen e përsosjes njerëzore duke ndjekur modelin e Muhamedit a.s., kurse ata që e përdornin në kuptimin negativ, e shoqëronin me shtrembërimet e ndryshme të mësimave islame. Shumica e autorëve myslimanë, që e kanë përmendur këtë fjalë, kanë marrë pozicione më të nuancuara, pa e pranuar me gjithë zemër dhe pa e anatëmuar. Në të shumtën e rasteve janë ngatërruar termet misticizëm (irfan) dhe sufizëm (tesavuf). Në terminologjinë islame sufizëm (tesavuf) ka kuptimin e rrugës apo metodës që ndiqet për t'iu afruar sa më shumë Zotit, e kjo metodë zbatohet me anë të largimit nga dëshirat dhe lakmitë e epshit dhe duke u mbështetur në parimet legjislacionit (shariatit) të fesë islame. Kurse misticizmi (irfan) është një shkollë mendore-filozofike, e cila ka për qëllim njohjen e Zotit, të vërtetat,

problemet dhe sekretet e kësaj bote, por në këtë rast jo me anë të logjikës dhe të menduarit, por me anë të perceptimit, iluminizmit dhe zbulimit spiritual. Ibni Sina (Avicena) në veprën e tij *Isharat* lidhur me mistikun, sufiun dhe asketin shkruan: “Personi që braktis pasurinë e kësaj bote dhe dëshirat e epshit quhet asket, ai që tregohet i kujdesshëm në lutje dhe devotshmëri ndaj Zotit quhet sufi, kurse individi i cili mendon në Shenjtërinë e të Plotfuqishmit, e percepton atë dhe në brendinë e tij lind drita e së vërtetës, ai është mistik, madje në disa raste kemi edhe përzierjen e këtyre treve”. Sipas Ibni Sinasë, mistiku në vete përmban edhe asketin edhe sufiun, dhe ky është një emërim më i përgjithshëm, për atë dhe në vazhdim do të përdoren termet mistik dhe misticizëm.

Lidhur me kohën e paraqitjes së misticizmit nuk kemi ndonjë periudhë të caktuar që mund të argumentohet me fakte historike. Ngase lindja apo zgjerimi i një lëvizjeje mendore apo filozofike nuk është sporadike por ajo kryhet në mënyrë graduale. Gnosa, asketizmi dhe largimi nga djallëzitë e kësaj bote, të cilat janë edhe elementet kryesore të misticizmit islam, ekzistonin edhe tek ithtarët e feve para Islamit, si te krishterët, budistët, zoroastrianët etj. Shumica e historianëve dhe kronistëve të misticizmit janë të mendimit se misticizmi islam ka lindur në shekullin e 2 h /8, kurse Shejh Attari, uvejsitët i konsideron si pasardhës të Uvejs Karanit, kurse siç dihet Uvejs Karani ka vdekur në vitin 37 hixhri. Ibnu Xhevzij thotë se emri sufi ka filluar të përmendet pak para vitit 200 hixhri.

Një grup tjetër i historianëve përkrahin qëndrimin se misticizmi islam ka lindur me Hasan Basriun (v. 110 h.) dhe janë të mendimit se ai është sufiu i parë mysliman, i cili ka folur në lidhje me misticizmin.

Njëri ndër shkaqet kryesore për daljen në pah të misticizmit është zbritja e Kur'anit të Madhërishëm dhe burimeve tjera të fesë islame. Studimi i Kur'anit dhe thellimi në ajetet e tij i tërhoqi shumë individë, të cilët mendonin se me anë të kësaj i afrohen më shumë Krijuesit të tyre. Kështu që largimi nga shoqëria dhe vetmia e mistikëve bëhej për të pasur një atmosferë të përshtatshme për të medituar mbi Zotin, kuptimin e Kur'anit dhe në ajetet e tij. Kurse disa, vetminë e mistikëve

myslimanë e cilësonin si imitim të murgërisë krishtere dhe të parimeve të disa feve të tjera. Në fakt kjo nuk është e qëndrueshme, sepse feja islame derisa njeriun e fton në besim në Zotin dhe të largohet nga teprimet e kësaj bote, gjithashtu atë e fton edhe t'i shfrytëzojë të mirat e kësaj bote dhe të përpiqet për një jetë dinjitoze (Kur'ani, 28:77). Po ashtu në shumë transmetime nga Pejgamberi i Islamit, shihet se ai myslimanët i ka penguar të ndjekin një jetë të vetmuar dhe të teprojnë në lutjet e tyre.

Studiues të tjerë mendojnë se gurra e misticizmit islam rrjedh nga mësimet dhe predikimet e Budës (563-483 para Krishtit). Buda predikonte torturimin e vetvetes dhe ishte i mendimit se tortura pakëson dëshirat dhe thoshte: largimi nga masa, mosndjekja e dëshirave të epshit, edukimi i brendësisë së njeriut dhe mundimi fizik dhe psikik i vetvetes janë elementet kryesore për shpëtimin e njeriut në këtë botë.

Rreth prejardhjes së misticizmit islam, ndikimeve të feve, shkollave filozofike dhe burimeve të mësimave mistike islame në përgjithësi, në mesin shkencëtarëve ekzistojnë divergjenca të dukshme. Disa prej tyre janë të mendimit se në mësimet dhe traditën mistike vërehet një influencë tepër e madhe e filozofisë neo-platonike. Disa mendojnë se në traditën mistike islame kanë ndikuar edhe mësimet krishtere, e sidomos tradita e mistikës krishtere të para Islamit. Kurse të tjerët theksojnë se iluminizmi i mistikëve të para Islamit dhe fetë si budizmi, maniheizmi dhe feja zoroastriane kanë lënë gjurmë të mëdha në misticizmin islam. Por, duhet theksuar se shumica e studiuesve myslimanë ofrojnë dëshmi se misticizmi islam është lëvizje autentike e myslimanëve dhe nuk ka të bëjë aspak me fetë dhe shkollave tjera të mëparshme, edhe pse ekzistojnë disa ngjashmëri mes tyre.

Modestia, përlulja dhe mohimi i vetvetes janë hapat e parë në misticizmin islam. Rumi thotë:

*Ku ke parë ti guri të gjelbërohet në pranverë?  
Bëhu dhe, që mbi ty të çelë lulja ngjyra-ngjyra*

Në librat e mistikëve kemi shumë tregime që flasin për sprovat e dervishëve gjatë ndjekjes së kësaj rruge. Mistiku është i dashuruar në bukurinë e Zotit, kështu që kushti i dashurisë është dorëzimi i tij në vullnetin e të Dashurit dhe mbështetja në mëshirën dhe udhëzimin e Tij. Mistikët, udhëtimin në rrugën e Zotit, edukimin shpirtëror dhe largimin nga vetitë e palakmueshme e konsideronin afim me Krijuesin dhe përfitim të dijes hyjnore, dije e cila, sipas tyre, dallon nga dija që zë mendja e njeriut. Hapi i parë i të dëshmuarit të robërisë dhe dashurisë hyjnore është ikja nga ankesa, ngase të ankuarit është shenjë që tregon pakënaqësinë e mistikut, kështu që ai është i detyruar që të durojë çdo dhembje dhe torturë që i jep i Dashuri i tij. Në shkollën e misticizmit dashuria është sekreti më i madh në jetë, madje mistikët mendojnë se dashuria është shkaku i krijimit të Gjithësisë. Gjatë rrjedhës historike, dijetarët në sferat e misticizmit, filozofisë, madje edhe të shkencës kanë shqyrtuar rëndësinë e dashurisë dhe kanë ofruar teori të ndryshme lidhur me të. Filozofët e shkollës neo-platonike ishin të parët që u morën me çështjen e dashurisë në Zotin. Pastaj, dashuria në Zotin u shndërrua në objektin kryesor të misticizmit iranien të para Islamit, që më vonë si duket depërtoi në mësimet e misticizmit islam. Sipas mistikëve myslimanë, vetëm dashuria ndaj Zotit është dashuri e vërtetë dhe e përhershme. Ata mendojnë se njeriu vetëm me anë të dashurisë ndaj Tij mund të bashkohet me Të dhe përsëri mund të kthehet tek Ai, nga ku dhe ka ardhur. Prandaj, dhe shkrimi apo tregimi në Zotin, mund të ndodhë vetëm me anë të dashurisë ndaj çdo gjëje që i takon Atij.



### Letërsia mistike

Mistikët pas vetes kanë lënë një trashëgimi të pasur të veprave letërore, qoftë në gjuhën arabe, persiane apo turke. Tematika e këtyre veprave është e ndryshme, duke filluar nga filozofia, komentimi dhe interpretimi hermetik i Kur'anit dhe hadithit, e deri në pasqyrimin e bindjeve, besimeve dhe termave mistike, shprehja e dashurisë dhe urtësisë, kritika ndaj racionalizmit, argumentimi i koordinimit të sheriatit me tarikatin, edukata dhe rregullat e dervishëve, traditat e teqeve, biografia dhe gjendjet shpirtërore të mistikëve të mëdhenj. Në kohën kur konkluzionet e reja nga feja dhe eksperiencat individuale shprehen me anë të gjuhës, e cila është prodhim i përvojës dhe ndjenjës, atëherë sistemi i semiologjisë gjuhësore dëmtohet nga forma natyrore e mëparshme, kështu që në mes tekstit dhe lexuesit lind nevoja për maturi e kujdes më të madh. Ajnul Kudat Hamedani (v. 525 h.) në librin e tij 'Zubdet'ul-Hakaik', fq. 67, në mes dijes, subjekti i së cilës është natyra dhe mjeti i kuptimit të saj ndjenja dhe mendja, dhe njohjes, subjekti i së cilës është metafizika, kurse mjeti i kuptimit të saj instinkti apo perceptimi, vë një dallim të madh dhe thekson se dijen mund ta shpjegojmë me shprehje të sakta dhe të koordinuara, kurse njohjen nuk mund ta përshkruajmë përveçse me terminologji homogjene. Mistikët për të përshkruar gjendjen e tyre shpirtërore përdorën një gjuhë simbolike, e cila për studiuesit ishte e vështirë për ta zbërthyer. Bejazit Bestami (v. 234) njëri ndër mistikët më të mëdhenj të historisë islame, ka thënë: "Fjalët më dalin sipas gjendjes shpirtërore që kam, por këto fjalë, njerëzit do t'i perceptojnë ashtu siç do t'ia kërkojnë rrethanat e tyre kohore, madje perceptimin e tyre personal nga fjalët e mija do ma atribuojnë mua". Fjalët e këtij mistiku dëshmojnë për vështirësinë e kuptimit të letërsisë mistike. Andaj, disa nga mistikët myslimanë, njohjen e historisë, filozofisë dhe rregullave mistike, madje edhe përjetimin personal të gjendjes së mistikut e kanë cilësuar si kriterin parësor për kuptimin dhe komentimin e vargjeve të poetëve mis-

tikë. Kështu që, letërsia mistike për nga kuptimi i saj gjuhësor ndahet në tre grupe:

1. Letërsia mistike, në shkrimet e së cilës gjuha përdoret për interpretimin, komentimin dhe shpjegimin e një çështjeje apo koncepti, me qëllim transferimin e tij deri te lexuesi, kurse personifikimi gjuhësor në këto vepra përbëhet nga figurat letrare dhe mjeshtëria e autorit për të krijuar.
2. Letërsia mistike, në veprat e së cilës gjuha përdoret për interpretimin e një kuptimi, por kësaj radhe është e përzier me emocionet apo ndjenjat e autorit, dhe në këtë rast, ndikimi i ndjeshmërisë emocionale i fal gjuhës një personifikim, kështu që ndonjëherë ndjeshmëria emocionale shkakton zbehjen e interpretimit të kuptimit që synohet.
3. Letërsia mistike, ku gjuha është në shërbim të pasqyrimin të përjetimeve shpirtërore personale, prandaj dhe nuk mund të përfitohet një dëshmi e kuptueshmërisë së kësaj gjuhe për shkak të mosnjohurisë me këto përjetime shpirtërore të përbashkëta dhe universale, dhe për arsye se gjuha ka indikacione në sistemin e leksikografisë.

Është e vështirë të përcaktohet një periudhë e saktë për fillimin e letërsisë mistike. Me lindjen e misticizmit islam, gradualisht u zhvillua edhe letërsia mistike. Kjo lloj letërsie edhe pse në shekullin e 3 h. / 9 m. nuk krijoi ndonjë interes të veçantë, pas kësaj periudhe pati një ngritje të jashtëzakonshme në botën islame. Mistikët në shekujt e parë, pra 2-8 dhe 3-9, më tepër shkruanin traktate me tematikë mistike, me anë të së cilave jepnin udhëzime, këshilla dhe mësimet fetare, si lutja (ibadeti), ruajtja nga gjërat e palakmueshme, largimi nga shoqëria dhe mbyllja në vetmi. Këto traktate janë shkruar zakonisht në gjuhën arabe. Përkrah këtyre traktateve mistike në këtë periudhë gjithashtu u shkruan edhe disa libra, në të cilët shqyrtoheshin çështje me tematikë filozofike dhe mistike.

Siç u theksua më lart, mistikët përdornin rrugë të ndryshme për të krijuar një gjendje të lartë shpirtërore, kurse këtë gjendje e cilësonin si

afrim më afër Zotit. Ata në fillim, nëpër teqe apo vende të caktuara filluan të kërkonin mjete që atyre do t'ua sillnin këtë gjendje të lartë shpirtërore, e që në terminologjinë mistike quhej 'halë'. Shumë shpejt arritën në përfundim se mjeti më i mirë për arritjen në halë ishte poezia e rimuar e shoqëruar me instrumente muzikore. Në këto poezi përdorshin fjalë të zbukuruara me simbole dhe metafora. Dëgjimin e kësaj muzike dhe melodie, më vonë disa nga të mëdhenjtë e misticizmit e konsideruan njërin nga parimet kryesore misticizmit dhe atë e quajtën *Sema*, që në gjuhën arabe do të thotë *dëgjim*. Ky rit i ri krijoi reagim dhe armiqësi të madhe në mesin e juristëve, filozofëve, madje edhe të disa mistikëve myslimanë. Ata kundërshtuan në formën më të ashpër dhe sillnin dëshmi se *Sema* është në kundërshtim me sheriatin islam. Megjithatë, të gjitha veprat me tematikë mistike që u shkruan në shekujt 4 h.-10 m. dhe 5 h.-11 m. shqyrtonin çështjen e *Sema* dhe përkrahnin atë me një entuziazëm të jashtëzakonshëm. Kishte edhe nga mistikët që nuk pajtoheshin me këtë rit të ri të teqesë, por në mesin e tyre, Gazaliu (v. 505 h. - 1111 m.) doli në përkrahje të *Semas*. Ai në veprën kolosale të tij '*Thjau Ulumud Din*' ia kushtoi një pjesë të rëndësishme kësaj çështjeje dhe solli fakte që *Sema* nuk është në kundërshtim me rregullat dhe parimet e fesë islame. Përmbledhja e shqyrtimit të Gazaliut në këtë vepër për *Sema* më vonë u transmetua edhe në veprën tjetër të tij, '*Kimija-u Sa'adet*'.

Nuk duhet harruar se edhe para kësaj periudhe, mistikët e mëdhenj krijonin gazele me tematikë dashurie për Krijuesin. Më pastaj këto gazele lexoheshin bashkë me instrumente muzikore dhe krijonin atmosferën nëpër vendet, ku mbledheshin mistikët. Gazaliu theksonte se për të organizuar ceremoninë e *Semas*, poezitë e dashurisë janë të domosdoshme, po ashtu duhet pasur kujdes që në këto poezi të mos ekzistojnë elemente që zgjojnë lakmitë e epshit. Në veprën, '*El-Lum'a fi tesavvuf*', të Ebu Nasr Serraxhit, janë sjellë vargje të mistikëve të hershëm myslimanë, si p.sh. vargjet e Xhunejd Bagdadit, ku thotë:

*O Ti, që me fuqinë Tende ndeze zjarrin në zemrën time*

*Sa herë që dëshiroje e fikje këtë zjarr që ma përvëlonte jetën time*

*S'është turp që të gjithçka që bën me mua, s'është turp, s'është turp*

*vdes nga frika e asketizmi?*

Në shekujt e mëvonshëm *Sema* shoqërohej edhe me vallëzim, dhe kjo traditë vazhdon edhe gjatë ditëve tona.

Studiuesit (Kasem Gani, Abdulhusejn Zerrin Kub, Annemarie Schimmel) janë të një mendimi se vepra e parë prozaike me tematikë mistike është shkruar nga mistiku i njohur i Horosanit, Abdullah Bin Mubarek Meruzi, e cila quhet '*Zuhd ve Rakik*'. Por Ibni Nedimi në librin e tij '*Fihrist*' i përmend disa iraniane të tjerë të cilët në kohën e tij kishin shkruar vepra mistike dhe i përmend emrat e Jahja bin Muadh Razi dhe Ahmed bin Harb Horosani. Por, Harith bin Muhasebi pas vetes ka lënë numrin më të madh të traktateve mistike, kurse pas tij radhitet Muhammed Ebu Ali Hakim Tirmidhiu. Ibni Nedimi gjithashtu në librin e tij përmend edhe disa mistikë iraniane, për të cilët thotë se ata ishin personat e parë që në letërsinë mistike përdorën prozën e thjeshtë dhe prozën e rimuar. Në mesin e këtyre ishin edhe Xhunejdi, Rabia, Mensur Hal'laxh dhe Shibliu. Po ashtu duhet përmendur edhe emrat e Abdullah Ensari, Ahmed Gazali, Ajnul Kudat, Suhreverdi, etj., të cilët ishin edhe më të njohurit në letërsinë prozaike të rimuar.

Letërsia mistike deri në shekullin 5-11 kishte një gjuhë të thjeshtë dhe modeste, pa figura të kompleksuara letrare, por në shekujt e mëvonshëm ndryshon tërësisht gjuha e kësaj poezie dhe në të depërtojnë figura të ndryshme letrare dhe vendin e gjuhës së thjeshtë e zë gjuha simbolike. Këtë revolucion gjuhësor në letërsinë mistike mund ta justifikojmë me reagimin e mistikëve ndaj pozitës së tyre të palakmueshme që u krijua në mesin e shoqërisë myslimane, ku si shembull mund të tregohet rasti i ekzekutimit të Mensur Hal'laxhit në shekullin e 4-10. Rasti tragjik i këtij mistiku të madh, mistikëve tjerë ia tërhoqi vë-

rejtiten se më nuk mund të shprehen të lirë dhe haptazi. Në këtë periudhë, pra në shekujt 4-10, 5-11 dhe 6-12, u shkruan veprat më të rëndësishme të misticizmit islam. Në këtë kohë, mistikët u detyruan të mbrojnë besimin dhe bindjet e tyre, madje në disa raste ata morën penën në dorë edhe për të mbijetuar ekonomikisht. Ata u përpoqën që duke u mbështetur në Kur'an dhe hadithin e Pejgamberit t'i shpjegojnë të vërtetat mistike. Veprat më të rëndësishme që u shkruan në atë kohë, e që tani nga studiuesit konsiderohen edhe si burimet kryesore të misticizmit janë: 'El-Lum'a fi Tesavuf' - Ebu Serrexh Tusi (378/988), 'Tearruf' - Ebu Bekr Muhammed Kolabadi Buhari (381/990), 'Kuvvetul-Kulub' - Ebu Talib Mekki (386/990), 'Tabakati Sufije' - Ebu Abdurrahman Selimi Nishaburi (412/1012), 'Risaletu Kushejrrije' - Ebul Kasem Kushejri Nishaburi (465/1072), 'Keshful Mahxhub' - Ali Huxhviri (463/1072), 'Ihjau Ulumid Din' - Ebu Hamid Muhammed Gazali (505/1111) dhe 'Avariful Mearif' - Ebu Nefs Omer Sohreverdi (632/1234).

### Poezia mistike

Evgeni Eduardovich Bertls në librin e tij "Sufizmi dhe letërsia e sofizmit", poezinë klasike mistike e ndan në katër grupe:

1. Poezinë e elitës, e cila më tepër përmbante elemente dashurie, ku poeti i kushtonte rëndësi më shumë formës së jashtme. Këto poezi patjetër duhej të ishin të rrjedhshme si lumi Nil dhe të kuptoheshin nga të gjitha shtresat shoqërore.
2. Poezia e pastër mistike, e cila shfrytëzonte terminologjinë e hershme poetike dhe ndiqte të njëjtin qëllim. Por, ndikimi i kësaj ishte më i dukshëm, ngase qëllimi i saj ishte njohja e rrethanave, me anë të së cilave ushtrohej një ndikim më i madh te lexuesi apo dëgjuesi. Njëra nga të metat e kësaj poezie ishte fshehja e gjendjes (halit) së brendshme të mistikut.
3. Poezia metaforike, qëllimi i së cilës ishte fshehja e qëndrimit të poetit dhe për këtë përdorej terminologjia e periudhës së parë, kështu

që në këto poezi, poeti mendimin e tij e shprehte në mënyrë indirekte.

4. Gazelet me tematikë didaktike dhe arsimore. Meqenëse këto gazele burimin e tyre e kanë në misticizëm, mund t'i quajmë edhe poezi mistike autentike. Në këto gazele nuk janë përdorur termat e misticizmit, por vërehen koncepte të përgjithshme të besimit islam dhe nuk kanë dallim aspak me gazelet e llojit fetar.

Në shekullin e 2-8 tek arabët poezia mistike kishte arritur kulmin e saj. Por, nga kjo poezi shumë pak ka arritur deri në ditët tona. Dr. Muhammed Reza Shefi'i Kedkeni ka të drejtë kur thotë "Edhe sikur në shekullin 2-8 të ishte krijuar vetëm Divani poetik i Ebul Atahijes (130-210 h.), do të mjaftonte për të plotësuar zbrazëtirën e poezisë me tematikë mistike në historinë e letërsisë arabe". Divani poetik i këtij poeti arab tërësisht përmban tematikë mistike, ku njeriun e njofton për afrimin e vdekjes, e kërcënon atë se një ditë do të vdesë dhe po ashtu mallkon këtë botë. Poeti tjetër mistik arab është Ibni Farizi që (576/1181 - 632/1234), pas vetes ka lënë një Divan me poezi mistike, i cili është komentuar disa herë. Është interesant se komentimet janë bërë në bazë të shijeve personale të komentuesve, për shembull poezitë e tij nga Shejh Hasan El-Burejni (v. 1024/1615) janë komentuar në bazë të kuptimit të jashtëm dhe sipas këtij komentuesi poezitë e Ibni Farizit nuk kanë dallim me ato të Ebu Nuvasit, kurse komentuesi tjetër, Shejh Abulgani En-Nablusi, poezitë e tij i ka komentuar brenda strukturës mistike.

Më pas, tradita mistike e poezisë, nga arabët u transferua te persianët dhe këta të fundit ishin ata që këtë letërsi e ngritën në majat më të larta dhe e bënë të pavdekshme. Në historinë e letërsisë persiane ekzistojnë divergjenca se cili ishte poeti i parë mistik në Iran. Disa thonë se Ebu Said Ebil Hajr, disa përmendin Rabia Binti Keab Kazdari, e disa të tjerë janë të mendimit se poeti i parë mistik persian ishte Baba Tahiri. Historianët e letërsisë persiane janë të një mendimi se themeluesi i poezisë mistike është Senai (467 – 529). Edhe pse para tij nëpër teqe dhe tubime të mistikëve krijoheshin gazele me tematikë da-

shurie ndaj Zotit, Senaiut ishte i pari që përdori terminologji mistike në poezitë e tij. Ai në fillim ishte poet oborrtar dhe kishte fituar një popullaritet tepër të madh në mesin e elitës letrare të asaj kohe, por më vonë braktisi famën dhe pozitën që kishte dhe jetoi si një dervish i vërtetë dhe thuri poezi jashtëzakonisht të bukura mistike. Shkaku i ndryshimit të personalitetit të Senaiut është komentuar në bazë të miteve të ndryshme. Një version që transmetohet është ky: një ditë Senaiu kalonte nga hamami (banjoja e publike) i qytetit. Duke kaluar andej pa se në hamam bashkë me shërbëtorin e tij po lahej një mistik dhe poet i asaj kohe, i cili njihej me emrin “Divane-i Lajhor” që ka kuptimin “budallai që pi llumin e verës”. Mistiku në fjalë kur e pa Senaiun, të cilin e urrente sepse ishte poet i oborrit dhe thurte vetëm lavdërime për mbretin e asaj kohe Ibrahim Gaznevi (sundoi në vitet 451-492) iu kthye shërbëtorit të tij me këto fjalë: “Ma mbush kupën të pi për verbërimin e burrecit, Ibrahim Gazneviut”, shërbëtori ia ktheu: “Ibrahimi është sundimtar i drejtë e i mirë, mos e nënçmo”. Divane-i Lajhori iu përgjigj: “Po, ashtu është, por është burrec i pafat dhe despot i pamëshirshëm, akoma pa e pushtuar mirë Gaznejin, po mendon të pushtojë rajone tjera”. Pastaj e ngriti dollinë dhe e piu kupën. Përsëri iu kthye shërbëtorit: “Ma mbush kupën të pi për verbërimin e burrecit, Senai poetit”. Shërbëtori i habitur i tha: “Të lutem, mos fol fjalë të pakëndshme për Senaiun, ai është njeri elegant dhe i pranuar nga shoqëria”. -“Po gabon, ai është një burrec dhe njeri i çmendur. Për të fituar autoritet në këtë botë, ka pranuar t’i servilohet një despoti dhe ditë e natë të thurë lavdërime për atë sundimtar shtypës. Një ditë do të vijë dhe nga ky poet do të pyesin se ç’ke bërë ti për Zotin gjatë jetës tënde? Si do t’i përgjigjet ai?”, i thotë mistiku dhe e ngre edhe kupën tjetër. Kështu që Senaiu e dëgjon gjithë këtë dialog dhe pendohet njëherë e përgjithmonë. Është thënë se ky poet i madh persian ka kërkuar të digjen të gjitha poezitë e periudhës së “injurancës” siç e quante ai periudhën kur shërbente në oborrin mbretëror. Tani nga Senai kemi këto vepra: “*Hadikatul Hakika ve Sheriatut Tarika*”, “*Sejrl Ibad ilel Mead*” për të cilat disa orientalistë dhe studiues myslimanë thonë se kanë ndikuar në veprën e Dantes “*Komedia hyjnore*”. Veprat tjera të

Senaiut janë “*Karnameji Belh*”, “*Tahrimetul Kalem*” dhe gjithashtu Divani që ka përmbledhur poezitë e tij.

Pas Senaiut këtë traditë e vazhdoi Feriduddin Muhammed Attar Nishaburi. Attari pas vetes la një trashëgimi të jashtëzakonshme të poezisë mistike. Disa nga veprat e tij janë: “*Mantikut-Tajr*”, “*Tezkiretul-Evlija*”, “*Esrarname*”, “*Ilahiname*”, “*Musibetname*”, “*Lisanul-Gajb*”, etj.. Por poezinë mistike në pedestal e solli Mevlana Xhelaleddin Rumi, për poezinë e të cilit do të flitet më poshtë. Këta tre poetë persianë, pra Senaiu, Attari dhe Rumi duhen konsideruar edhe si kolosët e poezisë mistike. Më vonë poetët mistikë në poezitë e tyre më tepër qenë nën ndikimin e misticizmit teorik të Ibni Arabiut (569/1165 - 638/1240). Nuk duhet harruar se Ibni Arabiu me veprat e tij “*Futuhut ul-Mekkije*” dhe “*Fusus ul-hikem*”, në të cilat ka komentuar teorinë mistike dhe këtë e ka dëshmuar me argumente logjike-shkencore, përjetime mistike, poezi dhe interpretime hermeneutike, ka dhënë një ndihmesë tepër të madhe në zgjerimin dhe ngritjen e letërsisë mistike, e sidomos poezisë. Disa nga poetët që krijuan nën ndikimin e Ibni Arabiut janë: Evhadeddin Kermani (635/1238), Iraki (688/1289), Shebesteri (720/1320) dhe Xhamiu (898/1492). Saadiu dhe Hafizi, të cilët edhe këta janë të mëdhenjtë e letërsisë persiane, më pak ishin nën ndikimin e Ibni Arabiut. Poeti i madh i fundit i poezisë mistike është Abdurrahman Xhamiu, që pas vetes la vepra të mëdha poetike si p.sh., “*Beharistan*” dhe “*Haft Ovreng*”. Me Xhamiun letërsia mistike ndryshon rrjedhën e saj dhe e humbi frymën edukativo-didaktike. Nga ana tjetër, forma metaforike dhe gjuha me plot simbole vihet në radhë të parë të poezisë mistike. Pas Xhamiut, tregimet dhe anekdotat shumë pak përdoren në këtë poezi. Në këtë periudhë dhe më pas lind një letërsi mistike popullore. Qëllimi i kësaj letërsie ishte tërheqja e sa më shumë lexuesve. Gjuha e kësaj poezie ishte shumë e thjeshtë dhe kuptueshme për masën e gjerë të popullit. Poetët më të njohur të kësaj periudhe janë persianët si Behaeddin Amoli, Nur Ali Shahu dhe Sejfullah Shahu, dhe turqit, Ahmed Jeseviu, Junus Emre, dhe djali i Rumiut, Sulltan Veledi etj.

### Mevlana Xhelaeddin Rumi

Xhelaeddin Muhammed Mevlana - Rumi (604/1207-672/1273) është një poet voluminoz. Në bibliografinë e tij janë të regjistruar 27.000 vargje të Mesnevisë Ma'nevisë dhe mbi 42. 000 vargje të Divani Kebirit (Divani Shems Tabrizi). Edhe dy librat e tjerë janë fjalët dhe ligjëratat e tij, pra bëhet fjalë për Fihi ma fihi dhe Mexhalisi Seb'a. Po ashtu, përmbledhja e letrave (Mektubat) dhe katrenave (rubai-ive) janë botuar në vëllime të veçanta. Duhet theksuar se Rumi gjithë këtë veprimtari e ka zhvilluar vetëm gjatë 22 vjetëve të periudhës pas takimit me Shems Tabrizin.

Rumi i përket një periudhe në të cilën shkencat e fesë islame, ndër to edhe filozofia pothuajse kishin arritur kulmin e tyre. Deri në këtë periudhë ishin shtruar pothuajse të gjitha çështjet dhe filozofët, mistikët dhe juristët myslimanë kishin dhënë përgjigjet e tyre. Pak para Rumiut, komentimi dhe interpretimi i filozofisë greke në botën islame ishte kryer nga Ibni Rushdi (v. 595/1198), kurse Gazaliu nuk kishte lënë hapësirë të diskutohet më për kelamin e fesë islame. Po ashtu poezia mistike pati një zhvillim të jashtëzakonshëm nga Senaiu dhe Attari. Por edhe pse Rumi u lind në një ambient të këtillë, ai më vonë u bë përfaqësuesi i denjë i të gjithë këtyre lëmenjve.

### Burimet që frymëzuan Rumiun

Mevlana në Mesnevinë e tij, është plotësisht nën ndikimin e Kur'anit Famëllartë. Ai si një mysliman ka qenë i lidhur ngushtë me doktrinën e fesë islame dhe Kur'anit. Sipas studimeve të bëra, mësojmë se në Mesnevi janë përmendur 2200 ajete kur'anore, kurse shumë prej tyre janë komentuar dhe janë shpjeguar në poezi. Për këtë arsye dhe Mesnevia e tij është quajtur 'Kur'an në gjuhën persiane', 'komentim i Kur'anit', kurse Mevlanën e kanë quajtur si një komentues shumë të suksesshëm dhe të rrallë. Mesnevia është komentim poetik dhe mistik i Kur'anit. Mevlana edhe një pjesë të jetës së Pejgamberit të Islamit e ka komentuar në disa tregime të tij në Mesnevi. Përveç burimit hyjnor

të Mesnevisë, një burim tjetër i kësaj vepre është edhe kultura dhe gjuha e thjeshtë popullore. Molana kishte njohuri të plotë me kulturën dhe gjuhën e popullit, prandaj është përpjekur që duke shfrytëzuar tregimet dhe ngjarjet e tregut dhe rrugës që janë diskutuar në mesin e popullit, t'i shprehë idetë dhe mendimet e tij. Në veprimtarinë dhe eksperiencën mistike të Mevlanës, përpos ndikimit të Kur'anit, hadithit të pejgamberit dhe kulturës islame në përgjithësi, gjithashtu mund të vërejmë edhe gjurmë të teorive të filozofisë së vjetër greke, të fesë krishtere dhe sidomos të filozofisë së vjetër iraniane dhe induse, të cilat e pasurojnë më shumë mesazhin madhështor të këtij mistiku të madh mysliman. Vepra e tij përmban tema dhe çështje të ndryshme. Në të shihen rrezatime të thyera të besimit të Zotit semit, urtësia greke me elemente të Pitagorës, teoritë e platonike, rrjedha e përsosmërisë së Aristotelit, individualizmi i Platonit dhe ekstaza e Unitetit me Njëshmërinë, çështje të diskutueshme të kelamit islam, mendimet e Ibni Sinasë dhe Farabiut rreth esencës së dijes, teoria Gazaliut rreth dijes pejgamberike, dhe teorinë e 'Unitetit të Qenies' të Ibni Arabiut. Kurse vetë Rumi nuk pranon burim tjetër të Mesnevisë përveç Kur'anit dhe hadithit.

### Mesnevia e Rumiut

Mevlana deri në moshën 40-vjeçare nuk u mor me krijimtari poetike, por pas takimit me Shems-i Tabrizin, ai pësoi një ndryshim rrënjësor në personalitetin e tij. Ai para se të takohet me Shemsin nuk kishte vullnet për të krijuar, por Shemi në brendinë e tij ndezi shkëndijën e dashurisë apo siç shprehet Mevlana "ndezi zjarrin e dëshirës".

Edhe Mesnevia e tij është e tillë. Mesnevia nuk i përngjan Hadikasë së Senaiut dhe Esrarnames së Attarit që të shprehë konceptet e misticizmit. Ajo nuk është vepër e projektuar më parë dhe me një stil të caktuar. Përpos sistemit të brendshëm i cili është krijuar me anë të tregimeve, në Mesnevi nuk ekziston asnjë rregull apo rend tjetër, e që sipas prof. dr. Zerrin Kubit, "Mesnevi Ma'nevia, padyshim se është

krijuar nga një inspirim i lartë hyjnor, i cili ka zgjatur disa vite me radhë. Mevlana çdo vend që ka gjetur rastin dhe sa herë që është inspiruar pa marrë parasysh vendin apo kohën, si në shtëpi, xhami, hamam, duke ecur dhe çdo vend tjetër, dhe e ka shprehur atë dhe të tjerët e kanë regjistruar. Në këtë mënyrë e thurte Mesnevinë dhe në anën tjetër Hisamuddini e shkruante atë. Pra, Mesnevia është krijuar në këtë mënyrë, pa bërë plane dhe projekte të mëhershme dhe ka ardhur deri në ditët tona”.

Në Mesnevi një ide apo mendim është përfunduar me mendimin tjetër, tregimi e tërheq tregimin tjetër, dhe në këtë mënyrë në të ekziston një koordinim i lirë, pa asnjë koklavitje apo rregull të caktuar, i cili mund të pengonte të menduarit apo të krijuarit e poetit. Mesnevia në realitet është transmetim i një biografie mistike dhe fillon me gjuhën e “fyellit” dhe nuk mbaron askund, vetëm nëse në atë moment paraqitet një ngjarje tjetër, lexuesi tërhiqet në një kuptim të freskët dhe ai lundron nga një tregim në tjetrin dhe rruga e tij përfundon me tregimin e pafund apo me vdekjen e Mevlanës. Tematika e Mesnevisë më shumë është mistike. Një ndër karakteristikat e kësaj vepre, përveç thjeshtësisë së shprehjes së poetit, është pasqyrimi i gjendjes shpirtërore të poetit. Sipas dr. Zarrin Kubit, këtu Mesnevia shndërrohet në urtësi dhe filozofi dhe del nga atmosfera e tregimit, pra është poezi dhe poezi abstrakte.

Studiuesit (Zerrin Kub, Purnamdarijan, Golpinarli) tregimet e Mesnevisë i kanë ndarë në katër grupe: tregimet mistike, didaktike, kur’anore dhe tregimet alegorike. Mevlana në të gjitha tregimet ndjek një qëllim, prandaj nuk u kushton shumë rëndësi formës krijuese dhe narracionit. Ai më tepër iu është përkushtuar rrymave të fshehta të tregimeve dhe botëkuptimeve mistike. Me anë të këtij përshkrimi, tregimi ka një shpirt dhe trup, pra trupi i tij është i dukshëm, kurse shpirti i tij i fshehur, për atë dhe lexuesi e ka të vështirë ta kuptojë menjëherë qëllimin apo atë që poeti ka dashur të thotë në tregim. Disa nga tregimet e Mesnevisë kanë tematikë didaktike dhe arsimore. Në këto lloj tregime, qëllimi kryesor është edukimi dhe urtësia. Mevlana ka folur shumë thjesht dhe në çdo tregim ka ardhur në përfundimin e dëshiruar.

Poeti me anë të këtyre tregimeve ia ka arritur që një pjesë të “mësimeve edukative” t’ia përcjellë lexuesit të vet. Karakteristika kryesore e tregimeve të Mevlanës është freskia e fjalëve që i ka thënë. Fjalët e tij nuk lodhin lexuesin, ngase vazhdimisht janë të freskëta. Nëse dëshirojmë që temën apo konceptin kryesor të gjashtë vëllimeve të Mesnevisë ta përshkruajmë në një fjali, atëherë duhet të themi se Mesnevia është një tregim që pasqyron dashurinë e mistikut, i cili ka mbetur larg nga origjinaliteti dhe esenca e tij, pra larg Zotit, mistikut i cili është pastruar nga vetvetja dhe ka ikur nga çdo gjë e kësaj bote, me qëllim që të fundoset në dashurinë e Zotit Fuqiplotë.

Kur vështrojmë krijimtarinë poetike të Rumiut mund të kuptojmë se ai stilin e gjuhën poetike, konceptet letrare, muzikalitetin poetik dhe shumë çështje tjera i ka trajtuar ndryshe nga paraardhësit, bashkëkohësit dhe pasardhësit e tij. Deri në periudhën e Rumiut, madje edhe pas tij, poetët e kishin zakon që divanin dhe poemat e tyre t’i fillonin duke e falënderuar Zotin dhe po ashtu t’i përshkruanin profetët e Zotit, ku si shembull mund t’i përmendim lutjet e Firdusit, Rudekit, Unsurit, Hakanit, Menuçehrit, madje edhe lutjet e Senaiut dhe Attarit. Por, Mevlana nuk ndoqi këtë traditë, kurse për falënderimin e Zotit paraqiti një formë të re. E gjithë Mesnevia, fund e krye, ka formë të gazelit. Në tërë Mesnevinë, poeti klithë duke përkujtuar Zotin me melodinë e dashurisë, dhe mistiku digjet në zjarr nga dhembja e dashurisë së kërkimit të Zotit.

Dashuria ndaj Zotit që valonte në shpirtin e Mevlanës nuk ishte vetëm një klishe në fjalët e tij. Ai nuk mjaftonte sikur poetët e tjerë, të përshkruante bukuritë dhe karakteristikat e qiellit, tokës dhe krijesave. Emocionet që lindin nga zemra e këtij mistiku, nuk kufizohen vetëm në shprehjet poetike të një poeti. Fillimi i vëllimit të parë të Mesnevisë, është një përshkrim dhe ankim i shpirtit të mistikut, i cili largimin e tij prej atdheut të vet burimor e shpreh me anë të gjuhës së “fyellit”. Ky fillim nuk është bërë në mënyrë tjetër veçse me përkujtimin e Zotit dhe të dërguarit të Tij.

*Pa dëgjo këtë fyell se si rënkton  
Nga ndarja e tij na tregon  
Kur më ndan nga fyllishtja  
Për mua qanë burra e gra  
Dua një gjoks të përgjysmuar nga largësia  
Që atij t'ia them dhimbjen e hallet e mia*

Fyelli, që Mevlana, tregimin dhe rënkimin e tij e ka shprehur në fillim të Mesnevisë, nuk është i rastësishëm. Tregimi i fyellit në mendjen e Mevlanës ka një kuptim të lartë dhe të veçantë hyjnor. Duke u bazuar në studimet e dr. Furunzanferit, studiuesit dhe kritikut modern iranian, në Mesnevi dhe në Divani Kebir, fjala fyell është përmendur mbi 28 herë, që është një dëshmi e qartë se Mevlana këtij i ka dhënë një kuptim hyjnor dhe të posaçëm. Fyelli edhe në mitologjinë e popujve të ndryshëm ka kuptime të llojllojshme. Por Rumi, fyellin e paraqet si simbol të mendimeve dhe koncepteve të larta hyjnore. Sa herë që fyelli tregimin e tij e përshkruan me gjuhën e poezisë, çdokush prej tij dëgjon një tregim të veçantë. Tregimi i fyellit i Mevlanës, është një tregim i shpirtit të ndarë, i cili është ndarë nga esenca dhe burimi i tij dhe vazhdimisht shpreson e përpiket të kthehet në esencën e tij. Sipas dr. Zarrin Kubit, “ajo që dëgjohej në fyellin e Mesnevisë është një tregim i shpirtit të thyer dhe të vuajtur me plot aventura. Është tregim i shpirtit që është pastruar nga bota fizike, ka anashkaluar mësimdhënien dhe studimet e jurisprudence islame (fikhut), ka lënë prapa një tufan dashurie siç është dashuria ndaj Shems Tabrizit dhe më në fund është kthyer në një dëshirë të flaktë për t'u kthyer në origjinalitetin dhe esencën e tij. Shpirti që vazhdimisht kërkon dashurinë, të cilën përpiket ta nxjerrë nga ngjyrat dhe nevojat e kësaj bote dhe po ashtu ta pastrojë këtë dashuri nga kufizimet e botës së ngushtë fizike, me qëllim që ta dërgojë në botën e pafund hyjnore”.

Ky fyell, që sipas shumë komentuesve të veprave të Mevlanës, në realitet është vetë Mevlana, i cili është ndarë nga vetvetja dhe është vënë në dispozicion të dashurisë në të Dashurin e tij, pra Zotit.

Përafërsisht të gjithë komentuesit dhe studiuesit e Mesnevisë janë të një mendimi se mrekullia e poemës “Nejname” është se Mevlana gjithçka që ka dashur të thotë gjatë gjashtë vëllimeve të Mesnevisë, e ka përmbledhur në këtë poemë, pra në hyrje të vëllimit të parë të Mesnevisë. Dr. Zarrinkub thotë: “Nejname apo 16 dyvargjet e parë të Mesnevisë janë përmbledhja e gjashtë vëllimeve të Mesnevisë, të cilët e komentojnë këtë poemë dhe të gjitha tregimet në to janë të lidhura me këtë poemë. Çdo gjë që Moleviu e ka sjellë pas këtyre vargjeve, në realitet janë vetëm disa pika të reja lidhur me këtë rënkim apo ankim të shpirtit, i cili është të kërkim të të Dashurit të tij. Pikërisht alegoritë dhe tregimet që janë sjellë në vëllimet tjera të Mesnevisë janë të ndërlidhur me fillimin e Mesnevisë”.

### Mesazhi i Rumiut

Rumi është i mendimit se shpirti transcendental ekziston në të gjitha fetë dhe këtë botëkuptim e privilegjon gjatë gjithë Mesnevisë së tij. Pikërisht për këtë arsye, studiuesi i Rumiut dhe veprës së tij, anglezi R. A. Nicholson, Rumiun e konsideron më lart se Danten, ngase Danteja në “Komedinë Hyjnore”, Pejgamberin Muhammed dhe shokët e tij i vë në Ferr dhe Nicholsoni duke i krahasuar këta dy shkruan: “Mevlana vdiq disa vite pas lindjes së Dantes, por poeti i krishterë për nga dashuria, humanizmi, toleranca, mirëkuptimi dhe dashamirësia nuk mund t'i afrohet bashkëkohësit të tij mysliman”.

Njëri nga mësimet e Mevlanës për njeriun modern është qëndrimi i tij për Zotin Një, dhe koncepti për Krijuesin e gjithësisë. Ai, Zotin nuk e vështron si një arsye për arritjen e njeriut në Parajsë apo në lumturinë e përhershme. Zoti për Mevlanën aq shumë është i Dashur dhe i Bukur, saqë tërë kujtesën e tij e ka vënë në perceptimin e madhështisë së Tij. Krijuesi për Mevlanën është Krijuesi i të gjitha qenieve, është Zoti i mëshirës dhe faljes. Zoti i tij nuk është një Zot që mezi pret robi i Tij të bëjë ndonjë gabim apo mëkat dhe ta dënojë atë. Në këndvështrimin e Mevlanës, zemërimi i Zotit është vetëm ndaj jobesimtarëve, të cilët ia kanë kthyer shpinën të vërtetës dhe nuk janë të gatshëm të

pranojnë realitetin hyjnor. E kanë verbuar syrin e tyre ezoterik dhe e kanë shurdhuar veshin e tyre të brendshëm. Ai gjithashtu, dashurinë e Zotit ndaj robërve të Tij e konsideron aq të lartë, saqë është i mendimit se dënimi i këtyre njerëzve të lartpërmendur rrjedh nga sjelljet, vendimet, dëshirat e paligjshme dhe mendimet e tyre të këqija, të cilat i kryejnë gjatë jetës së tyre.

Këtë shkrim do ta përfundoj me një tregim të Mesnevisë së Mevlanës, për të cilin mendoj se është tregimi që më së miri reflekton mesazhin e këtij mistiku të madh. Përkthimi i këtij tregimi do të jetë i lirë dhe në formë të shkurtuar, sepse është tregim shumë i gjatë.

Musai a.s. një ditë derisa kalonte në shkretëtirë e pa një çoban, i cili i lutej Zotit. Ky çoban në lutjet e tij përdorte një fjalorë shumë të thjeshtë dhe popullor, dhe Zotit iu kishte drejtuar me këto fjalë: "O Zot ma trego vendin ku ndodhesh, sepse dua të të shoh. O Zot dua të ndihmoj në çastet e vështira dhe të jem ngushëlluesi Yt. O Zot gjithë pasurinë time e flijoj për Ty dhe të gjitha këngët që ua këndoj dhenve t'i kushtoj Ty". Kur Musai a.s. i dëgjoi këto fjalë iu afrua dhe e pyeti se me kë je duke biseduar në këtë mënyrë?

Çobani iu përgjigj se jam duke folur me Krijuesin tim. Me Krijuesin e çdo gjëje në këtë botë. Hz. Musai e qortoi çobanin lidhur me këtë lutje dhe i tha se kjo lutja jote është blasfemi. Kështu që mbylle gojën dhe mos u lut kështu, sepse ato që ti i thua janë nevoja të njeriut, ngrënia, pija, fjetja të gjitha i përkasin njeriut dhe Zoti është larg këtyre gjërave. Nëse ti nuk i ndalon këto lutje blasfemike, atëherë Zoti do të zemërohet dhe do ta shkatërrojë këtë botë. Dhe mos harro se ti cilësitë e njeriut po ia atribuon Zotit të Madhërishëm, në kohën kur Zoti është shumë më i lartë dhe më i mirë. Hz. Musai me çobanin foli shumë fjalë të këtilla dhe atë e poshtëroi shumë. Çobanit iu thye zemra dhe u pikëllua shumë, kurse po në atë moment nga Hz. Musai kërkoj falje dhe nga pikëllimi i madh e shqeu këmishën e tij. Nga brendia e nxori një rënkim të madh dhe mori rrugën e shkretëtirës. Si i çmendur dhe i dashuruar u sul në drejtim të shkretëtirës dhe duke dënesur humbi thellë në horizontin e saj. Në këtë moment nga ana e Zotit të Madhërishëm, Musait a.s. i zbri shpallja:

*"O Musa pse ma largove robin tim nga adhurimi, e bëre atë të pashpresë nga mirësia dhe falja Ime. Unë asnjëherë nuk i marr parasysht gjërat e jashtme (dukshme) të robit, ngase për Mua brendia e tij e bazuar në besnikëri dhe dashuri është shumë më e rëndësishme, sesa pamja e tij e jashtme. O Musa, grupi që më kërkojnë dhe më dashurojnë Mua janë të pikëlluar dhe zemërthyer. Ata më adhurojnë në bazë të mendimeve dhe përfytyrimeve që kanë në mendjet e tyre. Ashtu sikur brenda Qabesë ku s'ka fare kuptim në cilën anë është kibla, në të majtë apo në të djathtë. Pra, pa marrë parasysht se në cilën anë kanë marrë qëndrim, ata janë të kthyer kah Unë. Edhe për robin e dashuruar dhe të devotshëm nuk ekzistojnë rregulla të caktuara. Adhurimi dhe përkujtimi i tij në çfarë gjuhe dhe mënyre të bëhet, është i pranueshëm te Unë".*

Pastaj Mevlana tregon se pas kësaj ngjarjeje Zoti, Musait a.s. ia tregoi një sekret, të cilin Mevlana thotë se nuk ka fuqi as ta thotë e as ta dëgjojë. Kur Musai a.s. i dëgjoi këto fjalë të Zotit filloi ta kërkojë çobanin e humbur dhe pasi e gjeti, atij ia tregoi çdo gjë që kishte ndodhur: "Zoti i ka dëgjuar lutjet dhe fjalët tua dhe është i kënaqur nga dashuria dhe sinqeriteti yt. Ashtu siç të do zemra lutu dhe falu. Tani ti ke zemër të pastër dhe ke arritur të vërtetën". Kurse Çobani ia kthen: "Unë kam hequr dorë nga kjo botë e vogël dhe e pavlerë dhe mendoj vetëm për Atë".

Në këtë tregim, Mevlana me një gjuhë shumë të thjeshtë tregon krijimin e ekzistencës. dr. Zerrin Kub shkruan: "Tregimi 'Musai dhe Çobani', lexuesin e mëson se në kohën kur mishërohet dashuria, sinqeriteti dhe kërkimi i së vërtetës, atëherë tejkalohen kufijtë e jashtëm fizikë dhe më nuk është e rëndësishme forma dhe mënyra e lutjes, jetës apo veprimit. Çobani i tregimit të Mevlanasë është simbol i dashurisë. Ai i lutet Zotit me një mënyrë tjetër dhe falet me një zemër të pastër dhe të dëlirë larg nga të gjitha pengesat e kësaj bote".



**Literatura:**

1. Bertls, Jevgeni Eduardovich, *Tesavuf ve Edebijati-i Tesavuf*, Entesharati Amir Kabir, Teheran, 1382.
2. Chittick, William C, *Në kërkim të zemrës së humbur*, përktheu prof. Dr. Sokrat Ahmataj, Botimet Logoreci, Tiranë, 2007.
3. Dizdaroğlu, Sedat, *Te'siri Mesnevi Molevi ve tarikati molevije ber Edebijati Klasiki Bosni*, disertacion doktore e mbrojtur në Universitetin Terbijeti Moderris, Teheran, 1386.
4. El Fahuri, Hanna, *Tarih-i Edebijati Arabi*, Entesharati Tus, Teheran, 1383.
5. Furuzanfer, Bediuzzaman, *Sherh-i Mesnevi-ji Sherif*, vëll. 1, Entesharati Ilmi Ferhengi, Teheran, 1382.
6. Gani, dr. Kasem, *Tarih-i Tesavvuf dar Islam - Tetauvvurat ve Tehavul'at*, Entesharati Zavvar, Teheran, 1383.
7. Golpinarli, Abdylbaki, *Mevlana Celaleddin, hayati, felesefesi, eserleri*, Inkilab Yayinalri, Istanbul, 1951.
8. Halife, Abdulhakim, *Irfani Molevi*, Entesharati Ilmi Ferhengi, Teheran, 1383.
9. Hoxhviri, Ebul Hasan Ali Bin Osman, *Keshful Mahxhub*, Soroush Press, Teheran, 1384.
10. Homai, Xhelaleddin, *'Molevi name - Molevi çe migujed'*, Vell. 1-2, Entesharati Shoraji Ali ferheng va honar, Teheran, 1355.
11. Kedkeni, dr. Muhammed Reza Shefi'i, *Tazjane-i Suluk*, Entesharati Agah, Teheran, 1383.
12. Neda, dr. Taha, *Edebijati-i Tatbiki*, Entesharati Ferzan, Teheran, 1380.
13. Ozturk, Yashar Nuri, *Mevlana ve Insan*, Yeni Boyut Yayinlari, Istanbul, 1993.
14. Purnamdarijan, dr. Taki, *Der Saje-i Aftab*, Entesharati Sokhan, Teheran, 1384.
15. Schimmel, Annemarie, *Eb'adi Irfani Islam* (Mystical Dimensions of Islam), Deferi neshri ferhengi islami. Teheran 1374.
16. Schimmel, Annemarie, *Shukuhi Shems*, (The Triumphal Sun), Entesharati Ilmi ve Ferhengi, Teheran, 1367.
17. Soroush, Abdulkarim, *Kumari Ashikane – Shems ve Molana*, Serat, Teheran, 1385.
18. Zerrin Kub, dr. Abdulhusejn, *Bahr der Kuze*, Entesharati Ilmi, Teheran, 1384.
19. Zerrin Kub, dr. Abdulhusejn, *Pil'le, Pil'le ta Molakati Khoda*, Entesharati Ilmi, Teheran, 1375

Abdullah Rexhepi

## ISLAMIC MYSTICAL LITERATURE AND MAWLANA RUMI

### (Summary)

Mysticism is one of the greatest manifestations of thought. It is also a perfection of human thought and perception. In Islamic literature there is no concord regarding the meaning of the word sufi. Furthermore, there are different views regarding its position in Islam. Those, who use this word in a positive sense, link it to a wide range of ideas and concepts, which aim at achieving perfection by following the Prophet's model. Whereas, those, who use it in the negative sense, link it to various misrepresentations of Islamic tradition. Most authors have a balanced approach (they do not accept it wholeheartedly, but, they do not consider it an anathema either).

عبد الله رجب

## أدب التصوف الاسلامي و مولانا جلال الدين الرومي

### (خلاصة البحث)

يعد التصوف من المظاهر العظيمة للفكر الانساني و كيفية التفكير للوصول إلى غايات عالية. لا يوجد اتفاق تام في التراث الاسلامي حول معنى كلمة التصوف، بصورة عامة ليس هناك اتفاقا بين العلماء حول مدى شرعيته في الاسلام بناء عليه فان الذين يستخدمون هذه الكلمة بصورة ايجابية يضعون في عين الاعتبار مجموعة من الافكار و المبادئ و التي تسعى إلى تحقيق كمال الانسان و سلوك نحو خطوات النبي (صلعم) و الذين يستخدمونها بطريقة سلبية يرونها بمنظار التغيرات التي طرأت على بعض التعاليم الاسلامية.

## HISTORIOGRAFI

*Filip K. Hiti*

### NDËRRIMI I ROLEVE - NDIKIMI I PERËNDIMIT\*

Sulmi i papritur i Napolonit në Egjipt ka shënuar periudhën më tepër se të një drejtimi. Ai shënon fillimin e ndërprerjes me të kaluarën. Me pajisje tjera sulmuesi francez solli në Kajro shtypshkronjën e parë arabisht, të cilën e kishte konfiskuar në Vatikan. Kjo ka qenë shtypshkronja e parë e llojit të tillë në luginën e Nilit. Ajo u zhvillua në Matba'at B'ulek të njohur vazhdimisht si ent zyrtar i shtypit shtetëror. Pushtuesi francez e përdorte për botimin e materialit propagandues në gjuhën arabe. Krahas saj ai vuri themelet e një lloj akademie letrare (acedemie litteraire) me bibliotekë. Në përgjithësi deri në atë kohë, popujt e botës arabe jetonin kryesisht të tërhequr me një jetë tradicionale dhe konvencionale, duke mos arritur kurrfarë përparimi dhe duke mos u interesuar për progresin e botës së jashtme. Atyre nuk u interesonin ndryshimet. Ky kontakt i vrullshëm me Perëndimin u dha atyre impulsin e parë, i cili u ndihmoi që të zgjohen nga gjumi i tyre mesjetar.

\* Filip Hiti: "Istoriya Arapa", bot II, viti 1973, Sarajevë.

### Penetrimi kulturor: Egjipti

Duke i kuptuar mundësitë e këtij kontakti preliminar kulturor, Muhamed Aliu filloi për t'i ftuar oficerët francezë dhe evropianë tjerë për instruktorë të ushtrisë së tij. Ai shkoi edhe më larg se kjo duke dërguar një grup studentësh për trajnim në Evropë. Në këtë ai ndoqi shembullin e Osmanlinjve turq. Në të dy rastet qëllimi i dërgimit ka qenë ushtarak. Mirëpo, gjuha- njëra nga parakushtet për trajnimin ushtarak, kur njëherë mësohet, paraqet çelësin për hapjen e të gjitha thesareve të mendimit- në këtë rast mendimit perëndimor, me idetë e tij nacionaliste, demokratike, shkencore, profane, dhe ide tjera eksplozive. Themeluesi i Egjiptit të ri në truallin e tokës së tij, vazhdoi me ndërtimin e shkollave të reja jo vetëm ushtarake, por edhe të medicinës, farmaceutikës, teknikës dhe të bujqësisë. Për fat të keq, nga numri i madh i institucioneve arsimore, të cilat i themeloi atëherë Muhamed Aliu, vetëm një numër i vogël e mbijetuan vdekjen e tij. Nipi i tij, Abasi (1848-1854) i largoi të gjithë këshilltarët e huaj (jashtëm) dhe i suprimoi të gjitha shkollat e huaja si dhe shumicën e institucioneve tjera të karakterit evropian. Trashëgimtari i Abasit, Seidi (1854-1863) gjithashtu ishte kundërshtar i ideve perëndimore. Nuk jetuan gjatë as shumë institucione të cilat i themeloi Ismaili (1863-1879), i cili në akademinë e tij ushtarake i punësoi oficerët amerikanë. Ai ishte i pari që themeloi shkollat për femra në Egjipt.

Animi i tij kah Perëndimi gjeti jehonë në thënien popullore se Egjipti ka qenë pjesë dhe copë e Evropës. Këto shkolla nuk kanë qenë të pajisura as të përgatitura mirë me të gjitha gjërat e nevojshme, nuk kanë pasur institucione speciale bamirëse, as nuk kanë qenë të plotësuar në mënyrë sistematike me ekspertë të shumëllojshëm nga të cilët ka mundur të zgjidhet personeli arsimor, as nuk kanë mundur të llogarisin në botimin e vazhdueshëm të teksteve në arabisht, e cila ka qenë gjuhë mësimore. Megjithatë, një institucion të cilin e themeloi Ismaili ekzistonte edhe sot. Ajo është biblioteka kombëtare, të cilës i vuri themelet duke tubuar disa libra nga oborret mbretërore dhe

xhamitë. Ajo sot numëron gjysmë milioni libra. Shoqata gjeografike mbretërore e Egjiptit, të cilën gjithashtu e themeloi ai, në vitin 1950-1951 e festoi shtatëdhjetëvjetorin.

Gjatë udhëheqjes së Ismailit u themelua Kolegji amerikan në Asjut (1865), i cili ende vazhdimisht punon. Kolegji amerikan për vajza në Kairo ka filluar si shkollë fillore në vitin 1861. Shtatë vjet më parë, misioni i bashkuar prezbiterian i Amerikës, filloi veprimtarinë e tij në Egjipt.

### Siria dhe Libani

Okupimi njëdekadësh egjiptian i Sirisë (1831-1840) përbën një periudhë të tërë të historisë kulturore të vendit. Ibrahim (Pasha) e shkatërroi fuqinë e sulmuesve lokalë (sinaj mukatixhi) vëri tatime të rregullta dhe i detyroi të pranojnë të drejtën që edhe jomyslimanët mund të jenë nëpunës të qeverisë lokale. Për dallim nga proklamata e sulltanit, proklamata e tij nga viti 1839 mbi barazinë para ligjit të anëtarëve të të gjitha feve menjëherë hyri në fuqi dhe filloi të aplikohet. Ai nuk u përmbajt nga përdorimi i forcës kundër myslimanëve në Damask dhe në Safed, të cilët kundërshtuan ndërrimin e statusit të bashkëqytetarëve të tyre dhimijjë. Katër vjet para shpalljes së proklamatës së tij, konsulli britanik ishte i detyruar në roje të fortë të hyjë në Damask. Një vit pas shpalljes së saj, ai ka mundur të lëvizë pa përcjellje ose të shkojë ku të dëshirojë.

### Siria dhe Palestina

Argumentet e politikës së re liberale dhe sigurisë publike i tërhoqën evropianët si kurrë më parë. Jezuitët, rendin e të cilëve Papa e ndaloi në vitin 1773, u kthyen në numër të madh. Misionarët protestantë - britanikë dhe amerikanë - formuan bazë të fortë në tokën libaneze. Në vitin 1834 u themelua kisha protestante vendore siriane. Në të njëjtin vit, arkeologu amerikan Edmond Robinson bëri ekskursionin hulumtues në Palestinë, i pari në vazhden e shumë ndodhjeve të cilat, më në fund, shpien deri te gërmimi, shpjegimi dhe publikimi i thesarit të

madh të këtyre viseve. Tre vjet para kësaj, shtypshkronja amerikane u transferua nga Malta në Bejrut. Në anën tjetër të qytetit në vitin 1853 u themelua shtypshkronja jezuite katolike. Këto dy shtypshkronja ende janë shtypshkronjat më të rëndësishme të Azisë Jugore. Këto dy institucione botuan përkthimin e Biblës në gjuhën bashkëkohore arabe.

Siria ka pasur shtypshkronjën e parë të saj arabisht para kësaj kohe qysh në vitin 1702, në Haleb. Atë këtu e sollën të krishterët. Konservatizmi i myslimanëve, kur ishte në pyetje qëndrimi i tyre ndaj Fjalës së Zotit, mbase e ngadalësoi zhvillimin e industrisë botuese. Madje edhe sot Kur'ani shkruhet me dorë ose litografohet dhe nuk shtypet (fjala është për në kohën e botimit të I të librit 1937, vër. përk.).

Fillimi i shtypshkronjës në Haleb, e para e këtij lloji në Lindje, ende është i mbështjellë me fshehtësi. Me siguri edhe kësaj i ka paraprirë ndonjë shtypshkronjë evropiane. Shtypshkronja më e hershme arabisht në Evropë është lajmëruar në qytetin italian në Fan, sigurisht nën patronazhin e Papës. Nga botimet e saj është ruajtur një libër lutjesh nga viti 1514. Libani në një manastir të tij të quajtur kazaja, ka pasur shtypshkronjën siriane, të cilën mund të jetë se e ka sjellë nga Roma njëri nga dijetarët maronit, i cili ka studiuar atje. Nga kjo shtypshkronjë kemi ekzemplarët e Psalmeve jo vetëm në gjuhën siriane, por edhe në atë arabe, të botuara me germa siriane.<sup>1</sup> Duhet pasur ndërmend se sirisht është folur në Liban që nga fundi i shek. 17.

Përpjekjet amerikane në fushën e arsimit u kurorëzuan me themelimin e kolegjit protestant sirian. Ai sot është universiteti amerikan në Bejrut. Veprimtaria edukative jezuite, e cila filloi në ditët e para të shekullit 17, e përjetoj kulmin e saj me themelimin e universitetit të Shën Jozefit në Bejrut (Universiteti Saint-Josefeh) në vitin 1874. Këto dy universitete bartin udhëheqjen në edukim në këtë pjesë të botës.

Para universitetit amerikan, në Bejrut në vitin 1830, u themelua shkolla për vajza, e cila edhe sot e kësaj dite punon. Misionarët lazarishtë të cilët kishin ardhur në Damask qysh në vitin 1875, përafërsisht

<sup>1</sup> Garshuni, shif: Hitti History of Syria. Faq. 546

pas dy dekadave themeluan shkollën për fëmijë, shkollën më të vjetër moderne, e cila ende punon në atë qytet. Këto shkolla u paraprinë të gjitha shkollave moderne shtetërore dhe shërbejnë si model i institucioneve të mëvonshme, pa marrë parasysh a ishin ato shtetërore apo private. Deri në ditët e sotme, përparësi ka mësimi i gjuhëve moderne, madje edhe në shkollat vendore, dhe shpeshherë frëngjishtja dhe anglishtja ishin gjuhë mësimi në shkollat e larta dhe ato profesionale. Personeli mësimor ka gëzuar privilegje speciale, mes të cilave mbrojtjen në bazë të kapitullimit.

Shkollat e vendit, shtypshkronjat, gazetatat, revistat, shoqëritë letrare, duke iu përmbajtur modelit evropian, së shpejti filluan të përhapen. Egjipti filloi gazetatat e para të tij në gjuhën arabe në vitin 1829, kur Muhamed Aliu themeloi ‘El-Vakiul Misrijje’ (Ndodhitë egjiptiane) e cila ende është organ zyrtar i qeverisë. Siria ka filluar me gazetatat e saj të para në vitin 1858, kur Halil-ul-Hurriu e themeloi në Bejrut ‘Hadiikat-ul-Ahbar’ (Kopshti i lajmeve). Dymbëdhjetë vjet më vonë, Butrus-Bustani (1819-83), i cili udhëhiqte një shkollë të vendit dhe bashkëpunonte me misionarët amerikanë, themeloi në Bejrut revistën dyjavore politike, shkencore dhe letrare ‘El-Xhinan’ (Kopshtet). Kjo është njëra ndër revistat e shumta të cilat ai i themeloi. Moton, të cilën ai zgjodhi për publikimin e ri të tij ishte *“Patriotizmi është njëri nga nenet e fesë”* i dha formulës kuptim të ri në gjuhën arabe, në vitin 1876. El-Bustani filloi të botonte në Enciklopedinë Arabe (Dairet-ul-Mea’rif) gjashtë volumet e para të së cilës ai i përfundoi vet. Shkrimet e këtij studiuesi të krishterë, në mesin e të cilave gjendej një fjalor dhe shumë tekste shkollore nga matematika dhe gramatika, i përgatitën rrugën e zgjimit të vetëdijes nacionale dhe fillimit të lëvizjeve kombëtare arabe. Libani arriti shkallën më të lartë të arsimit shkencor ndër shtetet arabe, falë në masë të madhe, me tepër angazhimeve të institucioneve shkencore të jashtme dhe private sesa shkollave që kujdesej shteti për to. Madje edhe sot institucionet më të larta mësimore janë në duart e francezëve dhe amerikanëve.

Libani si dhe vende tjera arabe u treguan tepër tërheqëse për këtë migracion kulturor nga Perëndimi, në rend të parë për shkak se dy ci-

vilizimet e tyre, edhe pse në disa pika kryesore ndryshojnë, i takojnë të njëjtës rrymë amzë. Civilizimi evropian dhe i Lindjes së Afërt nxjerrin trashëgimin e përbashkët të traditave çifute-krishtere dhe greko-romake. Nga kohërat më të hershme, herë të ngushta e herë të brishta, janë mbajtur lidhjet shoqërore dhe tregtare. Në realitet, gjithnjë deri në shekullin e 14, do të thotë deri në ditët e para të periudhës mameluke, dallimi mes Lindjes dhe Perëndimit ka qenë më tepër artificial sesa real. Vetëm në shek 16, do të thotë në fillim të periudhës osmane, rrugët e tyre filluan seriozisht të ndahen. Perëndimi u shërbye me metodën shkencore si dhe me mjetin ndihmës, eksperimentin, dhe zhvilloi profesionet teknike, të cilat dhanë fryte të kontrollit më të madh mbi fuqitë natyrore, ndërsa Lindja mbeti indiferent ndaj të gjitha këtyre. Në fund të shek. 18 diferenca arriti në pikën më të lartë, dhe të dy kulturat filluan përsëri të afrohen.

Në këtë proces të fekodimit kryqëzor të kulturave, Iraku nuk ka luajtur kurrfarë roli të rëndësishëm. Misionarëve britanikë u është lejuar hyrja në Bagdad dhe Basra qysh në shek 17, por ata nuk kanë bërë kurrfarë ndikimi me shoqërinë e tyre misionare. Nga iranianët, oficerëve të tyre dhe nëpunësve shtetërorë, të cilët kanë qenë të shkolluar në Stamboll, mezi ndonjë ka qenë i ekspozuar ndikimit të ideve moderne, por edhe ato kanë qenë të tipit special. Megjithatë, vendi ka qenë gjerësisht i hapur i penetrimit tregtar. Kur britanikët e përforcuan pozitën e tyre në gjirin Persik, penetrimet tregtare përfundimisht sollën deri te penetrimet politike dhe vendi u fut në rrethin e ndodhive botërore.

### Penetrimet politike

Invadimi i Ibrahimit në Siri dhe invadimi i Napolonit në Egjipt, në një kuptim dhanë rezultate të njëjta: ato i dhanë fund rendit të vjetër të decentralizimit të pushtetit në të dy shtetet dhe hapën periudhën e re të varësisë të centralizuar. Me tepër edhe se këtë, ato i hodhën këto dy vende në vatrën e makinacioneve imperialiste. Pretendimet ekspansioniste të fuqive të mëdha filluan aty të konfrontohen më tepër se çdo

kund tjetër. Sidomos, rivalitet të fuqishëm kishte mes Anglisë dhe Francës, ngase secila, nga shkaqe të njëjta, angazhoheshin për të marrë ndikimin përfundimtar në punët e Egjiptit dhe Sirisë, d.t.th. për të siguruar në mënyrë më të madhe përparimin në tregti me Indinë dhe Lindjen e Largët. Shkaqet e shumë luftërave në shek 19 duhet të kërkohen në Lindjen e Afërt. Njëri ndër shkaqet të luftës së Krim (1854-56) ka qenë fakti se Franca dhe Rusia venin të drejtën për mbrojtjen e vendeve të shenjta në Palestinë. Hapja e kanalit të Suezit në vitin 1869 i shtoi rëndësinë strategjike këtyre vendeve dhe shpejtoi përsëri hyrjen e tyre në qendrën të tregtisë botërore dhe të ngjarjeve botërore. Kanali shumë shpejt u bë pjesë integrale e arterieve kryesore të komunikacioneve internacionale dhe kompensoi humbjet e bëra me zbulimin e rrugës rreth Kepit të Shpresës së mirë. Mijëra e kanalit të gjatë rreth 100 mile ka kushtuar afër 20.000.000 funta. Pjesa më e madhe e parave është tubuar me anë të regjistrimeve publike në Evropë, në rend të parë në Francë.

Ka pasur 176.602 aksione të Hedrit dhe çdonjëra prej tyre ka kushtuar 20 funta. Në vitin 1875 ato i riblenu Qeveria britanike.

### Okupimi britanik i Egjiptit

Në Egjipt, shpenzimet e pavenda të Ismailit, gjatë sundimit të të cilit u hap Kanali, e sollën vendin deri te bankrotimi dhe më në fund deri te intervenimi evropian. Si kompensim për ofertën shpirtgjërë të Ismailit se do të dyfishojë haraçin e Egjiptit në vitin 1866 dhe 1873 Porta i dha të drejtë privilegjuese familjes së tij dhe titullin Hidir<sup>2</sup>, i cili gati është i barabartë me pranimin e sovranitetit. Në vitin 1879 Anglia dhe Franca vendosën kontrollin e dyfishtë mbi vendin dhe hediri u përmbys nga froni. Ndërkohë në oficerin Ahmet Arabiun, i cili ishte me prejardhje fshatare, gjetën mbrojtësin e ankesës së ushtrisë në kuadrin komandues të së cilës ishin më shumicë çerkezët dhe fshatarësia, e cila vuante nga taksat e rënda, rekrutimet dhe angaria, sipas të cilës qeveria ka mundur ta detyrojë çdo mashkull të aftë për të pu-

<sup>2</sup> Pers. Hidir: zotëri, sundues

nuar për një rrogë të vogël ose kurrfarë rroge në punët publike shpeshherë të fitimit të dyshimtë. Kryengritja shpejt u ngulat me fitoren e britanikëve të Tell el-Kebira, më 13 shtator 1882 dhe dëbimin e Ahmet Arabiut. Kjo rrethanë ua mundësoi anglezëve për të okupuar vendin, i cili ndonëse formalisht mbeti nën sundimin turk deri në ditët e para të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, kur Anglia e shpalli Egjiptin si protektorat të saj. Hidir Abas Hilmi atëherë është dëbuar, ndërsa axha i tij Husejn Kamili e trashëgoi me titullin sulltan. Fuadi, i cili e trashëgoi vëllanë e tij Husejnin në vitin 1917, u shpall për melikmbret në shkurt të vitit 1922, kur përfundoi protektorati, dhe se me shpalljen e Kushtetutës, Egjipti u shpall i pavarur. Këtë lëshim anglezët e bënë pas luftimeve të mëdha të njerëzve të vendit. Udhëheqësi i nacionalistëve Seid Zaglul ka qenë ihtar i Ahmet Arabiut dhe sikur ai rridhte nga një familje fshatare, mirëpo ka qenë më i aftë dhe njeri me shkollim të lartë. Në vitin 1919, ky jurist i flakët, nxënës i Xhemaludin Afganit dhe redaktor i mëhershëm 'El-Vakiul-Misrijje' në kohën e Muhamed Abduhu-së, kërkoi leje nga britanikët për ta lëshuar vendin dhe me një delegacion të mbrojtë çështjen e vendit në Konferencën Paqësore në Paris dhe Londër, por ai ishte refuzuar dhe ishte dërguar në Maltë. Ky veprim trimërie, atë menjëherë, e bëri hero kombëtar. Përpjekjet e tij dhe të partisë së tij u kurorëzuan me sukses në vitin 1936 kur u nënshkrua marrëveshja anglo-egjiptiane, në të cilën vërte-tohej tërheqja e forcave okupuese në zonën e Kanalit dhe përgjegjësia britanike për jetën dhe pasurinë e të huajve, i lihej kujdesi Qeverisë egjiptiane, si dhe dhënia e ndihmës reciproke kundër armikut, i cili do të synonte të shfrytëzojë limanet, aeroportet dhe mjetet tjera të komunikacionit.

Grushtshteti i pagjakderdhje i vitit 1952 e rrëzoi nga pushteti djalin e Fuadit, mbretin Faruk, e anuloi monarkinë dhe në vitin 1954 solli deri te themelimi i Republikës, në krye të së cilës qëndroi Xhemal Abdun-Naseri (Nasser), të cilin, qëndrimi i tij trimëror kundër agresionit izraelit, britanik dhe francez, e lartësoi në nivelin e heroit panarab. Nga kjo kohë ai zbatoi reforma ekonomike dhe politike të tipit socialist.

### Mandatet franceze dhe britanike

Në gjysmëhënën arabike, intervenimi politik mori formën e mandatit. Kështu që, britanikët pas Luftës së Parë Botërore u konsoliduan në Palestinë dhe Irak, kurse Franca në Siri dhe Liban. Interesat e Francës bazoheshin në llogaritjet ekonomike, një lloj prestigjit politik si të ndikimit britanik dhe të miqësisë tradicionale, e cila tërhoqte prejardhjen qysh nga koha e luftërave të kryqëzatave, e cila është vërtetuar me kapitullimin e sulltan Sylejmanit madhështor nga Franja I.

Në vitin 1860, trupat franceze shkelën në bregdetin e Libanit me pëlqimin e fuqive të mëdha për ta ndalur gjakderdhjen e banorëve të përçarë. Administrata e këtyre mandatorëve të quajtur klasa A, nuk ka plotësuar idealin e shtruar në rregullat e ligës së popujve se, "mirëqenia e popujve të besuar është detyrë e shenjtë e civilizimit", dhe se kujdesi kryesor i forcës mandatore është të japë këshillë dhe ndihmë të tillë që është e nevojshme për t'u arritur pavarësia e plotë. Sidomos, kanë qenë të papërshtatshme ankesat e sirianëve, me të cilat i denonconin nëpunësit francezë se po shërbehen me metoda të njëjta koloniale si në Afrikën e Veriut, se qeveria vendore shërben vetëm si fasadë, se nuk donë të pranojnë zgjimin e ndjenjave nacionale, se pengojnë përdorimin e gjuhës arabe, se po e zvogëlojnë vlerën e valutës vendore duke e lidhur me frankun, se po e nxisin një parti ose sekte kundër tjetrës dhe po përdorin masa represive siç janë spiunimet, burgosjet dhe ndjekjet. Ndarja e vendit në shumë shtete të vogla (fr. etates) për shkak të qëllimeve administrative dhe lëshimin e sanxhakut të Iskenderumit të Turqisë në prag të Luftës së Dytë Botërore, ishin shkaqet më të mëdha të pakënaqësisë. Të gjitha begatitë të cilat ishin në territoret e mandateve që rridhnin, ndoshta, falë përmbajtjes së rregullit dhe ligjit, përmirësimit të rrjetit të komunikacionit, zgjerimit të tokës së punuar, lehtësimit të përhapjes së arsimit, aplikimit të mënyrës bashkëkohore të udhëheqjes, modernizimit të shoqërisë, nuk kanë qenë të mjaftueshme për ta ndalur valën e pakënaqësive, gjithnjë më të mëdha. Kryengritja shpërtheu në Xhebel-ud-Duruz në korrik të vitit 1925

dhe më shpejtësi u zgjerua në Damask dhe qytetet përreth. Reaksioni, i cili filloi kështu nuk pushoi derisa nuk u përzunë trupat e fundit francez nga toka siriane në vitin 1945. Pas dy vjetëve edhe Libani i cili në fillim mbante marrëdhënie miqësore me mandatarin francez, arriti të çlirohet dhe të shpallet Republikë.

Iraku akoma më parë kishte marrë qëndrim armiqësor ndaj mandatarit britanik. Kryengritja e cila filloi në vitin 1920 ndërmjet fiseve në Eufratin e Ulët dhe në qytetet e shenjta Nexhet dhe Kerbela, i shtyri britanikët që udhëheqjen indirekte ta zëvendësojnë me udhëheqje të drejtpërdrejtë. Fejsali djali i dytë i mbretit Husejn (nga Hixhazi) u kurorëzua në gusht të vitit 1921 për mbret kushtetues të Irakut, pasi që kishte marrë fronin e përkohshëm të Sirisë më 8 mars 1920, pasuan shumë marrëveshje. Ndër më të rëndësishmet prej tyre ishte me atë të dhjetorit 1927. Britania ia pranoi Irakut autonominë dhe me të lidhi aleancë 25-vjeçare. Marrëveshja nga qershori i vitit 1930 ka qenë vendimtare. Britania hoqi dorë nga të drejtat e saj mandatare dhe i pranoi sovranitetin e plotë Irakut. Të gjitha meritat për këtë sukses duhet t'i pranohen aftësive shtetërore të mbretit Fejsal (1920-33), regjimi i të cilit nën pasardhësin e dytë të tij, megjithatë u diskreditua. Në grushtshtetin e rëndësishëm të vitit 1958, Fejsali i II (1939-1958) u mbyt me zëvendësin e tij, axhën dhe ministrin e presidentin. Atëherë iu vunë themelet e Republikës Socialiste.

### Reformatori egjiptian

Popujt arabë në këtë kohë paraqitnin paradoks iluzor. Në një anë i rezistonin depërtimit evropian, kurse në anën tjetër merrnin dhe përvetësonin dijet dhe teknikën evropiane. Arritjet e reja nga Evropa kanë qenë të shfrytëzuara kundër evropianëve. Nga idetë e reja të panumërta të sjella nga Perëndimi, padyshim më të fuqishmet kanë qenë nacionalizmi dhe demokracia politike. Pranimi i ideve nacionaliste i ka dhënë shtytje principit të vetëvendosjes dhe të dyja shpien deri te lufta për pavarësimin nga sundimi i huaj. Në këtë interval kohor, ideologjia e re nga Perëndimi me theksimin e saj të vlerave profane dhe

materiale dhe rëndësinë që ajo u jepte ndarjeve etnike dhe kufijve gjeografikë shkonin në kundërshtim me traditat më të dashura islame, me mendimet e saj mbi universalizmin fetar, teokracinë politike dhe sovranitetin ekskluziv. Panislamizmi më parë se panarabizmi ishte ideal të cilin myslimanët duhet synuar. Konfrontimi zhvillohej si në vijat interne ashtu edhe në ato eksterne. Në Egjipt dekadave të fundit të shek. 19, klima intelektuale ka qenë më e përshtatshme për pranimin dhe përhapjen e ideve të reja, falë, kryesisht, shkrimeve dhe ligjëratave të reformatorit liberal Muhamed Abduhu-së (1849-1905), i cili arriti në postin e myftiut, postin më të lartë fetar në vendin e tij. Mësuesi i Muhamed Abduhu-së ka qenë Xhemaludin el-Afganiu (1839-1897) iniciator i parë kryesor i futjes së ideve bashkëkohore në Islam. Xhemaludini i lindur në Afganistan, banoi në Indi, në Meke dhe Stamboll para se të vendoset në Egjipt për t'iu bashkangjitur lëvizjes, e cila arriti kulminacionin në kryengritjen e Ahmed Arabiut. Muhamed Abduhu ka qenë i internuar në Siri për shkak të pjesëmarrjes në këtë kryengritje. Prapambeturia në Islam e shtrëngonte rëndë zemrën dhe shpirtin e tij. Ai shkoi pas Ibn Tejmijes në gjykimin e besimeve të kotta dhe shumë gjërave të tjera të cilat e kishin njollosur fenë. Përcaktimet e tij i përfshinin ringjalljen intelektuale dhe politike të fesë, së bashku me bashkimin e myslimanëve nën një shef suprem. Njeriu që studioi e ligjëroi në El-Az'har, dhe i cili me Xhemaludinin botoi gazeta arabe në Paris, vërtetoi se në esencë nuk ekziston mosmarrëveshje mes Islamit dhe shkencës. Ai komentoi disa vende të Kuranit në mënyrë racionale dhe pranoi mangësinë dhe paaftësinë e skollistikës islame. Derisa Xhemaludini përfaqësonte revolucionin politik, Muhamed Abduhu angazhohej për ringjalljen fetare për të nxitur reformën.

Më tepër se çdo shkrimtar tjetër modern, këta dy burra kontribuan në thyerjen e gëzhgjës së skollistikës në të cilën ishte mbyllur islami qysh nga koha e Mesjetës. Edhe pse, as njëri e as tjetri, nuk e realizuan plotësisht atë që kishin menduar, megjithatë të dy lanë brez intelektualësh, në radhët e të cilëve numërohet Kasim Emini (vdiq 1908), i cili i pari sulmoi ashpër poligaminë, shkurorëzimin dhe bartjen e fereshe. Edhe Muhamed Reshid Rida-në (vdiq 1935), i lindur

në Kalamun në Libanin Verior, i cili shkoi në Egjipt më 1897, i botoi veprat e Muhamed Abduhu-së, shkroi biografinë e tij dhe vazhdoi punën e tij në revistën "El-Menar". Rikonstruktimi i shoqërisë arabe në bazat e politikës demokratike, dhe pajtimi i Islamit e botës moderne janë dy detyrat më të mëdha me të cilat përballet gjenerata bashkëkohore.

## Arabia

Gadishulli arabik është bllok në vete, plotësisht i ndryshëm nga blloqet e Afrikës Veriore dhe Egjiptit- të frytshëm gjysmëhënor. Arabia (saudite sh.p.) bart simbolin e shenjtërisë dhe mban vendin unik në zemrat dhe shpirtrat e besimtarëve në gjithë botën. Lidhja e saj me shenjtërimet, izolimi gjeografik dhe komunikacioni i pazhvilluar i kanë dhënë asaj vulën e karakteristikave mesjetare, të cilat i ka mbajtur deri në ditët e sotme. Sidomos, të izoluar dhe ndarë nga idetë dhe ndikimet perëndimore, kanë qenë Hixhazi dhe Jemeni, dy vende të ndara të Lindjes së Afërt.

Edhe pse kurrë nuk ka marrë pjesë në veprimtarinë e Profetit, Jemeni gjithashtu ishte i veçuar si Hixhazi, nëse jo edhe më tepër. Banorët e tij janë ithtarë të Zejdit, nipit të Husejnit, i cili u mbyt rreth viti 740 h. në një kryengritje kundër Emevitëve. Edhe pse janë filizë e shiive, zejditët (zujud) nuk shprehin mësimë shiite dhe janë shumë afër mësimëve synite. Njëri prej tyre me emrin Kasim arriti ta ndalë hovin turk në vitin 1633 dhe të vendosë imametin vendor, të cilin e mbajti, duke kaluar nëpër shumë peripeci, deri në vitin 1841. Nga fillimi i vitit 1849, megjithatë vendin përsëri filloi ta udhëheqin valitë turq deri me ardhjen e imam Jahja-së në vitin 1904. Në vitin vijues imami e mori San'an, e cila më vonë u bë kryeqyteti i tij, por Porta nuk e pranoi autonominë e tij deri në vitin 1911, në realitet turqit nuk u tërhoqën plotësisht prej vendit deri në vitin e fundit të Luftës së Parë Botërore. Jahja-ja ra si viktimë e tradhtisë së oborrit mbretëror në shkurt të vitit 1948. Një vizitues në të kaluarën e afërt, ndonëse ishte me përcjellje

të gardës së imanit, për pak e kishin sulmuar banorët e vendit në Ma'-rib vetëm për atë se ishte dukur si garib- i huaj...'

Përveç pavarësimit të plotë të Arabisë Saudite dhe Jemenit, gadi-shulli para vitit 1960 politikisht është përbërë nga kolonia e Adenit, protektorati i Adenit, sulltanati i Maskatit dhe Umanit (Omanit) dhe shejhateve (principatave) truciiale dhe autonome të Katarit dhe Bahrejnit. Ata ishin të gjithë të varur në shkallë të ndryshme nga Britania e Madhe dhe gëzonin mbrojtjen e saj. Nën protektoratin e tyre edhe një nga shejhatët (principatat) në gjirin Persik, Kuvajtin, e shpallën britanikët autonomë në vitin 1914, dhe emirat të pavarur në vitin 1961. Ky vend i pasur me naftë mund të jetë më i pasuri në botë me të ardhurat e tij nacionale. Umani dhe bregdeti juglindor arabik qysh se herët kishin rënë nën ndikimin portugez e pastaj nën atë britanik, dhe për dallim nga Hixhazi, Nexhdi dhe Jemeni, kurrë nuk kanë qenë në sundimin turk. Gati, gjatë një shekulli e gjysmë, sulltanati nominal i pavarur i tij me seli në Maskat ka mbajtur marrëdhënie të afërta me qeverinë britanike. Ato lidhje përsëri u forcuan me marrëveshjen e nënshkruar vetëm në vitin 1939. Nga skaji juglindor i gadishullit të Katarit deri në largësi prej 360 mile në drejtim të juglindjes, bregu i Gjirit Persik, i njohur me emrin Bregu i Kusarëve u takonte sheikëve truci-jal. Pas një periudhe të gjatë të armiqësive me kompaninë e Indisë Lindore, këta sheikë nënshkruan (vit. 1820) me Qeverinë britanike marrëveshjen me të cilën vërtetohej paqja dhe përmbajtja nga kusaria dhe tregtia me robër. Marrëdhëniet e Katarit me Qeverinë britanike ishin të ngjashme me marrëdhëniet e sheikëve jugorë dhe të rregulluara me marrëveshje në vitin 1916. Statusi i Bahrejnit praktikisht ishte i njëjtë. Me industrinë e njohur të gjahut në Indi, që ishte në rënie, në vitin 1932 u zhvillua industria shumë më profitabile e naftës. Në vitin 1968 Qeveria britanike e shpalli planin e tërheqjes së të gjitha forcave të saj ushtarake nga Gjiri Persik, me afat prej tre vjetësh. Përfaqësuesit e Bahrejnit, Katarit dhe shtatë shteteve të truci-janeve, filluan atëherë planifikimin e krijimit të Federatës së Emirateve Arabe.

Protektorati i Adenit shtrihej në drejtim të Lindjes nga kolonia e Adenit dhe përfshinte Lehexhin, Hadremevin, Mehrun dhe Sukutrin

(Socotra). Deri në gjysmën e shek. XVIII rajoni ka qenë nën imamin e San'a-së. Adeni, limani detar, kështjella dhe kryeqyteti janë fituar në vitin 1839. Në vitin 1967 i tërë rajoni u bë i pavarur dhe u formua Republika e Jemenit Jugor.

## Vehabitët

Historia e re e Arabisë fillon vetëm me ardhjen e Muvehidëve (unitaristëve) në gjysmën e shek. 18. Kjo ka qenë një rilindje puritane, të cilën e filloi Muhamed bin Abdul-Vehabi (vdiq 1797) nga Uajna në Nexhd. Pasi që udhëtoi nëpër Hixhaz, Irak dhe Siri, bin Abdul-Vehabi u kthye në shtëpi me bindje se Islami çfarë e praktikonin bashkëkohësit e tij, është larguar shumë nga praktika dhe teoria ortodokse (synite), të cilat i kanë përcaktuar Profeti e Kur'ani, dhe ai vendosi që personalisht ta pastrojë dhe t'i kthejë rigorozitetin e tij. Shihet qartë se inspirimet ai i nxori nga Ibn Hanbeli, sipas komenteve të Ibn Tejmijesë. Parathënësi i ri në Muhamed ibn Saudin (vdiq 1765), i cili në atë kohë ka qenë kryeparë i parëndësishëm në Arabinë Qendrore, gjeti aleatin dhe dhëndrin. Ky ka qenë edhe një rast i lidhjes dhe bashkëpunimit mes fesë dhe shpatës, pas së cilave pasoi përhapja e shpejtë e fesë dhe pushtetit të Ibn Saudit në Arabinë Qendrore dhe Lindore. Kundërshtarët e tyre pasuesit e Ibn Abdul-Vehabit i kanë quajtur Vehabitistë. Me fanatizmin e tyre për çlirimin e Islamit nga kulti i të shenjtëve dhe risive (bid'ateve) tjera, ata e shkatërruan Kerbelan në vitin 1801, e morën Mekën në vitin 1803, kurse pas një viti Medinën, i rrënuan varrezat e lashta dhe i pastruan këto qytete nga çdo gjë që i vinte erë idhujtarie.

Viteve që pasonin, ata e sulmuan Sirinë dhe Irakun, dhe zgjeruan territoret e tyre nga Palmira deri në Liman. Ky ka qenë territori më i madh i qeverisur në Gadishull që nga kohët e Profetit a.s. Suksesi i tyre është komentuar si shenjë e pakënaqësisë ndaj Zotit për shkak të futjes së risive- bid'ateve të sulltan Selimit III. Porta është shqetësuar dhe e ka lutur Muhamed Aliun që t'i dërgojë disa njësi ushtarake, të cilat përfunduan në vitin 1918 me humbjen e fuqisë së vehabitëve dhe



rrafshimin me tokë të kryeqytetit të tyre Dirije. Mësimet e vehabitëve, megjithatë edhe më tutje u përhapën dhe se ndikimi i tyre ndihet prej Sumatrës në lindje e deri në Nigeri në perëndim.

### Ibnu Saud

Me përjashtim të një periudhe të shkurtër të restaurimit, të cilin e filloi në vitin 1803, lëvizja vehabite qëndroi në gjendje të stagnimit gjithnjë derisa e përsëri e ringjalli kryepari i saj i atëhershëm Abdul-Aziz bin Saudi, rindërtuesi i shtetit dhe dinastisë vehabite (saudite). Duke filluar karrierën e tij si i ndjekur në Kuvajt, Abdul-Azizi në çerekun e parë të shekullit 20, krijoi mbretërinë e tij në dëm të familjes Ibnu Reshidit, në Taif, dhe familjes së Sherif Husejnit në Mekë, të cilat shtriheshin nga Gjiri Persik deri në Detin e Kuq. Me propozimin e britanikëve, Husejni në vitin 1916 kishte shpallur veten për mbret të arabëve. Ndërsa, në vitin 1924 mori titullin “Halife i myslimanëve”. Abdul-Azizi e përmbysi nga pushteti dinastinë e Reshidit në vitin 1921, e mori Mekën në vitin 1924, Medinën dhe Xhiden në vitin 1925, kurse në vitin 1932 themeloi mbretërinë e Arabisë Saudite, në krye të së cilës u vendos ai. Ibn Sau idi ekspeditat e kusarëve fisnorë i shpalli të paligjshme, rregulloi çmimet për transportin e haxhilerëve, vendosi standard të lartë të sigurisë, futi në përdorim radion, telegrafin pa tel, telefonin, qarkullimin e autobusëve në disa vende dhe u përpoq, por pa sukses të madh, që banorët e tij nomadë t’i vendosë si vëllezër (ihvan) në vise bujqësore. Me tepër se haxhi i shenjtë, kompania arabe-amerikane, e cila përherë të parë i fitoi koncesionet në vitin 1933, u bë burimi kryesor dhe më i madhi i të ardhurave nacionale të shtetit dhe popullit. Kontributi i saj në modernizimin e Arabisë, për çdo ditë është gjithnjë më i madh.

Përktheu nga boshnjakishtja:  
**Hajrullah Hoxha**

Philip K. Hitti

## THE CHANGING SCENE: IMPACT OF THE WEST

### (Summary)

Napoleon's unexpected attack on Egypt marked the end of an era. It marks a break with the past. Napoleon introduced the first printing press into Egypt, which he had seized in the Vatican. This was the first printing press in the Nile Valley. Napoleon used it for the publication of propagandistic materials in Arabic. Furthermore, he set the foundations of an *academie litteraire*. Until then, the Arabs lived conventional lives not paying any interest in the progress of the outer world. They were not interested in change. These contacts with the West helped them to reawaken from the lethargy of the middle ages.

فيليب حتى

### تغيير الادوار - تأثير الغرب

#### (خلاصة البحث)

ان الغزو الفرنسي إلى مصر بقيادة نابليون بونابارته غير تاريخها في أكثر من اتجاه. هو يسجل نقطة تحول كبرى مع الماضي و قد جلب القائد العسكري الفرنسي إلى القاهرة المطبعة الاولى باللغة العربية و التي كان قد اخذها في الفاتيكان. هذه كانت المطبعة الاولى في دول حوض النيل و عرفت فيما بعد في عهد محمد علي الكبير باسم مطبعة البوراق و اصبحت مطبعة رسمية للدولة. و كانت الحملة الفرنسية تستخدمها كاداة لطبع المنشورات الدعائية باللغة العربية إلى جانب هذا هو قد وضع الاسس لتكوين أكاديمية أدبية و مكتبة. يمكن القول بان حتى عهد حملة نابليون كان العرب يعيشون حياة منعزلة دون الاختلاط بالمجتمع الخارجي و يتطلع إلى التقدم الذي كان قد تحقق خارج العالم العربي.

Norman, dhe më në fund do të tregojë si për shkak të shtypjeve të shfaqura nga papat, përfundon prania e myslimanëve në këtë ishull.

### Sicilia nën sundimin Islam

Komandimi i Sicilisë na bëri të kuptojmë një rol të rëndësishëm në çështjet e botës Mediteriane, dhe kështu nuk ka dyshim se gjatë Mesjetës posedimi i ishullit ishte një çmim që garoheshin fuqitë e mëdha Mediteriane.<sup>2</sup> Në kohën e pushtimit Islam, në mes të shekullit 7, Sicilia (bashkë me pjesët jugore dhe lindore të Peninsulës Italiane) ishte një provincë e Perandorisë Bizantine. Më 827 Zijadet Allah I (817-838) sundimtari gjysmë i pavarur Ahlabidi i Ifrikijes (përfshirë Algjerinë lindore, Tunizinë dhe Tripolitanën), fiksoi një ekspeditë të suksesshme dhe futi rrënjë të thella në ishull.<sup>3</sup>

Nga baza e tyre, në Mazara, në bregun perëndimor, të marra në vitin 827, forcat myslimane të përbëra nga dhjetë mijë burra u zhvendosën.<sup>4</sup> Palermo u rrëzua në vitin 831, Mesina në 843, Enna në vitin 859, dhe atëherë ishulli erdhi nën një kontroll të fuqishëm të myslimanëve.<sup>5</sup> Forcat myslimane të ekspeditës shprehin qartë një karakter të fortë të Islamit, besimit dhe civilizimit. Ishte një përzierje e pafund e Arabëve, Spaniardëve, Sudanezëve e Berberëve.<sup>6</sup> Kështu pra, ishte ishulli nën sundimin e myslimanëve, ku diversiteti etnik dhe religjioz karakterizonte popullatën e ishullit gjatë viteve të 250-ta të sundimit të myslimanëve. Murgu Teodosius, i sjellë nga Sirakuza me kryepeshkopin Sofroniusi në vitin 883, pranoi madhësitinë e kryeqytetit të ri, Palermo, duke e përshkruar atë si:

<sup>2</sup> A.L.Udovitch: Islamic Sicily; në *Dictionary of the Middle Ages*; J.R. Strayer Editor; Charles Scribner's Sons, N.York, 1980 fwd; vol 11; pp. 261-3; p.261.

<sup>3</sup> A.L.Udovitch: Islamic Sicily; op cit; p. 261.

<sup>4</sup> J.D.Breckenridge: The two Sicilies; *Islam and Medieval West*; S.Feber Editor; A Loan Exhibition at University Art Gallery; State University of New York; April 6 May-4; 1975; p.43.

<sup>5</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; p.43.

<sup>6</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; p.43.

## GJEOGRAFI ISLAME

### Salah Zaimeche

#### SICILIA\*

Në përgjithësi shumë pak dihet për historinë e Sicilisë, për sa i përket periudhës myslimane. Po ashtu shumë pak dihet për ndikimin e civilizimit Islam në ujdhesë, veçanërisht sa i përket rolit të rëndësishëm të myslimanëve nën sundimin Norman të ishullit, dhe po ashtu shumë pak apo mund të themi aspak nuk kemi njohuri rreth fatit të myslimanëve të cilët dikur kanë jetuar në këtë ujdhesë.

Një dëshmi e përgjithshme e verbërimit të këtyre çështjeve mizore të historisë së këtij ishulli është fakti se punimi më i mirë për historinë e Sicilisë myslimane është ai i shkruar nga Majkëll Amari, në shekullin 19, dhe e ribotuar pas disa dekadave më vonë nga Italian Nallino.<sup>1</sup> Ky libër në gjuhën italiane ka qëndruar thuajse i lejuar, dhe gjitha informatat unike që ka përmbajtur kanë qenë tërësisht të paqarta. Kështu, është e nevojshme për ndonjë përvijim të Sicilisë së paku të sillen disa çështje kryesore të kësaj historie, derisa, ndoshta punimi i Amarit rilind, apo një punim sa më i mirë të mund të shpërndahet te publiku.

Në vijim, së pari do të shqyrtojmë Sicilinë nën sundimin e myslimanëve, pastaj lidhjet dhe ndikimin e civilizimit mysliman nën sundimin

\* Burimi i origjinalit: <http://www.fstc.co.uk>.

<sup>1</sup> M.Amari: la Storia dei musulmani di Sicilia, 3 vol, (1993-9) I korrigjuar në botimin e 2, nga C.A. Nallino, Romë.

*“Përplot me qytetarë dhe të huaj, kështu që duket se aty janë mbledhur gjithë populli Sarakin nga Lindja në Perendim, dhe nga Veriu në Jug...të përzier me sicilianë, grekë, lombardianë dhe jehudijë, aty ka arabë, berberë, persianë, tartarë, zezakë, disa të mbështjellë me mantela të gjatë dhe turbanë, disa të veshur me lëkurë e disa gjysmë lakuriq; me fytyra ovale, katrore apo rrumbullake, lloj-lloj çehresh e përfytyrimesh, mjekra dhe flokë nga çdo lloj ngjyre apo prerje.”*<sup>7</sup>

Shumica e banorëve i qëndruan besnik fesë krishtere dhe ishin në marrëveshje me zakonet e Islamit, sipas statusit të mbrojtjes së minoriteteve; që nënkupton se në vend të pagesës së taksave tatimore (xhizjes), dhe zbatimit të disa rregullave, ata garantoheshin për sigurinë e njerëzve dhe pasurinë, dhe lirinë për të ndjekur ligjet e tyre fetare dhe të mbajnë institucionet e unionit të tyre fetar.<sup>8</sup> I njëjti status ishte edhe për unionet e vogla të jehudijve që jetonin në ishull, që duket se kryesisht u janë përqendruar qyteteve bregdetare.<sup>9</sup>

Ndikimi i kulturës Islame në ishull është vënë nga udhëtari-geografi Ibën Hakal: 972-973. Ai sheshet e Palermos i përshkruante me pallatet dhe me qindra xhamia të tyre: “xhamitë e qytetit dhe sheshet rreth tij jashtë mureve e tejkalojnë numrin treqind.”<sup>10</sup> Ai kurrë më parë nuk ka parë një numër të njëtrajtshëm të xhamive, madje edhe në qytetet që ishin dy herë më të mëdha. Këto ndërtesa nuk ishin vetëm vend adhurimi, po ashtu shërbenin dhe si shkolla, ku secila kishte mësuesin e vet.<sup>11</sup> Gjithashtu aty ndodhej edhe universiteti i Balermos (Palermos), i cili thuajse ishte rival me atë të Kordobës, dhe kishte dijetarë të aftë, siç ishte Ibën Hamdis, fisniku Sirakuzani, i cili e la oborrin e Kontit Roger në Palermo për myslimanët e Spanjës, ku ai shkroi dhe rikujtoi rininë e tij në ishull.<sup>12</sup> Shkollat e Sicilisë myslimane, njëjtë si ato të myslimanëve të Spanjës, për një kohë të gjatë kanë

<sup>7</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; p.43.

<sup>8</sup> A.L.Udovitch: Islam Sicily; op.cit; p.262.

<sup>9</sup> A.L.Udovitch: Islam Sicily; p.262.

<sup>10</sup> Ibn Hawqal nw J.D. Breckenridge: The two Sicilies; op.cit; pp.43-4.

<sup>11</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; p.44.

<sup>12</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; p.44.

qenë strehim për studentët, ambiciozë për arritjet letrare dhe të dallueshëm nga çdo shtet tjetër i Evropës.<sup>13</sup>

Aspekte nga këso madhështish kulturore, do të na tregohen më shumë nga një përfaqësues tregtar valencian, Ibën Xhubejri, i cili e përshkruan Palermos si vijon:

*“Është metropol i ishullit, duke i bashkangjitur pasurinë dhe shkëlqimin e saj, aty ke gjithçka që dëshiron, të vërteta apo të qarta, gjitha nevojat e jetesës, të stazhionuara dhe të freskëta. Është një qytet antik dhe elegant, madhështor dhe i këndshëm, dhe joshëse për ta parë. Në hapësirat e gjëra dhe fushat, me krenari janë të mbushura kopshte, me rrugë të gjera dhe bulevarde, ajo me përkryerjen e vet t’i vërbon sytë. Është një vend i mrekullueshëm, i ndërtuar më stil të Kordovës, tërësisht nga gurë të njohur si kadhan (gur gëlqeror i lëmuar). Një lumë e ndan qytetin, dhe katër ujëvara burojnë në periferi... mbreti për kënaqësi dhe zbavitje endet nëpër kopshte dhe oborre....gratë krishtere të këtij qyteti ndjekin modën e grave myslimane, kanë të folur të rrjedhshme, mbështillen me mantel dhe janë të mbuluara”*<sup>14</sup>

Megjithëse fabrikat e tekstilit të Palermos ishin të famshme nën sundimin e myslimanëve dhe të vazhduara nën sundimin e Normanëve, shumë pak kanë mbijetuar, veçse shenja mbretërore e Roxher II, e ruajtur nga Pasuria e Perandorisë së Shenjtë të Romanëve, në Vjenë.<sup>15</sup> Burimi islamik i industrive dhe zejeve, është i qartë në shumë fjalë që përdoren edhe sot, veçanërisht emri i mullirit që në arabisht quhet: Ma’assara. Prezenca e myslimanëve gjithashtu ka demonstruar agrikulturë të bollshme.

Hyrja e teknikës së re dhe prodhimeve nga myslimanët e mundësuan ekonominë lokale të lulëzojë, dhe disa prej këtyre produkteve, siç janë frutat agrume, deri më sot e përbëjnë themelimin e ekonomisë

<sup>13</sup> S.P. Scott: History of the Moorish Empire; në tre vëllime; J.B.Lippincot Company; Philadelphia; 1904; vëll. 3; p.2.

<sup>14</sup> The travels of Ibn Jubayr; i përkth.nga origj.arab. me hyrje dhe shënime, nga R.J.C. Boadhurst, Jonathan Cape, London, 1952; pp 348.

<sup>15</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; p.54.

siciliane.<sup>16</sup> Përsëri ndikimi i myslimanëve shihet qartë përmes shumë termeve teknike. Mes shekullit 14-15 filologu Bresk Holds përmes një analize të hollësishme ka gjetur në dokumente notare të Sicilisë terme lidhur me kallam sheqerin dhe kopshtarinë.<sup>17</sup> Po ashtu ngjashmëritë e termeve teknike mes arabëve dhe sicilianëve; siç janë termet: katusu-kadus (gyp argjili), çaja-taja (gardh); fidenum-fideni (fushë e kallam sheqerit); fiskia-fiskija (rezervoar); noharia-nuara (kopsht kasolleje e ujitur); sulfa-sulfa (ngritje e kreditit dhuruar bujqve); etj.<sup>18</sup>

Periodha e sundimit mysliman në Sicili gjithashtu përputhet me etapën e hershme të revolucionit komercial në Mesjetë dhe për ujdhesën kjo ishte një periudhë e zhvillimit të shkëlqyeshëm të ekonomisë. Gjatë fundshekullit 10 dhe fillim i shekullit 11, Udoviç tregon se Sicilia ishte në qendër të zhvillimit tregtar në botën e Mesjetës.<sup>19</sup> Së bashku me Tunisin, Sicilia gjatë kësaj periudhe kohe ishte në ndërprerje të një numri të madh të rrugëve tregtare. Karvanët nga Silxhilmasa e Morokës jugore, duke bartur artikuj të përdorimit të gjerë Morokiane dhe Afrikane, udhëtonin për në Tunizi, dhe nga aty këto mallra merrnin rrugën për në tregjet e Palermos dhe Mazarës. Sicilia shërbente si ndërmjetësim komercial mes myslimanëve të Spanjës dhe myslimanëve të Lindjes, dhe anijet që udhëtonin rregullisht mes dy kufijve mesdhetarë njiheshin si limane të saj.<sup>20</sup> Për tregtarët evropianë (shumica italianë) që ishin në kërkim të mallrave të Lindjes (fije liri, sheqer, tekstil me prejardhje egjiptiane, biber, erëza, barëra mjekësore etj) tregjet e Palermos dhe Mazarës ishin më të afërta dhe më të arritshme sesa ato të Mesdheut të Lindjes.<sup>21</sup> Më së paku nga fundi i shekullit 10, Sicilia ishte prodhuesi kryesor i gjërave të papërpunuara dhe mëndaf-

<sup>16</sup> Francesco Gabrieli: Islam in Mediterranean World in *The Legacy of Islam*; I botuar nga J. Schacht me C.E. Bosworth, edicioni 2. Oxford Clarendon Press, 1974; pp. 63-104, në p.75.

<sup>17</sup> H.Bresk: Les jardins de Palerme; në *Politique et Societe en Sicilie*; xii-xv em siecle; Varorium; Aldershot; 1990; pp.55-127; p.67.

<sup>18</sup> H.Bresk: Les jardins de Palerme; në *Politique et Societe en Sicilie*; xii-xv em siecle; Varorium; Aldershot; 1990; pp.55-127; p.81.

<sup>19</sup> A.L. Udovitch: Islam Sicily; op cit; p.262.

<sup>20</sup> A.L. Udovitch: Islam Sicily; op cit; p.262

<sup>21</sup> A.L. Udovitch: Islam Sicily; op cit; p.262

shit, e cila tregtonte në tregun Mesdhetar. Monedhat e arta apo rubaja kishte vlerë të madhe dhe shumë e kërkuar në Egjipt dhe në vendet tjera tregtare të Sirisë dhe Palestinës.<sup>22</sup>

### **Rënia e Sicilisë myslimane dhe të myslimanëve nën sundimin Norman**

Për ta kuptuar rënien e Sicilisë në fund të shekullit 11, është e nevojshme që shkurt të sqarojmë kontekstin e myslimanëve në atë kohë. Në shekullin 11, bota myslimane ishte kyçur në luftë mes shijave dhe sunijve, mes taifave të ndryshme në Spanjë dhe mes princërve të ndryshëm në Lindje. Bota krishtere duke pasur dobi nga këto përçarje lëshoi një ofensivë të madhe nga të katër anët. Në Spanjë zbriti një aleancë e francezëve dhe forca tjera evropiane, ku e hoqën kontrollin e myslimanëve. Barbastro u mor në vitin 1063, i pasuar me therje dhe dhunime masive të grave myslimane.<sup>23</sup> Toledo ishte në rënie në vitin 1085.<sup>24</sup>

Të frikësuar nga ky sulm i furishëm, reisi i Taifës që quhej Berber Almoravids erdhi në Spanjë dhe i dërmoi forcat krishtere,<sup>25</sup> dhe më vonë i pasuar nga Almohadi, mbajti Spanjën nën kontrollin mysliman deri në mesin e shekullit 13, kur e gjithë Spanja myslimane (Kordova, Sevili, Valencia, Mursia etj) humbi (përveç Grenadës, e cila do të humbë në vitin 1492). Në Lindje, lufta e brendshme mes myslimanëve i ftoi kryqëzatat (1095-1291) një sulm i furishëm dyshekullorë i cili kërcënoi gjithë atë që ishte islame me zhdukje, gjë që nuk ka qenë për Selxhukët dhe Mamlukët, në veçanti, të cilët kanë luftuar në shumicën e luftërave kundër kryqëzatave dhe aleatëve të tyre mongol.<sup>26</sup> Sicilia pati të njëjtat simptome, sikurse Spanja dhe Lindja edhe ajo nuk pati forca të myslimanëve për të luftuar. Dy shekuj pas marrjes së ishullit nga Normanët, myslimanët u çrrënjësën nga ishulli.

<sup>22</sup> A.L. Udovitch: Islam Sicily; op cit; p.262

<sup>23</sup> J.Read: *The Moors in Spain and Portugal*; Faber and Faber, London, 1974.

<sup>24</sup> J.J.Saunders: Aspects of the Crusades; University of the Canterbury; 1962, p.19.

<sup>25</sup> J.Read: *The Moors in Spain and Portugal*; p.133.

<sup>26</sup> W.B. Stevenson: *The Crusades in the East*; Cambridge University Press; 1907.

Fillimi i fundit të myslimanëve në Sicili filloi në fillim të shekullit 11, me një luftë të hapur mes Kalbid Emir nga Palermo dhe Ziridi nga Tunizia. Plotësisht të vetëdijshëm nga kjo ngatërresë e brendshme mes myslimanëve sicilianë, aty erdhi një politikë parësore për forcat krishtere për ta marrë ishullin.<sup>27</sup> Së shpejti Normanët arritën për t'ua rrëmbyer ishullin myslimanëve. Normanët të cilët pastronin nëpër Italinë Jugore, ishin një bandë e vogël,<sup>28</sup> dhe myslimanët nuk ishin të ndarë, kurse Normanët nuk kishin pikëmbështetje; dhe brenda një gjenerate, banda e vogël e aventurierëve formoi një mbretëri për vete.<sup>29</sup> Lufta e brendshme e vazhdueshme mes kryekomandantëve vendorë ishte faktori kryesor në pushtimin e lehtë dhe të shpejtë të Normanëve në vitin 1070.<sup>30</sup> Në fakt një invadim fillestar i Normanëve ndoqi një ftesë vendore të myslimanëve.<sup>31</sup> Njëri nga emirët e myslimanëve formoi një marrëdhënie intelektuale me Roxherin vëllanë më të ri të Hativillëve norman, i cili nuk e refuzoi ofertën.<sup>32</sup> Nën këto rrethana të favorshme Normanët u zbarkuan në Sicili në vitin 1061 dhe filluan të përparojnë me shpenzimin e myslimanëve.<sup>33</sup> Kjo dukej se nuk i mërzieste aq myslimanët, madje edhe kur Normanët u bënë gjysmë pronarë të ishullit, kryetarët e myslimanëve vazhdonin ta luftonin njëri-tjetrin.<sup>34</sup> Në fakt, krishterët sicilianë, më pak e përkrahnin pushtimin Norman sesa fraksionet myslimane.<sup>35</sup> Në vitin 1062, Roxheri pati sukses në pushtimin e Mesinës, në vitin 1072 Palermo u rrëzua, dhe gjatë

<sup>27</sup> A.A.Vasilev: The struggle with the Saracens (867-1057): në The Cambridge Medieval History; vol. IV: I edituar nga J.R. Tanner, C.V.Previte; Z.N.Brooke, 1923.p. 150.

<sup>28</sup> J.D. Breckenridge: The tço Sicilies; op. cit; 46-7.

<sup>29</sup> N. Daniel: The Arabs; op cit; p.145.

<sup>30</sup> A.L. Udovitch: Islamic Sicily; op cit; p.262.

<sup>31</sup> N. Daniel: The Arabs; op cit; p.144

<sup>32</sup> M.L.De Mas Latrie: Traites de Paix et de Commerce, Et documents divers, concernant les relations des Chretiens avec les arabes de l'Afrique Septentrionale au Moyen Age, Burt Franklin, Neë York, orig. Pub.në Paris, 1866.p.42.

<sup>33</sup> John Glubb: A short history of the Arab people; Hodder and Stughton; 1969. p.148.

<sup>34</sup> G.Le Bon: La Civilisation des Arabes; IMAG; Syracuse; Italie; 1884; p.230.

<sup>35</sup> J.D. Breckenridge: The tço Sicilies; op. cit; 46-7.

njëzet vjetëve tjera e gjithë ishulli erdhi nën një kontroll të sigurt të Normanëve.<sup>36</sup>

Komunitetet arab-folëse mbijetuan në Sicili për më shumë se dy shekuj nën sundimin Norman.<sup>37</sup> Kjo mbijetesë tregon ndikimin e gjerë Islam të mësimi dhe civilizimit në të gjitha mënyrat dhe format.

Skoti e krahason shumë mirë natyrën e marrëdhënieve kulturore, ku së pari kanë ekzistuar mes myslimanëve të pushtuar dhe Normanëve pushtues; dhe në kesi kontrasti ai pushtoi tërësisht ndikimin islam në civilizimin, që do të përhapet prej Sicilisë në mbarë Evropën, për më shumë, Skoti nuk shmanget duke fajësuar moralitetin dekadent të myslimanëve për rënien e tyre. Ai vazhdon:

*“Asnjë antagonizëm goditës i zakoneve kombëtare, armiqësive fetare, shprehive dhe traditave nuk mund të konceptohet se sa ekzistencën mes fitores dhe mposhtjes apo mundjes. Njëra erdhi nga kufijtë e Rrethit Arktik, shtëpia origjinale e të tjerëve ishte në Zonën Toride. Të dyja ndoqën hapat e familjeve dhe fiseve të tyre që ishin të thiktë në barbarizëm dhe idhujtari; mirëpo Normani, megjithëse kishte ndryshuar sistemin e tij të adhurimit, akoma mbetën shumë tipare antipatike dhe degraduese, derisa arabët shpallën një besim që tregon neveri të hapur ndaj adhurimit të fotografive dhe lutjet që u bëhen shenjtrive. Varfëria, injoranca, egërsia akoma mbeti karakteristikë e Normanit, si atëherë kur me një grusht njerëzish të patundur, ai i çoi në ajër ushtarët e myslimanëve të Sicilisë. Ky i fundit, edhe pse inferior në rezistencë dhe energji luftarake ndaj pushtuesit të tij, ai posedonte mjeshhtëri e cila ligjërisht i dha të drejtën e një posti të rëndësishëm në unionin e popullit. Asnjë faktor i nderit, veçorisë, apo gjeniu shpikës nuk do të kishte dashur ta lartësojë emrin apo personalitetin e tij. Fama e arritjeve të tij ushtarake arriti në gjithë botën. Marrëdhëniet e tij tregtare e kanë bërë emrin e tij familjar dhe të respektuar nga kombet e largëta, të cilët mbretëritë krishtere të Evropës nuk i njihnin. Qeveria e tij civile ishte shumë e përshtatur për njerëzit dhe nevojat e tyre,*

<sup>36</sup> A.L. Udovitch: Islamic Sicily; p.263

<sup>37</sup> A.L. Udovitch: Islamic Sicily; p.263

*ligjet e të cilit ishin menduar për qeverisje. Nën këto ligje, të udhëhequr nga princër të mëdhenj e të suksesshëm, shoqëria myslimane u bë e pasur, e lustruar, dhe e shthurur, por eventualisht dhe në mënyrë të pashmangshme e dobësuar dhe rrënuar. Dezorganizimi politik dhe social, sidoqoftë nuk e shkatërroi tërësisht prestigjin që fituan me vite nga fama ushtarake dhe eminenca intelektuale”.*<sup>38</sup>

Në të vërtetë, fundi i myslimanëve të Sicilisë mezi e kuptoi një fund të ndikimit mysliman në ishull. Në të kundërtën, për Hittin, u shfaq lulëzimi i një kulture interesante islamo- krishtere;<sup>39</sup> dhe deri më sot myslimanët janë shumë të involvuar në luftë dhe grindje mes vete dhe nuk kanë kohë për t'u angazhuar për gjëra më të mira, nën Normanët, shpirti i tyre arriti një realizim të plotë në një shpërthim të pasur të artit dhe kulturës arabo-normane.<sup>40</sup> Shkëlqimi i civilizimit mysliman më shumë u ngrit sesa që u humb nga pushtuesit normanë, dhe nën të njëjtit normanë, armiqësia fisnore që ishte mallkim për shoqërinë myslimane u shua nëse nuk mund të themi u çrrënjësonte tërësisht.<sup>41</sup> Dhe ashtu si na tregon Miranda, një kohë Sicilia ishte e liruar nga germadhat e luftës, banorët e saj i përkushtoheshin zhvillimit të literaturës së tyre, poezisë, legjislacionit dhe diturisë shkencore që e merrnin nga Lindja.<sup>42</sup> Më pas, mbretëria e Sicilisë, sipas Haskins, u ngrit për ta okupuar “rëndësinë e veçantë të kulturës në historinë mesjetare”.<sup>43</sup> Briffauti e njeh Sicilinë e cila deri te sundimtarët e fundit Elohenstaufen, mbeti një qendër e kulturës myslimane dhe fokus i një civilizimi të zgjuar.<sup>44</sup>

Pre-eminenca e kulturës islame dhe shkencore kuptohej mirë nga Normanët, dhe ata këtë e vërtetonin në çdo aspekt:

<sup>38</sup> S.P. Scott: History of the Moorish Empire; pp.16-7.

<sup>39</sup> P.K. Hitti: History of the Arabs; MacMillan, London, 1970, ed.p.606.

<sup>40</sup> P.K. Hitti: History of the Arabs; op cit, p.606.

<sup>41</sup> S.P. Scott: History of the Moorish Empire; pp.24.

<sup>42</sup> A.H.Miranda: the Iberian Peninsula and Sicily; në The Cambridge History of Islam; vol2; ed: P.M.Holt.A.K.S. Lambton and B.Lewis, Cambridge University Press, 1970, pp.406-493; p.437.

<sup>43</sup> C.H.Haskins: Studies in the history of the Mediaeval Science;

<sup>44</sup> R.Briffault: The Making of Humanity; George Allen; London; 1928; p.212.

*“Eksperiencia e pushtuesve, e fituar në shumë prona, thekson Skoti, u mundësoi atyre të çmojnë vlerën e monumenteve të një civilizimi tepër të zhvilluar, promovuesit e të cilit shpejt kishin për të kaluar nën skeptrin e tyre. Për këtë arsye, në ato qytete nuk kishte asnjë grabitje, asnjë germadhë të rrëmujshme të vendeve pjellore të cilat janë përmirësuar nga punët e rënda dhe ruajtje nga kënetat, përroskat dhe humnerat. Rezultatet e qarta të treqind vjetëve të progresit kombëtar dhe kulturor iu transmetuan, por me pak dëmtim, të të huajve fitimtarë. Këto të mira menjëherë u kapën dhe u përvetësuan me një lakmi fenomenale te njerëzit, karriera e të cilëve ka qenë e drejtuar nga instinktet lakmitare të banditëve, sjelljet e të cilëve kanë qenë midis licencës së kampit, paragjykimin e manastirit dhe masakrën e zonës”.*<sup>45</sup>

Roxheri I, ishte sundimtari i parë i ishullit pas myslimanëve në vitin 1091, dhe duke rrezikuar të qenit si mysliman, i inkurajoi ata t'i përsosin dhuntitë e tyre'.<sup>46</sup> Gjithashtu edhe pasardhësit e tij e bënë të njëjtën gjë dhe kështu, ata jo që mbetën pa tokë të mirë, por u akuzuan si të qenit më shumë myslimanë sesa krishterë.<sup>47</sup> Natyra e mbretërisë së Roxherit II, dhe e vetë Roxherit, ishte ndryshe nga Evropa e krishterë.<sup>48</sup> Pallati i tij ishte thajse krejt i stilit mysliman, dhe me shkëlqim të këndshëm, i mbushur me eunukë myslimanë, poetë arabë, gjeografë.<sup>49</sup> Gjuha aktuale në pallatin mbretëror ishte e ngjashme me arabishten; dhe për një kohë të gjatë një numër i dokumenteve vazhdonte të lëshohet në arabisht, me data sipas Hixhrit, si dhe çështje të caktuara të monedhave.<sup>50</sup>

Vetë mbreti dinte jo vetëm latinshten, por edhe greqishten dhe arabishten, përshtypjet e fituara nga pallati i tij mbretëror ishte përzierja e pamjeve madhështore të ekspozitës Bizantine dhe Islamike.<sup>51</sup> Në pa-

<sup>45</sup> S.P. Scott: History of the Moorish Empire; op cit; p.18-9.

<sup>46</sup> A.H.Miranda: the Iberian Peninsula and Sicily; në The Cambridge History of Islam; vol 2; op cit;p.438

<sup>47</sup> R.Briffault: The Making; p.212.

<sup>48</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; op. cit; 53.

<sup>49</sup> C.Waern: Medieval Sicily; Duckworth and Co; London; 1910; p.43.

<sup>50</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; op. cit; 53.

<sup>51</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; op. cit; 53.

llatin e tij mbretëror kishte mikpritës zyrtarë me tituj arabë, një prej tyre duke qenë kuzhinier i mbretit; faktor i rëndësishëm që nuk mund të tejkalohet.<sup>52</sup> Eunuku, me mantel të gjatë dhe turbane si dëbora, mizëron nëpër pallate; kadiu duke ruajtur simbolin dhe autoritetin e punësimit të tij zyrtar, ishte anëtar i rëndësishëm i gjyqit sicilian, jo vetëm për çështjet e myslimanëve, por shpeshherë ishte edhe këshilltar i besueshëm i monarkut.<sup>53</sup>

Një sundimtar tjetër i Sicilisë ishte Uilliam II (1166-1189), ku sipas Ibn Xhubejrit, u ngjanë mbretërve myslimanë, në mënyrën e të jetuarit, të zhytur në kënaqësitë e mbretërimit, gjithashtu u ngjanë në procedurën e administrimit, në sjellje dhe adete, në klasifikim, në madhësinë e oborrit mbretëror dhe salltanet. E madhe është mbretëria e tij... Ai mundte të lexojë dhe shkruajë arabisht. Njëri nga njerëzit e tij të besueshëm na tregoi se alamja (motoja mbretërore që është përdorur sipas zakoneve arabe si një mbishkrim në arabisht) e tij është lavdërimi i qoftë Zotit ashtu si i takon, kurse alamja e babait të tij ishte “lavdërimi i qoftë Zotit për të gjitha të mirat e Tij”.<sup>54</sup>

Sistemi i myslimanëve për administrim pjesërisht vlerësohej nga Normanët, të cilët e ruajtën atë; mbretëria prezantonte një “spektakël unik” të një mbretërie krishtere në të cilën myslimanët mbanin pozitën më të lartë.<sup>55</sup> Brifolti tregon që posti i nderit dhe urdhrave qëndroi në duart e myslimanëve.<sup>56</sup> Kryeministri i mbretërisë mbante titullin interesant të dyfishtë “Emiri i Emirëve” dhe kryekonti i kryekontëve, një lloj veziri i madh dhe kryeudhëheqës.<sup>57</sup> Në vitin 1125, ishte Xhorxhi i Antiokës, një vendës krishterë i Sirisë myslimane, i cili kishte shërbyer Ziridët të Mehdiu (Tunizi).<sup>58</sup> Megjithatë, myslimanët të princërve Normanë patën besim dhe simpati të lartë.<sup>59</sup> I shpejtë për t’u takuar me

<sup>52</sup> C.Waern: *Medieval Sicily*; pp.43.

<sup>53</sup> S.P. Scott: *History of the Moorish Empire*; op cit; p.28.

<sup>54</sup> C.Waern: *Medieval Sicily*; pp.59.

<sup>55</sup> P.K.Hitti: *History*; op cit; p.607.

<sup>56</sup> R.Briffault: *the Making*; p.212.

<sup>57</sup> C.Waern: *Medieval Sicily*; pp.43.

<sup>58</sup> J.D. Breckenridge: *The two Sicilies*; op. cit; 53.

<sup>59</sup> S.P. Scott: *History of the Moorish Empire*; op cit; p.28.

nevojat e çdo çështjeje; aftësitë e tij fizike nuk mjaftonin për të shuar anarkinë dhe vendosje të rendit; këshilltarët e myslimanëve ishin ata që qëndruan nën hijen e fronit.<sup>60</sup> Skoti tregon që Sicilia normane rrëfen për të gjitha qëllimet dhe synimet, një zgjatim, nën rrethana të favorshme më të lumtura, të atij sundimi të cilit ishulli i kishte borxh prosperitetin dhe famën; ndikimi i suksesit ekonomik i myslimanëve, kapaciteti dhe aftësia manifestohej dhe vërtetohej gjithkund. Puna e tyre e qetë i ndihmoi ata në përparim dhe rritje të fuqisë.

Leverditë bregdetare të ishullit ishin në duart e myslimanëve; ata i kontrollonin të ardhurat; i diskutonin kontratat; administrimi i drejtësisë dhe edukimi i rinisë ishte kryesisht në duart e tyre.

Integriteti i tyre vërtetohej edhe nga ata, puna e të cilëve dukej e pafavorshme për nga krahasimi; talenti i tyre i gjithanshëm i ngriti ata në postet më të larta dhe më të besueshme në pallatin mbretëror të Normanëve. Sipas historianëve bashkëkohorë, ky pallat mbretëror për nga kultura dhe madhështia barazohet me atë të Kajros dhe Bagdadit.<sup>61</sup> Dhe padyshim, në udhëheqjen e qeverisë, në financa, në legjislacion, në rregullimin e tregtisë, në mbrojtje dhe nxitje për bujqësi, në mirëmbajtje të rendit - sundimi Norman në Sicili jep shembullin e një civilizimi të përparuar që nuk ishte parë askund në Evropë.<sup>62</sup>

Shumë nga këto menaxhime administrative Islame dhe aftësi drejtuese duket se janë përhapur anëmbanë Perëndimit.<sup>63</sup> Nga Sicilia, zyrrat e qeverisë u bënë dogana dhe zyra administrative.<sup>64</sup> Brifolti pohon se sistemi administrativ i Sicilisë dhe përparësitë e veta islame, shërbyen si një model për Evropën.<sup>65</sup> Ndërmjet pallatit mbretëror Norman që ishte nën sundimin e Henrit të II, kishte marrëdhënie të vazhdueshme nëpërmjet së cilës shumë elemente të kulturës islame shkuan direkt në Britaninë e largët.<sup>66</sup> Dhe një e tillë arriti të Kaid Brun (pronari

<sup>60</sup> S.P. Scott: *History of the Moorish Empire*; op cit; p.28.

<sup>61</sup> S.P. Scott: *History of the Moorish Empire*; op cit; p.19-20.

<sup>62</sup> S.P. Scott: *History of the Moorish Empire*; op cit; p.22.

<sup>63</sup> R.Briffault: *the Making*; p.212.

<sup>64</sup> R.Briffault: *the Making*; p.212.

<sup>65</sup> R.Briffault: *the Making*; p.212.

<sup>66</sup> R.Briffault: *the Making*; p.212.

Tomas Braun) në departamentin e financave, ku jeta dhe roli i tij në Angli ka qenë hollësisht e studiuar nga Haskinët.<sup>67</sup> Tomas Braun ishte një refugjat mysliman nga Sicila, i cili u detyrua ta lëshojë Sicilinë me ardhjen e Uilliamit të Keqit. Mesa duket ai arriti në Angli në vitin 1158, kur është përmendur në Pajp Roll.<sup>68</sup> Si një nëpunës i të dyve mbretit Roxher dhe Henrit II, Tomas Broun kishte një interes të veçantë për studentët e lidhjeve ndërkombëtare në shekullin 12, dhe po ashtu një ndikim që atribuohet si një hallkë lidhëse mes sistemeve fiskale të të dy mbretërive.<sup>69</sup> Tomas Broun u ul në tavolinën e financave, dhe me asistencën e dy nëpunësve mbikëqyrte gjitha veprimet e fondeve të larta dhe të ulëta. Ruloja e tretë është ruajtur nga ai si një çek mbi rulot e thesambajtësve dhe kancelarit, dhe ky rul pa dyshim ka qenë e caktuar për informatat private të mbretit dhe për këtë Tomas Brauni kujdesej për të kudo që shkonte.<sup>70</sup>

Ndikimi i myslimanëve në Sicili ishte i dukshëm edhe në sistemin e drejtësisë. Skoti krahason gjerësisht ndikimin e myslimanëve me sistemin e ashpër të Normanëve të mëparshëm, i cili vlen të riprodhojë masa më të gjera:

*Paragjykimet barbare të pushtuesve Normanë mbijetuan në shumë institucione të trashëguara nga shekujt e injorancës dhe paragjykimeve të mëdha. Mes tyre ishin edhe gjykime të padrejta dhe absurde me zjarr, me ujë, konflikte gjyqësore, mbizotërues në shoqëritë e sunduara pjesërisht nga priftërinjtë e pjesërisht nga armiku...njerëzit e njohur me kodin Bizantin dhe Islamik përfundimisht i zvogëluar të këqijat e krijuara nga këso procedura irracionale; dhe ndonëse jotërësisht të braktisur, tiparet e saj më sulmuese gradualisht filluan të vjetroheshin. Nga ana tjetër, administrata e drejtësisë shquhej për nga përsosmëria e sistemit të saj, për shpejtësinë me të cilën gjyqet drejtoheshin, për mundësinë që i jepej ndërgjyqit për apele dhe përsëritje të gjykimeve.*

<sup>67</sup> C.H.Haskins: England and Sicily in the 12<sup>th</sup> century; The English Historical Review; Vol XXVI (1911) pp 433-447 dhe 641-665.

<sup>68</sup> C.H.Haskins: England and Sicily in the 12<sup>th</sup> century;

<sup>69</sup> Stubb: Constitutional History; i.408, in Haskins.

<sup>70</sup> C.H.Haskins: England and Sicily in the 12<sup>th</sup> century;

*I veshur me një karakter shenjtëror, gjykatësi për nder të pozitës së tij zyrtare, ishte inferior vetëm të mbreti. Karakteri i tij ishte i paprekur. Kryetari i gjyqit suprem të mbretërisë, nga e cila të gjitha kërkesat e bëra nga tribunatet inferiore që më në fund u gjykuan, thirrej Nëpunësi i madh gjyqi. Me fuqinë dhe dinjitetin e tij ai arriti të ketë konsideratë të lartë. Askush pos burrat ishin ata që u lartësuan në një integritet dhe mësim dukshëm të lartë në këtë nëpunësi madhështore. Gjyqi i madh, parapriu të ketë një bujari madhështore, titulli i të cilit shumë i vjetër dhe i fituar në Egjipt dhe Palestinë, tanimë është bërë historik. Para tij mbartej një flamur i mëndafshit dhe një emblemë e zyrës së tij. Në kuvendet publike dhe audiencat mbretërore, ai ulej në anën e majtë të sunduesit. Vetëm një polic i thjeshtë, nga të gjithë nëpunësit e mbretit, arriti t'i afrohet në post. Këto nderime të pazakonta, të cilat duhej të respektoheshin, tregojnë një përparim të madh në personalitetin e njerëzve, të cilët para pak viteve më herët, nuk njihnin asnjë ligj tjetër përveçse atë që është fizikisht superior, asnjë gjykatë pos atë të armëve.<sup>71</sup>*

Trashëgimia kulturore islame gjithashtu kishte stilin dekorativ dhe arkitektural të kishave të hershme Normane, si dhe artet e vogla dekorative të periudhës Normane.<sup>72</sup> Në kishën e Martoranës e ndërtuar nga Xhorxhi i Antiokës për një manastir për murgeshat greke në Palermo, mbishkrimi arab gjendet në bazën e kubes së vogël, ku faktikisht aty është përkthimi i himnit grek.<sup>73</sup> Dyert e Martoranës ishin të gdhendura nga zejtarë vendës, duke rikthyer mjeshtëritë e myslimanëve, të cilët e punuan tavanin fantastik të Faltores së Roxherit.<sup>74</sup> Struktura e çatisë dhe tavanit të Faltores janë punë e myslimanëve, të zbukuruara me vizatime dhe stile orientale të ilustruara nga fabulat dhe legjendat e Lindjes.<sup>75</sup>

<sup>71</sup> S.P. Scott: History of the Moorish Empire; op cit; p.21-2.

<sup>72</sup> A.L. Udovitch: Islamic Sicily; p.263

<sup>73</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; op. cit; 53

<sup>74</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; op. cit; 53

<sup>75</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; op. cit; 53



Periferitë e Palermos, sikurse është Ziso, emri i të cilit rrjedh nga gjuha arabe ‘El Aziz-i Shkëlqyer’,<sup>76</sup> është gjë që thekson ndikimin e Islamit. Influenca Islame vazhdoi madje edhe nën sundimin e Uilliamit I (i Keqi) (sundoi prej 1154-1166), trashëgimtar i Roxherit II.<sup>77</sup> Ai ndërtoi një numër të strehimoreve në periferitë e Palermos, nga të cilat asnjë nuk ishte më madhështore sesa “Zisa”, një dizajn gjeometrik që sugjeron një lidhje e modeleve tekstile e punuar me dorë, mjete të dendura të transmetimit të motiveve ornamentale, të cilat janë përdorur gjatë mesjetës.<sup>78</sup> Katedralja e krishterë e Palermos kombinohet me mjeshtërinë myslimanëve dhe artistëve bizantinë. Muret ishin të veshura me ar, shkëlqimi i së cilës gjallërohej nga mermeri i çmuar me lloj-lloj ngjyrash dhe i kufizuar me pikturim gjethesh me mozaik të gjelbër; shtyllat e zbukuruara me lule, të larmuara me mbishkrime të llojit Kufik.<sup>79</sup>

Në fushën e diturisë, Normanët gjithashtu pranuan sistemin superior Islam të mësimi. Kështu që, kur këta Normanë morën nga myslimanët Sicilinë dhe pjesën jugore të Italisë, ata i dhuruan shkollën medicinale të themeluar nga të fundit, të cilën ata gjithashtu ua dhuruan gjitha institucioneve myslimane.<sup>80</sup> Djali i Roxherit I, Roxheri i II, kont i Sicilisë, Dukë i Kalabrisë, nga viti 1101, ishte monarku më i shkolluar në kohën e tij, dhe përkrahës i shkencës dhe artit.<sup>81</sup> Ai kënaqej kur gjendej në shoqëri me myslimanët e shkolluar dhe katërmbëdhjetë vjetët e tij të fundit i kaloi në meditime shkencore në një traditë të vërtetë myslimane.<sup>82</sup> Është ky Roxheri i II, i cili do të jetë mecenat i el Idrizit, një gjeograf i famshëm dhe kontributi i të cilit në këtë lëmi shkencore do të shihet në vijim. Roxheri II gjithashtu ishte i përgjegjshëm, i mirësjellët në influencën e Islamit, një ndër depërtimet më

<sup>76</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; p.55

<sup>77</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; p.55

<sup>78</sup> J.D. Breckenridge: The two Sicilies; p.55

<sup>79</sup> S.P. Scott: History of the Moorish Empire; op cit; p.26

<sup>80</sup> G.Le Bon: La Civilisation des Arabes; IMAG; Syracuse; Italie; 1884; p.391.

<sup>81</sup> G.Sarton: Introduction to the History of Science; 3vol; the Carnegie Institute of Washington; 1927-48; p.191.

<sup>82</sup> G.Sarton: p.191.

vendimtare në shkencë dhe civilizim: themelimi i një sistemi për ekzaminimin e të gjitha ushtrimeve mjekësore. Skoti tregon se si në Kristendom, klerikët ishin depozitarë të përgjithshëm të diturisë, një përfitim të cilën ata e kuptuan plotësisht dhe në asnjë mënyrë nuk donin ta braktisin. Por nga ana tjetër, ata të vetëm dobësoheshin:

*Për mjekësinë e paligjshme e asaj kohe, siç praktikohesh nën sanksionet e “Vështrimit të Shenjtë”, Skoti thotë:*

*“U ngrit një kope e injorantëve dhe sharlatanëve me mëditje kish-tare, që vepronin në mënyrë të psalmeve, relikteve dhe thimjameve, dhe fitimet e tyre të pa masa ishin një nga burimet kryesore të të ardhurave të famullisë dhe manastirit, dhe një ngarkesë përgjegjësie mbi njerëzt”.*<sup>83</sup>

Mbreti Roxher shfuqizoi këtë keqpërdorim dhe kërkoi një ekzaminim nga ana e mjekëve me përvojë, të të gjithë kandidatëve të mjekësisë dhe kirurgjisë. Themelimi dhe vendimi i fakulteteve të mjekësisë dhe dhënia e titullit mjekësor ishin të kontraktuara nën të.<sup>84</sup> Në vitin 1140, ai miratoi që çdokush që dëshiron të ushtrojë mjekësinë, nën vuajtjen e burgimit dhe konfiskimit të mallrave, patjetër të paraqiten para një magjistrature dhe të fitojnë një mandat.<sup>85</sup> Kjo përmasë i shtrëngoi ata, mësimi i të cilëve ishte i mangët në shërbimet e fshehta të faltoreve dhe rrëfyesorëve.<sup>86</sup>

Në shekullin që vijon, Roxheri II u rivalizua në shumë anë nga nipi i tij Frederiku II, i cili u bë mbreti i Sicilisë në 1198, pastaj kryetar i Perandorisë së Shenjtë në vitin 1220, dhe mbret i Jerusalemit në vitin 1229.<sup>87</sup> Brifolti tregon se “kur ai ishte në sundim, kultura e myslimanëve në ishull arriti kulmin e saj dhe kishte një ndikim të lartë e të gjerë të civilizimit mbi Evropën e prapambetur.”<sup>88</sup> Sikurse, nën sund-

<sup>83</sup> S.P. Scott: History of the Moorish Empire; op cit; p.27.

<sup>84</sup> D.Campbell: Arabian medicine and its influence in the Middle Ages; Philo Press; Amsterdam; 1926; I riprintuar në 1974; p.119.

<sup>85</sup> D.Campbell: Arabian medicine and its influence in the Middle Ages; Philo Press; Amsterdam; 1926; I riprintuar në 1974; p.119.

<sup>86</sup> S.P. Scott: History of the Moorish Empire; op cit; p.26.

<sup>87</sup> G.Sarton: Introduction; op cit; p.575.

<sup>88</sup> R.Briffault: The Making; op cit; p.212.

imin e gjyshit të tij ashtu edhe nën Frederikun, influenca e myslimanëve u bë shumë e fortë, madje edhe më e fortë pas vizitës së tij që e bëri në Lindje, dhe i mirëmbajti marrëdhëniet politike dhe komerciale me vendet myslimane.<sup>89</sup>

Në parapëlqimin e tij të jetë më shumë në rrethin e myslimanëve sesa krishterëve, Sartoni thotë së ai ishte gjysmë mysliman në mënyrën e tij.<sup>90</sup>

Në fakt, për më shumë ai kishte frikë-respekt, temperament që të shtonte dyshimin se mësimi dhe kultura e tij e lartë përfundimisht ka molepsur krishterimin e tij.<sup>91</sup> Sikur edhe vetë el Endelusi, ai shfaqej me mahnitje, admirim, zili të përzier me frikë dhe dyshim.<sup>92</sup> Frederiku gjithashtu mbante shkëmbime intelektuale me sunduesit myslimanë në mënyrë që të merrte përgjigje ndaj disa pyetjeve të tij. Në kohën e sulltanit të Egjiptit Malik el Kamil, (1218-38) perandori dërgoi shtatë çështje të rënda, në mënyrë që t'i provojë dijetarët myslimanë dhe gjatë këtyre këmbimeve atij iu dërguan një varg dhuratash që përfshihejshin në vitin 1232, El Eshrefi, sulltan i Damaskës, i bëri dhuratë një 'planetarium' madhështor i cili hap figura të diellit dhe hënës që tregojnë kohën në rrotullimin e tyre të caktuar.<sup>93</sup> Kryesisht, besohet se "njeriu i parë modern në fron" ishte nën sundimin e Frederikut sesa në ditët e Petrarkut, ku shihet një fillim i vërtetë i Renesances Italiane.<sup>94</sup> Dhe sipas Brifoltit, nëse emri i ndonjërit nga sunduesit meriton të lidhet veçanërisht me shpengim të botës krishtere nga barbarizmi dhe injoranca, nuk është ai i Sharlemanit, parodia e të cilit me një karakter civilizues është tepër patriotik dhe trillim kishtar, por është i sunduesit të shkolluar dhe entuziast (Frederiku), i cili miratoi civilizimin "Sara-

<sup>89</sup> C.H.Haskins: England and Sicily in the 12<sup>th</sup> century; op cit; p.244.

<sup>90</sup> G.Sarton: Introduction; op cit; p.575.

<sup>91</sup> Maria Rosa Menocal: the Arabic Role in the Medieval Literary History; University of Pennsylvania Press; Philadelphia; 1987; p.63.

<sup>92</sup> Maria Rosa Menocal: the Arabic Role in the Medieval Literary History; University of Pennsylvania Press; Philadelphia; 1987; p.63.

<sup>93</sup> C.H. Haskins: Studies; op cit; pp.253 dhe 265.

<sup>94</sup> J.Burckhardt: Die Cultur der Renaissance in Italien; ed.Geige, Leipzig, 1899, i.4. në C.H.Haskins: Studies; op cit.p. 299.

kenik" dhe punoi më shumë për të stimuluar përhapjen e tij në krahasim me sunduesit e tjerë para tij.<sup>95</sup>

Megjithëse Frederiku nën presionin e papave, u detyrua që sicilianët myslimanë t'i zhvendosë në Lucera, në një zonë të thellë italiane, ku dekada më vonë sunduesit Angevin sicilianë do ta shuajnë këtë prezencë të myslimanëve, vetë Frederiku duket se ka treguar shumë respekt madje edhe dëshirë për manifestimet e besimit Islam. Në Palermo dhe gjithashtu edhe në vende tjera si: Mesinë, Sirakuzë, Ena, Agrigento, nga majat e qindra minareve që dukeshin se e shponin qiellin, myezini zëshëm këndonte pjesë të Kur'anit dhe thërriste për në namaz pasuesit e Islamit.<sup>96</sup> Dhe kur ai udhëtoi për në tokën e Shenjtë, në gjakosjen më të pakët të të gjitha kryqëzatave në 1228-9, në Jerusalem, kur ra nata dhe thirrja e mbrëmjes për në namaz nuk u dëgjua, ai (Frederiku II) u hidhërua shumë dhe u kthye kah Kaidi duke i kërkuar t'i jepte sqarim.<sup>97</sup> Kaidi iu përgjigj duke i thënë se atë ditë ky ka dhënë urdher që ezani të mos dëgjohet atë natë për arsye respekti për të- Perandorin, pas së cilës Frederiku u përgjigj se "kjo është një shenjë paralajmëruese e një turisti inteligjent modern". Pas një studimi të butë se në vendet e tij Kaidi mund ta dëgjojë këtë, Frederiku e vërejti se Kaidi ka bërë gabim tek Allahu. Arsyeja kryesore, pse ai, perandori vendosi të kalojë një natë në Jerusalem ishte në mënyrë që ta dëgjojë thirrjen për në namaz dhe lavdërimet të deklamuar nga myslimanët përgjatë natës.<sup>98</sup>

<sup>95</sup> R.Briffault: The Making; op cit; p.212

<sup>96</sup> S.P.Scot: History of the Moorish Empire; në tri volume; J.B.Lippincot Company; Philadelphia; 1904; p.28-9.

<sup>97</sup> C.Waern: Medieval Sicily; pp.233-4.

<sup>98</sup> C.Waern: Medieval Sicily; pp.233-4.

## El Idriziu – një dijetar në pallatin e Palermos

Gjatë pushtetit të Roxherit II dhe viteve të para të pushtetit të Uilliamit I, ishte nëse mund të themi një fushë e Gjeografisë, e drejtuar nga el Idrizi, një morokian nga qyteti i Ceutës (1099-1100-d.1166), i deklaruar nga vetë mbreti Roxher.<sup>99</sup> Mendjemprenhtësia e Mbretit siç na informon Uaerni, formoi ‘një kënaqësi të veçantë lidhur me gjithçka që ka të bëjë me këtë degë të dijes, në të cilën, arabët shquheshin për këtë lëmi.<sup>100</sup> Me të vërtetë, ashtu si Skoti shënon, puna e pakompletuar e ptolemisë greke, me shekuj ka qenë një burim i besueshëm dhe i vetmi që njihej;<sup>101</sup> trajta e sipërfaqes së tokës, klima e saj, pozicioni e kontinenteve dhe deteve, i qyteteve dhe perandorive, ishin fakte shumë pak të njohura, madje edhe te ata njerëz me shkollim më të lartë. Edhe në tokat e krishtere, kisha me këmbëngulësi kundërshtoi gjitha këto mësimë si armiqësi e shkrimeve të Shenjta.<sup>102</sup> Kështu, si që thotë Idrisiu, Roxheri vendosi që të përpilojë një Gjeografi Universale, të bazuar në të dhënat e burrave me përvojë.<sup>103</sup> I vendosur në Palermo, siç duket kishte një pozitë shumë të leverdishme për ta kryer gjithë punën e tij, ndonëse Sicilia ishte një vendtakim i lundëtarëve nga ujërat e Mesdheut, Atlantikut dhe Veriut.<sup>104</sup> Puna i merrte 15 vjet për ta kryer atë si që thotë El Idriziu në hyrjen e tij.<sup>105</sup> Për ta bërë këtë, njerëzit me eksperiencë në udhëtim ftoheshin apo mirëpriteshin nga të gjitha anët e botës; dhe të dhënat e tyre krahasoheshin, ata që përputheshin i pranonin dhe të tjerat i mohonin; ndërsa të dhënat e shkruara më të vjetra i shfrytëzonin.<sup>106</sup> Pas pesëmbëdhjetë vjetëve të shoshitjes së këtyre evidencave, “gjatë kohës që nuk ecte dita” thotë Idriziu në

<sup>99</sup> C.Waern: Medieval Sicily; pp.47-8.

<sup>100</sup> C.Waern: Medieval Sicily; pp.233-4.

<sup>101</sup> C.Waern: Medieval Sicily; pp.233-4.

<sup>102</sup> S.P.Scot: History of the Moorish Empire; op cit; pp.461-2.

<sup>103</sup> C.Waern: Medieval Sicily; pp.47-8.

<sup>104</sup> G.H.T.Kimble: Geography in the Middle Ages; Methuen & Co Ltd; London; 1938; p. 56.

<sup>105</sup> M.Dunlop: Arab Civilisation; AD 1500; Longman; Librarie du Liban; 1971, p.71.

<sup>106</sup> C.Waern: Medieval Sicily; pp.47-8.

hyrjen e tij “kur mbreti nuk mori aktivitet në punë”<sup>107</sup> el Idrizi e përfundoi punën. Kjo përfshinte gjithë diturinë e mundshme të mbishkruar në një hartë të madhe të argjendit, dhe një volum i tekstit përshkruar në gjuhën arabe, një projekt që përfundoi në vitin 1154,<sup>108</sup> i quajtur Naz’hat el Mushtak apo Libri i Roxherit. Libri i Roxherit është një ndër librat më të elaboruara të kohës së mesjetës në botë “duke gjykuar për nga niveli i diturisë dhe koncepti i hulumtimit kritik të kohës së tij”, Ronarti shkruan “Libri Roxherian i Idrizit duhet të rangohet mes arritjeve më të rëndësishme në historinë e shkencës së gjeografisë”.<sup>109</sup> Pas një përshkrimi të shkurtër të tokës si glob, të cilën ai e llogariti të jetë 22.900 milja në qark dhe qëndron “stabile në kozmos sikur e verdhë e vezë”, dhe të hemisferave, klimave, deteve dhe gjireve, el Idrizi lëshoi një të dhënë të stërgjatur për rajonin e sipërfaqes së tokës.<sup>110</sup>

Ai i ndau shtatë klimatet, secilën prej tyre në dhjetë seksione të gjatësisë. Këto shtatëdhjetë seksione ai i përshkruan në detaje, ku secilin përshkrim e ilustron me hartë.<sup>111</sup> Dhe kur këto harta bashkohen përbëjnë një hartë botërore drejtkëndore. Përshkrimi i tij nga secila pjesë e ndarë ka një vlerë të veçantë kur krahasohet me të krishterëve, i cili mes tyre është në masë më të gjerë sa u përket detajeve dhe metodës së tij shkencore.<sup>112</sup> Përpilimi i El Idrizit shënon një epokë në historinë e shkencës, në gjallërinë e përshkrimit, në dataje të përpikta, vlerësim korrekt të hapësirës, dhe kjo është një ndër krijimet më të shquara letrare në kohën e Mesjetës.<sup>113</sup> Jo vetëm në të dhënat historike më të vlerësuara dhe më interesantet, por edhe përshkrimet e shumë pjesëve të tokës të cilat akoma janë të besueshme. Për tre shekuj gjeografët kopjuan hartat e tij pa ndonjë ndryshim. Pozita relative e liqeneve që përbëjnë Nilin, si një përvijim në punën e tij, nuk ndryshon

<sup>107</sup> C.Waern: Medieval Sicily; pp.47-8.

<sup>108</sup> M.Dunlop: Arab Civilisation; op cit; p.171.

<sup>109</sup> S dhe N Ronart: Concise Encyclopedia of Arabic civilization, Djambatan; Amsterdam, 1966, p.164.

<sup>110</sup> G.H.T.Kimble: Geography in the Middle Ages; op cit; p.57.

<sup>111</sup> G.H.T.Kimble: Geography in the Middle Ages; op cit; p.57.

<sup>112</sup> G.H.T.Kimble: Geography in the Middle Ages; op cit; p.57.

<sup>113</sup> S.P.Scot: History of the Moorish Empire; op cit; pp.461-2.

shumë nga ajo e Bejkërit dhe Stenlit pas më shumë se shtatëqind vjetëve.<sup>114</sup> Një hartë u përgatit dhe më në fund u transportua në një planisferë gjigante të argjendit (e ndarë në segmente, sipas Ammarit).<sup>115</sup> Kjo hartë shfaq një paraqitje të botës së njohur në formë të diskut ‘me vlerë 400 funta, ku secila funtë ka vlerë 112 dirhemë’.<sup>116</sup> Planisfera qiellore ishte përafërsisht gjashtë këmbë në diametër, në njërën anë zodiak dhe yllësi, në anën tjetër e ndarë për lehtësi apo komoditet në segmente, pjesët e tokës dhe ujit, sipas pozicioneve përkatëse të vendeve të ndryshme që janë skalitur.<sup>117</sup> Kjo përfshinte detet botërore, lumenjtë, gjiret, malet, shkretëtirat, rrugët dhe një numër shumë i madh i veçorive të tjera.<sup>118</sup> Një përshkrim gjithashtu u është shkruar edhe vendeve të cilat figuruan në hemisferë, veçoritë e tyre fizike, prodhimet, llojet e ndryshme të ndërtesave, monumenteve dhe arteve që lulëzonin; eksportet dhe importet e tyre, klimën dhe karakteristikat e banorëve, natyra e tyre, feja, stolitë, veshja dhe gjuha.<sup>119</sup> Kjo planisferë, sipas Danlopit, natyrisht që është zhdukur, është shkruar, por libri akoma qëndroi si një “monument i madh i arabëve dhe gjeografisë myslimanë”.<sup>120</sup> Më vonë, el Idrizi shkroi një enciklopedi gjeografike madje më të gjerë e titulluar *Naz’hat el Mushtak fi ikhtirak el Afak* (kënaqësitë e njeriut dhe ëndjet e shpirtit) (tekst integral i asaj që është humbur).<sup>121</sup>

Si kompensim për aftësinë e tij, Skoti shënon:

*“Idrizi nga mbreti pranoi tepricën e materialit të tij të çmuar, me vlerë prej dy të tretave, njëqind mijë pjesë të argjendit, dhe një anije e ngarkuar me mallra të çmuara. Kështu ishte bujaria e madhe me të cilën i biri i një pirati Norman, i rritur me armë dhe grabitje dhe injorant në shkronja, shpërbleu aftësinë gjeniale e një dijetari, gara e të*

*cilit u njollos ‘si barbar dhe i pafe’ nga çdo fuqi krishtere në Evropë”.*<sup>122</sup>

Kjo na çon te pika e fundit e kësaj pune: perceptimi i myslimanëve tjetërkund pos Sicilisë dhe pasojat e saj.

## Fundi i prezencës së myslimanëve në Sicili

Danieli tregon se:

*Kur Uiliami i Apulisë në De Rebus Gestis Normannorum in Sicilia, tregon për pushtimin e Palermos, ai cilëson përpjekjen e Roxherit për siguri dhe përkrahje për banorët myslimanë, i cili në të njëjtën kohë shkatërron të gjitha xhamitë, kurse xhamitë kryesore i shndërron në kisha të pastra, kështu që “atje ku djajtë kanë qenë ulur, tani do të jetë ulëse e Zotit dhe derë e përshtatur për në parajsë”.*<sup>123</sup>

*Ky nuk është një konspekt i keq mëshire se Evropa gjithmonë do t’i përkrahë myslimanët: një kusht për të shkatërruar fenë e tyre dhe së fundi të prishë identitetin e tyre.*<sup>124</sup>

Danieli, padyshim, me një përsosmëri arriti ta kuptojë nivelin dhe mënyrën se çka saktësisht do të thotë durimi i myslimanëve.

Disa kanë llogaritur se popullsia e myslimanëve në Sicili ka arritur më shumë se gjysmë milioni banorë.<sup>125</sup>

Në fillim të shekullit katërmëdhjetë, e gjithë prania e myslimanëve u zhduk nga ujdhesa. Eliminimi i myslimanëve nga Sicilia ishte i ngadaltë por me presion të papërkulshëm i bërë nga sundues të ndryshëm për t’i mënjeluar myslimanët nga mesi i krishterëve. Papa Klementi V për praninë e myslimanëve në mesin e krishterëve e deklaroi si një “fyerje apo ofendim ndaj Krijuesit”.<sup>126</sup> Për papat e tjerë, Lomaksi tregon, se prej Gregorit IX deri te Boniface VIII iu gjuajtën feudallëve të Luçerës (kolonia e fundit e myslimanëve në Sicili) lidhur me

<sup>114</sup> S.P.Scot: History of the Moorish Empire; op cit; pp.461-2.

<sup>115</sup> C.Waern: Medieval Sicily; op cit; p.47-8.

<sup>116</sup> A.L.Udovitch: Al-Idrisi; Dictionary of the Middle Ages; Charles Scribner’s son; New York; vol 6, p.412.

<sup>117</sup> S.P.Scot: History of the Moorish Empire; op cit; pp.461-2.

<sup>118</sup> A.L.Udovitch: Al-Idrisi; op cit; p.412.

<sup>119</sup> C.Waern: Medieval Sicily; op cit; p.47-8.

<sup>120</sup> D.M.Dunlop: Arab Civilisation; op cit; p. 171.

<sup>121</sup> D.M.Dunlop: Arab Civilisation; op cit; p. 171.

<sup>122</sup> S.P.Scot: History of the Moorish Empire; op cit; pp.461-2.

<sup>123</sup> N.Daniel: the Arabs and the Medieval Europe; Longman Librarie du Liban; 1975. p. 148.

<sup>124</sup> N.Daniel: the Arabs and the Medieval Europe; op cit; p.148

<sup>125</sup> A.L. Udovitch: Islamic Sicily; op cit; p.262

<sup>126</sup> V.Green: A New History of Christianity; Sutton publishing; Stroud; 1996; pp.90-1.

çështjen e myslimanëve.<sup>127</sup> Papat shpesh regjistronin ekzistencën e dukshme të kolonisë për raste lufte përsëri të kryqëzatave, ku Papa i Pafajshmi i IV dhe pasardhësit e tij u hodhën kundër sunduesve Hohe-nstaufen të Sicilisë dhe armiqve të papave të Italisë jugore.<sup>128</sup> Për këtë Skoti jep komentimin:

*Qendra e fuqive papnore dhe situatave të ndryshme të autoriteteve të tanishme - një pushtet tanimë i rëndësishëm, por akoma jo mirë i ushtruar nga autoritetet e miratuara- nuk do të dështojë të jetë thellë e impresionuar nga fuqia e kësaj perandorie anormale; ku simbolet krishtere dhe legjendat kuranore përziheshin në zbukurimet e katedrales, ku kryqëzimi dhe motot e sunduesve 'muhamedanë' së bashku u impresionuan nga monedhat e mbretërisë; ku klerikët e lartë eminentë fituan pushtet, bënë homazh, dhe ua paguan taksat fuqive laike; ku myslimanët dinjitoz jo rrallë patën prioritet të të dërguarit e papave; kurse armiqët e betuar të botës krishtere luftuan trimërisht nën normat e kryqit. Dhe ky model ogurzi as që pati efekt me vendet e kufizuara, ku afërsia e përditshme shkaktoi që kjo të humbë origjinalitetin e vet.*<sup>129</sup>

Skoti vetëm se ka cekur vetitë e myslimanëve patriotikë, të cilët iu përkushtuan sundimtarëve të tyre të rinj, jo vetëm në shërbim të tyre si që u pa më lart, por edhe luftuan në krah të tyre, madje edhe kundër bashkëfetarëve të tyre. Të urtit e Afrikës Veriore mezi e besonin prarinë e myslimanëve në radhët e ushtrisë dhe flotave detare ushtarake të mbretërve Normanë gjatë sulmit në Aleksandri të vitit 1174, apo më vonë me Frederikun II gjatë kryqëzatave të tij në Lindje.<sup>130</sup>

<sup>127</sup> Housley: The Italian Crusades; 40; 62; 64-5 në J.P.Lomax: Frederick II, His Saracens, and The Papacy; in Medieval Christian Perception of Islam, I edituar nga J.V.Tolan; Routledge; London; pp. 175-97; p. 189.

<sup>128</sup> Housley: The Italian Crusades; 40; 62; 64-5 në J.P.Lomax: Frederick II, p.189.

<sup>129</sup> S.P.Scot: The History of the Moorish Empire; op cit; p.29.

<sup>130</sup> D.Abulafia: Commerce and Conquest in the Mediterranean, 1100-1500; variorum, 1993; p.112.

Myslimanët ishin shërbyesit më besnikë dhe lojalë për cilindo sundimtar apo mbret që të vinte.<sup>131</sup> Vetëm refuzimi për të mohuar fenë e tyre ishte shkak për rënien e tyre përfundimtare.

Madje me sa thuhet edhe nën sundimin e myslimanëve, presioni mbi myslimanët rritej. Eunuku i Roxherit II, Filipi, në fillim si një agjent i fshehtë e më vonë si një komandant fitues i sulmit detar (kundër myslimanëve të Tunizisë), u denoncua si një mysliman i fshehtë:

*Nën perden e emrit krishterë, ai mbrojti një ushtar të fshehtë të djallit, përderisa nga pamja e jashtme mundahej të tregohet i krishterë, ai tërësisht ishte mysliman në mendje dhe vepra; ai i urrente krishterët dhe shumë i donte paganët (myslimanët), rrallë shkonte në kishat e Zotit, kurse shpesh i vizitonte sinagogët keqdashës (xhamitë). Ai ata i furnizonte me naftë për të rregulluar dritat dhe po ashtu me gjëra të tjera të nevojshme. Aspak nuk respektonte traditat krishtere, ai nuk ndalohej të hajë mishin të Premteve apo në Kreshmët e mëdha. Ai dërgonte kurbane për të varri i Muhammedit, dhe tepër i lëvdonte lutjet e imamëve të atij vendi.*<sup>132</sup>

Roxheri u zemërua shumë me Filipin të cilin e rriti si një katolik qysh në fëmijëri, dhe se ai tani e tradhtoi.<sup>133</sup> Filipi u dorëzua te baronët për t'u dënuar. Filipi u hoq zvarrë me thembrat e kalit deri te sheshi para pallatit dhe pastaj u gjuajt në zjarr për vdekje.<sup>134</sup> Edhe bashkëfjatorët e tij gjithashtu u ekzekutuan. Mbreti nuk ndërhyri për të treguar se ai ishte një 'princ krishterë dhe një katolik'.<sup>135</sup>

Gjendja e myslimanëve u keqësua ashpër nën sundimin e Uilliamit I (i Keqi) (sundoi prej 1154-1166) në Palermo, tregtarët myslimanë u masakruan masivisht në vitin 1160. Në vitin 1161, Lombardët zaptuan territorin mbretëror dhe thernin myslimanë kudo që gjenin.<sup>136</sup> Myslimanët vrapuan drejt Perëndimit për të gjetur vende më të sigurta, ku

<sup>131</sup> A.Lowe: The Barrier and the Bridge, G.Bles; London; 1972. p. 92.

<sup>132</sup> Nw N.Daniel: The Arabs and the Medieval Europe; Longman Librarie du Liban; 1975. p. 149.

<sup>133</sup> Nw N.Daniel: The Arabs; p. 149.

<sup>134</sup> Nw N.Daniel: The Arabs; p. 149.

<sup>135</sup> Nw N.Daniel: The Arabs; p. 149.

<sup>136</sup> N.Daniel: The Arabs; p. 151.

popullata ishte kryesisht myslimane.<sup>137</sup> Lombardët shkatërruan gjithçka që ishte myslimane, pa dallim moshe apo gjinie,<sup>138</sup> edhe ata që jetonin me krishterët nëpër qytete të ndryshme edhe ata që jetonin të ndarë, që kishin fshatrat e tyre. Vetëm disa prej myslimanëve shpëtuan duke u maskuar me veshje të krishterëve për siguri të përkohshme në qytetet myslimane në jug, por përjetuan një tmerr nga Lombardët, ku me gjenerata do të kalojnë pa dëshirë nëpërmes tyre.<sup>139</sup>

Nën sundimin e Uillimait II (1166-1189), gjendja e myslimanëve u përmirësua pak, por larg ishte nga e përkryera. Duke udhëtuar më vonë për në Sicili, një përfaqësues tregtar mysliman Valencian, Ibën Xhubjeri, dukej se ndjente se po iu afrohej fundi. Ai takoi një mysliman të mirënjohur, kryetarin e gjithë myslimanëve të ujdhesës, i cili erdhi në Trapani në kohën kur përfaqësuesi tregtar ndodhej aty. Ky ishte Kaid ebu Kasim ibën Hammad, me mbiemrin ibën Haxher, një nga fisnikët e ujdhesës i cili ka trashëguar sundimin nga babai te i biri... shumë i lavdëruar për virtytet e tij dhe bamirësinë ndaj myslimanëve, duke liruuar të burgosurit dhe duke u dhënë dhurata bujare udhëtarëve të varfër dhe pelegrinëve, kështu që i gjithë qyteti iu gëzua ardhjes së tij. Ky njeri kishte humbur privilegjin nga tiranët përmes intrigave, ka qenë i burgosur në shtëpinë e tij dhe ia konfiskuan gjitha pallatet e tij dhe pronësitë e trashëguara nga paraardhësit e tij.<sup>140</sup>

Ai shprehu dëshirë të takohet me Ibën Xhubejrin dhe patën një bisedë, dhe ky burrë i madh tha se ky dhe gjithë të afërmit e tij donin vetëm t'i shitnin gjithçka kishin dhe kështu të çlirohen nga fatkeqësitë dhe të jenë të lirë të jetojnë në vendet myslimane. Kur udhëtari ynë u nda nga ibën Hammadi qau dhe po ashtu i bëri edhe ata të qajnë.<sup>141</sup>

*“Fisnikëria e prejardhjes së tij, dhunti të rralla në karakterin e tij, sinqeriteti i tepërt në jetën e tij, bamirësia ndaj të afërmeve, liberaliteti*

*i tij, bukuria e trupit dhe shpirtit të tij, tepër na mallëngjeu”, tha Ibën Xhubejri’.*<sup>142</sup>

Nuk mungojnë as rastet e tjera të persekutimeve, ku u ekspozuan myslimanët në atë kohë, siç na tregon ibën Xhubejri:

*“Kështu është thënë se kur njeriu humb durimin me gruan e tij apo djalin, ose nëna me vajzën e saj, dhe këto në momente të zemërimit u gjuhen kishës, dhe bëhen krishterë dhe pagëzohen, dhe as babai nuk mund ta shohë djalin e tij e as nëna të bijën në ndonjë paraqitje tjetër, kështu që ata frikësoheshin që kjo t'u ndodhë myslimanëve të Sicilisë ashtu siç u ndodhi atyre të ishullit të Kretës (kur të gjithë banorët pa një pa dy u detyruan të bëhen të krishterë). Mallkimi qoftë mbi të pafetë”.*<sup>143</sup>

Një rast tjetër i mjerë na rrëfen si vijon: njëri nga liderët e qytetit e dërgoi të birin e tij në një festë të ibën Xhubejrit, duke i kërkuar atij që vajzën e tij të re ta pranojë për grua nëse ajo i pëlqen, apo ta martojë me ndonjë nga fshatarët e tij, por për çfarë do rasti ta marrë me vete edhe atë, ajo me dëshirë do ta lërë babanë dhe vëllezërit vetëm që të mund ta mbajë fenë.<sup>144</sup>

Gradualisht myslimanëve iu mor me forcë çfarëdo pasurie dhe toke që kishin, dhe teprica e myslimanëve me forcë u detyruan të shkojnë në Sicilinë Perëndimore nga ana e latinëve agresivë të kolonizuar në pjesën lindore të ujdhesës.<sup>145</sup>

Vazhdimësia e presionit Latin mbi këta myslimanë sollën një kryengritje në mal dhe kodra, në lindje dhe perëndim të Palermos dhe Monrealit në vitin 1220, një kryengritje, të cilën Frederiku e mposhti pas dy vjet luftime të ashpra (1222-4).<sup>146</sup> Tani largimi total i myslimanëve ishte vetëm çështje kohe.

<sup>142</sup> C.Waern: Medieval Sicily; p. 74-5.

<sup>143</sup> C.Waern: Medieval Sicily; p. 74.

<sup>144</sup> C.Waern: Medieval Sicily; op cit; p. 75...

<sup>145</sup> J.P.Lomax: Frederic II; His Saracens, and The Papacy; nw Medieval Perceptions of Islam; ed. nga J.V.Tolan; Routledge; London; pp.175-97; p. 177.

<sup>146</sup> J.P.Lomax: Frederic II; p.177.

<sup>137</sup> D.Abulafia: Commerce and Conquest; op cit; p.108.

<sup>138</sup> N.Daniel: The Arabs; p. 151.

<sup>139</sup> N.Daniel: The Arabs; p. 151.

<sup>140</sup> C.Waern: Medieval Sicily; op cit; p. 74-5.

<sup>141</sup> C.Waern: Medieval Sicily; p. 74-5.

Frederiku së pari i dëboi në zona të thella italiane në Luçera, ku u supozua të mos paraqesin asnjë rrezik të çfarëdo lloji. Sidoqoftë, presioni papnor u rrit për zhdukjen e tyre të plotë. Sipas Lomaksut, “retorika e zjarrit dhe e hidhur me të cilën papat sulmuan myslimanët e Luçerës, dhe shpesh pronarët e tyre mbretëror, zbulon armiqësinë e thellë dhe karakterin e papave”.<sup>147</sup>

Papa Gregori IX nxiti Frederikun t’i copëtojë “tepricat” e myslimanëve kështu që ata nuk do të mund t’i shqetësojnë zemrat e besimtarëve të Zotit, qoftë edhe për pak veçanërisht që kur dëmi i veçantë do të duket t’i jetë bërë Zotit tonë nëse djemtë e djallit të cilët janë të lidhur me zinxhirë të përjetshëm skllavërie, mbysin djemtë e ndritshëm brenda kufijve tanë, apo tmerresisht të imagjinojmë veten me privilegje të barabarta me ta’.<sup>148</sup>

Papa shikoi për t’i ungjillizuar myslimanët në Luçerë, dhe tek ai fund, shpalli se u drejtohet murgjve dominikanë për t’i ungjillizuar ata. Gregori e stimuloi Frederikun që t’i përkrahë dominikanët me ‘shpatën e rëndësishme, pa të cilën mund të dështojë misioni i tyre; në të vërtetë, për t’i ‘tërhequr zvarrë këta njerëz të cilët haptazi janë të mashtruar nga lajthitja e ferrit, t’i ringjallë dhe përtërijë duke u bërë terror, sepse vetëm atëherë skllavëria e tyre do të jetë më produktive, qysh atëherë kur Zoti të vijë te ti dhe ata’.<sup>149</sup>

Frederiku u shprehu mirëseardhje madje edhe asistoi në konversionin e tyre. Në të njëjtën kohë, ai me kujdes arriti t’i largohet parashtrimit të konversionit (ndërrimit të fesë) së myslimanëve me ushtrim të dhunës gjë të cilën e shtyu papa, dhe pa asnjë dyshim ai deklaroi se myslimanët e Luçerës nuk paraqesin ndonjë kërcënim për kishën dhe fqinjët e tyre të krishterë.<sup>150</sup>

Të pakënaqur me përgjigjen e Frederikut, në shkurt të vitit 1236, Gregori e akuzoi Frederikun me *crimina manifesta* (manifesti i krime-

<sup>147</sup> J.P.Lomax: Frederic II; p.179.

<sup>148</sup> M.GH (Monumenta Germaniae Historica) Epist. Saec. XIII 1:398-9; No 494 nw J.P. Lomax: Frederic II, p. 180.

<sup>149</sup> M.GH Epist. Saec. XIII 1:398-9; No 494 nw J.P. Lomax: Frederic II, p. 182-3.

<sup>150</sup> J.P.Lomax:Frederic II; p.183.

ve) në një letër që titullohej *Dum preteritorum consideratione* e cila përmban:

“Ndërtesat ku emri hyjnor është i nderuar janë detyruar të bëhen vende ku i mallkuari Muhamed adhurohet”...

Pastaj ai shtoi për myslimanët:

“Janë vendosur thuajse në mes të mbretërisë, shumë lehtë mund ta korruptojnë fenë krishtere me helmin e pabesisë së tyre. Prej aty vazhdojnë rreziqe më të mëdha, përderisa të krishterët janë të përzier me ta. Me anë të shoqërimit me paganët turma e besimtarëve do të largohet nga tufa e Zotit”.<sup>151</sup>

Gregori e kërcënoi Frederikun me përjashtim apo dëbim në mënyrë që ta detyrojë atë të kthehet mbrapsht, por Frederiku mbrojti të kundërtën, që ai i ka zhvendosur Sarakenët me një shpenzim të madh, dhe i ka vendosur në mes të krishterëve, ku për çdo ditë shërbejnë si një shembull për ta.<sup>152</sup>

Në tetor të vitit 1238, Gregori dërgoi paralajmërimin e tretë dhe të fundit për dëbim; i pasuar me kërcënime tjera. Mbi të gjitha, papat tërboheshin me praninë e myslimanëve enklavë në Luçerë, dhe argumentet legale me të cilat Gregori IX mbështeste sulmet e tij dhe mecenatin perandorak, vazhduan për shumë kohë pas vdekjes së Gregorit IX në 1241 dhe Frederikut në 1250.<sup>153</sup>

Pastaj, më në fund, në vitin 1300, myslimanët plotësisht u zhdukën nga ujdhesa,<sup>154</sup> disa prej tyre u shitën si skllavër, pjesa tjetër thjesht u zhduk në errësirën e historisë. Papa Bonifaci i VIII u kënaq me marrjen e lajmit për shkatërrimin e fundit të kolonisë myslimane në Sicili, si që na tregon Housli.<sup>155</sup>

Nga gjuha angleze:

**Hanife Alija - Dauti**

<sup>151</sup> M.GH (Monumenta Germaniae Historica) Epist. Saec. XIII 1:398-9; No 494 nw J.P. Lomax: Frederic II, p. 185-86.

<sup>152</sup> J.P. Lomax: Frederick II; p.186.

<sup>153</sup> J.P. Lomax: Frederick II; p.188.

<sup>154</sup> D.Abulafia: Commerce and Conquest; 1100-1500; Varorium, 1993; p.4.

<sup>155</sup> Housley: The Italian Crusades; p.65; në J.P.Lomax: Frederick II; p.189.

### Bibliografia

- M.Amari: la Storia dei musulmani di Sicilia, 3 vol, (1993-9) Rrevised 2<sup>nd</sup> edition by C.A. Nallino, Rome.
- D.Abufalia: Commerce and Conquest in the Mediterranean, 1100, Varorium, 1993.
- J.D. Breckenridge: The two Sicilies; in Islam and the Medieval West, S.Feber Editor; A Loan exhibition at the university Art Gallery; State university of New York; April 6- may 4, 1975;
- H.Bresc: Les Jardins de Palerme; in Plotique et Societe en Sicile; XII-XV em siecle; Varorium; Aldershot; 1990; pp. 55-127.
- R.Briffault: The Making of Humanity; George Allen; London, 1928.
- D.Campbell: Arabian medicine and its influence on the Middle Ages; Philo Press; Amsterdam; 1926; reprinted 1974.
- N.Daniel: The Arabs and the Medieval Europe; Longman Library du Liban, 1975.
- M.Dunlop: Arab Civilisation, to AD 1500, Longman; Librarie du Liban, 1971.
- Francesko Gabrieli: Islam in the Mediterranean World in The Legacy of Islam, edited by J.Schacht with C.E. Bosworth, 2nd edition, Oxford Clarendon Press, 1974. pp. 63-104.
- John Glubb: A Short History of the Arab peoples; Hodder and Stoughton, 1969.
- V. Green: A New History of Christianity; Sutton Publishing; Stroud; 1996.
- C.H. Haskins: England and Sicily in the 12th century; the English historical Review; Vol. XXVI (1911) pp. 433-447 and 641-665.
- C.H. Haskins: Studies in the histori of the Medieval Science; Frederick Ungar Publishing Co. New York. 1967 ed.
- P.K. Hitti: History of the Arabs, MacMillan, London, 1970 edt.
- G.H.T. Kimble: Geography in the Middle Ages; methuen & Co Ltd; London; 1938.
- G.Le Bon: La Civilisation des Arabes; IMAG; Syracuse; Italie; 1884.
- J.P.Lomax: Frederick II, His Saracens, and the Papcy; in the Medieaval
- Christian perception of Islam; edited by J.V.Tolan; Routledge; London; pp.175-97.
- A.Lowe: The barrier and the Bridge, G.Bles; London; 1972.
- M.L. de Mas Latrie: Traites de paix et de Commerce, et Documents Divrs, Concernant les Relations des Chretiens avec les Arabes de l'Afrique Septentrionale au Moyen Age, Burt Franklin, New Yok, Originally Published in Paris, 1866.
- Maria Rosa Menocal: The Arabic Role in Medieval Literary History, University of Pennsylvania Press, Philadelphia, 1987.
- A.H. Miranda: The Iberian Peninsula and Sicily, in The Cambridge History of Islam, vol 2, edt: P. M. Holt. A. K. S. Lambton, and B. Lewis, Cambridge University Press, 1970, fq. 406-439.

- J. Read: The Moors in Spain and Portugal, Faber and Faber, London, 1974.
- S and N Ronat: Concise Encyclopaedia of Arabic Civilisation, Djambatan, Amsterdam, 1966.
- G. Sarton: Introduction to the History of Science; vwll. 3; The Carnegie Institute of Washington; 1927-48.
- J.J. Saunders: Aspects of the Crusades, University of Canterbury, 1962.
- S. P. Scott: History of the Moorish Empire; nw tre vëllime; J. B. Lippincott Company; Philadelphia; 1904; vwll. 3.
- W. B. Stevenson: The Crusades in The East; Cambridge University Press; 1907.
- The Travel of Ibn Jubayr, trsltd from the original Arabic with introguction and notes, by R.J.C. Broadhurst; Jonathan cape, London, 1952; fq. 348.
- A.L. Udovitch: Islamic Sicily; in Dictionary of the Middle Ages; Charles Scribners' Son; New Yor; Vwll. 11.
- A.A. Vasiliev: The Struggle with the Saracens (867-1057); in The Cambridge Medieval History, vwll. IV; Edited by J.R tanker, C.W. Previte; Z.N. Brooke, 1923.
- C. Waern: Medieval Sicily; Duckworth and Co; London 1910.

### Salah Zaimeche

## SICILY

### (Summary)

Generally, little is known on the history of Sicily, with respect to its Muslim phase. Little is known about the impact of Islamic civilization on the island, in particular with respect to the important role of Muslims under Norman rule of the island. Little or hardly anything is known about the whereabouts or fate of the Muslims who once lived on the island. A proof of the general blackout of these crucial points of the history of the island is the fact that the best work on the history of Muslim Sicily was written by Michelle Amari in the 19th century, and reedited decades later by another Italian Nallino. This book in Italian has remained hardly if at all accessible, all the unique information it contains has been thereby effectively totally obscured. Thus, it is necessary for any outline on Sicily to try at least to bring out some of the main aspects of this history until, maybe, Amari's work is revived, or a work as good as it can be delivered to the public.



صالح زائمة

## الصقلية

### (خلاصة البحث)

نحن نعرف قليلا عن تاريخ الصقلية بصفة خاصة تاريخها الاسلامي، كما نعرف قليلا عن تأثير الحضارة الاسلامية في هذه الجزيرة و مساهمة المسلمين خلال حكم برمان في شتى المجالات العلمية و كذلك عن حياة المسلمين و مصيرهم الذين استوطنوا بهذه الجزيرة.

مع الاسف الشديد هناك تجاهل تام عن تاريخ الصقلية الاسلامي و يمكن القول بان أحسن كتاب عن تاريخ المسلمين في الصقلية هو الكتاب الذي الفه ما يكل عمار في القرن التاسع عشر و تم نشره بعد عدة عقود من قبل نالينو. و قد سمح لهذا الكتاب ان يكون متداولاً في ايطاليا الا أن معلوماته كانت غامضة. و لهذا السبب نحن في حاجة ماسة إلى مراجعة كتاب عمار عن الصقلية أو كتابة مرجع جديد عن تاريخ المسلمين بالجزيرة و نشره بين القراء.

## PSIKOLOGJI

*Abbas Husein Ali*

## NATYRA E PSIKËS NJERËZORE: KONTRIBUTI I GAZALIUT NË KONCEPTIN ISLAM TË PERSONALITETIT

**Abstrakt:** Ky punim merret me kritikën e modeleve psikologjike bashkëkohore të natyrës njerëzore dhe thekson kontributin e Ebu Hamid el-Gazaliut të të konceptuarit më të mirë të afinitetit njerëzor. Është dhënë një paraqitje e shkurtër themeleve filozofike të tre shkollave kryesore psikologjike: psikanalizës së Frojdit, bihejviorizmit të Skinnerit dhe humanizmit të Rogersit dhe Maslovljevit. Në këtë qëllim janë shqyrtuar metaforat me të cilat ata kanë përshkruar natyrën e njeriut. Duke parë implikimet e tyre praktike, veçanërisht për psikologjinë e personalitetit, punimi gjithashtu thekson mangësitë e këtyre modeleve. Pjesa e fundit potencon kontributin e Gazaliut në konceptin islam të natyrës njerëzore dhe personalitetit.

Përgjigjja në pyetjen se çfarë do të thotë, të jesh njeri, është në qendër të interesimit të psikologjisë bashkëkohore. Shumë gjëra varen nga mënyra se në çfarë forme përgjigjesh në këtë pyetje, ndërsa pyetjet e lidhura me studimin e personalitetit, rëndësisë së jetës dhe qëllimit të krijimit janë vetëm disa nga më të rëndësishmet në mesin e tyre. Literatura e psikologjisë bashkëkohore tregon se njeriu është mister i

vetvetes dhe se çështja e natyrës së njeriut paraqet temë të errësuar për shumë shkencëtar<sup>1</sup>.

Ky problem nuk është i tanishëm, por, vërtetë kjo çështje që janë marrë mendjet më të mëdha njerëzore. Në mesin e tyre ka qenë edhe Ebu Hamid el Gazaliu, shkrimet e shumta të të cilit rreth kësaj çështjeje meritojnë vëmendje më të madhe sesa janë dhënë deri më tani.

Qëllimi i këtij punimi nuk është të tregohet metodologjia e Gazaliut apo teoria e tij e njohjes, por vetëm mendimi i tij për natyrën e njeriut. Bile edhe kjo nuk është kaq e thjeshtë ashtu siç duket, ndoshta. Gazaliu me këtë çështje merret në libra të ndryshëm dhe, si duket me shkaqe të ndryshme. Kjo përfshinë polemikat e tij si filozof, sufi, ripërtëritës, apo të dikujt, i cili ka kaluar nëpër faza të rëndësishme të zhvillimit shpirtëror.

Për nevojat e këtij studimi, paraqitja ynë do të koncentrohet në “Ihja‘ulumid-dinin” e tij<sup>2</sup>. Në këtë libër ai jep paraqitjen e përgjithshme të natyrës njerëzore, para së gjithash nga aspekti i fesë dhe moralit. Në të ai kalimthi shpjegon mendimet e tij për atë çfarë do të thotë të jesh njeri.

### Themelet filozofike të psikologjisë bashkëkohore

Të gjitha shkollat psikologjike si pikënisje të tyre e kanë filozofinë për atë se çfarë do të thotë të jesh njeri. Gjatë kohës, këto mendime kanë ndryshuar në mënyrë drastike dhe mes vete ndryshojnë. Ndryshimi mes njeriut dhe qenieve tjera, megjithatë ka mbetur interesi kryesor i psikologëve.

Ky përkufizim është esenca e çështjes, e cila rëndom në filozofi përmendet si problem “intelekt-trup”. Filozofi ngushtë i lidhur me kë-

<sup>1</sup> The Nature of Human Disposition: al-Gazali's Contributions to an Islamic Concept of Personality”, Intellectual Discourse, vol. 3, nr. 1 (1995), page 51-64.

Shih, p.sh. L. Stevenson, Seven Theories of Human Nature (Oxford University Press, 1987); N. Chaney, Six Images of Human Nature (Englewood Cliffs, New Jersey: Prentice-Hall, 1990); dhe L. S. Wightman, Assumptions About Human Nature: Implications for Researchers and Practitioners (London: sage Publications, 1992)

<sup>2</sup> Ebu Hamid el-Gazali: Ihja‘ulumid-din (Bejrut: Darul ma`rifet, pa datë)

të filozofi është Rene Dekart (Rene Dekartes). Si duket, disa argumente sugjerojnë që Dekarti në masë të madhe ka qenë në ndikimin e shkrimeve të Gazaliut. Vizita e një dijetari tunizian në bibliotekën e Dekartit në Paris, ka zbuluar se ai ka poseduar kopjen e përkthimit të librit të Gazaliut “El munkidh mined-dalal” (“Shpëtimi nga lajthitja”) me komente të shkruara me dorë në këndet e saj, në të cilin thoshte: “Këtë duhet praktikuar në metodologjinë tonë”.<sup>3</sup>

Njeriu shikohej si një qenie e tërë racionale, krijesë e cila ka shpirt dhe shumë cilësi tjera, të cilat ia dhuroi **Zoti**. Për qeniet njerëzore gjithashtu mendohej që kanë trup, i cili është burim i dëshirave, epsheve dhe fuqive fizike. Andaj, shpirtëroren mund ta mbizotërojnë materializmi, ndërsa dëshirën njerëzore nuk e kanë përcaktuar epshet, por qëllimi racional.

Ky qëndrim qartë shpreh gjendjen e njeriut të dëshirës së lirë para determinizmit. Njeriu mund të zgjedhë mënyrën si të bëjë mirë, ndërsa nacionaliteti i tij nënkupton aktivitetin, i cili është rezultat i pranimet e jo dhunës. Kështu ishte ndikimi i teologjisë së krishterë në shkencë para darvinizmit.<sup>4</sup>

Mjerisht, siç do të shohim më vonë, kur njeriu filloi të shikohet si një hyjni, çështja e nacionalitetit është fryrë tej mase.

Atë që bëri Darvini, në realitet ishte kthimi i vëmendjes në drejtim të strukturës anatomike të njeriut dhe konceptit të mbijetesës së më të fuqishmit, si dhe në çfarë marrëdhënie është me evolucionin. Ai, gjithashtu ka përkrahur kontinuitetin mental apo evolucionin mental mes qenieve njerëzore dhe krijesave jo njerëzore. Pra për darvinizmin, dallimi mes njerëzve dhe qenieve jonjerëzore është gjë e masës, para sesa llojit. Kjo ka pasur implikime serioze për modelet psikologjike të natyrës njerëzore. Pohimi se njerëzit nga kafshët dallojnë vetëm për atë që të parët kanë më shumë instinkte se të tjerët, mendim të cilin shumë psikologë e kanë përfaqësuar mjaft gjatë, është shembull i mi-

rë. Ky koncept mbi njeriun ka sjellë deri të formimi i metaforës njeriu si makinë.<sup>5</sup>

### Implikimi i këtyre metaforave në psikologjinë bashkëkohore

Metaforat, të cilat i kanë konceptuar Dekarti dhe Darvini (njeriu si qenie racionale kundruall njeriut si makinë), kanë qenë paraprijëse kyçe historike të përpjekjeve të psikologjisë moderne që të përgjigjet në çështjet e natyrës njerëzore. Përpjekjet e të konceptuarit të natyrës njerëzore nga kjo mund të ndahen në dy kategori të mëdha:

1. Njerëzit janë të gjithëdijsëm, të plotfuqishëm dhe përplot dashuri (d.m.th. hyjnor);
2. Sjellja e njerëzve është e pavetëdijshme, e kryer pa dituri koshiente, e përcaktuar, fikse, rutinore (d.m.th. njeriu është si makinë)<sup>6</sup>

Këto dy kategori dominuese metaforike, njeriu si makinë dhe njeriu si hyjni, kanë prodhuar dhe në vete kanë përmbledhur një numër modelesh të natyrës njerëzore, që u paraqit në psikologjinë moderne.

Ajo që pason është analizë e shkurtër e psikanalizës, bihejviorizmit dhe psikologjisë humanistike.

Pa dyshim, ndikimi i mendimit të Darvinit, konceptit të tij të pae-pur të natyrës njerëzore, te Frojdi ka qenë shumë i madh. Por, disa faktorë, Frojdin e kanë sjellë në konceptin e tij mekanistik të natyrës njerëzore. Ndër këta më të rëndësishmit kanë qenë: arsimi i tij medicinal, përparimi shkencor i arritur në lëmenjtë e fizikës dhe kimisë dhe në fund, aspak më pak i rëndësishëm, ateizmi i tij.

Si doktor i mjekësisë, Frojdi ka qenë i mësuar që më tepër të koncentrohet në strukturën anatomike të trupit dhe të besojë më tepër në darvinizëm sesa në vetë judaizëm. Përveç kësaj, fryma e kohës së tij dhe përparimi i arritur në shkencat e fizikës e kanë shtyrë që të konce-

<sup>3</sup> Jusuf el Kardavi, El-Imama el Gazali, bejne madihihi ve nakidihi (Kajro: Mektebet Wehbeh, 1993)

<sup>4</sup> A. Korman, The Psychology of Motivation (Englewood's Cliffs: Prentice Hall, 1974)

<sup>5</sup> B. Weiner, Motivation: Metaphors, theories and Research (London: Sage Publications, 1992)

<sup>6</sup> Weiner, Motivation

ptojë trupin njerëzor si një sistem të mbyllur të energjisë, i cili e kthen energjinë në aksion. Citati vijues i Holtit, njërit prej studentëve dhe pasuesve të tij, vërteton këtë:

*“Koncepti i energjisë ka qenë preokupim i Frojdit që nga fillimi i punës së tij shkencore, duke paraprirë kështu cilindo model psiko-analitik. Në kohën kur Frojdi ka qenë student, energjia ka qenë në modë të madhe, term që ka qenë aq i popullarizuar sa fjala informatë sot, bile, ndoshta edhe më tepër.”*<sup>7</sup>

Pra, ngjashëm me makinën me avull, njeriu është shikuar si një qenie me libid (energji seksuale), e cila më vonë do të “robërohet” në tre pjesë: **IDI**, i cili është tejet instiktiv dhe kërkon direkt kënaqësitë e nevojave të tij; **EGO**, i cili është racional dhe gjithmonë ka në konsideratë realitetin; dhe **SUPEREGO**, i cili paraqet moralin dhe vetëdijen. Këtu është konflikti, veçanërisht mes IDIT dhe SUPEREGOS, për shkak të interesave të ndryshme është i pashmangshëm. Kur këta dy elefantë kacafyten, bari nën këmbët e tyre, d.m.th. **egoja** është e detyruar të durojë. Mënyra e vetme që **egoja** të mbrohet është që duke u shërbyer me ventilin siguries të lëshojë diç avull, t'i qaset mekanizmeve mbrojtës, siç janë: fantazia, sublimimi, represioni dhe ngjashëm. Mekanizmat mbrojtës janë në realitet, kënaqja e epsheve në mënyrë të ndryshuar, me fjalë të tjera, **egoja** mashtron edhe **idin** edhe **superegon**. Rezultati i fundit është “pa vetëdije” punë të shumta të pambaruara (epshe), të cilët më vonë do t'i bëjnë probleme individit të caktuar.

Bihejvioristët, në anën tjetër, janë marrë vetëm me format objektive të sjelljes, duke menduar që do të rrezikojnë rënie në irracionalizëm nëse merren me diç tjetër. Për këtë kanë studiuar atë që është e jashtme e qenieve njerëzore. Kështu Skinneri në bazë të eksperimenteve të bëra te kafshët, ka ardhur në përfundim se njerëzit, mu sikur robotët apo makinat, sillen në mënyrë të njëjtë.

Rrënjët e behejviorizmit radikal, me siguri gjenden në filozofinë e Hobsit (Hobbes) dhe ndoshta në kontinuitetin mes qenieve “jo njerë-

zore” dhe njerëzve, të cilën e ka mbështetur darvinizmi, Hobsi i impresionuar me dituritë shkencore të kohës së tij, në kozmos ka shikuar si një sistem i madh mekanik. Për të kozmosi është vetëm një makinë e madhe, e cila funksionon sipas principeve, të cilët janë lehtë për t'u kuptuar për mendjen njerëzore. Posaçërisht e ka interesuar problemi i kauzalitetit dhe për të njeriu ka qenë vetëm një makinë. “Pra, çfarë është zemra, përveç se një spirale; nervat vetëm tela të shumtë; ndërsa nyjet, rrotë që lëvizin tërë trupin”<sup>8</sup>, thoshte ai.

Qëndrimi radikal behejviorial i Skinnerit mbi natyrën e njeriut përsërit mendimin mekanicistik të Hobsit me diç me potencim të determinizmit ambiental. Lidhur me këtë libri i Skinnerit “Beyond Freedom and Dignity” (Përtej lirisë dhe dinjitetit) flet në vetë.

Kjo metaforë e makinës ka dominuar në psikologji prej vitit 1930 deri në vitin 1955. pjesa e dytë e decenies së pestë të shekullit të kaluar ka qenë dëshmitare e asaj që mund të quhet revolucion kognitiv në psikologji. Fryma e kësaj kohe ka qenë nën ndikimin e fuqishëm në fushën e teorisë informatike dhe modeleve kompjuterike. Për këtë metafora e makinës përsëri është ftuar në aksion, por kësaj radhe me modifikime të caktuara në mënyrë që t'i përgjigjet zhvillimit teknologjik të kohës. Si pasojë e kësaj, psikologët kognitivë e kanë paraqitur njeriun si kanal, i cili ka kapacitet të kufizuar të procedimit të informatave, ndërsa truri i njeriut është identifikuar shumë me kompjuterin.

Ky dehumanizim masiv në psikanalizë dhe behejviorizëm ka sjellë te paraqitja e “forcës” së tretë në psikologji, shkollës humanistike. Si reaksion në determinizmin biologjik të psikanalizës dhe determinizmin ambiental të behejviorizmit, humanistët kanë lansuar qëndrimin jo-determinist. Këta kanë potencuar aftësinë njerëzore të krijojë dhe orientojë fatin e tij. Për këta, ne nuk jemi krijuar nga asnjë qenie dhe nga asgjë nuk kemi evoluar. Ne jemi ekstrem të lirë dhe nga ne kërkohet vetëm të plotësojmë jetën me kuptimin personal. Qeniet njerëzore kanë kapacitet të pakufizuar të zhvillimit dhe vetëpërsosjes; thënë më

<sup>7</sup> Cituar nga C.N. Coefer and M. H. Appley, Motivation: Theory and Research (New York: Wiley, 1964), 596.

<sup>8</sup> Cituar nga Chaney në librin Six Images.

thjeshtë, njeriu është vetë zot. Si pasojë e kësaj, qëllimi i humanistit është që të harxhojë kohë dhe mund duke shpjeguar të gjitha ato që mund t'i bëjë njeriu, më tepër sesa të flasë për atë çfarë është ai-ajo.

Themelet e drejtimit humanistik mund të gjenden në veprat e Xhon Dju-it (John Dewey) në Amerikë dhe ekzistencializmin ateist të Sartrit (Sartre) në Evropë. Sartri ka qenë i obsesuar me termin “liri” dhe, sipas tij, i vetmi kufi i lirisë njerëzore është që askush nuk mund të ndalet për të qenë i lirë. Interesi kryesor i filozofisë së Dju-it, në anën tjetër, është zhvillimi i potencialit njerëzor deri në maksimumin e tyre: vet-aktualizimi, që është term qendror në veprat e personave kyç të psikologjisë humanistike.

Mirëpo, nëse idesë së lirisë duhet dhënë rëndësi, atëherë vështirë është që konceptit darvinistik të natyrës njerëzore, d.m.th. determinizmit biologjik, ta mendosh përkatës. Ngjashëm termin e determinizmit ambiental, i cili është i qartë në shkollën bihejvioristike, qartë është i paharmonizuar. Sipas tyre, modeli kognitiv është gjithashtu tejet i kufizuar, dhe e tërë kjo bashkërisht ka sjellë që të pranojnë metaforën kryesore të njeriut si hyjni, dhe kështu psikologjia u bë religjion apo kult sekular në vete.<sup>9</sup>

Qasja humanistike e studimit të psikologjisë është për shumë përkrahës të saj do të thotë pranimi i humanizmit sekular dhe refuzimi i Zotit, plus besnikëri e tërësishme e termit “seli”. Liria është fuqi motorike, e cila lëviz aktivitetin njerëzor, qëllimi i fundit i së cilës është vetë-respektimi dhe vetë-aktualizimi. Rëndësia e këtij koncepti të njeriut është i rritur me faktin që ekonomitë e vendeve të industrializuara kanë pasur nevojë për harxhues. Si pasojë e kësaj, “Pranimi i qartë i përvojës momentale nga ana e kultit të vetvetes si dhe refuzimi i tij apo ndalimi ka qenë shërbim për industrinë e marketingut”.<sup>10</sup>

Andaj, hedhja e dy qëndrimeve deterministe të psikanalizës dhe bihejviorizmit, lindi përsëri ekstremin e qëndrimit tjetër të humanizmit.

<sup>9</sup> P. Vitz, *Psychology as Religion: The Cult of Self-Worship* (Carlisle: The Paternoster Press, 1994)

<sup>10</sup> Ibid.

## Implikimi i këtyre tre koncepteve të njeriut

Sot, psikanaliza është vetëm pjesë e historisë së psikologjisë. U tregua se është pak e vlefshme kur është në pyetje dobia praktike e saj. Popullariteti i bihejviorizmit radikal gjithashtu po bien për shkak të potencimit të madh të konceptit mekanistik të njeriut. Skaneri nuk arriti të përgjigjet në pyetjen: “Nëse mjedisi kontrollon sjelljet e njeriut, kush atëherë e kontrollon kontrolluesin ?!”

Mirëpo, konceptet në të cilat njeriu është i njëjtë me hyjninë në vendet e industrializuara, e veçanërisht në SHBA, në një moment në Kaliforni u themelua grupi për qëllime të veçanta, i cili është dashur të ngritë nivelin e vetë-respektimit të fëmijëve. Shkaku kryesor për këtë veprim, ka qenë që niveli i ulët i vetë-respektimit është çmuar si faktor kryesor dhe shkak i problemeve të përhapura psiko-sociale, nga narkomania dhe shtatzënia e hershme, deri të aftësitë e dobëta matematikore dhe mungesat në shkollë.<sup>11</sup>

Mirëpo, asnjë hulumtim shkencor nuk përkrahë dobinë e kësaj teze si tregues korrekt dhe bindës i sjelljes njerëzore.<sup>12</sup>

Nëse asgjë më tepër, atëherë mendimi për veten si hyjni prodhon disa pasoja negative, të cilat janë në vijim. E para, fokusimi në vetvete kultivon vetë dashurinë jorealiste me shumë pasoja dëmshme psikologjike, siç janë: narcisizmi dhe vetëmashtrimi, thënë më lehtë. Një hulumtim ndërkombëtar ka treguar se studentët amerikanë (të cilët kanë pasur mendim të lartë për veten), kanë arritur rezultate shumë më të dobëta në provim nga matematika, në krahasim me studentët kolegë koreanë. Mirëpo, kur hulumtuesit kanë kërkuar nga studentët që të vlerësojnë sa janë realisht matematikanë të mirë, studentët amerikanë në vlerësimin e aftësive të tyre matematikore u ranguan më së larti, ndërsa koreanët u ranguan më së ulëti.<sup>13</sup>

<sup>11</sup> Shih “The Curse of Self-Esteem”, *Newsweek*, 17 shkurt, 1992

<sup>12</sup> S. Black: “Self-Esteem: Sense and non sense” *American School Board Journal*, Jul 1991, 27-29.

<sup>13</sup> A. Lapointe, N. A. Head, and G. Philips, *A World of difference: An International Assessment of Mathematics and Science* (Princeton: Educational Testing Service, 1989)

E dyta, mësimi i kultit të adhurimit të vetvetes, me qëndrimin e tyre të qartë anti-religjioz, kanë probleme serioze kur është në pyetje metodat edukuese të fëmijëve dhe familjeve. Koncepti i tyre për natyrën e njeriut pohon se fëmijët janë “natyral, spontan, jodefanziv, kureshtar, dhe se në mënyrën e vet, kreativ në masë më të madhe se individit tipik të rritur ose fëmijëve të moshuar”.<sup>14</sup>

Mirëpo, kjo nuk merr në konsideratë faktin se fëmijët janë gjithashtu “...zakonisht të shqetësuar, impulsivë, shkurtpamës, agresivë, egocentrikë dhe të kufizuar në nevojat fiziologjike”.<sup>15</sup>

Duket se janë të kënaqur dhe kënaqësia e çdo impulsi në mënyrë të gjeneralizuar janë bërë detyrë e epokës post-frojdiqe. Vlera dhe rëndësia e situatës janë gjëra të dominimit individual dhe çdo përpjekje e pengimit moral është i keq dhe i dëmshëm për vetë respektim.

Kështu, vet-aktualizimi nuk është term i thatë deskriptiv, por term-in moral me të cilin vet-aktualizimi paraqitet si diç e vlefshme dhe diç për të cilin duhet gjuarmuar. Si pasojë e kësaj, për të rriturit nuk ka vend që të udhëheqin ose të kultivojnë te fëmijët e tyre ndonjë sistem me vlerë.

Kur janë në pyetje vlerat dhe koncepti i qasjes humanistike të natyrës së njeriut kanë njësoj pasoja serioze. Ato nuk kanë të bëjnë vetëm në formimin dhe themelimin e familjes, por edhe në mbajtjen të këtyre lidhjeve kaq të gjata. Këtu, në emër të përparimit, autonomisë dhe vet-aktualizimit, martesat vlen për të vazhduar, sipas Rogersit, përderisa ajo paraqet “...përvojë të përparuar, e cila sjell përparim për çdo individ”.<sup>16</sup>

Mirëpo, njeriu nuk pyet, ashtu siç kanë bërë M. Wallace dhe L. Wallace, çfarë do të ndodhë kur një bashkëshort sëmuret ose kur lindin fëmijët.<sup>17</sup>

<sup>14</sup> Vitz, *Psychology as Religion*.

<sup>15</sup> Ibid.

<sup>16</sup> C. Rogers, e cituar në M. Wallace and L. Wallace in *Psychology's Sanction for Selfishness: the error of Egoism in Theory and Therapy* (San Francisco: Freeman, 1983), faqe 160.

<sup>17</sup> Ibid.

Për këtë nuk është aspak e çuditshme që përqindja e divorceve të ashtuquajturat kombe të vet-aktualizuara, siç janë SHBA-të, rriten në mënyrë drastike, e nëse kjo bie, kjo është për shkak se vlera e re e dhënë familjes qartazi bie në përqindjen martesore. Divorci i partnerëve të cilët jetojnë në harmoni me modelin e porsazhvilluar me të pranuar masivisht “besnikëri jo e obliguar” në partneritet, nuk mendohet si divorc.

Së fundi, pohimi se qeniet njerëzore të lindura janë të mira është pikëpyetje. Shumë ndodhi sociale, historike dhe të tanishme, vërtetojnë jo saktësinë e kësaj hipoteze. Luftërat dhe krimet e bëra mbi njerëzit tjerë në Lindje e Afërt, Bosnjë, Kosovë, Çeçeni dhe Kashmir, etj. Janë vetëm disa shembuj. Me siguri niveli i ulët i vetërespektimit vështirë mund të pranohet si fajtor për krimin e parë të vrasjes në Tokë, të cilin e bëri i biri i Ademit.

### Kontributi i gazaliut të konceptit islam të personalitetit

Gazaliu para shumë shekujve kuptoi se debati rreth problemit të natyrës së njeriut automatikisht detyron individin që të merret me çështjet metafizike. Nëpër të gjitha veprat e tij ai insiston në kufizimin e mendjes teorike, ndërsa vërteton rolin e dëshirës, përvojave shpirtërore dhe morale në përpjekjet e arritjes së diturisë. Sipas tij, cilado paraqitje e natyrës njerëzore, formën në të cilën njerëzit janë të krijuar, nuk mundet tërësisht të kuptohet pa kuptuar qëllimin e krijimit dhe rëndësinë e jetës së kësaj bote. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë:

**“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë.”**<sup>18</sup>

Kështu, i Drejti absolut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëbërësi, Allahu xh.sh., qeniet njerëzore i krijoi në formën më të mirë të mundshme, në mënyrë që t'i përgjigjet rolit të krijimit të tij. Është e habitshme që me çështjen e qëllimit të krijimit psikologët sekularë asnjëherë nuk janë

<sup>18</sup> Edh Dharijatë, 56

marrë me personalitetin, ndërsa secili individ duhet të dijë se kuptimi më i mirë i çdo gjëje kërkon njohjen e qëllimit të ekzistencës së tij.

Gazaliu e shikon njeriun si qenie që i janë dhënë dy gjëra karakteristike për njeriun, e këto janë: dituria dhe dëshira. Kjo është për arsye se njeriu e ka natyrën duale: fizike dhe shpirtërore.<sup>19</sup>

Trupi shërben si mjet, i cili bart shpirtin, ndërsa shpirti është shtëpi e diturisë. Pra, shpirti është ai që njeriun e afron te Allahu xh.sh. ose e largon nga Ai. Në një hadith kuds, Allahu xh.sh. thotë:

**“Ai i cili më afrohet një pëllëmbë, Unë i afrohem një llanë”**<sup>20</sup>

Në një transmetim tjetër të Pejgamberit a.s. thuhet:

*“Sikur shejtanët të mos fluturonin para syve të njerëzve, ata do t'i shihnin madhështitë e pushtetit qiellor dhe tokësor.”*<sup>21</sup>

Prandaj, kualiteti i diturisë e ngrit njeriun deri te bota qiellore ose e degradon në nivelin shtazarak. Natyra fizike dhe shpirtërore e njeriut përbëhet nga katër elemente, të cilat manifestohen në katër cilësi. Këto katër cilësi përfshijnë: kafshët, shtazët, shejtanin dhe hyjnoren. Të përkthyer në terminologjinë psikologjike ato u përgjigjen epsheve, zemërimit, kryelartësisë dhe qartësisë hyjnore, e cila mund t'i nënshtrojë dhe ngadhënjë tri të përmendurat. Kur njeriu i përmbahet udhërrëfimit Hyjnor, atëherë ai në zemrën e tij e gjen Zotin. Mu për këtë “zemra” është një term i rëndësishëm në sistemin Islam. Sipas një hadithi të Pejgamberit s.a.v.s.:

*“Në trup ekziston një copë mishi, e cila kur është e mirë, i mirë është i tërë trupi, e kur është e keqe, i tërë trupi është i keq. Kjo është zemra.”*<sup>22</sup>

Këtë ndarje dytësore të natyrës së njeriut Gazaliu e shpjegon më tej duke definuar me katër terme: **Kalb (zemër)**, **Nefs (uni)**, **Rruh (shpirti)** dhe **Akl (mendja-intelekti)**. Këto katër terme kanë të bëjnë me katër substanca fizike. Mirëpo, kur paraqesin kompetencën shpir-

tërore te njeriu, ato kanë të bëjnë me një gjë, e kjo është “...substanca shpirtërore (latifeh ruhanijeh), e cila është e krijuar e pavdekshme; kjo nuk matet me diametër në hapësirë dhe kohë, ose me kuantitet; kjo është e vetëdijshme për veten dhe vendin e njohjes, por e vetmja mënyrë që të kuptohet është nëpërmes mendjes dhe vëzhgimit të sje-llejeve të jashtme që ajo prodhon”.<sup>23</sup>

Në kuptimin fizik, zemra ka të bëjë me një copë mishi në formë konike në anën e majtë të kraharorit, funksioni i së cilës është qarkullimi i gjakut. Si e tillë, ajo mund të gjendet te të gjitha kafshët. Nefsi në kuptimin fizik paraqet instinktët shtazarake të përmendura. Katër janë armiq për të cilat ka aluduar Pejgamberi s.a.v.s. kur ka folur për xhihadin (luftën) e madh. Ngjashëm Rruhi (shpirti) paraqet substancë të stërholluar, e cila buron nga zemra fizike dhe përhapet në të gjitha pjesët e trupit. Është i ngjashëm me llambën e vendosur në shtëpi, nëpërmes së cilës në shtëpi përhap dritën e saj. Në fund, mendja-intelekti ndihmon procesin e abstraksionit në kontakt me botën fizike dhe është i vendosur në tru.<sup>24</sup>

Ndryshimet individuale janë si rezultat i ndryshimeve kualitative, të cilat ndodhen në nivelin shpirtëror (aval). Kur shpirti mbizotëron dhe nënshtrohet epshet shtazarake, ai quhet **nefs mutme`inne**; ndërsa kur ai kritikon veten, atëherë quhet **nefsi levvamme**; ndërsa kur ai dërgon në të keqe dhe haptas lëshohet duke kënaqur epshet e njeriut, quhet **nefsi emmareh bil-su**.

Deri këtu kontributi i Gazaliut në mënyrën që ai përsëri ka thënë atë që paraardhësit e tij myslimanë dhe jomyslimanë e kishin thënë më herët. Kontribut me vlerë i tij është në mënyrën se si ai kupton perceptimet, emocionet, motivimin dhe si pasojë e kësaj personi, i cili ka natyrën duale.

Sipas Gazaliut, perceptimi, dituria, disponimi, emocionet, motivimi dhe si pasojë e kësaj, sjelljet varet nga gjendja shpirtërore e individit. Kjo është kështu për arsye se personi, të cilin e koncepton Gazaliu

<sup>19</sup> S.M.N. Al-Attas, The Nature of Man and the Psychology of Human Soul (Kuala Lumpur: International Institute of Islamic Thought and Civilization, 1990).

<sup>20</sup> Sahihul Buhari, Kitabul-teuhid.

<sup>21</sup> Musned Ahmed ibn Hanbel, vol. 2. faqe 353,363.

<sup>22</sup> Sahihul Buhari, Kitabul-iman.

<sup>23</sup> Al-Attas, The Nature of Man, 7.

<sup>24</sup> El Gazali, Me`arixhul Kuds fi Ma`rifet Mearixh Nefs (Bejrut: Darul Afak el Xhedeid, 1978).

ka formën e jashtme (fizike) dhe të brendshme (shpirtërore) individuale. Forma fizike (trupi) mund të vërehet me shqisa, ndërsa individualiteti shpirtëror (shpirti) vërehet nëpërmes njohurisë intuitive. Sipas tij “shpirti, i cili vërehet nëpërmes njohurisë intuitive është prapëseprapë më e vlefshme se trupi, i cili vërehet nëpërmes syve”.<sup>25</sup>

Për këtë substancë shpirtërore ai në shumë vepra të tij shërbehet me termin zemër. Ai pohon se zemra është esenca reale e njeriut, e cila e ndan nga qeniet jonjerëzore: **“...sepse zemra është ajo që e njuh Zotin, i afrohet Atij, vepron në emër të Tij dhe mallëngjehet për Të.”**<sup>26</sup>

Kështu, zemra i kryen disa funksione të rëndësishme perceptive, kognitive dhe motivuese. Në esencë, kjo është për arsye se zemra është “substancë Hyjnore, rreze e dritës së Zotit, shkundi nga Flaka e Përhershme dhe brenda Tij, dhe atij i zbulohet Realiteti i Fundit dhe shprehje e Tërësisë. Kështu si ky, gjithashtu mbushet me dritën Hyjnore dhe e paraqet Atë”.<sup>27</sup>

Si pasojë e kësaj, ata që ngrihen shpirtërisht me zemrat e tyre shohin më mirë dhe me precizitet nga atë që vërejnë me sytë e jashtëm (trupor).<sup>28</sup>

Lidhur me këtë Kurani thotë:

**“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë dhe veshët me të cilët do të dëgjojnë? Pse në të vërtetë sytë nuk verbohen, por verbohen zemrat në kraharor.”**<sup>29</sup>

Ngjashëm ekziston edhe dëgjimi “shpirtëror”:

**“Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për Xhehenem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë vesh që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët bile edhe më të humbur. Të tillë janë ata të marrët.”**<sup>30</sup>

<sup>25</sup> El Gazali, Ihja, 3:46.

<sup>26</sup> El Gazali, Ihja, 3:2.

<sup>27</sup> El Gazali, Ihja, 3:350.

<sup>28</sup> El Gazali, Ihja, 4:26, shih gjithashtu faqe 431.

<sup>29</sup> El Haxh, 46.

<sup>30</sup> El A`rafë, 179.

Ata, tek të cilët dëgjimi “shpirtëror” është topitur ndajnë aftësinë e dëgjimit të jashtëm me kafshët tjera, ndërsa tek të afirmuarit shpirtërorë të gjithë zërat në mjedisin e tyre, duke përfshirë edhe zërat e zogjve, frymës dhe valëve, janë zëra të qartë të madhësisë së Krijuesit, i cili dëshmon Njësinë e Zotit dhe e falënderojnë Atë me zë të qartë.<sup>31</sup>

Këtij lloji të njerëzve, e tërë bota i është faltore (xhami) e madhe.<sup>32</sup>

Me rëndësi të veçantë është të vëresh se Gazaliu, edhe pse u jep rëndësi cilësive racionale dhe intelektuale të njeriut, ai prapëseprapë nuk ka mbështetje të tepruar në këto, dhe asnjëherë nuk i mendon të mjaftueshme për kontrollimin e epsheve njerëzore.

Më tepër, besimi është ai, i cili njeriun e afron kah virtytet njerëzore dhe përsosmëria duke e ngritur në vendin fisnik të mëkëmbësit të Zotit në Tokë.

### Kontributi i Gazaliut në teorinë e personalitetit

Në veprat e tij Gazaliu ka trajtuar disa çështje me rëndësi, të cilat janë me rëndësi vitale për zhvillimin e konceptit të qartë të personalitetit njerëzor. I frymëzuar me kuptimin themelor të rëndësisë së kësaj bote dhe me pejgamberët fisnikë si shembull që duhet pasuar në jetë, ai ka shqyrtuar disa probleme, të cilat pa dyshim janë relevante për psikologjinë e personalitetit. Kështu p.sh., ai merret me çështjen e cilësive të lindura dhe edukimin, dhe si këta faktorë të fuqishëm mund të ndikojnë në personalitet. Gazaliu, gjithashtu trajton problemin e ngjarjeve të kaluara dhe të tanishme në jetën e njeriut dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin e personalitetit njerëzor. Përveç kësaj, ai me skica kryesore paraqet një qasje tejet të shëndoshë të metodave të edukimit të fëmijëve. Secila nga të përmendurat, meriton hulumtim të veçantë. Ne, por shkurtimisht, do t'i theksojmë këto qëndrime, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me psikologjinë e personalitetit.

<sup>31</sup> El Gazali, Ihja, 2:218-219.

<sup>32</sup> Malik Bedri, El-Tefekun minel meshahedeh ilel shuhud (Herdon, Virginia: International Institute of Islamic Thought, 1993).



## 1. Karakteristikat e lindura kundruall edukimit

Psikologët mjaft gjatë janë marrë me çështje të koklavitura të rëndësisë së faktorëve biologjikë dhe enviromental në formimin e sjelljeve njerëzore. Ky problem zakonisht është i njohur me emrin “natyra-edukata” debatim dhe tejet larg është pranuar si lufta më e gjatë në historinë e psikologjisë. Lidhur me këtë çështje, psiko-analitikët fuqishëm mbështesin qëndrimin natyralistik, ndërsa biheviortistët potencojnë rolin e edukimit, ndërsa psikologët humanistikë mendojnë që njeriu në esencë është i mirë. Këta të fundit si duket fokusohen në “mirësinë trupore dhe fizike”, siç u përmend më lart. Kjo është e qartë në veprat e Masllovljevit, i cili ka hulumtuar autobiografitë e disa personave, të cilët sipas mendimit të tij, paraqesin shembujt më të mirë të vet-aktualizimit në historinë njerëzore. Por, shpirtëroja apo religjioni, asnjëherë nuk janë shikuar si tregues të suksesit të tyre apo kusht i domosdoshëm për të realizuar nivelin e vet-aktualizimit. Në realitet, nëse do të pranohej kriteri i Masllovljevit, bile edhe konsumuesit e drogës mund të arrijnë shkallë të vet-aktualizimit. Sa i përket konceptit të Gazaliut, i cili bazohet në Shpallje dhe traditën e Pejgamberit s.a.v.s., esenca e njeriut është mirësia shpirtërore. Mirëpo, mjedisi dhe edukata janë njësoj të rëndësishme në ruajtjen ose rrënimin e pastërtisë së shpirtit njerëzor.

## 2. Dëshira e lirë kundruall determinizmit

Një detaj i rëndësishëm në konceptimin e Gazaliut të natyrës njerëzore ka të bëjë me çështjet problematike të dëshirës së lirë apo determinizmit në psikologjinë moderne. Për Gazaliun, njeriu është ai që mban bilancin mes determinizmit dhe lirisë. Vijimi uniform i ndodhive është i përcaktuar, mirëpo ihtijari i njeriut është element përbërësi i dëshirës së tij. Mu sikur El-Attas bindshëm dhe me elokuencë<sup>33</sup>, ihtijari nuk d.m.th. vetëm zgjedhje, por kuptimi i tij është i përcaktuar me

rrënjën **h-j-r**, që nënkupton mirësi. Pra, përcaktimi për të keq nuk është ihtijar (mirësi). Andaj, nëpërmes besimit në Zotin, individi nën presionin e epsheve shtazarake shkakton reduktimin e qëllimshëm dhe vendimtar, i cili-e cila si refleks liron nga ngushtica e presionit biologjik ose fuqive enviromentale.

## 3. Periudha vendimtare në zhvillimin e personalitetit

Shkrimet e Gazaliut për fëmijërinë dhe metodat edukuese të fëmijëve janë me siguri relevante për çështjet e përvojave të hershme në zhvillimin e personalitetit njerëzor. Psiko-analitikët, posaçërisht potencojnë fëmijërinë e hershme. Frojdi mendon se me përfundimin e moshës pesë ose gjashtëvjeçare të jetës, personaliteti i individit është formuar. Nga kjo, përvojat e kaluara janë vendimtare ose kyçe në formësimin e mënyrës se si dikush mendon, ndjen ose sillet. Në rastin e biheviortizmit, faktori kohë nuk ka aspak rëndësi. Ajo që është me rëndësi është që ndonjë përvojë është “argumentuar” apo jo. Njerëzit kanë aftësi të mësim, studimit dhe rimesimit. Psikologët humanistikë u japin më shumë rëndësi përvojave të vjetra.

Mirëpo, Gazaliu shikon në zhvillimin e personalitetit si një proces, në të cilin fëmijëria mendohet si fushë treningu për vetë qëllimin e krijimit të njeriut, të ashtuquajtur teklik. Qëndrimi i tij është vërtet gjithëpërfshirës, kështu sjell qasje sekulare në statusin e ngjashëm me tregimin e elefantit dhe të verbrit. Për të, personaliteti i njeriut do të jetë i ndikuar që nga momenti kur ai ose ajo është mëkuar dhe ndërprerë nga mëkimi. Gazaliu nuk është i interesuar aq për çështje sipërfaqësore se si është ushqyer fëmija, por është vërë aksenti në burimin e vetë furnizimit; a thua prindërit kanë arritur me mjete të lejuara. Pra, duhet ndërruar të gjitha mjetet e mundshme për të siguruar se lufta mes të keqes dhe së mirës, të shenjtës dhe shenjtërisë, në personalitetin e njeriut të përfundohet me ndërtimin e virtyteve dhe shkatërrimin e veseve (të këqija).

Gazaliu kërkon nga prindërit që në edukimin e fëmijëve të tyre, në vend që t'i urdhërojnë, ata duhet që me lidhje të fuqishme emotive

<sup>33</sup> El-Attas, The Nature of Man

mes tyre dhe fëmijëve të tyre, të vendosin kërkesa të forta morale përpara fëmijëve të tyre.

Metodat e jashtme të dënimit dhe shpërblimit, duhet t'i përdorin vetëm gjatë fëmijërisë, në mënyrë që në kohën e adoleshencës, t'i tra-sojnë rrugën e metodave të tyre të brendshme. Përveç kësaj, prindërit duhet të përpiqen t'i dënojnë psikikisht në vend se fizikisht, në mënyrë që te fëmijët të ndërtojnë ndjenjën e ndërgjegjes dhe koshiençës, në vend të frikës dhe zemërimit.

*Tabela: Komperacioni i qëndrimeve të Gazaliut për natyrën njerëzore me qëndrimet e psikologëve modernë:*

|                                                    | GAZALIU                            | FREUD                             | SKINNER                           | ROGERS                             |
|----------------------------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| Koncepti central                                   | Njeriu e ka natyrën duale          | Përvoja e pavetëdijshme           | S-R (reaksion ngacmues) i njësisë | Vetaktualizimi                     |
| Ndikim locus                                       | Shpirtëror (i brendshëm)           | Biologjik (i pavetëdijshëm)       | Enviromental                      | "Self" (i brendshëm)               |
| Natyrë-mjedisi                                     | Mirësia shpirtërore                | Njeriu për nga natyra është i keq | Njeriu nuk ka natyrë              | Njeriu për nga natyra është i mirë |
| Dëshira e lirë-Determinizmi                        | Dëshira e lirë                     | Determinizëm                      | Determinizëm                      | Dëshira e lirë                     |
| Periudha vendimtare në Zhvillimin e personalitetit | E kaluara, e tashmja dhe ardhmëria | E kaluara                         | Irrelevantë                       | Këtu dhe tani                      |

Tabela më sipër përmbledh pikat më të rëndësishme në kornizën e të cilave qëndrimet e Gazaliut për natyrën e personalitetit njerëzor mund të krahasohen me qëndrimet që dominojnë në psikologjinë moderne në këtë çështje. Është mjaft e qartë se qëndrimi i tij është vërtet i gjerë. Gjithashtu, kjo posedon masën e madhe të konzistencës dhe

dobisë funksionale. Kjo ka rëndësi të madhe nëse shfrytëzohet, kontrollohet dhe parasheh sjelljen njerëzore.<sup>34</sup>

Natyrisht, kjo nuk është e habitshme duke marrë parasysh që koncepti i Gazaliut përfshin atë që mungon në modelet e njeriut të konceptuar nga ana e dijetarëve sekularistë, e ky është komponenti spiritual. Mu kjo është përbërës i domosdoshëm, i cili ngërthen të gjitha elementet esenciale të personalitetit të njeriut, në mënyrë që të ndërtojë cilësitë pozitive, të cilat secili person i paraqet në nivelin motiv, kognitiv dhe bihejvioral.

*Përktheu dhe përshtati:  
Prim. dr. sc. med. Ali Iljazi*

<sup>34</sup> Abbas H. Ali "Sukul insane bejner-Rrahman ve aklu insan", punim i prezentuar në seminarin ndërkombëtar mbi islamizimin e diturisë. Universiteti Xhezira, Sudan, shkurt, 2-5, 1995.

Abbas Husein Ali

## THE NATURE OF HUMAN DISPOSITION: AL-GAZALI'S CONTRIBUTIONS TO AN ISLAMIC CONCEPT OF PERSONALITY

### (Summary)

Abstract: This paper deals with the critique of contemporary psychological models of human nature and stresses the contribution of al-Gazali to the concept of personality. A brief presentation of the philosophical foundations of the main psychological schools is made: the psychoanalytic school of Freud, the behaviourist school of Skinner and the humanistic school of Roger/Maslow. The metaphors through which they have described human nature are analysed. Seeing their implications, in particular for the psychology of personality, the work also stresses the weaknesses of these models. The final part deals with the contribution of al-Gazali to the Islamic concept of personality.

عباس حسين على

طبيعة النفس البشرية: مساهمة الغزالي في بناء مبدأ الإسلام

للشخصية

(خلاصة البحث)

الموضوع: يتناول نقد الاساليب الحديثة لطبيعة النفس البشرية مركزا على مساهمة ابي حامد الغزالي في التطرق للموهبة الفردية و قد تم التطرق باختصار إلى الاسس الفلسفية لثلاثة مدارس نفسية رئيسية: مدرسة التحليل النفسى لفرويد، المدرسة السلوكية لسكينر و المدرسة الانسانية لروجرس و ماسلوييف. و قد تم مناقشة الرموز التي وصفت طبيعة الانسان مع التركيز على التأثيرات العملية بصفة خاصة

فيما يتعلق بنفسية الفرد مشيرا إلى نواقص هذه الاساليب، و يتناول الجزء الاخير مساهمة الغزالي في شرح مبد الاسلام لطبيعة البشرية و بناء شخصية الفرد.

## THIRRJA ISLAME

*Dr. Zakir Naik*

### THIRRJA (DA'VETI) NË ISLAM ËSHTË NJË PËRGJEGJËSI E MADHE - (2)

#### PËRGJIGJE NDAJ PYETJEVE TË SHPESHTA TË JOMYSLIMANËVE MBI ISLAMIN

#### India posedon numër më të madh të meshkujve sesa të femrave, kjo si shkak i mbyetjeve praktike dhe me dashje të foshnjave femra

India është njëra nga ato shtete e rralla së bashku me disa shtete fqinje, në të cilat numri i femrave është më i vogël sesa numri i meshkujve. Arsyeja shtrihet në numrin e lartë të mbyetjeve me dashje të foshnjave femra në Indi.

E vërteta është se në këtë shtet (Indi) më shumë se një milion fetuse abortohen për çdo vit, kjo ndodh vetëm atëherë kur vërtetohet se fetus i përket gjinisë femërore. Po qe se kjo praktikë djallëzore ndalohet, padyshim se edhe India gjithashtu do të ketë më shumë femra sesa meshkuj.

### Numri i femrave në botë është më i madh se ai i meshkujve

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gratë për nga numri i popullsisë, ua kalojnë burrave me 7.8 milionë. Vetëm Nju-Jorku ka një milion femra më shumë krahasuar me numrin e meshkujve, dhe ç'është e vërteta, një të tretën e numrit të meshkujve të Nju-Jorkut (New York) e përbëjnë homoseksualët d.t.th, njerëzit perversë apo thënë më shkurt pederët. SHBA-të në tërësi numërojnë më shumë se njëzet e pesë milionë homoseksualë, kjo nënkupton faktin se këto krijesa nuk shprehin dëshirë të martohen me femra. Numri i vajzave në Britaninë e Madhe ia kalon numrit të meshkujve me shifër prej katër milionësh. Gjermania arrin në pesë milionë femra me shumë sesa meshkuj. Rusia ka nëntë milionë vajza më shumë sesa meshkuj. Vetëm Krijuesi është në dijeni rreth numrit më të madh të femrave në tërë botën

### Kufizimi i lirisë, se çdo mashkull duhet të ketë vetëm një grua, nuk është praktike

Edhe po qe se çdo njeri marton një grua, përsëri aty do gjejmë më shumë se tridhjetë milionë femra në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat nuk do jenë në gjendje të martohen, duke pasur parasysh se Amerika ka një numër të madh të homoseksualëve, të cilët numërojnë rreth 25 për qind.

Do të vërejmë se në Angli do ketë më shumë se pesë milionë vajza, në Gjermani pesë milionë, dhe në Rusi nëntë milionë femra, të cilat nuk do jenë në gjendje të martohen (po qe se kufizohemi vetëm me një grua). Të supozojmë se motra ime është njëra nga ato gratë të pamartuara, e cila jeton në SHBA, apo ta zëmë që motra jote ka shansin të jetë njëra ndër gratë e pamartuara në Amerikë. Dy opsionet e mbetura për të janë; ose të martohet me një burrë, i cili në pushtetin e tij ka një grua, apo të bëhet "pronë publike". Zgjedhje tjetër nuk ka. Të gjithë ata të cilët janë të përmbajtur dhe modest, do zgjidhin opsionin e parë, respektivisht të martohen për burra të martuar. Shumica e gra-

ve nuk do të dëshironin që një grua tjetër të ketë hise në bashkëshortin e saj. Mirëpo në fenë Islame, po qe se rrethanat e shohin të domosdoshme dhe të pashmangshme që gruaja myslimane për shkak të besimit mund të humbë një gjë të thjeshtë personale, në mënyrë që të parandalojë një humbje më të madhe duke lejuar motrat tjera myslimane të shndërrohen në “public properties”, pronë shoqërore.

### **Të martohesh me një burrë të martuar, është më e dobishme sesa të bëhesh “pronë shoqërore”**

Në shoqërinë perëndimore është diçka e zakonshme që mashkulli-burri të posedojë dashnore apo të ketë lidhje të shumta jashtëmartesore, çështje kjo, në të cilën gruaja të shpie drejt një jete të pambrojtur dhe të turpshme. Sido që të jetë, është po e njëjta shoqëri, e cila nuk mund të pranojë që një burrë të martojë më shumë se një grua, ku gratë, në një ambient të tillë do ishin në gjendje të ruanin nderin dhe pozitën e tyre të lartë dhe dinjitoze në shoqëri dhe të udhëhiqnin një jetë të mbrojtur. Si rrjedhojë, dy opsionet e vetme për një grua që nuk mund të martohet (për shkak të numrit të vogël të meshkujve) paraprakisht nga ajo kërkohet që ta martojë një burrë të martuar ose të involvohet në prostitucion. Islami preferon që gruas t'i dhurojë statusin e respektuar duke i lejuar asaj opsionin e parë dhe duke ndaluar të dytin. Ekzistojnë edhe shumë shkaqe dhe arsye tjera se përse islami ka legjitimuar poligaminë e kufizuar, mirëpo legjitimiteti kryesisht synon ruajtjen dhe mbrojtjen e modestisë së gruas.

## **Pyetja e dytë e sektorit A**

### **POLIANDRIA**

#### **Pyetja:**

*Pasi që mashkulli e ka të lejuar të martojë më shumë se një grua, atëherë përse Islami i ndalon gruas që ajo të ketë më shumë se një burrë?*

#### **Përgjigje:**

Shumë njerëz, përfshirë këtu edhe disa myslimanë, pyesin rreth asaj që t'u lejohet myslimanëve të martohen më me shumë se një grua, përderisa një e “drejtë” e tillë u mohohet grave. Më lejoni që prerazi ta potencoj këtu se drejtësia përkatësisht paanësia është themeli i një shoqërie islame. Krijuesi i kësaj Gjithësie ka krijuar mashkullin dhe femrën në formë të barabartë, mirëpo aftësitë dhe përgjegjësitë e tyre ndryshojnë, prandaj burrat dhe gratë ndryshojnë për nga ana fiziologjike dhe ajo psikologjike; roli dhe përgjegjësitë e tyre gjithashtu janë të ndryshme. Burri dhe gruaja në Islam janë të barabartë, mirëpo nuk janë të ngjashëm me attribute identike. Allahu i Plotfuqishëm në kaptinën En-Nisa tregon qartazi se me cilat gra ndalohet martesë:

“Mos u martoni me ato gra me të cilat qenë të martuar prindërit tuaj, me përjashtim të asaj që ka kaluar (para islamizmit) pse ajo ishte turpësi, përbuzje dhe traditë e shëmtuar”<sup>1</sup>

“U janë ndaluar juve (të martoheni me): nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezet tuaja, bijat e vëllait, bijat e motrës, nënat tuaja që ju kanë dhënë gji, motrat nga gjiri, nënat e grave tuaja (vjehrrat) dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt, e nëse nuk kini pasur kontakt me to (me gratë), atëherë s'ka pengesë (të martoheni me ato vajza), dhe (janë të ndaluara) gratë e bijve tuaj që janë të lindjes suaj

<sup>1</sup> Kur'an, En-Nisa; 22.

(jo të bijve të adoptuar), dhe të bashkoni (përnjëherë në një niqah) dy motra, përpos asaj që ka kaluar. Vërtet, All-llahu falë shumë, është mëshirues i madh”.<sup>2</sup>

“Nuk ju lejohet të martoheni edhe me gra të martuara (që kanë burrat e nuk janë të lëshuara), përveç atyre që i keni futur në pushtetin tuaj (robërshat e luftës). Ky është obligim mbi ju nga All-llahu. U janë lejuar, pos këtyre (që u përmendën), të tjerat që t’i merrni me pasurinë tuaj (me niqah) duke pasur për qëllim bashkëshortësi e jo prostitucion. E për atë që përjetuat ju nga ato (gratë me të cilat patët kurorë), jepuni shpërblimin e tyre të caktuar se është obligim. E nuk ka pengesë për ju, pas përcaktimit (të niqahut), në atë që ju pëlqeni mes vete. All-llahu është i gjithëdijsmi, i urti”.<sup>3</sup>

Pikat në vazhdim numërojnë arsyet se përse Poliandria është e ndaluar në Islam:

1. Nëse një burrë ka më shumë se një grua, prindërit e këtyre fëmijëve është shumë lehtë të identifikohen. Pra, edhe babai edhe nëna njihen shumë lehtë. Në rast se një grua lidh kontratë martesore me më shumë se një burrë, atëherë vetëm nëna e fëmijëve të lindur - të këtij lloji martesor - do jetë në gjendje për t’u njohur, thënë më mirë, vetëm nëna e tyre dihet, mirëpo assesi prindi. Feja Islame i kushton rëndësi të jashtëzakonshme njohjes se prindërve - nënës dhe babit-nga ana e fëmijëve. Psikologët tregojnë se fëmijët të cilët nuk njohin babanë e tyre, pësojnë trauma të rënda si dhe çrregullime mendore. Në të shumtën e rasteve, ata në memoriet e tyre posedojnë një fëmijëri fatkeqe dhe shumë të trishtuar. Kjo ndodh për arsye se fëmijët e prostitutave (fëmijë bastardë) nuk kanë fëmijëri të shëndoshë. Po qe se fëmija është i lindur nga një martesë e tillë dhe regjistrohet në shkollë, dhe kur e ëma pyetet për emrin e babit të të birit, ajo do të japë më shumë se një emër!

Jam i vetëdijsëm se të arriturat shkencore bashkëkohore kanë bërë të mundur identifikimin e të dy prindërve - nënës dhe babës - dhe atë përmes asistencës së testit gjenetik. Si rrjedhojë, kjo pikë e cila qe e zbatueshme në të kaluarën, mundet që mos të zbatohet në kohën që po jetojmë.

2. Mashkulli nga natyrshmëria e tij është krijuar që të jetë më poligomues se sa gruaja.
3. Nga ana biologjike, për mashkullin është shumë më lehtë t’i kryejë obligimet e tij si burrë që është, pavarësisht numrit të grave që ka në pushtetin e tij. Një grua, më pozitë të ngjashme, e martuar me shumë burra, nuk mund t’i mundësohet kryerja dhe përmbushja e obligimeve ashtu siç i ka hije. Gruaja pëson disa ndryshime psikologjike në sjelljet e saj për shkak të fazave të ndryshme të cikleve të përmuajshme.
4. Gruaja e cila ka lidhje martesore me shume burra do të ketë seks me partner të shumtë në po të njëjtën kohë, ndaj dhe ka gjasa të mëdha që të marrë sëmundje ngjitëse, të cilat mund të kalohen prapë te burri i saj, madje edhe nëse të gjithë ata (burra) nuk kanë pasur marrëdhënie jashtëmartesore. Kjo çështje nuk ka të bëjë vetëm me një burrë që ka më shumë se një grua dhe që asnjëri prej tyre të mos ketë pasur marrëdhënie seksuale jashtëmartesore. Shkaqet e sipërsënuara janë ato të cilat shumë lehtë identifikohen. Padyshim se ekzistojnë shkaqe dhe arsye tjera të cilat dëshmojnë se përse Allahu më Urtësinë e Tij Absolute ka ndaluar Poliandrinë.

<sup>2</sup> Kur’an, En-Nisa; 23.

<sup>3</sup> Kur’an, En-Nisa: 24.

## Pyetja e tretë e sektorit A

### MBULESA (HIXHABI) PËR GRUAN

#### Pyetja:

*Përse Islami e degradon gruan duke e mbajtur atë nën mbulesë?*

#### Përgjigja:

Pozita e gruas në Islam në të shumtën e rasteve është objekt i sulmeve nëpër media laike (jofetare). ‘Hixhabi’<sup>4</sup> apo veshja islame nga shumë njerëz tregohet si një shembull i nënshtrimit të gruas në ligjin Islam. Para se t’i analizojmë shkaqet pas urdhrit fetar të hixhabit (mbulesës), me lejon që t’i hedhim dritë studimit të pozitës së gruas në shoqëritë paraislame.

1. Në të kaluarën gratë konsideroheshin shkalla më e ulët e njerëzisë dhe shfrytëzoheshin vetëm si objekt epshi.

Shembujt vijues nga historia janë të shumtë për të treguar faktet dhe realitetin se pozita e gruas në qytetërimet e hershme ishte shumë e ulët, deri në atë masë sa që u mohohej dinjiteti i tyre njerëzor.

<sup>4</sup> Fjala Hixhab (mbulesë) vë nga folja e gjuhës arabe Haxhebe, jahxhubu, hixhāben, që në kuptimin etimologjikisht donë të thotë: mbulesë, mbulim, perde, barriërë, pengesë në mes të dy gjërave. Kurse në kuptimin terminologjik: Mbulesa është çdo send me të cilën gruaja e mbulon kokën e saj. Apo me fjalë tjera, mbulesa sipas Islamit nënkupton mbulimin e trupit të femrës (përveç duarve dhe fytyrës së saj), shenjë adhurimi dhe respekti, sipas normave që ka parashikuar Kur’ani dhe Hadithi. Për sa i përket historikut të mbulesës, ai është i vjetër sa vet njeriu. Dihet fare mirë se mbulesa është praktikuar që nga kohët e lashta ndër popuj të ndryshëm. Dijetari i njohur Abbas Mahmud Akkad në lidhje me këtë thotë: “...Mbulesa e femrës ishte e njohur tek Hebrejtët që nga periudha e Ibrahimit [paqja e Allahut qoftë mbi të], dhe si e tillë vazhdoi të jetë e njohur tek ata gjatë gjithë kohërave të Profetëve të tyre deri pas shfaqjes së krishterimit...” Ndërsa Ali Abdul Halim Mahmud thotë: “Çdo kush që lexon historinë...do ta kuptoj se mbulesa e femrës ka qenë e njohur para Islamit me shekuj të tërë. Ishte e njohur edhe para periudhës së babait tonë Ibrahimit [alejhis-selam], dhe si e tillë vazhdoi të jetë e njohur tek çdo religjion... (El-Mer’etul Muslimetu ve fikhud-da’veti ilallah, dar el-vefa, bot. V, 1424h-2003m, fq. 406.) (Shën. i përkthyesit).

#### A. Qytetërimi babilonas:

Sipas së drejtës Babilonase, gruaja ishte shumë e ulët, ndaj dhe i mohoheshin të gjitha të drejtat njerëzore. Po që se burri vriste ndonjë grua, në vend që ai të marrë ndëshkimin për krimin e kryer, gruaja e tij ishte ajo që do të mbytej në vend të tij.

#### B. Qytetërimi grek

Qytetërimi grek konsiderohet ndër sistemet më të shkëlqyeshme dhe më të famshme të të gjitha qytetërimeve antike. Sipas këtij sistemi, shumë të “famshëm” gruas i merreshin me forcë të gjitha të drejtat dhe atë e shikonin me përçmim dhe të nënçmuar.

Në mitologjinë greke, një “grua e imagjinuar” me emrin “Pandora” ishte shkaktare për fatkeqësinë e qenieve njerëzore. Grekët gruan e konsideronin të jetë më e ulët se qenia njerëzore si dhe më të dobët se mashkulli. Megjithatë dëlirësia e grave ishte e çmuar, dhe gratë që në mbajtur dhe nderuar aq shumë, më vonë ato u mposhtën nga egoizmi dhe çoroditjet e tyre seksuale, për më tepër, prostitucioni u bë një praktikë e rregullt në mesin e të gjitha klasave të shoqërisë greke.

#### C. Qytetërimi romak:

Kur qytetërimi romak ishte në kulm të “lavdisë”, një njeri zotëronte edhe të drejtën për t’i marrë jetën gruas së tij. Lakuriqësia dhe prostitucioni ishin të zakonshme në mesin e romakëve.

#### D. Qytetërimi egjiptian:

Egjiptianët gruan e konsideronin si diçka të keqe dhe si një shenjë e një djalli.

#### E. Arabia para ardhjes së Islamit:

Para se Islami të përhapej në vendet arabe, arabët e shikonin gruan si të ulët dhe të nënçmuar, në të shumtën e rasteve, kur fëmija i lindur ishte vajzë, ajo varrohej për së gjalli.

## Feja islame u dha grave një pozitë të lartë, barazi dhe shpreson që ta ruajnë statusin e tyre që u dhuroi

Nuk ka dyshim se Islami e lartësoi statusin e gruas, duke i dhuruar të drejtat e tyre qysh para 1400 vjetësh. Islami pret nga gratë që ta mbrojnë pozitën e tyre që ua dhuroi ky din.

### MBULESA PËR BURRAT

Njerëzit në të shumtën e rasteve çështjen e ‘hixhabit’ e diskutojnë vetëm në kontekstin e gruas. Sido që të jetë, në Kur’anin famëlartë, Allahu i Madhërishëm, fillimisht ka përmendur hixhabit - mbulesën - për mashkullin, para përmendjes të mbulesës së gruas. Allahu Fuqiplotë, në Kaptinën Nur, thotë:

***“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.”***<sup>5</sup>

Në momentin kur një burrë shikon në një grua dhe nëse ndonjë mendim i paturpshëm dhe i pacipë vjen si rezultat i shikimit, atëherë, nga ai kërkohet që sa më parë ta ulë shikimin e tij.

### MBULESA (HIXHABI) PËR GRATË

Ajeti tjetër i sures Nur, thotë: ***“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të venë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robërshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë për***

<sup>5</sup> Kur’an, Nur; 30.

***gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”***<sup>6</sup>

### Gjashtë kriteret e mbulesës

Mbështetur në Kur’an dhe traditën e Pejgamberit alejhi selam, ekzistojnë gjashtë kriteret, të cilat duhet zbatuar gjatë mbajtjes së mbulesës - hixhabit. Ato janë:

#### 1. Pjesa e trupit, e cila duhet mbuluar

Kriteri i parë ka të bëjë me pjesët e trupit, të cilat doemos duhet mbuluar. Kjo vlen si për burrat, gjithashtu edhe për gratë. Sipërfaqja e pjesëve të cilat gjithsesi duhet mbuluar të meshkujt, fillon nga kërthiza e deri te gjunjët. Për sa u përket grave, ato janë të obliguara të mbulojnë tërë trupin, përveç fytyrës dhe duarve deri te kyçi i dorës. Mirëpo po qe se dëshirojnë, ato mund t’i mbulojnë edhe pjesët e sipërpërmendura. Disa dijetarë-studiuues të islamit, këmbëngulin që fytyra dhe duart janë pjesë përbërëse dhe duhet mbuluar gjithsesi. Pesë kriteret tjera të mbetura janë të njëjta si për burrat, ashtu dhe për gratë.

#### 2. Robat e veshura nuk duhet të jenë të ngushta, ato duhet të jenë të gjera, apo të lëshuara dhe nuk lejohet që të duken pjesët e trupit.

#### 3. Robat nuk duhet të jenë të tejdukshme, saqë ndokush mund të shikojë përmes tyre organet e turpshme.

#### 4. Veshjet nuk duhet të jenë magjepse, të cilat tërheqin gjininë e kundërt.

#### 5. Robat nuk duhet të jenë të ngjashme me ato të meshkujve.

#### 6. Robat (veshja) nuk duhet t’u përngjajnë jobesimtarëve, p.sh; ata nuk duhet veshur rroba, të cilat paraqesin identitetin ose simbolet e religjioneve të jobesimtarëve.

<sup>6</sup> Kur’an, Nur; 31.



## Mbulesa në vete përmban sjelljet dhe moralin e mirë

Mbulesa e kompletuar, krahas gjashtë kritereve të rrobave, përfshin edhe moralin dhe sjelljet e mira, mënyrën e të vepruarit, qëndrimet dhe synimet e individit. Personi i cili ka përmbushur vetëm kriterin e 'hixhabit', d.t.th., vetë mbulesën, ai vazhdon ta zbatojë atë me një kuptim dhe arsye të limituar. Mbulesa e rrobave duhet të shoqërohet së bashku me mbulesën e syve, mbulesën e zemrës, mbulesën e të menduarit dhe mbulesën e qëllimeve. Ajo gjithashtu përfshin mënyrën se si ecën një individ, mënyrën e të folurit të tij si dhe sjelljet dhe moralin e tij, etj.

## Mbulesa të mbron nga ngacmimet

Arsyeja përse mbulesa është bërë obligim i domosdoshëm për gratë, më se miri e përshkruan Kur'ani në ajetet kur'anore të Kaptines el-Ahzab:

***"O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t'i vënë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. All-llahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues."***<sup>7</sup>

Kur'ani për mbulesën thotë se ajo është e detyrueshme për gruan, kështu që të njihen ato si gra modeste dhe kjo gjithashtu do t'i mbrojë nga ngacmimet e meshkujve.

## Shembujt me dy motra binjake

Të supozojmë dy motra, të cilat janë binjake dhe nga bukuria janë të barabarta. Përderisa juve jeni duke ecur rrugës, do të shikoni se njëra prej tyre është e mbuluar me veshje islame, i tërë trupi është i mbuluar, përveç fytyrës dhe shuplakave të duarve, kurse motra tjetër është e veshur në stilin evropian të rrobave; një "mini" apo shortse. Atje në qysh të rrugës pret një rrugaç apo kopuk për të ngacmuar ndonjë vajzë. Cilën vajzë do ta kishte ngacmuar ai? Vajzën e cila është e mbuluar me hixhab, apo vajzën e cila është veshur në mini apo fustan shkurtër? Natyrisht ai do ta kishte bezdisur vajzën, e cila është veshur në mini apo në shortse. Të tilla veshje janë ftesë indirekte për gjininë e kundërt; ftesë për bezdisje e ngacmim. Ndaj edhe Kur'ani në mënyrë të drejtë thotë se mbulesa e mbron gruan nga çdo lloj ngacmimi.

## Dënimi me vdekje ndaj përdhunuesve

Sipas jurisprudencës Islame, njeriu i dënuar për dhunim të ndonjë gruaje, meriton dënim me vdekje. Shumë njerëz janë të habitur lidhur me këtë masë të ndëshkimit. Disa shkojnë aq larg sa që thonë se feja islame është e pamëshirshme, barbare dhe fe e prapambetur! Unë kam parashtruar një pyetje mjaft të thjeshtë për jomyslimanët. Të supozojmë, - Zoti mos e bëftë - dikush dhunon gruan e juaj, nënën apo motrën. Juve jeni gjykatës dhe dhunuesi është sjellë pranë jush. Çfarë dënimi do t'i jepnit atij? Shumica prej tyre përgjigjeshin se do ta ekzekutonin me vdekje. Disa shkuan edhe më larg duke thënë se do ta torturonin me vdekje. Pasi dëgjova këto përgjigje, atyre iu drejtova me këto fjalë; për ju, nëse ndokush e dhunon gruan apo nënën e juaj, ju do ta ekzekutoni me vdekje. Mirëpo, nëse krimi i ngjashëm është kryer në gruan apo vajzën e dikujt tjetër, ju do të thoni se ekzekutimi me vdekje është prapambeturi. Përse i dalloni këto, kur në esencë janë krime të njëjta?

<sup>7</sup> Kur'an, El-Azab; 59

### **Shoqëria perëndimore në mënyrë të gabuar pretendon se kinse ka ngritur gruan dhe statusin e saj**

Diskutimi i Perëndimit rreth liberalizmit të gruas nuk është asgjë tjetër, vetëm se një formë maskimi i shfrytëzimit të trupit të saj; degjenerimit të shpirtit dhe grabitja e nderit të saj. Shoqëria perëndimore pretendon të ketë “ngritur pozitën e gruas”. Në të kundërtën, ata faktikisht i kanë ulur pozitën e saj duke e konsideruar atë si një grua pa kurorë, dashnore, flutura për shoqërinë, të cilat thjesht janë vegla në duart e kënaqësi të kërkuesve dhe kontrabandistëve të seksit, të fshehur pas ekranit të ashtuquajtur “art” dhe “kulturë”.

### **SHBA-të posedojnë shkallën më të lartë të dhunimeve**

Shtetet e Bashkuara të Amerikës është supozuar të jenë ndër vendet më të zhvilluara dhe më të avancuara të botës. Ajo gjithashtu numëron numrin më të lartë të dhunimeve krahasuar më çdo vend tjetër të botës. Sipas raportit të FBI, në vitin 1990, vetëm në SHBA për çdo ditë shënoheshin mesatarisht 1756 raste dhunimesh. Më vonë, një raport tjetër thotë se për çdo ditë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kryhen mesatarisht 1900 dhunime. Viti nuk është cekur. Mund të ketë qenë 1992 ose 1993. Ka gjasa që amerikanët në vitet në vazhdim u bënë shumë të “guximshëm”.

Paramendo një skenar sikur veshja islame do të ishte zbatuar në Amerikë. Sa herë që dikush do të shikonte në ndonjë grua dhe sa herë që në mendjen e tij të sillej ndonjë mendim apo qëllim i paturpshëm, ai do ta ulte shikimin dhe vështirësinë e tij ngultas.

Kur çdo grua të vishej me mbulesën islame; pra ta mbulonte trupin në tërësi, përveç fytyrës dhe duarve deri në nyje. Pas kësaj, nëse një burrë kryen apo dhunon ndonjë vajzë, ai do të meritonte dënimin e rëndë, me fjalë të tjera ai do të ekzekutohej. Tani, unë pyes, në rrethana të tilla, a do rritej numri i dhunimeve, do të qëndronte shifra ashtu siç është tani, apo do të zvogëlohej?

### **Aplikimi i legjislacionit (shariatit) islam do ta zvogëlonte shifrën e dhunimeve**

Natyrisht se sa më shpejt që do të ishte implementuar sheriatu islam, rezultatet pozitive nuk do të kishin munguar; do të ishin të njohura për masën dhe të pashmangshme. Po qe se ligji islam do të ishte zbatuar në çfarëdo vendi të botës, qoftë ajo Amerika apo Evropa, shoqëria do të kishte frymuar më lirshëm. Islami nuk e degradon asnjë grua, në fakt, ai e ngrit dhe e mbron modestinë dhe pastërtinë e saj.

- vazhdon në numrin vijues -

**Mr. Fehim Dragusha**  
**ANSWERS TO NON - MUSLIMS'**  
**COMMON QUESTION ABOUT ISLAM**  
*(Spreading the Truth of Islam)*  
*Islamic Research Foundation*

Zaik Naik

## DAWAH IS A DUTY – 2 ANSWERS TO NON-MUSLIMS' COMMON QUESTIONS ABOUT ISLAM

(Summary)

**India has more male population than female due to female foeticide and infanticide**

India is one of the few countries, along with the other neighbouring countries, in which the female population is less than the male population. The reason lies in the high rate of female infanticide in India, and the fact that more than one million female fetuses are aborted every year in this country, after they are identified as females. If this evil practice is stopped, then India too will have more females as compared to males.

زاكر نايك

### الدعوة إلى الاسلام مسئولية كبيرة (2)

(خلاصة البحث)

الاجابة على تساؤلات كثيرة من قبل غير المسلمين عن الاسلام في الهند يتجاوز عدد الذكور عدد الاناث الامر الذي يسبب تلقائيا قتل البنات و التخلص منهن بعد الولادة مباشرة.

تعتبر الهند من الدول النادرة في العالم مع عدد من الدول المجاورة التي يقل فيها عدد الاناث عن عدد الذكور و السبب يرجع إلى القتل المتعمد للاناث فيها بعد الولادة مباشرة. تقول الاحصائيات الرسمية بان في الهند يتم اجهاض أكثر من مليون فتاة خلال مرحلة الحمل بمجرد المعرفة بانهن اناث. و اذا تم التوقف عن هذه العملية غير الانسانية حتى في الهند سوف يكون عدد الاناث أكثر من عدد الذكور.

ESE

Avni Aliu

## JETËN PLANIFIKOJE EDHE PËR ATË QË NDODH PËRTEJ VARRIT

Derisa po përgatitesha për ligjëratën e së Premtes, cingërroi telefoni, ngrita receptorin, kur qe, zëri i mikut tim, i cili më kërkoi t'i bëja një vizitë në shtëpi. -“U bë, me gjithë dëshirë”, i them unë dhe, me të mbyllur telefonin, më shkuan sytë përpara librit që kisha në dorë, pikërisht te fjala “La ilahe il-lall-llah”, rrezet e së cilës, varësisht personi si i pranon nga forca ose dobësia e tij, largojnë mjegullën dhe errësirën e mëkateve. Këto fjalë, thosha vetë me vete, kanë dritën, nurin, e cila te njerëzit ndryshon sipas forcës. Forcën dhe dobësinë e kësaj drite e di vetëm Allahu i Lartësuar.

Zemra besimtare dhe e mbushur me qetësi nga fjala “La ilahe il-lall-llah”, e ka të qartë në vetvete se kush është Zoti i saj, kush është i adhuruari i saj, kush ka në dorë çështjen; kush është Krijuesi; kush është organizatori; kush është mbizotëruesi, mbikëqyrësi. Dhe përdërisa zemra e besimtarit dëshmon e thotë se Allahu është Krijuesi dhe njeriu është krijesa, kështu, është përcaktuar pozita e Zotit dhe pozita e robit, dhe, Ai që ka të drejtën e ligjëvënies sikurse në çdo gjë tjetër - është Allahu, Krijuesi i njeriut dhe jo njeriu krijesa, veçse nëse e lejon atë i zoti i së drejtës:

**“...Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar Allahu, Zoti i botëve!”<sup>1</sup>.**

**“...Vendimi i përket vetëm Allahut. Ai ka urdhëruar që të adhuroni vetëm Atë. Kjo është e vetmja fe e vërtetë...”<sup>2</sup>.**

**Allahut të Lartësuar i takon Feja e pastër, ndaj urdhëron:**

**“Njëmend, Ne ta kemi zbritur ty Librin me të vërtetën. Andaj, adhuro vetëm Allahun me përkushtim të çiltër për Të!”<sup>3</sup>.**

Prandaj njerëzve të tillë, njerëzve me zemër të mbushur me qetësinë e imanit, drita e fjalës “La ilahe il-lall-llah”, është porsi drita e diellit; te të tjerët mund të jetë porsi drita e yjeve; ndërsa te disa të tjerë është si drita e llambës; te të tjerët si drita e qiriut, e te disa të tjerë si një dritëz gazi.

Në ditën e Gjykimit kjo dritë do të paraqitet para njerëzve varësisht nga forca e imanit të tyre dhe varësisht se sa ka qenë kjo dritë e pranishme në zemrat e tyre, në fjalët e tyre, në dijen dhe vetëdijen e tyre, në punët e veprimet e tyre. Sipas kësaj, për myslimanët rritja shpirtërore e njeriut është e lidhur në mënyrë të pandashme me të gjitha kërkesat e kësaj fjale dhe me të gjitha format e tjera të natyrës së tij. “Pasionet fizike janë pjesë përbërëse e natyrës së njeriut, jo rezultat i ndonjë mëkati të parë” - nocion ky i huaj për natyrën islame - por i fuqive pozitive, të dhëna nga Zoti, që të jenë të pranuar dhe si të tillë të shfrytëzohen me mend. Nga kjo, për njeriun nuk është problem si t'i shtyjë nevojat e trupit të tij, por si t'i harmonizojë me nevojat e shpirtit të tij në atë mënyrë që jeta të bëhet më e këndshme, e plotë dhe e drejtë. Në Kur'an thuhet: **“Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer, - (gjendje e pastërtisë që mund të prishet vetëm me sjellje të këqija) - e pastaj e çuam atë në gjendjen më të ulët, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera”**.<sup>4</sup> Pas namazit të xhumasë po shkoja te

<sup>1</sup> Kur'ani, sura El-A'raf, ajeti 54.

<sup>2</sup> Kur'ani, sura Jusuf, ajeti 40.

<sup>3</sup> Kur'ani, sura Zumer, ajeti 2.

<sup>4</sup> Kur'ani, sura Et-Tin, ajeti 4-6.

miku im, i cili më thirri dhe, derisa ecja rrugës nuk mund të çlirohesha nga preokupimet e hutbes që kisha mbajtur. Diçka, vazhdimisht, më thoshte në mendje lidhur me Njëshmërinë e Allahut: “Ai që mëton të arrijë esencën e Allahut, s’e ka konfirmuar njësinë e Tij; ai që bën shenjë kah Ai, s’është drejtuar drejt Tij; ai që e kufizon, nuk synon Atë; ai që e ka ndarë në pjesë, nuk i është dorëzuar Atij; ai që pyet: ‘ku është’, i ka përshkruar një send Atij; çdokush që thotë: ‘në çka është’, i ka atribuuar një pozitë Atij; çdokush që thotë: ‘në ç’drejtim është’, i ka caktuar një kufizim Atij; çdokush që thotë: ‘pse’, i ka emërtuar një shkak Atij; çdokush që thotë: ‘çfarë është’, i ka ngjasuar ndonjë gjë Atij; çdokush që thotë: ‘kur’, i ka definuar një kohë Atij; çdokush që thotë: ‘deri këtu’, i ka emëruar një fund Atij dhe kush e emëron fundin, e ka ndarë Atë në pjesë; kush e ndan Atë në pjesë, e ka cilësuar Atë; kush e cilëson Atë e ka mohuar; dhe kush e mohon Atë, ka kthyer fytyrën prej Tij”. Dhe, derisa isha në preokupimin e këtyre mendimeve, ashtu i inspiruar nga fjala “La ilahe il-lall-llah”, më bëhej gjithçka e kthjellët jo vetëm rreth e qark por edhe brenda vetvetes, në shpirt, në zemër. Më dukej sikur gjithçka që më rrethonte më fliste për Krijuesin, dhe kjo nuk ishte diçka e pabesueshme për mua. Më bëhej sikur e gjithë bota, tërë gjithësia që duket sheshit se është një libër i shkruar prej “gishtit” të Zotit, ku çdo gjë më flet për mirësinë e pafund të Krijuesit të saj, ku çdo krijesë është “shkrim e pasqyrë” e jetës dhe vdekjes, ku edhe lulja më kokulur kthehet e bëhet fjalë shpjeguese e udhëtimit tonë tokësor, gjithçka pra sikur nuk më fliste për tjetër veç për përhershmërinë e Mëshirëplotit. Më dukej se gjithë bota është caktuar për të treguar për fuqinë, mirësinë dhe urtësinë e Zotit, Fuqiplotë, Krijuesit... Miqtë e mi, ju nuk mund ta ndjeni ëmbëlsinë e jetës derisa nuk e kuptoni brendësinë e kësaj fjale. Dhe atëherë kur ta keni kuptuar brendësinë e saj, keni arritur fitoren: çlirimi është fitorja më e madhe që ju mund ta përjetoni. Dhe kjo është e mundshme pikërisht tani.

Miku im po më priste te dera. Dhe, duke u bërë gati ta përshëndesja sipas rendit dhe etikës që kërkon përshëndetja islame, ai ma priti përpara: “Hajde, e mirë se na vjen, Hoxhë. Të kam thirrur, thjesht,

vetëm për qejf. Të bëjmë një muhabet me njëri-tjetrin, se njeriu paska nevojë edhe për një fjalë goje. Mirë bëre që erdhe. Zoti të shpërbleftë!” dhe, me një buzëqeshje të rëndë, pa të keq, që mezi i dilte nga buzët shtoi: “Ndoshta, ju hoxhallarët nuk shkoni vetëm aty ku ka shërbime, apo jo?”

“Jo, miku im, ne shkojmë edhe te xhemati që na thërret vetëm për muhabet, si thua ti, bile, me dëshirën më të madhe. Mirëpo... ti ku ishe, s’të pashë sot...dita e premte...namazi i xhumasë!?” - i them unë dhe shtova, “Njeriu ka nevojë edhe për një vend ku mund t’i drejtohet Zotit e të çlodhet, të pushojë e të mbushet shpirtërisht”. Heshti, u bë sikur s’më dëgjoi. Miku im s’vinte në xhami. Ngandonjëherë pinte. Unë atë e dija. Mirëpo, ishte një njeri që, si të thuash, s’kalonte kurrë pa të përshëndetur, sa herë më takonte, shprehte dëshirën për të ndernjur e për të biseduar për çështje të ndryshme. Dhe ja...ku i erdhi radha. Hymë brenda në dhomë, dhe tash më mirë po e vëreja se miku im nuk ishte ai që kisha takuar ndonjëherë, ishte diçka i shqetësuar, ishte i rënduar si të kishte gur në zemër, diçka e mundonte, fytyra e tij reflektonte dëshpërim e pendim, dyja bashkë. Ndërsa unë, u preka, u preka thellë në shpirt me fjalën time që e lëshova ashtu, aq lehtë dhe jo në momentin e duhur. Për më tepër pyetja ime ishte një nxitje, prandaj, më doli si e ashpër, megjithëse e pata me çiltëri dhe me shumë sinqeritet. Kjo s’është dashur të ndodhte, kurrsesi, sepse nuk përkiste as me natyrën time, as për moshën e tij. Dhe, derisa ai po bënte gati dy gota me lëngë molle, mua më sillej vërdallë nëpër kokë, si një lloj qortimi ndaj vetes, këshilla e një mendimtari të urtë: “Qysh në njohjen e parë, fytyra e personit, mënyra se si përshëndet e si të pret, si bisedon dhe sillet janë tregues që na japin një ide paraprake për të. Duke e kryer detyrën, hoxha, duhet pasur jashtëzakonisht kujdes, duhet qenë jashtëzakonisht i dhembshur, i mëshirshëm, i butë dhe lëshues. Veçanërisht në këtë kohën tonë ku turma të tëra njerëzish kanë nevojë që të kapen për dore, që gjërat që do t’u tregohen, t’u tregohen ëmbël e t’i vënë në mendime dhe, më në fund, që kanë nevojë të orientohen në Rrugën e drejtë (Sirat al-mustekiim) që përcakton Kur’ani. Të sillesh ashpër me një person i cili tashmë periudhë të gjatë është ushqyer në

prehrin e kushteve vetëm materiale, pa një ushqim shpirtëror, është njëlloj si të thuash “rri aty ku je”. Është shumë me rëndësi të sillesh butë, me mirëkuptim dhe virtytshmëri me besimtarin dhe personin e përshtatshëm për t’i fituar, kurse në mënyrë të logjikshme e njerëzore, me mohuesin dhe njeriun zemërgur duke ditur ta trajtosh dhe drejtosh ashtu siç bëhet. E veçanta që duhet bërë kujdes në të gjitha situatat, është që patjetër të mbash një rrugë të hapur prej nga t’u përcjellësh të tjerëve të drejtën dhe të vërtetën. Në Kur’an, profeti Musa, paqja e Zotit qoftë mbi të, urdhërohet të sillet me fjalë të buta edhe para faraonit:

**”Shko te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjitha kufijtë”.**

(Musai) tha: **“O Zoti im, zgjeroma kraharonin tim,**

**Lehtësoma punën time,**

**dhe zgjidhmi nyjat e gjuhës sime,**

**që ata të kuptojnë fjalën time!**

**Më jep një ndihmës nga familja ime,**

**Harunin, vëllanë tim!**

**Ma rrit fuqinë nëpërmjet atij**

**dhe bëma ortak në punën time,**

**që të thurim shumë lavde për Ty**

**e të përmendim Ty vazhdimisht!**

**Vërtet, Ti do të jesh gjithnjë Mbikëqyrësi ynë”.**

(Allahu) tha: **“Kërkesa jote u plotësua, o Musa!**

**Edhe më parë, Ne të kemi bërë mirë ty,**

**kur i frymëzuam nënës tënde atë që iu frymëzua”...**

**“...Ti qëndrove me vite të tëra midis banorëve të Medjenit, pastaj erdhe sipas porosisë së caktuar, o Musa!**

**Unë të kam zgjedhur ty për Vete.**

**Shkoni ti dhe vëllai yt me mrekullitë e Mia dhe mos reshtni së përmenduri Mua!**

**Shkoni te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë!**

**Flitni atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!”<sup>5</sup>.**

I Dërguari Muhammed (a.s.), ishte i butë e nuk ishte i vrazhdë. Pas luftës së Uhudit Profetit a.s., i thuhet: **“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishte i ash-për dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje...”**<sup>6</sup>. Ndërsa Muhammedi a.s., thoshte: *”Përgëzoni, mos neveritni; lehtësoni, mos vështirësoni”*<sup>7</sup>, kurse diku tjetër: *“Unë jam i urdhëruar për t’i drejtuar njerëzit”*. Enesi (r.a.) shoku dhe shoqëruesi i pandashëm në shërbime i Muhammedit (a.s.), citohet të ketë thënë: *“I kam shërbyer të Dërguarit të Allahut (xh.sh.) përplot dhjetë vjet dhe kurrë nuk më ka thënë as “uh” (kjo shenjë mospërfillje). Asnjëherë nuk më ka thënë për diçka që e kam bërë - përse e bëre, dhe as për diçka që s’e kam bërë dhe që është dashur ta bëj - përse e lë”*.<sup>8</sup> Dhe për t’i drejtuar njerëzit, i them vetes, ata duhet t’i dëgjosh, t’ia kuptosh gjendjen e brendshme dhe gjërat për të cilat ka nevojë, t’ia tregosh me një mënyrë që të mos e humbasësh në vend që ta fitosh atë njeri. Ky nuk është lëshim. Përkundrazi: Orientim-edukatë e nevojshme e kryerjes së detyrës në përputhje me frymën e Kur’anit dhe Hadithit, për të zbutur, për të lehtësuar dhe shëruar sado pak njeriun tonë me zemër të thyer dhe mendjen të pakënaqur. Madje një mënyrë e tillë kumtimi me metodën përkatëse në frymën e Kur’anit dhe praktikës së Muhammedit a.s., duhet të përdoret edhe në gjërat më të thjeshta, si për shembull në punë, në vizitë etj., sepse edhe në këto gjëra të thjeshta kërkohet një synim, një qëllim final, një fleksibilitet, një plan dhe një projekt. Po a nuk ishte edhe vizita ime mikut me një qëllim të caktuar. Sigurisht. Atëherë, pse nxitova, pyesja veten! Në gjithësi ka një ekuilibër, plan dhe program të caktuar. Atëherë, edhe hoxha, në detyrën qoftë edhe si kjo e imja duhet të jetë tejpamës, duhet të veprojë me vetëdije, pa nguti dhe në mënyrë sistematike, për sa kohë na dëgjojnë dhe përfitojnë. Por, nëse nisin të ironizojnë e të tallen me gjërat për të cilat ne u fla-

<sup>5</sup> Kur’ani, sura Ta Ha, ajeti 24-38; 40-44.

<sup>6</sup> Kur’ani, sura Ali Imran, ajeti 159.

<sup>7</sup> Hadithin e shënon Buhariu.

<sup>8</sup> Hadithin e transmeton Buhariu 4/10, Muslimi 4/1804, Ebu Davudi 5/133.

sim, duhet që, sipas urdhrit të Kur'anit, ta ndërpresim prirjen ndaj tyre dhe të ngrihemi e ikim mençurisht, gjakftohtë e pa u nxehur, pa u folur fjalë të këqija dhe pa u sjellë në mënyrë të shëmtuar e fyese për ta, duke pasur gjithmonë kujdes për mundësinë e përshëndetjes. Kur'ani thotë: **“Ai ju ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata (njerëz që veprojnë kështu), derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata...”**<sup>9</sup>.

E shpejtë është mendja. Gjithë këto mendime m'u sollën, derisa miku im po më ofronte gotën me lëngë molle. Po ç'e detyroi mikun tim të më thërriste? Ç'ka ndërmend të më thotë? Ç'e mundonte? Do ta dëgjoj mikun tim deri në fund.

Duke ma dhënë gotën në dorë, më pyeti:

- “Ke dëgjuar gjë këto ditë”?

- Jo, jo, - i them, - pse, ç'ka ndodhur?

- Djali i X. ka vrarë veten!”

Një shtangie më shtrëngoi gjithë trupin. E njihja këtë të ri. Ishte student. Djalë pasaniku. Ai kishte çdo gjë që gjithkush ia kishte lakmi. I pasur, i pashëm, i shëndetshëm, me veturë të veten, i ndershëm dhe kurrë i përzier me ndonjë punë të dyshimtë. Dhe ishte ky i ri që kishte mbyllur jetën - me vetëvarje!

- “Pranë tij u gjet një copë letër me ca rreshta”, vazhdoi miku im, “me të cilën kishte shpjeguar aktin e tij”: “Bota më është kthyer mbra-pshtë, ndjehem i mashtruar nga jeta. S'dua të jetoj më. Kështu po i jap fund jetës. Ajo s'ka aspak kuptim”.

Është për të ardhur keq! Kjo është e tmerrshme!

- “E tmerrshme”, pohoi miku im dhe, duke më shikuar në sy pyeti:

- “Hoxhë, ç'farë thotë feja për këtë?”

- “Për çfarë?”

- “Për vetëvrasjen, de?!”

Islami nuk e pranon vetëvrasjen. Përderisa ne nuk e kemi krijuar vetveten, ne nuk i zotërojmë trupat tanë. Ne na janë besuar për t'u ku-

jdesur për ta, për t'i ushqyer; për t'i ruajtur dhe për t'i mbrojtur. Sa shumë gjëra ka që njeriu e pandeh veten për pronar të tyre, pra dhe që u del zot ndërsa, duke vrarë mendjen fare pak, do ta kuptonte se pronari dhe i zoti i tyre është Allahu i Lartësuar dhe, kështu, do të hiqte dorë nga kjo çështje! Ne s'mund të jemi pronar as i kafshatës që e fusim në gojë, sepse duhet të futet në punë tërë gjithësia që të përgatitet ajo kafshatë e të na vijë në tryezë. Kjo do të thotë se ai që na e dhuron atë kafshatë, mund të jetë vetëm Zoti që është i aftë për të krijuar tërë gjithësinë. Meqë Ai është i zoti i çdo gjëje, vetëm Ai ka të drejtë të veprojë në pronën ku është zot, sepse pronari vepron si të dojë në pronën e vet dhe vetëm pronari mund ta administrojë pronën e vet! Por, shihni guximin dhe padrejtësinë e njeriut: i jep vetes të drejtë të mbyllë jetën me duart e veta. Zoti është pronari dhe dhënësi i jetës dhe të drejtat e Tij për dhënie dhe marrje nuk duhet të shkelen. Përpjekja për të vrarë veten konsiderohet krim në Islam, si dhe mëkat i rëndë. Kur'ani thotë: **“...Dhe mos e vritni veten (dhe njëri-tjetrin)! Vërtet, Allahu, është i Mëshirshëm për ju.”**<sup>10</sup>.

Ndërsa Muhammedi, qoftë paqja e Zotit mbi të, ka thënë: “Cilido që vret veten me armë prej hekuri do të vazhdojë ta mbajë atë për jetë në ferr. Cilido që pi helm dhe vret veten do të vazhdojë të pijë atë për jetë në ferr. Cilido që hidhet nga një mal dhe vret veten do të vazhdojë të rrëzohet për jetë nëpër thellësitë e ferrit”.<sup>11</sup> “Jeta njerëzore ka vlerë të brendshme, që duhet respektuar pa kushte, pavarësisht nga rrethanat. Koncepti i jetës që nuk ia vlen të jetohet nuk ekziston në Islam. Profeti Muhammed (a.s.) na ka mësuar: “Na ishte një herë një njeri që kishte një ndëshkim që e sprovonte durimin, ndaj ai mori thikën, preu kyçin dhe e la gjakun të rrjedhë derisa vdiq. Pas kësaj Zoti tha: “Robi im e nguti fundin e vet, ia mohoi parajsën”. Gjatë njërës prej fushata-ve ushtarake, u vra një nga myslimanët dhe bashkëluftëtarët e profetit vazhduan të lavdërojnë trimërinë dhe mjeshtërinë e tij gjatë luftimit, por, për habinë e tyre, profeti shpjegoi: “Fati i tij është ferri”. Pas lë-

<sup>10</sup> Kur'ani, sura En-Nisa, ajeti 29.

<sup>11</sup> Hadith, transmeton Buhariu.

<sup>9</sup> Kur'ani, sura En-Nisa, ajeti 140.

ndimit, bashkëlufëtaret zbuluan se burri qe lënduar rëndë dhe, prandaj, mbështeti shpatën në tokë dhe krodhi gjoksin në majën e saj, duke kryer vetëvrasje.<sup>12</sup> Kështu qëndron puna e fatit të atyre që kryejnë vetëvrasje, miku im. Me asnjë arsye nuk mund të justifikohet vetëvrasja as “në mënyrën estetike të të menduarit që beson se jeta jonë në këtë tokë pasohet nga zbrazëtia, as për shkak të sëmundjes së pashpresë, as për shkak të varfërisë dhe vuajtjes. Për më tepër, është një përmasë tejprëcaktuese për çështjen e dhimbjes dhe të vuajtjes”.<sup>13</sup> Ka raste kur njeriu, herë më gjatë, e herë më shkurt, ndjehet i fuqishëm, i paluhatshëm, i pathyeshëm, tejet i vendosur, i fortë e këmbëngulës në përcaktime dhe zgjidhje jetësore. Dhe ka raste kur i njëjti njeri, në ca rrethana tjera është i dobët, i luhatshëm dhe i pavendosur, gati si një lloj lodre në duart e fatit, aq sa nuk e njeh më as veten, kurse të tjerët me befasi pyesin: ç’është me këtë njeri? Dje ishte i tillë, e sot ndryshe? Disa njerëz sillen tërësisht gabimisht ndaj jetës: jepen pas alkoolizmit, jetës epshore, shfrenimit sa humbin rrugën në oborr. Disa të tjerë shkojnë aq larg, sa që humbin kuptimin e jetës dhe të punës, ndiejnë zbrazëti në shpirt, zbrazëti në zemër, grindje të brendshme, shqetësime ndërgegjeje etj. Prandaj, provojnë të bëjnë edhe “hapa terri apo vetëvrasje”. Nuk janë në gjendje të kuptojnë ndryshe lojën e jetës! Allahu i Lartësuar thotë: **“Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë të dëgjojë dhe të shohë”**<sup>14</sup>. Me këto përvoja të tilla çdokush përballet, së pari me vetveten, pastaj edhe me të tjerët gjatë rrugës jetësore. Ngandonjëherë, njeriu duhet të pyes veten, duke pasur për pikënisje fenë, mësimet e Kur’anit dhe praktikën e Profetit Muhammed (a.s.):sa jemi të dobët dhe të pavendosur para të keqes, sprovimeve të djallit, dhe s’kemi fuqi t’i përballojmë, por shpeshherë dorëzohemi dhe kështu, e keqja ngadhënjën dhe mbizotëron, dhe, në anën tjetër sa jemi të fortë, të qëndrueshëm, kokëfortë para Zotit, sepse kurrsesi nuk “dorëzohemi”

<sup>12</sup> Hadith, transmeton Buhariu.

<sup>13</sup> Gjërësisht: Hasan Hathout, Leximi i mendjes së muslimanit, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë 2006.

<sup>14</sup> Kur’ani, sura El-Insan, ajeti 2.

s’ia mundësojmë udhëzimit të Tij të depërtojë në shpirtin tonë, të na çlirojë dhe ndërrojë! Përse në disa raste kemi aq fuqi për t’u mbyllur para mirësisë dhe faljes së Zotit, e në disa raste jemi aq të dobët për t’u hapur para së keqes, mëkatit dhe tundimeve të djallit sa ta mbyllim jetën para kohe!? “Prej nga gjithë kjo fuqi, krenari, mbyllje, dëbim para të mirës, dashurisë, para teje, o Zot!?” A mund të ketë shpjegim në këto pyetje? A mund t’u rezistojmë këtyre stuhive? Po, pa dyshim, nëse e largojmë indiferentizmin dhe me përkushtim kapemi pas mësimëve të Zotit. Qoftë lavdëruar Allahu, Mëshirëplotë na ka mësuar: **“Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm: kur e godet e keqja, ai ligështohet fort, por, kur i bie e mira, ai bëhet koprrac. Përjashtim bëjnë ata që falen, e që janë të vazhdueshëm në faljet e tyre”**.<sup>15</sup> Durimi dhe përballja janë vlera tejet të vlerësuar dhe tejet të shpërblyera në Islam: **“Vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë”**<sup>16</sup>, **“...Dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve.”**<sup>17</sup>. **“Kurse për ata, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të ketë kopshte nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Kjo është fitorja madhështore”**. **“Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira”**.<sup>18</sup>

Profeti Muhammed (a.s.) na ka mësuar: “Kur besimtari kaplohet nga dhimbja, që nga shpimi nga një majë gjembi e më shumë, Zoti ia fal mëkatet, dhe gjithë prapësitë e tij shlyhen, ashtu si pema që zhvishet nga gjethet”.

- “Po Hoxhë, por ja që po ndodhin”!, ndërhyri miku im, - “Jetë absurde!”.

Unë nuk mendoj ashtu, miku im, pyetja për kuptimin e jetës sonë është me rëndësi të madhe. Jeta e njeriut është e shenjtë sipas Islamit. Ajo bëhet akoma më e rëndësishme kur mendojmë se nëpërmjet saj e fitojmë jetën e botës së ardhshme...

<sup>15</sup> Kur’ani, sura El-Mearixh, ajeti 19-23.

<sup>16</sup> Kur’ani, sura Ez-Zumer, ajeti 10.

<sup>17</sup> Kur’ani, sura Lukman, ajeti 17.

<sup>18</sup> Kur’ani, sura El-Bejjine, ajeti 7.



- “Hoxhë”, prit një minutë, që të shpjegohem unë për veten time”, ndërhyri miku im duke u shtirë sikur nuk dëgjoi fjalët e mia të fundit dhe fytyrën ia përshkoi një e skuqur si kur qëndron pranë zjarrit.

U bë, i them unë duke i buzëqeshur. Ç’është e drejta m’u bë qejfi se më në fund miku im do të shpalosë brengën e vet që e mundonte. Ndoshta do të ndjehet më i qetë dhe më i lehtësuar, por edhe unë gjithashtu dhe, mendova se kjo do të mund të shërbente si një shenjë se në ç’drejtim duhet vazhduar bisedën.

- “Ju e dini ashtu si edhe unë se një kohë ka qenë vështirë të shkollohesh. Gjyshi im, ishte i njohur në qytet për pasurinë që gëzonte. Kishte vetëm një djalë. Ai ishte babai im, i cili, tash 23 vjet të plota bën që ka vdekur. Edhe babai im trashëgoi pasurinë e Gjyshit, kështu që, lë se nuk kemi ndjerë hallin e varfërisë, por pati mundësinë e mirë të më shkollonte, si të vetmin djalë që më kishte. Kreva shkollën fillore dhe e regjistrova gjimnazin. Ishte gëzim i madh për familjen, por edhe më i madh që gëzimi kur e mbarova gjimnazin. Ëndrra ime, si ëndrra e të riut. Edhe unë fillova të planifikoja të ardhmen dhe, një ditë po i them babait: “dua të vazhdoj studimet”. “Ani, shumë mirë”, më thotë babai, -“por ku?”. I them: “dua të shkoj në Juridik”. “Bukur”, më thotë babai. Studimet më shkuan mirë, kreva Juridikun dhe pasi fitova një përvojë të mirë u punësova në Gjykatën e Qarkut. Pas kësaj u bëra gjykatës i mirë dhe qytetarët më njihnin për ndershmëri dhe korrektësi. S’shkoi pak, u martova dhe më lindën dy djem dhe dy vajza. Tani të gjithë janë të martuar dhe kanë fëmijë. Mirëpo, erdhi pleqëria dhe m’u desh të dal në pension. Kur u pensionova s’më mbeti tjetër veç të merresha me rritjen e luleve në kopshtin që e kam pas shtëpisë. Dal aty paradite, kthehem brenda, prapë dal pasdite deri në mbrëmje, kështu çdo ditë. Një ditë shteret edhe kjo pak energji që më ka mbetur dhe s’mund të dalësh as aty. Dhe çka pastaj? Ja, fati i njeriut. ”Gjatë gjithë jetës kaq shumë punova. Dhe ja, ku jam në fund të jetës sime. Jam plak dhe kur plakesh e di ç’të mbetet? Jeta të paraqitet me kufizime. Kapi një kokërr molle në dorë dhe, duke mbajtur nga unë shtoi: “Mbetet të shijosh vetëm aromën e frutave”.

Qeshëm të dy me ilustrimin që bëri. Ishte një ilustrim i mirë.

Mirëpo, miku im prapë vazhdoi: -“E sheh, Hoxhë, çfarë të pret? Ku do të përfundosh...? - Dështim! Njeriu hiçgjë!- shfryu miku im, dhe shtoi”, kur mendoj, kjo më fut të dridhurat”!

Kjo ishte historia e mikut tim që më tregoi. Njeriu disa herë bie në një gjendje të tillë shpirtërore që gjithë kjo botë e gjerë i duket e ngushtë dhe shtypëse, që tërë gjithësia në sytë e tij duket e veshur në të zeza. Miku im kishte rënë në një gjendje të tillë. Ai ishte i shqetësuar. Unë nuk mund të rrija pa u përgjigjur, por si ta bëj - nuk dua që ta lëndo në asnjë mënyrë. Islami e refuzon tipin e njeriut të ashpër, egoist dhe të trashë në sjellje. Feja thotë që myslimani është njeri i ndjeshëm, delikat dhe me sjellje të holla. Dhe të gjitha këto varen gjithmonë nga niveli ndjesor. Për pak çastesh mbretëroi një heshtje, dhe për të mos e lënë të rëndonte më shumë, iu drejtova me këto fjalë:

- Historia jote, mik, më kujton ajetin e Kur’anit: **“Allahu është ai që ju ka krijuar juve në një gjendje të dobët, pastaj, pas dobësisë, ju dha fuqi e, pas fuqisë, dobësi dhe pleqëri...”**<sup>19</sup>. Një poet, i frymëzuar nga ky ajet thuri këto vargje:

*“U linde i dobët dhe i zhveshur  
Jeton pak  
I dobët do të vdesësh  
Njeri, ku je?”*

Ndoshta i ke lexuar diku, miku im. Mirëpo, siç e sheh edhe vetë, kjo nuk ka të bëjë aspak me idenë e fatalizmit, humbje shpresës, pesimizmit, apo jo. Për më tepër, po t’i analizojmë mirë e mirë, në këto vargje gjejmë thirrjen që i drejtohet njeriut për ta zgjuar nga gjumi dhe të flakë tej plafin që ia ka mbyllur sytë. Të shohë fundin e kësaj jete si vazhdimësi e jetës së ardhshme. Prandaj, detyra më me rëndësi e njeriut në këtë botë duhet të jetë përgatitja për “botën pas vdekjes”, e cila është një perspektivë absolute dhe e përjetshme. Kur’ani thotë: **“Andaj, shikoj gjurmët e mëshirës së Allahut, si e gjallëron tokën pas shkretimit të saj. Vërtet, Ai do t’i ringjallë edhe të vdekurit...”**,<sup>20</sup>

<sup>19</sup> Kur’ani, sura Er-Rum, ajeti 54.

<sup>20</sup> Kur’ani, sura Er-Rum, ajeti 50.

dhe në një vend tjetër: **“...Në të njëjtën mënyrë do të ktheheni edhe ju në jetë”**. Kurse në një vend: **“Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, Allahu do t’i shpërblejë nga dhuntitë e Veta. Në të vërtetë, Ai nuk i do mohuesit”**<sup>21</sup>. Këto janë ajete të Kur’anit, mik, të cilët, kur t’i kemi pranuar si duhet dhe, në pajtim me to të bëjmë hapin e gjallë, mund të ecim nëpër rrugën e jetës me gëzim, sepse kemi një shtëpi të përfunduar ku mund të strehohemi, ku mund të çlodhemi dhe të shpërblehemi nga i Madhi Zot. Besimtari atë “shtëpi shpëtimi” e shikon që nga larg, shikon “dritat” e shtëpisë së tij. Atje ai do të gjejë ngrohtësi. Atje ai do të shohë Zotin, atje ai do të qeshë me vështirësitë e rrugës. **“Atëherë ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjeshe te Zoti yt”**.<sup>22</sup>

Kjo, miku im, është mënyra se si shkojnë nëpër botë njerëzit që ia kanë përkushtuar jetën e tyre Allahut të Lartësuar dhe kanë gjetur jetën tek Ai. I hedhim një sy shoqërive njerëzore, do të shohim shumë prej tyre kanë bërë dhe bëjnë një jetë krejtësisht të gabuar, në atë çka e quajmë të keqe dhe mëkat dhe, në fund, vdesin. Njerëz të tjerë kanë bërë dhe bëjnë një jetë përplot vuajtje, duke luftuar për të vërtetën, për drejtësi, për idealet e tyre dhe, në fund, vdesin. Kaq është e gjitha?! A mund të jetë vdekja mbarimi i të dyja këtyre mënyrave të jetesës? Ka diçka, diçka që në thellësi të qenies sonë nuk do ta pranojë. Ku, pra, është përgjegjshmëria njerëzore, kur e dimë se kjo është njëra nga katër tiparet themelore njerëzore me të cilën Zoti e ka pajisur. Po qe se vdekja do të ishte fundi i fabulës, jeta njerëzore do të binte ndesh me atë ekuilibër delikat që sundon tërë gjithësinë. Përfundimi i vetëm, pra, është se vdekja kurrë nuk mund të jetë fundi. Vdekja nuk mund të pasohet nga zbrazëti, përveçse nga një jetë tjetër, ku rivendoset ekuilibri dhe përmbushet përgjegjshmëria. Kjo është jeta e përtejme për të cilën na flet feja, kur njerëzit do të gjykohen nga Zoti, Gjykatësi i Mbramë - Ditën e Gjykimit.

<sup>21</sup> Kur’ani, sura Er-Rum, ajeti 45.

<sup>22</sup> Kur’ani, sura El-Inshikak, ajeti 6.

Zoti na jep pavarësi dhe na kërkon llogari. Ne nuk jemi krijesa të përkryera, as nuk u paracaktuam të ishim të tilla. Na kërkohet të bëjmë gjithçka mundemi përballë vështirësive dhe tundimeve dhe, shpesh, “mundi” ynë nuk është i pagueshëm. Përpiqemi dhe jeta jonë është betejë e përhershme. Prandaj, është e arsyeshme që Zoti t’i pranojë përpjekjet tona, t’i çmojë ato dhe të na dojë si krijesat e Tij me fisnike. Ndërsa nuk kërkon prej njerëzve më shumë se ç’kanë mundësi. Zoti i ka bërë përgjegjës ata në raport të drejtë me kapacitetet dhe mundësitë që u ka dhënë. Sigurisht, Ai do të donte të na shihte të kalojmë provën e përgjegjshmërisë, pavarësisht nga liria jonë e zgjedhjes. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është të na kujtojë vazhdimisht se tek Ai është Strehë e Mbramë, se çfarë është e mira dhe çfarë është e keqja. Ashtu siç na i përshkruan Ai, dhe për Ditën e pashmangshme të Gjykimit, kur do të japim llogari: **“Po u ofrohet njerëzve dita për të dhënë llogari...”**<sup>23</sup>. **“Dhe do të thonë: “Mjerë për ne, kjo është Dita e Gjykimit!” Po, kjo është Dita e Gjykimit, të cilin ju e keni përgjesh-truar!” “Ndalini ata, se do të pyeten”**<sup>24</sup>. **“Në Ditën e Ndarjes vendimtare!”**<sup>25</sup>. **“Ata thonë: “O Zoti ynë, shpejtona pjesën tonë (të dënimit) para Ditës së Llogarisë!” “Kjo ju është premtuar për Ditën e Llogarisë.”**<sup>26</sup>. **“Atë Ditë do të mbeteni zbuluar dhe asnjë fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur”**.<sup>27</sup> **“Në të vërtetë ata as që e çonin ndërmend se do të jepnin llogari, dhe shpalljet Tona i mohonin prerazi”**.<sup>28</sup>

Për t’u mundësuar robërve të Tij të arrijnë të vërtetën, Zoti i lartë i ka favorizuar njeriut një sërë vetish të larta. A nuk duhet që njeriu, si qenia më e përsosur, të cilit Zoti ia ka dhuruar një mendje të shëndoshë, njohjen, vetëdijen, lirinë e zgjedhjes, përgjegjshmërinë të ketë më shumë largpamësi se kaq? Ç’do të ndodhë më pas? Njerëzit sot vepro-

<sup>23</sup> Kur’ani, sura El-Enbija, ajeti 1.

<sup>24</sup> Kur’ani, sura Es-Saffat, ajeti 20-21 dhe 24.

<sup>25</sup> Kur’ani, sura El-Murselat, ajeti 13.

<sup>26</sup> Kur’ani, sura Sad, ajeti 16, 53.

<sup>27</sup> Kur’ani, sura El-Hakka, ajeti 18.

<sup>28</sup> Kur’ani, sura En-Nebe, ajeti 27-28.

jnë sikur vdekja të ishte fundi!. Dhe, nëse nuk e dimë se ç'do të ndodhë pas vdekjes t'i hedhim një sy Kur'anit, Fjalës së Allahut, i Cili e di me saktësi. Vetëm ai që na krijoi mund të thotë pse na krijoi. Me fjalë të tjera vetëm me anë të Kur'anit mund të marrim një përgjigje për pyetjen tonë: ç'është jeta e ç'do të ndodhë pas vdekjes sonë? Unë vetëm ca ajete të Kur'anit i theksova më sipër. Ju mund të gjeni më shumë. Nëse tashmë nuk do të isha një lexues i kujdesshëm i Kur'anit, vetë kjo pyetje do të më detyronte ta lexoja atë. Pas vdekjes vjen gjykimi i Allahut. Njerëzit ose humbin ose shpëtojnë.

“Të bësh plane për jetën deri në varr nuk mjafton. Duhet të planifikosh gjithashtu për atë që ndodh përtej varrit”. Një jetë e kushtuar punës, nuk kam menduar kurrë për vete, detyra ime më e lartë ishte familja...Mua më duket se një qenie njerëzore nuk ndodhet në tokë vetëm të punojë si skllav gjatë gjithë jetës së tij. Kjo do të ishte vërtet shumë e trishtueshme. Nëse kjo do të ishte jeta, atëherë do të ishte më mirë të mos ndodhemi në tokën e Zotit. Kur'ani jep përgjigje se pse ndodhemi në këtë jetë: **“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij...”**<sup>29</sup>. **“Dhe Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë”**.<sup>30</sup> Adhurimi është kulmi i dashurisë. Allahu, qoftë lavdëruar, ka dashur që ta njohin robërit e Tij, prandaj, nga ata ka kërkuar që ta adhurojnë. “Sikur të mos kishte qenë mëshira e Tij ndaj njerëzve, nuk do t'u takonte nderi i ibadetit i adhurimit për Të, sepse nderin e ibadetit, përkatësisht, adhurimit e arrijnë vetëm ata që meritojnë shpërblime të mëdha”. Ndaj, çdo punë e mirë që bën, qoftë për shoqërinë, qoftë që i detyrohesh familjes, ngritjes dhe edukimit të saj, kur bëhet në emër të Tij, s'është tjetër veçse adhurim i pranuar te Zoti. Njeriu i cili e rregullon jetën nën orientimin e Kur'anit, shpëton nga e keqja e nefsit dhe tundimeve të djallit dhe jeton duke kërkuar vetëm pëlqimin e Zotit dhe, atëherë zemra i bëhet e merituar e shfaqjeve hyjnore. Për njeriun që arrin në këtë gjendje, hapet një dri-

tare shpirtërore për të parë përtej kushteve të kësaj bote dhe gjithësia shndërrohet në një libër madhështor.

Po kush është fajtor për ne, miku im, pse u desh të mësojmë në shkollë që na thoshte: “Njeriu e ka prejardhjen prej një kafshe, që përfshihet ngjan më të - prej majmunit. Ndërkohë, që nuk e quajmë vetveten kafshë. Megjithatë, në kuptimin e sistemit të qarkullimit, tretjes, frymëmarrjes, metabolizmit, imunitetit, etj., kemi të njëjtën biologji, jemi të vetëdijshëm se nuk është ndërtimi ynë biologjik ai që na bën qenie njerëzore. Njeriu ka dy anë: lëndoren dhe shpirtëroren. “Që të dyja këto anë kanë kërkesat e tyre të ndryshme të varura nga krijimi i tyre. Feja i ofron njeriut një program ekuilibri mes lëndores dhe shpirtërores. Po që se njeriu, duke mbetur vetëm në planin fizik-trupor, e vëzhgon çdo gjë me një vështrim materialist, atëherë, edhe ngjarjen më abstrakte, madje, sheh në kallëpe konkrete dhe të pashpirt”. Shpirti orienton kafazin e vet-trupin. Feja i hap shpirtit një rrugë kënaqësie në përputhje me kapacitetin individual të personit. Me të vërtetë, po që se fesë i hiqet aspekti moral-shpirtëror që i jep kënaqësi shpirtit të njeriut, njeriu zbret në nivelin e sistemeve njerëzore të ngritura thjesht mbi dobinë dhe përfitimin material. Në këto kushte, duke i dhënë jetës vlerën vetëm në drejtimin formal dhe të interesave materiale e të përkohshme, njeriu privohet nga përfitimi ndjesor që është synimi dhe qëllimi i vërtetë i jetës adhuremore. Është për t'u tmerruar kur sheh se si njerëz të shkolluar e lënë veten e tyre të tërhiqen për hunde nga njerëz të tillë si Darvini, Hegeli dhe Niçeja. Mosbesimi i tyre i bazuar në arsyetime të gabuara i fut në rrezikun e madh të lënies jashtë shpëtimit të përjetshëm. Arsyetimet e tyre të papërligjura nuk mund të kënaqin ndërgjegjen e njerëzisë. Të gjitha supozimet dhe hipotezat e pathemelta materialiste, falimentojnë dhe bien poshtë para së vërtetës. Sot sheh ndër njerëz aq shumë mosbesim saqë çdo kokëmençur duhet të nxitë pa përtesë - t'i jepni fund qëndrimit tuaj mosbesues - sepse shpëtimi i shpirtit tuaj është në rrezik. Hiqeni qafe atë! Flakni tej mendimin sipërfaqësor mbi të cilin ju bazoni mosbesimin tuaj! Dhe thoni: **“...Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të**

<sup>29</sup> Kur'ani, sura El-Isra, ajeti 23.

<sup>30</sup> Kur'ani, sura Edh-Dharijat, ajeti 56.

***Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë me Atë!***<sup>31</sup>.

Prandaj, miku im, unë nuk mendoj se jeta është “absurde”, se njeriu është “hiçgjë”, se “vdekja është fundi”. Unë i edukuar nga mësimet e Kur’anit dhe Hadithit, të nxit t’i shikosh këto gjëra me një sy tjetër të mendimit: “Jeta ka kuptim”, “Ti ke rol”, dhe “Nga vdekja në jetë”.

- “A mund të m’i argumentosh këto që thua!”

- Tashmë, të kam sjell ca nga argumente të nevojshme, nëse më ke dëgjuar me kujdes. Për të kuptuar jetën është e nevojshme të kesh një fe që të jetë e pastër dhe monoteiste. Nga çasti që unë bëhem rob i Zotit dhe i adhuruari i Tij, jeta ime merr kuptim. Nuk përbën ajo se kush jam: qofsha hoxhë apo pastrues rrugësh, menaxher apo rrobaqepës, grua shtëpiake apo mësues, mjek apo inxhinier, jeta ime merr kuptim vetëm që nga momenti që bëhem rob i Zotit, i adhuruari i Tij. Por, edhe sikur të isha në çfarëdo gjendje, sapo të kisha aftësinë për të menduar drejt, çdoherë do të kapesha pas këtij ajeti: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”. Ju mund të pyetni pse? Që nga ky çast që unë bëhem adhurues i Allahut, jeta ime merr kuptim. Po ju duhet të dëgjoni Allahun, Krijuesin e gjithësisë, të adhuron Atë. Vetëm atëherë ajo do të ketë qëllim të vërtetë.

Duke mos kundërshtuar fare tha:

- “Po roli i njeriut, Hoxhë?,- pyeti dhe vazhdoi,- “shiko unë kam qenë një gjyqtar dhe, detyra e çdo gjyqtari është të ndajë drejtësi. Dhe nëse unë kam ndarë drejtësi dhe kam shërbyer në ndërtimin e besimit mes njerëzve, kam mbrojtur sistemin e drejtësisë, a nuk është kjo një arsye e mirë për kryerjen e misionit - të rolit, si thua?”.

- “Ajo që thua ti është e bukur, ia ktheva, por, nëse ti nuk e di se për ç’qëllim e bën këtë dhe në emër të kujt, atëherë është pa kuptim të kërkojë të mbrosh ose të ndash drejtësi. Tani, mos e keqinterpretimi atë që sapo e thashë!. Ajo që dua të them është se përgjigjja jote, miku im, nuk është vërtet një zgjidhje për çështjen që po e diskutojmë. Më

fal! Por ti po më flet për detyrën. Pyetja: “Ç’është detyra” ne mund ta diskutojmë një herë tjetër. Megjithatë, dua të them se, Allahu urdhëron drejtësinë. Në Kur’an thuhet: **“Më të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë...”**<sup>32</sup>. **“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë...”**<sup>33</sup>. Prej cilësive të Zotit janë edhe këto që kanë të bëjnë me këtë çështje: E para, Ai e cilëson Vetën “El-Hakk” (I Vërteti ) dhe, e dyta, Ai e cilëson Vetën “El-Adl”, (I Drejti ). E vërteta dhe e drejta janë bazat kryesore për mbarëvajtjen e çdo njeriu, bashkësie dhe populli. Pa këto të dyja çdo popull do të zhytet në pellgun e prapështisë dhe të humbjes. Kush e shkel të drejtën e njeriut ose e mohon të drejtën e tij, ai shkakton zemërimin e Zotit, është jashtë ligjeve të drejta që i ka bekuar i Madhi Zot, i Cili e cilëson Vetën: “Gjykatës i Drejtë”, “Gjykatësi më i Mirë”.

Por, e lëmë këtë temë për një herë tjetër. Tani fjala është për “rolin e njeriut”. Kur të thash -“ti ke rol”, pikërisht kam menduar në diçka tjetër. Kam menduar mbi rolin e mëkëmbësisë dhe të adhurimit që ka njeriu, kam menduar mbi pozitën e tij shumë të lartë që ia ka dhënë Zoti i Gjithëfuqishëm. Pse jemi në tokë? Vetëm për të bërë detyra si ndonjë robot i programuar!? Jo, miku im. Në gjithësi asgjë nuk është e kotë e rastit. Ja, po e marrim vetëm një shembull: Flutura. Siç dihet, ky insekt, derisa zhvillohet që të marrë emrin flutur, kalon disa metamorfoza:

- a) flutura pjell vezët e saj përmbi gjethe.
- b) Krimbi del nga vezët dhe ushqehet me gjethe.
- c) Nga krimbi del nusja (nimfa).
- d) Nuses i dalin krahët dhe bëhet flutur.

Ta marrim në shqyrtim e të mendojmë. Edhe në këtë rast lind një pyetje: Si ndodhi që, kur doli krimbi nga veza, nëna e tij, flutura, ishte zhdukur? Si e dinte flutura dhe kush ia pati mësuar fluturës që u zhduk, se pjella e saj që do të dalë vetiu nga veza, në fillim ka nevojë të ushqehet me gjethe e prandaj e vendosi vezën mbi fletët e gjelbra,

<sup>32</sup> Kur’ani, sura 16:90.

<sup>33</sup> Kur’ani, sura En-Nisa, ajeti 135.

<sup>31</sup> Kur’ani, sura Ihlas, ajeti 1-4.

mbi gjethe? Cili mund të jetë mësuesi i këtij insekti përveç një Pa-rashikuesi të Amshuar?. Shih se ç'thotë Kur'ani: **“...Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar”**.<sup>34</sup> Po atëherë ç'mund të thuhet për njeriun, për rolin dhe pozitën e tij? Pra-ndaj, edhe njeriu ka pozitën e vet në tokë. Pozita e tij është më e larta, më e nderuara, por edhe e përgjegjshmërisë më të madhe. Ai është mëkëmbësi i Zotit në Tokë.

- “Si, njeriu mëkëmbës i Zotit në tokë, s’e kuptoj dot?,- pyeti miku im me habi.

Kjo është e qartë si drita. Libri i Zotit (xh.sh.), Kur'ani famëlartë, na mëson dhe thotë se njeriu është i krijuar për këto arsye:

- **për të qenë halif në tokë**, (El-Bekare, ajeti 30),
- **për të adhuruar Zotin**, (Edh-dharijat, ajeti 56) dhe,
- **për të qenë i sprovuar në jetë**. (El-Insan, ajeti 2)

Ne këtu po mjaftohemi lidhur me pikën e parë dhe, i referohemi ajetit të Kur'anit ku Allahu (xh.sh.) thotë: **“(Përkujto, o Muhammed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj në tokë një halife (krijesë) që do të trashëgohet në zbatimin e porosive të Allahut në tokë!”**”<sup>35</sup>.

Në këtë ajet, Kur'ani hedh dritë mbi ngjarjen më të rëndësishme të historisë, atë të krijimit të njeriut të parë dhe i rolit të tij. Termi “halif” përdoret për identifikimin e dikujt, i cili është administrues, por që vepron në bazë të urdhrave të një autoriteti më të lartë se vetja e tij. Një shpjegim i tillë i këtij termi i referohet raportit të vendosur midis njeriut dhe Zotit. Njeriu është krijesa më e përsosur e Allahut (xh.sh.), të cilit i dha të drejtën e kontrollit dhe administrimit të tokës në emrin e Tij. **“Ai është që ju bëri sundues (zëvendësues) në tokë dhe lartësoi në një shkallë më të lartë disa nga ju mbi të tjerët për t’ju sprovuar në atë që ju dha”**<sup>36</sup>. Meqenëse njeriu u dërgua mëkëmbës i Zotit në tokë, ai u pajis nga Allahu me aftësi të nevojshme intelektuale dhe fizike, me qëllim që të kryejë detyrën e mëkëmbjes në mënyrën më të mirë. Njeriu u dërgua në tokë për të shtrirë paqen kudo në botë. Me

anë të saj do të arrihet lumturia e vërtetë, kënaqësia e pastër dhe paqja e patrazuar që qëndron në njohurinë dhe dashurinë ndaj Zotit. Kur ti e njeh Zotin dhe e do atë, fiton mundësinë e paqes së pafundme. Kështu, Allahu komunikoi me njerëzimin qysh me njeriun e parë të vendosur në faqen e dheut, Ademin (a.s.).

Njeriu nga natyra e tij nuk është keqbërës apo tiran. Ai është një qenie e pajisur me ndjenja të larta, e aftë për virtyt, e dhënë pas përjetësisë. Detyra e parë dhe numër një e çdo njeriu, është të zbulojë dhe të njohë veten, dhe në saje të këtij zhvillimi cilësor, të orientohet kah Zoti i vet.

Ardhja e Ademit në këtë botë, nuk ishte si dënim për mëkatin e tij, por një provë që ai të dalë fitimtar ndaj shejtanit dhe të fitojë sërish xhennetin, vendbanimin e tij të parë. Meqë njeriu është vënë në një sprovë të vështirë, Allahu vendosi të mos e linte atë që të gjente rrugën e drejtë vetëm me ndihmën e arsyes dhe intelektit të tij. Për këtë arsye dërgoi të dërguarit e Tij që t'i dalin në ndihmë njerëzimit drejt njohjes së Krijuesit.

Në botëkuptimin Islam, shfaqja e njeriut në këtë botë ka nisur me Ademin (a.s.). Ai është njeriu i parë, peygamberi i parë dhe prijësi i parë i përkryer, por nuk ka dyshim se ai ishte njeri i qytetëruar. Në tokë ai mori premtimin e udhëzimit hyjnor dhe u siguroi se, ata që do të ndiqnin këtë udhëzim do të meritonin mëshirën e Allahut të Lartësuar: **“Kush i përmbahet udhëzimit Tim nuk ka për të humbur as nuk ka për të qenë fatkeq. Dhe kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Gjykimit do ta ringjallë të verbër.”**<sup>37</sup>

Ekzistenca e njeriut në tokë fillon me vetëdijen e një misioni dhe jo me një endje të kotë nëpër errësirë. Idealja atij iu prezantua nëpërmjet shpalljeve hyjnore. Engjëjt nuk e kundërshtuan vendimin e Zotit për caktimin e Ademit si zëvendës, por dëshiruan të mësojnë edhe më shumë për aftësitë e njeriut, krijesë fizike e materiale, që sipas natyrës së vet është e gatshme të bëjë edhe çrregullime në tokë.

<sup>34</sup> Kur'ani, sura Ta Ha, ajeti 50.

<sup>35</sup> Kur'ani, sura Bekare, ajeti 30.

<sup>36</sup> Kur'ani, sura El-Enam, ajeti 165.

<sup>37</sup> Kur'ani, sura Ta Ha, ajeti 123-124.

Islami e shpall dhe e ngrë lart fisnikërinë e njeriut. Ai e ka vendosur njeriun në pozitën e mëkëmbësit të Zotit në sipërfaqe të tokës, me qëllim që ai të njohë ekzistencën e Tij, ta adhurojë, t'i bindet, dhe të fitojë mëshirën dhe kënaqësinë e Tij. Krijuesi i Gjithësisë njeriun e ka veçuar në raport me krijesat e tjera, duke nënshtruar çdo gjë për të mirën e Tij.<sup>38</sup> ***“A nuk e shihni ju se si Allahu ju ka bërë të munduar t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme? E megjithatë, disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyesi dhe pa libër ndriçues”.***<sup>39</sup>

Allahu (xh.sh.), bëri aq shumë mëshirë ndaj krijesave të Veta, sa që nuk la popull pa ndonjë peygamber, ose pa njeri të zgjedhur, i cili ndihmoi orientimin për në rrugën e drejtë.<sup>40</sup> Madje duhet të kuptojmë se Islami e konsideron njerëzimin si një familje të madhe, të cilën Zoti e krijoi prej një shpirti në shumë ngjyra dhe gjuhë, si shenjë e plotfuqishmërisë së Tij. Këtu e ka rrënjën nderimi dhe respekti për njeriun si krijesë e Zotit, i cili duhet ta njohë atë si Krijues të tij dhe të njohë detyrimet që ka ndaj Tij. ***“O ju njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdhijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë”.***<sup>41</sup> Prandaj, njerëzit janë të barabartë. Para Tij nuk ka privilegj i bardhi ndaj të ziut dhe anasjelltas, më i miri tek Ai është më i ruajturi.

Kur'ani është pasqyrimi i vërtetë i fjalës së Allahut, ku del qartë se qëllimi i qenësishëm për të cilën është krijuar njeriu, është adhurimi i Zotit. Duke adhuruar dhe madhëruar Zotin, njeriu zgjedh të jetë në harmoni me krijesat e tjera, të cilat prej natyre-vetveti e madhërojnë Krijuesin e tyre. Adhurimi i Zotit dhe nënshtrimi ndaj ligjit hyjnor sigurojnë suksesin në këtë botë dhe hapin dyert për lumturi në botën tjetër.

<sup>38</sup> Gjërësisht: Mustafa Tahan, Aftësimi edukativ Islam, f.143, SHB “Furkan ISM”, Shkup 1424/2003.

<sup>39</sup> Kur'ani, sura Lukman, ajeti 20.

<sup>40</sup> shih, Dr. Jusuf Kardavi, Veçoritë e përgjithshme të Islamit, f. 64-65, Prishtinë 2002.

<sup>41</sup> Kur'ani, sura El-Huxhurat, ajeti 13.

Përveç rolit të mëkëmbjes dhe adhurimit të vërtetë ndaj Krijuesit, njeriu erdhi për të shpërndarë mbi sipërfaqen e tokës vlerat e tij të larta morale me të cilat ishte obliguar. Sjellja që duhet të ketë njeriu, është ajo brenda kufijve që cakton Kur'ani i shenjtë, i cili është kodi Hyjnor për të orientuar njeriun drejt lumturisë së të dy jetëve. Jeta e njeriut në këtë botë mund të jetë e ëmbël ose e hidhur, e lumtur ose e mjerueshme. Të gjitha veprimet e njeriut, që i drejtohen kësaj jete, kanë për t'u shpërblyer në këtë jetë, ndërsa veprat që bën njeriu për hir të Krijuesit do të shpërblehen në jetën e pasosur. Faktin që vetëm ata që do të dalin para Allahut me zemër të paqësuar, me një zemër të pastruar prej të gjitha sëmundjeve moralo-shpirtërore dhe të mbushura plot me dashurinë hyjnore, me vepra të bëra vetëm në emër të Tij, kanë për të shpëtuar, Allahu e bën të ditur kështu: ***“Atë ditë nuk do të bëjnë dobi as malli, as fëmijët. Me përjashtim të atyre që vijnë me zemër të paqësuar”***<sup>42</sup>, dhe në një vend tjetër thuhet: ***“Pasuria dhe djetmë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës (për shpëtim)”***<sup>43</sup>.

Nuk di a isha i qartë, miku im, por një gjë të ma kuptosh: dëshira ime ka qenë të të them se ti ke rol në këtë jetë dhe mision të caktuar nga Zoti dhe, për këtë duhet të mburresh.

- “Hoxhë, për mua gjithçka vonë”, - dhe duke gërryer fytyrën vazhdoi, - “shkoi e shumta, mbeti e pakta, unë tashmë jam plakur. Ç'dobi mund të kem nga ajo pak...?”<sup>44</sup>

- Gabim e ke, ia preva fjalën, duke mos e lënë të thoshte atë që donte të thoshte, sepse e mora vesh se ku do dilte. Kjo nuk është arsye që thua ti, miku im, sepse kurrë s'është vonë, nëse synon të bësh diçka. Një dijetar ka thënë: “Të mendosh për të kaluarën, të jetosh me të dhe të dëshpërohesh me të këqijat e saj është çmenduri dhe vrasje e dëshirës për jetën e tashme. Te të mençurit fletët e së kaluarës shuhën dhe nuk transmetohen që të përsëriten. Ato mbyllën njëherë e përgji-

<sup>42</sup> Kur'ani, sura Esh-Shuara, ajeti 88-89.

<sup>43</sup> Kur'ani, sura El-Kehf, ajeti 46.

<sup>44</sup> Aid el-Karni, La tahzen, f. 16-17, Gostivar, 1426/2005.

thmonë në burgun e harresës, duke u lidhur e shtrënguar fortë që të mos dalin kurrë më. Nëse kujtohesh, kjo s'të jep gjë veç lodhjes e sëmundjes psikike, ndaj mos e bëj këtë, se nuk rrjedh dritë nga këto kujtime vrastare... A mund të kthesh lumin në rrjedhën nga doli e rrodhi?! Po diellin mbasi lindi?! Po a mund ta rikthesh fëmijën në mitrën e së ëmës?! Po qumështin a mund ta kthesh në gjoksin e së ëmës ku ishte?! Po lotin në sy a mund ta kthesh pasi që u derdh?! Jo, kurrë...? Ajo që doli u bë dhe shkoi, kaloi...më nuk kthehet...Për këtë arsye mos jeto më me të kaluarën e të verbohesh...Ta bësh këtë do të thotë ta humbasësh të tashmen dhe ta shuash vullnetin. Ai që e do të kaluarën dhe i kthehet asaj është porsi ai që e bluan miellin që në fakt është i bluar, apo si ai që e sharron tallashin e drurit. Në të vërtetë gabimi ynë më i madh është se harrojmë të tashmen dhe angazhohemi me të kaluarën... E sheh se njerëzit nuk shkojnë pas dhe as që kthehen të vështrojnë gjurmët që lanë prapa?! Ndaj, as ti mos shko kundër rregullit të jetës... Kjo është dita jote...Jeta jote është një ditë e vetme, në mëngjes ngjalleh dhe në mbrëmje vdes, dhe nuk kthehesh më. Pra, mos e humb këtë ditë që peshon sa jeta, bëhu i kujdesshëm brenda këtyre orëve të kufizuara dhe vepra me seriozitet, adhuroje Krijuesin..."<sup>45</sup>. Ty të duhet të bësh vetëm një hap, miku im. Dhe ky hap nuk është i lehtë për t'u bërë. Ai kërkon një shpëputje totale me të kaluarën. Asgjë më pak! Shpresoj se do të jesh në gjendje t'i thuash "mjaft" të kaluarës dhe të kthehesh kah Zoti. Je i kompletuar me trup, me zemër dhe me mend kur ta përkujtoshe Allahun (xh.sh.) e të qëndrosh para Tij. Peshoi veprat tua dhe vështro se cila anë të rëndon më tepër, krijo moral të lartë për veten tënde dhe pajtohu me atë që Allahu caktoi për ty. Përpiku të bësh mirë për të tjerët, se vetëm sot je i gjallë, pra shfrytëzoje rastin e fundit...! Nga orët e kësaj dite vepra mirë dhe nxirr dobi për veten tënde sikur të ishin vite, dhe nga minutat e orëve të saj kërkoi falje Allahut (xh.sh.) për mëkatet e tua..."<sup>46</sup>. Të lavdërosh Atë, që i dha qëllim jetës së njeriut dhe ju jep mundësi që

tani e tutje ta nderoni Atë në fjalë, mendime e vepra. Të praktikosh moralin e Kur'anit, njeriut i duhet një punë mjaft e vështirë, sepse kërkohet prej atij një luftë e rreptë ndaj ambicieve negative. Dhe për të pasur sukses, krahas të gjitha punëve tjera të mira, të nevojitet pendimi dhe pendesa për të ndryshuar hapin që çon drejt greminës. Pendimi dhe pendesa janë përpjekje për ta shtyrë njeriun drejt spirales që e lartëson te Zoti. Pendesa është vetë ripërtëritja e njeriut dhe një meremetim i brendshëm. Pra, pendesa është me qëllim për ta rivënë në rregull ekuilibrin shpirtëror të prishur prej mendimeve e sjelljeve devijuese. Pendimi dhe pendesa janë të nevojshme jo vetëm për ty, për mua, por për të gjithë. Lidhur me këtë, Kur'ani u drejtohet besimtarëve kështu: ***"O ju besimtarë! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, që Zoti juaj t'ju shlyejë gabimet..."***<sup>47</sup>.

Pendesa është një lloj strehimi te bujaria e Zotit prej ndëshkimit të Tij, te mëshira dhe favori i Tij prej llogarikërkesës së Tij! Pendesën është e mundur ta karakterizojmë edhe si një larje hesapësh në vetvete mbështetur në ndjenjën e mëkatimit. Nëse mëkati është humbja e ekuilibrit dhe, si rrjedhojë, rrëzimi në një humnerë, pendesa është, sipas mënyrës së saj, kërcim dhe dalje jashtë që atje. E thënë ndryshe, nëse mëkati është plaga e marrë nga shpirti për shkak të një mungese syçelësie të vetëdijes, pendesa është rifuqim i syçelësisë, i vetëkontrollit dhe i ndjenjave.<sup>48</sup> Përkundër veprimit gërryes e shkatërrues të erozionit të mëkatit, pendesa është mbjellja dhe gjelbërimi i shtratit të ndjesive dhe parandalimi i erozionit. Sikur të ishim të aftë ta bënim pendesën në atë nivel që të mbyllte çarjen e hapur prej çdo mëkati! Pendimi (teube) është, pas hutimit dhe daljes nga ruga, rikthim dhe gjetje e vetvetes. Muhammedi (a.s.) e përshkruan kështu këtë kthim: "Allahu mbetet i kënaqur prej pendesës së robit. Mendoni: një njeri udhëton në shkretëtirë. Devoja mbi të cilën janë të ngarkuara plaçkat, ushqimet dhe uji i tij, e lë dhe ikën. Njeriu vrapon majtas e djathtas duke e kërkuar, por s'e gjen dot. I rënë trupërisht e shpirtërisht, bie nën hijen e një peme dhe e zë gjumi. Kur i hap sytë, ç'të shohë? De-

<sup>45</sup> Po aty, f. 18.

<sup>46</sup> Po aty, f. 19.

<sup>47</sup> Kur'ani, sura Tahrim, ajeti 8.

<sup>48</sup> Shih: Ibn Kajjim el-Xhevzij, Na putu kah Allahu, f.229, Sarajevë, 2005.

veja e tij me gjithë sendet, ushqimet dhe ujin po i qëndron mbi kokë. Aq shumë turbullohet njeriu nga gëzimi, saqë, duke e falënderuar Zotin, i thotë Atij: “Unë jam zoti Yt e Ti je robi im!” Ja, par, gëzimi i Zotit për robin që është penduar, është më i madh se i atij njeriu!”<sup>49</sup>.

- “Do të thotë, pendimi sjell gëzimin dhe kënaqësinë e Zotit?”,- ndërhyri miku im.

- Pa dyshim. Por, kënaqësia e Zotit nuk është cilësisht si ajo e njeriut. Ajo është diçka krejt tjetër, është kënaqësi e shenjtë, hyjnore, e pakonceptueshme prej nesh. Rëndësi për ne ka vetëm të dimë se Zotin e kënaq shumë pendesa e njeriut, gjë që rrjedh prej mëshirës së Tij. Kur njeriu pendohet me një pendesë serioze, kur ai nis të ndjejë në ndërgjegje peshën e fajit të kryer, ndjenja e virtytit në qenien e tij të brendshme zgjohet dhe zemra, e përfshirë nga një pendim (teve) të thellë, e djegur, e përbotur, ngre duart kah Zoti, me lutje për falje, pas pendimit, duke u përpjekur të qëndrosh brenda kuadrit të mësimave Islame dhe orientimeve të të Dërguarit, ndërkaq, kjo është me të cilën Allahu (xh.sh.) kënaqet me këtë lloj pendimi dhe pendese të robit të Vet. Sepse Ai është zotërues i atributëve “mëshirues” dhe “bamiër”. Dhembshuria dhe mëshira e Allahut ndaj robërve të Vet është, pa dyshim, më e madhe se ajo e nënës për të voglin e saj.<sup>50</sup>

Miku im, shfrytëzoje kohën për të gëzuar Allahun. Kthehu në mësimet e fesë dhe dije se funksioni i saj është t’i marrë njerëzit për dore që të mos dalin kurrë nga udha. Dije, gjithashtu, se feja vihet në jetë me anë të njerëzve që janë në udhën e saj e që i këshillojnë edhe të tjerët dhe i ndihmojnë të ecin në atë udhë.

Ora iku, miku im, shpresoj të më kishe mirëkuptuar.

- “E po, mos dëshironi tani të ikni?

- Patjetër më duhet, ja, edhe koha e namazit të pasdites.

- U ngrit dhe më shoqëroi deri te dera duke më thënë: - “Hoxhë, shihemi”. - Këto ishin fjalët kur u ndamë. Fytyra e tij m’u duk këtë radhë më e gëzuar se nga ajo fytyrë kur u takuam. Ndryshimi i fytyrës së tij ishte një pretekst...më ngjalli ndjenjën e shpresës...!

Avni Aliu

## PLAN YOUR LIFE – EVEN FOR THE PERIOD AFTER DEATH

### (Summary)

While preparing for Friday’s lecture, the phone rang. I lifted the handle. It was a friend of mine who invited me to visit him. I told him I would be glad to do so. While putting down the phone, I threw a look at the book in my hands, respectively at the word “La ilahe il-lall-llah”. Its rays dispense the fog and the darkness of sins. These words carry light.

عوني علي

## خطط حياتك حتى للمرحلة ما بعد القبر

### (خلاصة البحث)

بينما كنت استعد لخطبة الجمعة رن جرس الهاتف. رفعت السماعة فاذا بناجني صوت صديق لي طلب مني أن أقوم بالزيارة في بيته. اجبت عليه باختصار مديد: نعم، بكل سرور" و قبل ان ارد السماعة إلى مكانها نظرت إلى الكتاب الذي كان بين يدي و بالتحديد إلى كلمة: "لا اله الا الله" اشعتها التي ترفع عن الانسان الضباب الذي قد يرتفع امامه من حين إلى آخر. و قلت بنفسى ان لهذه الكلمات قوة السحر في رفع معنويات الانسان بقدره الله سبحانه و تعالى.

<sup>49</sup> Hadith, transmeton Buhariu dhe Muslimi.

<sup>50</sup> Shih: Osman Nuri Topbash, Vargu i profetëve në dritën e Kur’anit 1. f.77, Stamboll 2001.



ESE

*Tajib Salih - (Sudan)***Koha e shpërnguljes në veri - (5)****-7-**

E festuam synetinë e dy djemve. Unë u ktheva në Hartum. Gruan dhe vajzën time i lashë në fshat. Udhëtova rrugës së shkretëtirës me një makinë të projektit të cilin e kishte përmendur Mahxhubi. Zakonisht udhëtoja me anije deri në portin e lumit në Kerime. Prej andej merrja trenin duke kaluar nëpër Abu Hamed dhe Atbara deri në Hartum. Mirëpo, kësaj radhe po nxitoja, gjë që edhe për mua nuk ishte e qartë sa duhet, andaj preferova ta shkurtoja rrugën.

Kamioni u nis herët në mëngjes në drejtim të lindjes paralel me rrjedhën e lumit Nil. Udhëtuam afro dy orë. Pastaj, mori drejtimin e jugut, në një transversale të drejtë, duke depërtuar thellë në shkretëtirë. Nuk kishte kurrfarë shpëtimi nga dielli, i cili po ngjitej lart në qiell me hapa të ngadalshëm. Ai po i drejtonte rrezet e tij në tokë sikur në mes tij dhe banorëve të tokës të kishte një hakmarrje të vjetër. Nuk kishte shpëtim, përveç hijes së nxehtë në brendi të makinës, por ajo nuk ishte hije. Një rrugë monotone me kodra dhe lugina, nuk mund të shihje asgjë që të kënaqë syrin. Disa drunj tek-tuk nëpër shkretëtirë, me plot thera, pa asnjë gjethë, drunj të varfër që nuk janë të gjallë e as të vdekur. Makina ecën me orë të tëra duke mos takuar njeri apo shtazë.

Pastaj kalojmë pranë një grumbulli devesh të lodhura e të dobëta. Nuk sheh asnjë re që mund të japë shpresë për shi në këtë qiell të nxehtë, sikur ai të ishte një mbulesë xhehenemi. Sot, në këtë vend, asnjë send nuk ka vlerë, përveç një dënim me të cilin ndëshkohet qenia e gjallë duke e pritur natën. Nata është shpëtim. Në këtë nxehtësi aq të madhe në kokën time m'u sollën disa mendime, disa fjalë në fjali, pamje të disa fytyrave dhe zërave, të cilët vijnë varfër sikur shtrëngatat e vogla që të ngrihen në ara të papunuara. Për çka kjo nguti? Më pyeti ajo: "Përse nguti?" Më tha: "Përse nuk po rri edhe një javë?" Më tha .. Gomarja e zezë. Një beduin e ka mashtruar xhaxhanë tënd dhe ia ka shitur gomaren e zezë. Kurse babai im ma ktheu: "A është kjo diç që të bën të hidhërohesh?" Mendja e njeriut nuk ruhet në frigorifer. Ajo është si ky diell që nuk mund të bartet. Të shkrin trurin dhe të paralizon të menduarit. Mustafa Seidi, fytyra e tij më paraqitet e qartë në imagjinatën time ashtu siç e pashë ditën e parë, pastaj humbet nga ushtrimi e motorit të makinës si dhe nga lëvizjet e gurëve të shkretëtirës. Përpiqem ta rikthej pamjen e tij përsëri, por nuk mundem.

Ditën e synetisë Hasna nuk e kishte vënë shaminë në kokë, ashtu siç vepronte zakonisht. Ajo vallëzoi ashtu siç bën çdo nënë kur feston për synetinë e të bijve. Ja çfarë gruaje dukej ajo. Përse ti nuk martohesh me të? Ashtu si i lutej atij Izabela Simor? "Më vra mua, o përbindësh afrikan. Më digj mua në zjarrin e tempullit tënd, o ti zot i zi. Më lejo mua të përpëlitem në ceremoninë e lutjes sate dhe ja këtu është burimi i zjarrit. Ja ky është tempulli. Nuk ka asgjë. Dielli, shkretëtira, bimët e thara dhe shtazët e dobëta. Makina dridhet kur ajo hyn në një luginë të vogël. Kur ajo kalon mbi eshtrat e disa deveve që kanë ngrordhur për shkak të etjes në këtë shkretëtirë. Në imagjinatën time kthehet pamja e Mustafa Seidit nëpërmjet birit të tij të madh. Ai i përngjan më së shumti atij.

Ditën e synetisë unë dhe Mahxhubi pimë më shumë sesa duhej. Njerëzit, në vendin tonë, për shkak të modestisë së jetës, për çdo rast gëzimi, sado i vogël të jetë ai, marrin shkas dhe organizojnë manifestime sikur për një dasmë. Gjatë natës e kapa përdore, kur këngëtarët po këndonin e burrat po duartrokitnin mes shtëpisë. Qëndruam para

derës së dhomës dhe i thashë: “Unë jam i vetmi që kam çelësin e kësaj dhome. Dera ishte prej hekuri “. Mahxhubi ma ktheu me zërin e tij të pirë. “A e di se çka ka brenda?” Ia ktheva: “Po”. Më tha: “Çka ka?” I thashë duke qeshur nën ndikimin e alkoolit: “Asgjë, asgjë përfundimisht”. Kjo dhomë është një shaka e madhe. Mahxhubi ma ktheu: “Ti je i pirë. Kjo dhomë është përplot nga toka e deri në tavan me thesar. Ar, diamante e margaritarë. A e di se kush ishte Mustafa Seidi? Ia ktheva: Mustafa Seidi ishte një gënjeshtër. Qesha edhe një herë me një qeshje nën ndikimin e alkoolit dhe i thashë: “A dëshiron ta dish të vërtetën e Mustafa Seidit?” Mahxhubi ma ktheu: “Ti nuk je i pirë, por ti je i marrë. Mustafa Seidi në realitet është peygamberi i Allahut Hidr. Paraqitet befasisht dhe tretet befasisht. Thesari që gjendet në këtë dhomë është thesari i mbretit Sulejman, të cilin e kanë bartur xhinët këtu. Ti je ai që e ke çelësin e këtij thesari. Hape, o “simsim” (bukurosh) dhe na lër ne t’ua shpërndajmë arin dhe diamantet njerëzve”. Për pak Mahxhubi sa nuk bërtiti me zërin e tij më të lartë sikur të mos ia mbyllja gojën me dorën time.

Në mëngjes, secili prej nesh u zgjua në shtëpinë e vet dhe nuk e dimë si arritëm aty. Rruga nuk ka të mbaruar, dielli nuk lodhet. Nuk është për t’u habitur, sepse Mustafa Seidi iku tek acari i veriut. Izabel Simor i kishte thënë atij: “Të krishterët thonë se Zoti i tyre është gozhduar për ta bartur peshën e mëkateve të tyre. Ai atëherë paska vdekur kot. Atë që ata e quajnë mëkat, ajo nuk është tjetër vetëm psherëtimë për të përqaftuar ty o zot i paganizmit tim. Ti je Zoti im dhe nuk ka zot tjetër përveç teje.” Me siguri kjo ishte shkak i vetëvrastjes së saj, jo sëmundja e saj me kancer. Ishte besimtare kur jam takuar me të. Pastaj ia ktheu shpinën fesë së saj dhe adhuroi një zot ashtu siç besuan izraelitët viçit. Çfarë çudie. Çfarë ironie. Njeriun, vetëm për faktin është lindur në vijën e Ekuadorit, disa të marrë e konsiderojnë rob e disa të tjerë e konsiderojnë zot. Ku është arsyeja? Ku është matura? Gjyshi im me zërin e tij të dobësuar dhe qeshjen e tij djallëzore kur është në gjendje të mirë, ku është pozita e tij në këtë qilin ahmedian? A është ai në të vërtetë ashtu si mendoj unë? A është ai mbi këtë kaos? Nuk e di. Por, ai mbeti në këtë gjendje, me gjithë së-

mundjet, pushtetin e korruptuar dhe vrazhdësinë e natyrës. Unë jam thellë i bindur se kur t’i paraqitet vdekja, ai do të buzëqeshë para saj. A nuk mjafton kjo? A kërkohet prej njeriut më shumë se kjo? Pas një kodre na u paraqit një beduin duke vrapuar në drejtim tonin. Doli në rrugë para makinës dhe ne u ndalëm. Trupi dhe rrobat e tij kishin ngjyrë të dheut. Shoferi e pyeti se çka kërkonte? Ai ia ktheu: “Ma jepni një cigare për hir të Allahut. Ka dy ditë që nuk kam pirë asnjë cigare.” Ia dhashë një cigare. Vendosëm që të pushojmë pak nga lodhja e udhëtimit. Nuk kam parë në jetën time njeri ta pinte duhanin me aq lezet. Beduini u ul dhe nisi ta pinte cigaren me një grykësi që nuk mund të përshkruhet. Pas dy minutave ma zgjati dorën dhe ia dhashë edhe një cigare tjetër. E “hëngri” edhe këtë, ashtu siç kishte vepruar me të parën. Pastaj, nisi të përpëlitej sikur të ishte i goditur nga epilepsia. U shtri në tokë, kapi kokën me dorën e tij dhe u qetësua sikur të ishte i vdekur. Vazhdoi kështu gjatë tërë kohës së qëndrimit tonë, afër një çerek ore. Kur u ndez motori i makinës, u ngrit në këmbë. Njeri i ringjallur përsëri në jetë, nisi ta falënderonte Zotin dhe të lutej për mua për jetë të gjatë. Ia hodha kutinë e cigareve me ato që kishin mbetur në të. U ngrit pluhuri pas neve. Vërejtja beduinit duke vrapuar në drejtim të disa tendave të leckosura te disa drunj në jug. Aty ishin disa dele dhe fëmijë lakuriq. Ku është hija, o Zot i im? Sikur kjo tokë nuk rrit vetëm peygamberë. Këtë thatësi nuk mund ta shërojë vetëm qielli. Rruga nuk ka fund dhe dielli nuk mëshiron. Makina filloi të lëshonte zhurmë nga gurët e shkretëtirës. “Ne jemi popull i vuajtur, andaj na flitni fjalë që na japin shpresë”. Kush e ka thënë këtë? Pastaj: “Sikur fidanishtja që as tokën nuk e ka prerë e as shpinën nuk e ka mbajtur”. Shoferi nuk flet. Makinën të cilën e drejton nganjëherë e mallkon e nganjëherë e shan. Toka rreth nesh shihet e mbytur në vegim. “Nganjëherë na ngritte lart e nganjëherë na ulte dhe mbaheshim dorë për dorë”. Muhamed Seid Abas, çfarë poeti. Ebu Nevas. “Pimë pijen e një populli që ishin të etur nga koha e Adit”.

Kjo është tokë e pesimizmit dhe e poezisë ku askush nuk këndon. Takuam një makinë shtetërore të prishur rreth së cilës ishin pesë ushtarë dhe një rreshter të armatosur me pushkë. U ndalëm. Pinë nga uji

ynë, hëngrën nga ushqimi ynë, u dhamë edhe benzinë. Na thanë se një grua nga fisi Al-Murajsat e kishte mbytur burrin e saj dhe qeveria shkante ta arrestonte atë. Cili është emri i saj? Cili është emri i tij? Përse e ka mbytur atë? Nuk e di - vetëm atë, se ajo është nga Al-Murajsat, se ajo e ka mbytur dhe se ai është burri i saj. Mirëpo, ata do ta njohin atë. Fiset Al-Murajsat, Al-Havavir dhe Al-Kababish. Gjykatësit disa janë rezidentë e disa janë lëvizës. Inspektori në veri të Kurdufanit, inspektor në veri-jug, inspektor në lindje të Hartumit. Barinjte janë në burimet e ujit. Paria dhe mbikëqyrësit. Beduinët në tenda të poezisë, në lugina të ndryshme, të gjithë ata duhet ta dinë emrin e saj. Sepse nuk ndodh që për çdo ditë ta mbysë femra mashkullin, apo burrin e saj, në këtë tokë ku dielli nuk mund të lërë vend për mbytësin. Papritmas më erdhi një ide, të cilën e shtjellova në kokën time. Vendoja ta shprehja dhe ta shihja se çka po ndodhte. U thashë atyre se ajo nuk e ka mbytur atë, por ai ka vdekur nga rrezet e diellit, ashtu siç kanë vdekur Izeabela Simor, Shila Grinod, An Hamend dhe Xhin Moris e nuk ka ndodhur asgjë. Rreshteri ia priti: “Ka qenë te ne një komandant i mallkuar i policisë që quhej Mejxher Kok”. Nga e tërë kjo nuk ka farë dobie. Nuk ka asgjë për t’u habitur. Ata u nisën, u nisëm edhe ne. Dielli është armik. Ai tani gjendet në zenitin e qiellit, ashtu siç thonë arabët. Kështu do të mbetet për orë të tëra pa lëvizur, apo kështu i duket çdo krijese të gjallë, derisa të zbutet edhe guri, të qajë druri, e të kërkojë ndihmë hekuri.

Rrotat e makinës rëndojnë mbi rërën e shkretëtirës me urrejtje. Rruga me leqe mund të çojë në katastrofë. Në të shumtën e rasteve katastrofa para tij është e qartë sikur dielli. Ne habitemi se si një njeri i mençur sikur ky, ndërkohë ai është kulmi i marrëzisë. Atij i është dhënë një mençuri, por nuk ka urtësi. Ai është budalla i zgjuar. Kështu ka thënë gjykatësi në “Alvad Beli” para se ta shqiptonte vendimin. Rruga nuk ka të mbaruar, kurse dielli është i qartë si dielli. Do t’i shkruaj zonjës Robinson. Jeton në Qanklin në Ajl of Wajt. Adresa e saj ka mbetur në kokën time nga biseda me Mustafa Seidin atë natë. Burri i saj ka vdekur në Paltifod dhe është varrosur në Kajro në varrezat e Imam Shafiut. Po kishte kaluar në islam. Mustafa Seidi trego-

nte se ajo kishte marrë pjesë në gjykim prej fillimit e deri në mbarim. Ishte e qetë gjatë tërë kohës. Pas shqiptimit të vendimit qau në kraharorin e saj. Ia ledhatoi kokën e puthi në ballë dhe tha: “Mos qaj, o fëmija im i dashur.” Nuk e ke dashur Xhin Morisin. Ta kam tërhequr vërejtjen prej martesës me të. Do t’i shkruaj asaj dhe ndoshta ajo do ta pranojë dritën, ndoshta asaj do t’i kujtohen gjërat, të cilat ai i ka harruar, apo nuk ka dashur t’i përmendë. Lufta mbaroi shumë shpejt me fitore. Perëndimi i diellit nuk është gjak, por ai është në këmbët e gruas. Era, e cila na përcjell neve në luginën e Nilit bart me vete parfum, të cilin nuk do ta harroj derisa të jem gjallë. Ashtu si ndalet karvani për të pushuar, u ndalëm edhe na. Ka mbetur edhe një pjesë e vogël e rrugës. Hëngrëm dhe pimë. Disa njerëz falën namazin e jasisë. Shoferi dhe ndihmësit e tij nxorën nga sënduku i makinës shishet e rakisë. Unë isha shtrirë në shpinë në rërë. Kisha ndezur një cigare dhe isha tretur në bukurinë e qiellit. Makina po ashtu u mbush me ujë, benzinë dhe vaj. Ajo tani ishte e qetë e kënaqur si një mace në shtratin e saj.

Lufta mbaroi me fitoren tonë të përbashkët: gurët, drunjte, shtazët dhe hekuri. Unë jam tani nën këtë qiell të bukur, të mëshirshëm, ndiej se të gjithë ne jemi vëllezër. Ai që pi, ai që falet, ai që vjedh, ai që bën kurvëri, ai që mbrohet dhe ai që vret. Burimi është i njëjtë. Askush nuk e di se çka mendon Zoti. Ndoshta Ai nuk bëhet merak. Ndoshta, Ai nuk është i hidhëruar. Në një natë të këtillë t’i ndjen se mund të ngjitesh në qiell në shkallë prej litari. Kjo është tokë e poezisë, vajza ime quhet Amal (Shpresë). Do ta rrënojmë, do ta ndërtojmë do t’ia nënshtrojmë vetë diellin vullnetit tonë dhe do ta mundim varfërinë me çfarëdo mjeti. Shoferi, i cili tërë ditën nuk foli asnjë fjalë, ja tani e ka hapur gojën me këngë. Një zë i ëmbël melodik, mendon se nuk është zëri i tij, i këndon makinës së tij, ashtu siç u këndonin poetët në kohërat e vjetra deveve të tyre.

Derisa ne ishim kështu, të gjitha makinat që shkonin apo vinin, ndaleshin, aq sa u bë një karvan i madh. Më shumë se njëqind njerëz hëngrën dhe pinë, u falën dhe u pinë. Pastaj formuam një rreth të gjatë erdhën disa të rinj në mes të rrethit dhe nisën të vallëzonin ashtu siç vallëzojnë vajzat. Duartrokitëm dhe e shqelmuam tokën me këmbë, në

mes të shkretëtirës bëjnë një gazmend për asgjë. Dikush e solli një radio-transistor, të cilin e vendosëm në mes të rrethit, duartrokitëm dhe vallëzuam nga këngët e tij.

Dikujt i erdhi ideja dhe shoferët i radhitën makinat e tyre në formë rrethi dhe i drejtuan dritat në mes të valltarëve, nga e cila u bë një ndriçim aq i madh sa që nuk e di se mund të ketë pasur në atë vend ndonjë ndriçim të tillë. Burrat kënduan ashtu siç këndojnë gratë në raste gëzimi, boritë e makinave u lëshuan në të njëjtën kohë. Drita e madhe bëri që aty të vijnë beduinët nga të gjitha anët e luginave dhe kodrave të afërta. Burra e gra, njerëz të cilët nuk mund t'i shohësh gjatë ditës, thua se treten nën rrezet e diellit. U tubua një numër i madh i njerëzve dhe në rreth hynë edhe gra të vërteta po t'i shihje ato ditën nuk do ta ktheje kokën për t'i shikuar. Mirëpo, ato janë të bukura për këtë vend dhe për këtë kohë.

Erdhi një beduin me një dash, e preu dhe poqi mishin e tij në zjarrin që e ndezi vetë. Njëri prej udhëtarëve nxori dy pako me birra, të cilat i shpërndau duke bërë titur: "Gëzuar për Sudanin, gëzuar për Sudanin!" Pastaj u shpërndanë pakot me cigare dhe ëmbëlsira. Beduinët këndonin dhe vallëzonin. Nata dhe shkretëtira reflektonin jehonën e një dasme të madhe, sikur ne të ishim fis i xhinëve. Dasmë pa kuptim, vetëm një veprim i kotë, që improvizohet si uragan i vogël që vjen nga shkretëtira dhe pastaj vdes.

Në mëngjes u shpërndamë, beduinët u kthyen prapë në luginat e tyre. Njerëzit bërëtitën: "Mirupafshim, Mirupafshim". Secili shkoi te makina e vet. U ndezën motorët dhe u kthyen dritat, nga një vend, i cili deri pak më parë ishte teatër shoqërimi dhe miqësie, u kthye në gjendjen e tij të mëparshme, pjesë e shkretëtirës. Dritat e makinave u kthyen disa kah jugu në drejtim të Nilit dhe disa të tjera kah veriu, në drejtim të Nilit. U ngrit pluhuri, pastaj humbi. U ngrit dhe humbi përsëri. Dielli na zuri në majë të maleve Kereri mbi Omdurman.

## -8-

Anija u soll rreth vetes që motorët të mos jenë në drejtim të rrjedhës. Çdo herë ndodhte diçka. Fishkëllima e vrazhdë, barkat nga ana e kundërt e bregut, druri panjë dhe zhurmë në trotuar të stacionit. Me një dallim të madh. Dola, më përshëndeti Mahxhubi, por duke iu shmangur shikimit tim. Ishte vetëm kësaj radhe në pritjen time. Ishte i turpëruar. Sikur ndihej i fajësuar, apo sikur mbi mua hidhte përgjegjësinë. Posa e përshëndeta i thashë: "Si lejuat të ndodhë kjo?" Ai u përgjigj, derisa ishte duke rregulluar samarin e gomares së zezë e të gjatë, gomares së xhaxhait tim Abdul Kerimit: "Ajo ka ndodhur. Dy djemtë janë mirë, ata janë tek unë". Unë nuk kisha menduar për dy djemtë gjatë tërë këtij udhëtimi fatkeq. Mendoja për të. Iu ktheva Mahxhubit përsëri: "Çka ka ndodhur?" Ai ende po shmangej shikimit tim. Vazhdoi i heshtur. Rregulloi gëzofin mbi samar dhe e lidhi rripin rreth barkut të gomarit të tij. Tërhoqi samarin përpara pak, kapi frenin e pastaj kërceu. Vazhdova të qëndroja në këmbë duke pritur përgjigjen që nuk ma kthente, atëherë kërceva edhe unë. Teksa po mëshonte gomarit të tij më tha: "Ashtu siç të kam njoftuar në telegram. Nuk ka nevojë të flasim për këtë temë. Nuk e kemi pritur ardhjen tënde në asnjë mënyrë". Ia ktheva duke e nxitur që të fliste. "Ah sikur të veproja sipas këshillës sate dhe të isha martuar me të". Nuk pata asnjë dobi, përveç që ai u thellua në heshtje. Me siguri ai ishte i hidhëruar. I dha gomarit me thembrën e tij një të rënë të fuqishme, ndërkohë gomari nuk kishte bërë asgjë. I thashë atij dhe unë e ndoqa atë, por assesi nuk mund ta mbërrija: "Prej momentit që kam marrë telegramin tënd nuk kam ngrënë, nuk kam pirë dhe nuk kam folur me njeri. Tri ditë prej Hartumit me tren, me anije, unë mendoj dhe e pyes veten si ka ndodhur ajo që ka ndodhur dhe nuk gjej përgjigje".

Si duket i erdhi keq për gjendjen time më tha me dhembshuri: "Kjo është hera e parë që shumë shpejt je kthyer në fshat". Ia ktheva: Po. Kanë kaluar tamam tridhjetedy ditë". Më pyeti "A ka diçka të re në Hartum?" Ia ktheva: "Ishim të angazhuar me kongresin". U duk një

interesim në fytyrën e tij. Ai dëshiron t'i dëgjojë lajmet e Hartumit, në veçanti lajmet që kanë të bëjnë me aferat, korrupsionet dhe skandalet e njerëzve në pushtet. Më tha me një interesim të madh dhe të qartë, gjë që më lëndoi shumë për shkak se ai harroi temën për çka po bisedonim. “Për çka po mbani kongres kësaj radhe?” “I thashë me lodhje, duke dashur ta shkurtoja rrugën. “Ministria e Arsimit organizon një kongres, në të cilin fton përfaqësues nga njëzet vende të Afrikës për të shikuar mundësinë e unifikimit të metodave të arsimit në tërë kontinentin. Unë isha anëtar në Sekretariatit e Kongresit”. Mahxhubi ma priti: “Le të ndërtojnë shkollat në fillim, pastaj le t'i shqyrtojnë metodat e unifikimit të arsimit. Si mendojnë ata njerëz? Humbin kohën në kongrese dhe në fjalë të kota, kurse këtu fëmijët tanë udhëtojnë disa milje për të shkuar në shkollë. A nuk jemi ne njerëz? A nuk po japim tati? A nuk kemi të drejtë në këtë shtet? Çdo gjë gjendet në Hartum. I tërë buxheti i vendit shpenzohet në Hartum. Një spital gjendet në Merevi, duhet të udhëtosh tri ditë, gratë po vdesin gjatë lindjes. Nuk gjendet asnjë mami në këtë anë. Ti çka po bën në Hartum? Çfarë dobie kemi ne që e kemi një djalë tonin në qeverinë që nuk bën asgjë?”

Gomarja ime e kishte kaluar, andaj tërhoqa frenin e saj që të më bashkëngjitet dhe preferova heshtjen. Po të ishte ndonjë kohë tjetër do ta qortoja ashpër. Unë dhe ai kështu jemi prej kohës së femërisë, i bërtaşim njëri-tjetrit derisa të hidhërohemi. Pastaj pajtohemi dhe harrojmë. Mirëpo, unë jam i uritur, i lodhur dhe zemra ime është e rënduar me një brengë të rëndë. Po të ishte koha më e mirë, do ta bëja të qeshte dhe të hidhërohet me tregimet e atij kongresi. Nuk do të besoj, se zotërinjtë e rinj të Afrikës, fytyrëlëmuar, gojët e tyre si gojët ujëve, në duart e tyre shndrisin unazat me gurë të çmuar, të parfumuar me erërat më të shtrenjta, të veshur me rroba të bardha, të kaltra, të gjelbra prej mëndafshi të shtrenjtë, që rrëshqasin në krahët e tyre sikur të ishin lëkura të maceve të shtrenjta, këpucët e tyre reflektojnë dritën e qirimbajtësve. Nuk do të besonte Mahxhubi se ata kanë shqyrtuar nëntë ditë ardhmërinë e arsimit në Afrikë në “Amfiteatrin e Pavarësisë”, i cili është ndërtuar për këtë qëllim dhe ka kushtuar më shumë se një milion funte. Një pallat prej guri, çimentoje, graniti, xhami, me formë të rru-

mbullakët, projekti i të cilit është bërë në Londër, sallat janë prej graniti të bardhë, që është sjellë prej Italisë, xhamat e dritareve me ngjyrë. Dyshemeja është e shtuar me tepi persiane, kurse tavani në formë kupole është i stolisur me ngjyrë ari. Bina, në të cilën folën njëri pas tjetrit ministrat e Arsimit të Afrikës, për nëntë ditë rresht, është nga graniti i kuq, sikur ai që është në varrin e Napoleonit në Infalid, ndërsa mesi i saj është i lëmuar dhe i shndritshëm prej drurit abinos. Në mure janë të varura piktura prej vaji, kurse para hyrjes ishte vendosur harta e madhe e Afrikës prej mermeri me ngjyra, secili shtet me një ngjyrë. Si mund t'i them Mahxhubit se ministri, i cili, në fjalimin e tij të gjatë, u prit me një duartrokitje frenetike, tha: “Nuk duhet të ketë kundërtënie mes asaj që mëson nxënësi në shkollë dhe mes realitetit të popullit. Secili që mëson sot dëshiron të ulet në një zyrë luksoze me erkondishen dhe të banojë në një vilë me kopsht dhe me erkondishen, të shkojë dhe të vijë me makinë luksoze amerikane sa është e gjerë rruga. Nëse ne nuk e çrrënjosim këtë sëmundje nga rrënjët e tij dhe nëse formohet te ne një shtresë e borgjezisë, e cila nuk ka lidhje me realitetin tonë, ajo do të jetë më e rrezikshme për të ardhmen e Afrikës se vetë kolonializmi”. Si mund t'i them Mahxhubit se ky njeri gjatë muajve të verës iku nga Afrika në vilën e tij në liqenin e Lokarno. Gruaja e tij blen gjërat prej Herotzit në Londër, i sjell ato me aeroplan special dhe se anëtarët e delegacionit të tij thonë haptazi se ai është njeri i prishur e i korruptuar, ka krijuar një pasuri marramendëse nga djersa e popullit gjysmëlakuriq që jeton në xhungël. Këtyre njerëzve nuk iu intereson asgjë tjetër, përveç stomaku dhe ngopja e epsheve të tyre”.

Në botë nuk ka drejtësi. Mustafa Seidi pati thënë: “Unë nuk po kërkoi lavdi, njeriu si unë nuk do madhështi”. Po të kthehej ai, një kthim të rëndomtë do t'i bashkohej këtij grupi ujqish. Të gjithë i përngajnë atij. Fytyra të bukura, fytyra që tregojnë për një jetë të begatë. Njëri prej ministrave tha në manifestimin përfundimtar të kongresit se ai ishte profesor i tij. Në paraqitjen e time të parë, bërtiti: “Ti ma rikujton një mik të dashur me të cilin isha në lidhje të ngushta në Londër, dr. Mustafa Seidin. Ka qenë profesor imi në vitin 1928. Ishte kryetar i

Shoqatës së Luftës për Çlirimin e Afrikës, kurse unë isha anëtar i komisionit. Ja çfarë njeriu i madh ishte. Ai ishte njeriu më i madh i Afrikës që e kam njohur. Kishte lidhje të shumta. O Zoti im, sa njeri i madh ishte! Gratë dorëzoheshin para tij sikur ujë. Thoshte se do ta çlironte Afrikën me.....” Qeshi derisa i shihej pjesa e prapme e fytyrës së tij. Desha ta pyesja, por ai u zhduk në mesin e kryetarëve dhe ministrave. Mustafa Seidi nuk më intereson mua tash, kam preokupime tjera. Telegrami i Mahxhubit ka ndryshuar tek unë çdo send. Kur lexova përgjigjen e zonjës Robinson në letrën time, për herë të parë ndjeva një gëzim të madh. Gjatë udhëtimit në tren e lexova për herë të dytë, për t’iu shmangur të menduarit rreth asaj pike që ishte bërë bosht i përqendrimit të përsiatjes sime. Mirëpo, pa sukses.

Gomari vazhdoi t’i nxirrte gurët me thundrat e tij. Mahxhubi papritmas më tha: “Përse po hesht si të ishe memec? Përse nuk thua diçka? Iu përgjigja: “Nëpunësit si unë nuk mund të ndryshojnë asgjë. Nëse zotërinjtë tanë na thonë bëni diçka ne e bëjmë. Ti je kryetar i Partisë Nacional Demokratike Socialiste këtu. Ajo është parti në pushtet. Përse nuk e drejton hidhërimin tënd tek ata?”

Mahxhubi ma ktheu sikur donte të kërkonte falje: “Sikur ... Sikur të mos ishte kjo katastrofë të ... Ditën e ndodhisë ishim përgatitur me një delegacion për të kërkuar ndërtimin e një spitali të madh, një shkolle të mesme për meshkuj, një shkolle fillore për vajza, një shkolle të bujqësisë dhe....”. Ndërpreu fjalimin e tij për një çast duke kërkuar ngushëllim në heshtje. Unë shikova lumin në anën tanë të majtë që shndriste me rrezik dhe po zhuriste me zëra të panjohur. Para nesh ishin dhjetë kupolat në mes të varrezave. Në zemrën time u ringjall një kujtim. Mahxhubi më tha: “E kemi varrosur herët në mëngjes pa zhurmë. I urdhëruam gratë të mos qanin. Nuk kemi hapur të pame dhe nuk e kemi lajmëruar askënd. Do të na vinte policia, pyetje, përgjigje e afëra”. Ia ktheva me panik: “Përse policia?” Më shikoi mua për një çast pastaj heshti, pas një periudhe bukur të gjatë më tha: “Një javë apo dhjetë ditë prej udhëtimit tënd, babai i saj tha, se ia kishte dhënë fjalën të birit të kryetarit të fshatit. Bënë kurorëzimin me të. Babai i saj e ofendoj, i ra dhe i tha asaj: Do të martohesh me të, me gjithë

vullnetin tënd. Unë nuk isha prezent me rastin e ceremonisë së martesës. Askush nuk mori pjesë në ceremoninë e kurorëzimit, përveç Beqirit, gjyshit tënd dhe bijës së Mexhdxhubit. Miqtë e tij. Unë, personalisht, jam munduar ta bindja atë që të hiqte dorë, por ai ishte i vendosur në realizimin e qëllimit të tij. Sikur të ishte çmendur. Fola edhe me babanë e saj, i cili më tha se nuk mund të bëhej objekt talljeje, që njerëzit të thonë se vajza i ka dalë razi. Pas martesës i thashë kryetarit të fshatit që ai ta merrte atë me të mirë. Qëndroi tek ai dy javë, nuk i foli atij e as ai nuk i foli asaj. Ishte....një gjendje që nuk mund të përshkruhej. Ishte bërë si i marrë. I ankohej çdokujt. Thoshte si mund të qëndrojë në shtëpinë time një grua, të cilën e kam martuar sipas synetit të Allahut dhe të dërguarit të Tij dhe nuk ndodh në mes tyre ajo që zakonisht veprohet në mes burrit dhe gruas. Ne e këshillonim duke i thënë: Ke durim. Pastaj ....”

Gomari dhe gomarja pallën rastësisht në të njëjtën kohë, derisa për pak nuk rashë prej samarit. Për dy ditë vazhdova të pyesja dhe nuk gjeta askënd të më thoshte, të gjithë iknin prej meje me shikimet e tyre, sikur të ishin pjesëmarrës në një krim të madh. Nëna ime më tha: “Përse e le punën tënde dhe erdhe?” Iu përgjigja: “Djemtë”. Më shikoi për një çast me një shikim domethënës dhe tha: “Fëmijët, apo nëna e fëmijëve? Çka ka mes teje dhe asaj? Ka ardhur te babai i yt dhe ka deklaruar vetë. Thuaj atij të më marrë për grua. Çfarë guximi dhe pafytyrësie. “Gra të ahir zemanit”. Tërë atë marri që e bëri.

Gjyshi im po ashtu nuk më kurseu aspak. E gjeta të shtrirë në krevatin e tij në një gjendje të lodhur, që nuk e kam parë ndonjëherë. Dukej sikur burimi i jetës tek ai rastësisht ishte ndalur. Vazhdova të qëndroja ulur, kurse ai vazhdoi të heshte. Vetëm kohë pas kohe ofshante. Rrotullohej në shtratin e tij dhe kërkonte mbrojtje prej Allahut nga shejtani i mallkuar. Sa herë që bënte kështu ndjente një lloj therjeje, sikur mes meje dhe shejtanit kishte ndonjë shkas. Pas një pritjeje të gjatë, tha duke i folur tavanit të dhomës: “Allahu i mallkoftë gratë. Gratë janë motrat e shejtanëve. I biri i kryetarit, i biri i kryetarit”. Gjyshi im ia plasi vajit. Asnjëherë në jetën time nuk e kisha parë duke qarë. Qau gjatë, pastaj i fshiu lotët me mangët e rrobave të tij. Heshti

aq gjatë, sa mendova se kishte fjetur. Pas një kohe tha: “Allahu të pastë mëshiruar, o i bir i djalit të kryetarit. O Zoti, im fale atë dhe përfshije në mëshirën Tëndë”. Pëshpëriti disa lutje, pastaj tha: “Ishte njeri që nuk kishte shok. Vazhdimisht qeshte. Gjithnjë të gjendej në raste të vështira. Askush nuk ka kërkuar prej tij diçka e që nuk është përgjigjur. Sikur ai t’i dëgjonte fjalët e mia. Nuk do ta kishte këtë përfundim. Nuk ka fuqi tjetër, përveç fuqisë së Allahut. Për herë të parë ndodh në këtë fshat një gjë e tillë prejse e ka krijuar Zoti. Ne jemi në kohën e ahir zemanit”. Mora fuqi dhe e pyeta: “Çka ka ndodhur?”

Nuk i bëri përshtypje pyetja ime dhe u angazhua një kohë me tshipihet e tij, e pastaj tha: “Nga ajo kabile (fis) nuk mund të vijmë vetëm gjëra të këqija (sherre). I thashë të birit të kryetarit: “Kjo grua është grua e ligë (baksuz). Largohu prej saj, por exheli.....”.

Mëngjesin e ditës së tretë, mora një shishe uiski në xhep dhe shkova tek e bija e Mexhdhubit. Nëse nuk më tregon mua e bija e Mexhdhubit nuk do të më tregojë askush tjetër. Ia qita të bijës së Mexhdhubit uiskin prej shishes në një enë të madhe prej alumini. Ajo ma priti: “Me siguri ti do diçka. Ne nuk njohim alkoolin sikur ky që përdoret nëpër qytete”.

I thashë asaj: “Dua të di se çka ka ndodhur. Askush nuk dëshiron të më tregojë”.

Piu një dozë të madhe nga ena, ngrysi fytyrën e saj e tha: “Veprën që ka bërë e bija e Mahmudit nuk mund ta rrëfejë gjuha. Diçka që nuk kemi parë, as kemi dëgjuar në të kaluarën e as që mund të ndodhë në të ardhmen.

Piu përsëri. Qëndrova duke pritur derisa shkoi një e treta e gasteres, por alkooli nuk ndikoi fare tek ajo, përveçse të disponohet më shumë. Kjo vërehej në fytyrën e saj. Bija e Mahmudit e mbylli dritaren dhe tha: “Kjo mjafton. Alkooli i të krishterëve është më i fortë, nuk është si alkooli i hurmave”.

E shikova me habi e më tha: “Atë që do ta them unë nuk do ta dëgjosh prej asnjë njeriu në fshat. I varrosën me të bijën e Mahmudit dhe të birin e kryetarit të mjerë. Fjalë turp që është vështirë të shqipto-

het”. Pastaj më pa me një shikim domethënës me sytë e saj depërtues e tha:

“Këto fjalë nuk do të të pëlqejnë, në veçanti nëse....” e ndërpreva pak e i thashë: “Dua ta di çka ka ndodhur si të gjithë njerëzit e tjerë. Përse duhet të jem unë i vetmi që nuk duhet ta di këtë?”

Ia dhashë një cigare pasi që e ndezi tha: “Pak pas namazit të jancisë u zgjova nga britma e Hasnes, bijës së Mahmudit në shtëpinë e të birit të kryetarit. I tërë fshati po pushonte në qetësi. Nuk dëgjoje asnjë lëvizje më të vogël. Thënë të vërtetën, unë mendova se, më në fund, i biri i kryetarit e mori hakun e vet prej saj. Burri i ngratë, gati sa nuk u çmend. Dy javë me grua nuk i flet e as e lejon t’i afrohet. I hapa veshët përsëri e dëgjova atë duke bërtitur dhe vajtuar. “O Zot im më fal mua”. Qesha kur unë po e dëgjoja britmën e saj. Thash vetë me vete: I biri i kryetarit ende e mban veten. U shtua britma, dëgjova një lëvizje në shtëpinë e Beqirit, ngjitur me shtëpinë e të birit të kryetarit. Dëgjova Beqirin duke bërtitur: O njeri, ki frikë për gjakun tënd. Patjetër duhet ta bësh aferë? Pastaj dëgjova Seiden, gruan e Beqirit, duke thënë: Oj vajzë, ruaje nderin tënd, çka janë këto marri? Nusja beqare nuk bën një gjë të tillë. Sikur ti nuk i ke provuar burrat më parë. Britma e bijës së Mahmudit sa vinte e ishte më e lartë, pastaj dëgjova të birin e kryetarit duke bërtitur me zërin e tij më të lartë: “O Beqir. O Haxhi Ahmet. O bija e kryetarit. O njerëz. E bija e Mahmudit më mbyti”. U ngrita dhe rrobat e mia më shkonin zvarrë, kërceva derën e Beqirit dhe të Mahxhubit, nxitova te dera e të birit të kryetarit, por dera e oborrit ishte e mbyllur. Bërtita me zërin tim më të lartë dhe erdhën Mahxhubi e Beqiri. Pastaj u tubuan njerëz të tjerë. Derisa ne ishim duke e thyer derën e oborrit, dëgjuam një britmë. Britma ishte aq e tmerrshme sa që mund t’i lëviznin edhe kodrat dhe vinte nga i biri i kryetarit. Pastaj, një britmë të ngjashme nga bija e Mahmudit. Hymë unë, Mahxhubi dhe Beqiri. I thashë Mahxhubit: Mos i lejo njerëzit të hyjnë në dhomë. Mos lejo asnjë grua të hyjë në dhomë. Mahmudi doli dhe u bërtiti njerëzve. Me atë u kthyen xhaxhai yt Abdul Kerimi, Seidi Tahir err-Rrevasi edhe gjyshi yt i ngratë erdhi prej shtëpisë së tij”.

Djersët e kishin mbuluar të bijën e Mahmudit. Fyti i ishte tharë. Më dha shenjë t'i jepja pak ujë, të cilin ia solla. E piu ujin, i fshiu djersët prej fytyrës dhe tha: “Kërkoj falje prej Allahut dhe pendohem tek Ai.” Të dy i gjetëm, në dhomën e vogël të birit të kryetarit, që ka pamje nga rruga. Llamba ishte ndezur. I biri i kryetarit lakuriq, ashtu si e ka lindur nëna e vet. Kurse bija e Mahmudit ishte me rroba të shqyera. Edhe ajo ishte lakuriq. Qilimi i kuq po notonte në gjak. E ngrita llambën, pashë të bijën e Mahmudit të kafshuar dhe të gërvishtur në çdo pëllëmbë të trupit të saj. Barku, ijët, qafa. Kishte të kafshuar majën e gjirit derisa ia kishte këputur. Gjaku rridhte prej buzëve të poshtme. Nuk ka fuqi tjetër, përveç fuqisë së Allahut. I biri i kryetarit ishte i therur më shumë se dhjetë herë. E kishte therur në bark, në gjoks në këmbë”. Bija e Mahmudit nuk mundi të qëndronte më. Përiu pështymën e saj me vështirësi. Iu dridh ftyti, pastaj tha: “O Zot im, nuk ka kundërshtim ndaj gjykimit Tënd”. E gjetëm të shtrirë në shpinë, kurse thika ishte ngulur mu në zemër. Gojën e kishte hapur, kurse sytë e saj dukeshin sikur ajo të ishte gjallë. Të birit të kryetarit gjuha i ishte zgjatur mes nofullave, kurse këmbët ishin të ngritura lart në ajër”.

Bija e Mahmudit e mbuloi fytyrën me dorën e vet, kurse djersët rridhnin në mes gishtave. Kraharoni i saj nisi të ngrihej e të ulej me shpejtësi dhe vazhdimisht thoshte me vështirësi: “Kërkoj falje prej Allahut të madhërishëm”... Që të dy dhanë shpirt përnjëherë. Gjaku i nxehtë, po pikonte nga zemra e bijës së Mahmudit dhe nga kofshët e të birit të kryetarit. Gjaku vërshoi qilimin dhe shtratin dhe bëri vija që shkonin rrëke në tokë. Mahxhubi, Zoti i dhëntë jetë të gjatë, ishte i fuqishëm. Kur e dëgjoi zërin e Mahmudit kërceu jashtë dhe i tha babait tënd: Assesi mos e lejo të hyjë. Mahxhubi dhe burrat tjerë e morën xhenazen e të birit të kryetarit, kurse unë, gruaja e Beqirit dhe gratë e tjera të vjetra e morëm xhenazen e bijës së Mahmudit. Ua përgatitëm qefinët në të njëjtën natë. I bartën para lindjes së diellit dhe i varrosën. Bijën e Mahmudit e varrosën aty pranë varrit të nënës së saj, kurse të birin e kryetarit pranë varrit të gruas së tij të parë, të bijës së Rexhepit. Disa gra deshën të bënin funeral varrimi, por Mahxhubi, Zoti e ruajt erdhi e i qortoi, duke u thënë: Ajo grua që e hap gojën do t'ia heq

kokën. Çfarë funerali, djali im mund të bëhej në atë gjendje? Ishte katastrofë e madhe për fshat. Gjatë tërë kohës kemi qenë në mbrojtje të Allahut. Në ahir zeman neve na ndodh diç e këtillë. Kërkoj falje dhe pendohem te Ti, o Krijuesi im”.

Ajo qau ashtu siç qau gjyshi im. Qau gjatë dhe dhembshëm, pastaj buzëqeshi përmes lotëve dhe tha: “Është për t'u habitur me këtë rast, sepse gruaja e tij më e vjetër Mebrukja, nuk ishte zgjuar gjatë tërë kohës, edhe pse britmat ishin dëgjuar në tërë lagjen. Shkova tek ajo e shkundullova pak, ngriti kokën dhe tha: Bija e Mexhduhit, çka të ka pru ty në këtë kohë? Ia ktheva: “Çohu. Ka ndodhur vrasje në shtëpinë tuaj”. Ma ktheu: “Vrasja e kujt?” I thashë: “E bija e Mahmudit e ka mbytur të birin e kryetarit dhe e ka mbytur edhe veten”. Ma ktheu: “Le të shkojnë në xhehenem”. Dhe vazhdoi gjumin e saj. Kur ne ishim duke përgatitur xhenazen e bijës së Mahmudit dëgjnim gërmimë e saj. Kur njerëzit u kthyen nga varrimi, e gjetëm ulur teksa po e pinte kafënë e saj të mëngjesit.

Disa gra donin të qanin me të, por ajo u bërtiti: “Oj gra, secila prej jush le të shkojë në punën e saj. I biri i kryetarit e ka hapur varrin me duart e veta. Allahu e bekoftë bijën e Mahmudit, ia ka paguar për të vjetrat dhe të rejat”. Pastaj bërtitën në shenjë gëzimi. Po, o djali im, bërtitën gratë e thanë: “Atij që nuk i pëlqen le të pijë ujë deti”. Kërkoj falje prej Allahut. Babait të saj Mahmudit ... Vetëm sa nuk i doli shpirti prej vajit. Bërtiste si kau. Gjyshi yt e shau, i ra me shkop, i bërtiti dhe qau. Xhaxhai yt, Abdul Kerimi, u përlesh me Beqirin pa asnjë shkak. I tha: Ndodh kasaphane në fqinjësinë tënde e ti fle? I tërë fshati dukej sikur atë natë të kishin ardhur shejtanët në të. Vetëm Mahxhubi dukej i fortë. Përgatiti çdo send, i solli qefinët, nuk e di prej nga? Djemtë e të birit të kryetarit bënë zhurmë, ai i heshti. Pamje tmerruese, djali im, Zoti mos ta pruftë ta shohësh diçka të këtillë që ta këput zemrën e që e plak fëmijën. E tërë kjo nuk kishte pasur nevojë të ndodhte. Ajo e kishte pranuar njeriun e huaj, përse të mos e pranonte të birin e kryetarit?”

Arat ishin kthyer në zjarre e tym. Ishte koha e përgatitjes për mbjelljen e grurit. Fshatarët pastrojnë tokën, tubojnë tallën e misrit,



rrënjët e mbetura kujtim nga sezoni kaluar, të gjitha i tubojnë grumbuj nëpër ara dhe i djejin. Toka e zezë, e rrafshët, përgatitet për ndodhinë e ardhshme. Burrat janë mbështetur në shata e disa pas plugjeve. Majat e palmave lëvizin nga një erë e lehtë, një avull i nxehtë ngrihet prej arave të ujitura të tërfilit, nën rrezet e nxehta të diellit në mesditë. Me çdo dhunti ere, përhapet aroma e limonit, portokallit dhe mandarinës. Aty-këtu dëgjohet bulurimë gjedhi, pëllitje gomari, apo krismë e sëpatës duke prerë dru. Mirëpo, bota ka ndryshuar.

Mahxhubin e gjeta të zhytur në baltë, djersët rridhnin prej trupit tij lakuriq. Kishte vetëm në leckë në mes të trupit, përpiquej të ndante një short palme nga rrënja kryesore. Nuk e përshëndeta edhe ai nuk u drejtua kah unë. Vazhdoi të rrëmihte për rreth shortit. Qëndrova në këmbë duke shikuar. Ndeza një cigare, ia ofrova atij kutinë, refuzoi duke më bërë shenjë me kokë. U largova pak dhe e mbështeta kokën në një dru të palmës aty afër. Thashë me vete: Nuk ka vend për mua këtu. Përse nuk e marr çantën time e të shkoj? Këta njerëz nuk i habit asgjë. Kanë bërë llogari për çdo send. Nuk gëzohen për ardhjen e një foshnje në jetë e as nuk pikëllohen për vdekjen e dikujt. Kur qeshin thonë: “Kërkoj falje nga Allahu” dhe kur qajnë thonë: “Kërkoj falje nga Allahu”. Nuk thonë: E çka mësova unë? Kanë mësuar durimin dhe heshtjen prej lumit dhe drunjve. E unë çka mësova? E pashë Mahxhubin se si kishte kafshuar buzën e tij të poshtme, si zakonisht kur ai vendos të punojë diçka. Fitoja kundër tij në garat e mundjes dhe të vrapimit, kurse ai fitonte në garat e notit në lumë prej një bregu në tjetrin si dhe në ngjitjen në palma. Nuk ka asnjë palmë në të cilën ai nuk mund të ngjitet. Dashuria mes tij dhe meje është sikur të jemi vëllezër të një babe dhe një nëne. Mahxhubi e mallkoi palmën e vogël kur më në fund, pati sukses ta ndante atë pjesë nga rrënja e palmës kryesore pa ia dëmtuar rrënjët e saj. Mbuloi gropën me dheun e shumtë, që kishte mbetur në rrënjë ku ishte. Shkurtoi degët e palmës së vogël, hoqi dheun dhe e hodhi të terej në diell. Vetë me vete thashë se ai do të jetë më i përgatitur të flasë tash. Erdhi te hija ku isha ulur u ul dhe i shtriu këmbët. Për një çast heshti, e pastaj mori frymë thellë dhe tha: “Kërkoj falje nga Allahu”. E zgajta dorën ia dhashë një cigare. Ai nuk pi du-

han, vetëm atëherë, kur unë vij në fshat, thotë: “T’i ndezim të hollat e qeverisë”. E hodhi cigaren para se ta përfundonte, duke m’u drejtuar me këto fjalë: “Ti si dukesh je i sëmure. Me siguri udhëtimi të ka lodhur. Nuk ke pasur nevojë të vish. Kur e dërgova telegramin, nuk e kam pritur ardhjen tënde”.

Thashë sikur unë të bisedoja me vete: “Ajo e mbyti atë, e mbyti edhe veten. E theri atë më shumë se dhjetë herë dhe ..... ja çfarë tmerri”.

U kthye kah unë i habitur dhe më pyeti: “Kush të ka treguar?”

Vazhdova duke mos i dhënë rëndësi pyetjes së tij: “Kafshoi majën e gjirit të saj derisa ia preu, e kafshoi dhe e gërvishti në çdo pëllëmbë të trupit të saj. Ja çfarë tmerri”.

Mahxhubi bërtiti i hidhëruar: “Patjetër të ka treguar e bija e Mexh-dhubit. Zoti e mallkoftë! Nuk e mbyll gojën e saj. Këto fjalë është turp të thuhet”.

Ia ktheva: “Të thuhet apo të mos thuhet, kjo ka ndodhur. Ka ndodhur para syve tuaj dhe nuk keni ndërmarrë asgjë. Dhe ti, ti je prijës e kryetar në fshat dhe nuk ke ndërmarrë asgjë”.

Mahxhubi ma ktheu: “Çka të bëjmë? Përse nuk ke ndërmarrë diçka ti? Përse nuk e ke martuar? Vetëm di të flasësh. Gruaja është ajo që pati guximin të thotë: “Jetuam dhe pamë që gratë të fejojnë burrat”.

Ia ktheva: “Çka ka thënë”:

U përgjigj: “Ajo çka ndodhi, ndodhi. Çfarë dobie bëjnë fjalët? Falenderoj Zotin që nuk je martuar me të. Veprën që e ka bërë ajo nuk ishte vepër njeriu. Ishte vepër shejtani”.

Ia ktheva atij, kurse unë po shtrëngoja dhëmbët e mi: “Çka ka thënë?”

Më shikoi pa keqardhje e më tha: “Kur shkoi babai i saj dhe e ofendoi, erdhi tek unë në shtëpi, me lindjen e diellit. Më tha ta shpëtoja prej birit të kryetarit dhe lëmshit të fejesës. Vetëm të bësh kurorë me të. Nuk do prej teje asnjë send. Më tha të më lërë me dy djemtë e mi. Nuk dua prej tij asnjë shërbim i madh apo i vogël qoftë ai. Ia ktheva të të mos fuste në probleme. E këshillova ta pranonte realitetin. Babai është kujdestar i saj, ai ka të drejtë të veprojë si të dojë. Pastaj i tha-

shë: I biri i kryetarit nuk do të jetojë gjithmonë. Burrë i çmendur dhe grua e çmendur. Cili është mëkati ynë? Çka kemi mundur ne të bëjmë? I mjeri babai i saj. Prej asaj dite ogurzezë, ai nuk e braktis shtratin. Nuk del, as nuk takohet me njeri të gjallë. Çka mund të bëj unë apo të tjerët, kur bota është e sëmurë me çmenduri? Është parë qartë se marrëzia e bijës së Mahmudit nuk ka shembull as në të kaluarën, as nuk do të ketë në të ardhmen”.

I thashë atij se unë po bëja çmos që të mos qaja: “Hasna nuk ishte e çmendur. Ishte gruaja më e inteligjente në fshat. Ju jeni të çmendur. Ishte gruaja më inteligjente në fshat dhe gruaja më e bukur në fshat. Hasna nuk ishte e çmendur”.

Mahxhubi qeshi. Qeshi me zë të lartë dhe me plot gojën. E dëgjo-va duke thënë dhe qeshur: “Ja çfarë çudie. O njeri, zgjohu prej agonisë. Je dashuruar në ahir zeman. Je çmendur sikur i biri i kryetarit. Shkollat dhe arsimimi ta kanë zbutur zemrën. Qan sikur gratë. Betohem në Zotin se unë po shoh çudira. Dashuri, sëmundje dhe vaj. Ajo nuk vlente për pesë para. Po të mos na vinte turp, ajo nuk meritonte të varrosej. Do ta hidhnim në det, apo ta linim xhenazen e saj ta hanin shqiponjat”.

Ajo që ndodhi më vonë nuk ishte fare e qartë për mua. Mirëpo, mua më kujtohet ... dy duart e mia në fytyrë e Mahxhubit, Më kujtohet se dy sytë i kishin dalë të zgurdulluar, më kujtohet një e rënë e fuqishme në barkun tim dhe më kujtohet Mahxhubi ulur mbi krahatorin tim. Më kujtohet Mahxhubi i shtrirë në tokë, kurse unë e shqelmoja me këmbët e mia. Më kujtohet, po ashtu zëri tij duke bërëtitur: I çmendur, i çmendur”. Më kujtohet një zhurmë, britmë, kurse unë e shtrëngoja me sa fuqi kisha fytyrë e Mahxhubit. Dëgjoja gjëmim dhe duar të fuqishme që më tërhiqnin mua për qafe, pastaj në kokë më ra një shkop i trashë.

*Në numrin vijues (pjesa e fundit)*

*Tayeb Salih*

## SEASON OF MIGRATION TO THE NORTH (5)

### (Summary)

After we had had the circumcision celebrations for the two boys I returned to Khartoum. Leaving my wife and daughter in the village, I journeyed by the desert road in one of the Project's lorries. I generally used to travel by steamer to the river port of Karima and from there I would take the train, passing by Abu Hamad and Atbara to Khartoum. But this time I was, for no particular reason, in a hurry, so I chose to go the shortest way.

الطيب صالح

## موسم الهجرة إلى الشمال (5)

### (خلاصة البحث)

احتفلنا بختان الولدين و عدت للخرطوم. تركت زوجتي و ابنتي في البلد، و سافرت في الطريق الصحراوي في سيارة من سيارات المشروع التي ذكرها محبوب. كنت اسافر عادة بالباخرة إلى مبناء كريمة النهرى و من هناك آخذ القطار مارا بابي حمد و اتبرا إلى الخرطوم. لكننى هذه المرة كنت في عجلة من أمرى دون سبب واضح، ففضلت اختصار الطريق.

## TERMINOLOGJIA FETARE

*Qemajl Morina*

### GLOSARI ÇIFUT - (4)

**A lahma anja:** shih: (h)a lama anja.

**Afikoman** (fjalë greke në hebraisht: - desert. Në (H)alahun bashkëkohor ky termin ka të bëjë me pjesën e fundit të bukës pa tharmë, të cilën i zoti i shtëpisë e merr në mbarim të darkës. Në kohën kur mbrëmja merr formën definitive standarde, bashkimi i festës përfundon me desert. (H)alaha ndalon dëfrimin me çfarëdo qoftë përveç me ( lëngje), pas ngrënies së kafshatës së fundit të sakrificës së pashale.

**Aftara** - shih: (h)aftara.

**Agada** - shih: (h)agada.

**Alaha** - shih: (h)alaha.

**Al-haroset** - ëmbëlsirë e përzier prej mollëve të bluara, bajameve, mjaltit dhe rrushit të terur, e cila hahet gjatë festës së mbrëmjes, me qëllim të përkujtimit të baltës prej të cilës janë ndërtuar tullat për ndërtimin e ndërtesave të faraonëve, me një fjalë tjetër për të

përkujtuar kohën e robërimit të bijve të Izraelit në Egjipt. Ky termin shumë herë përdoret pa nyjën shquese 'al'.

**Alija** (hebr.): tekstualisht: ngritje - hyrje në leximin publik të Tevratit me rastin e lutjes së përbashkët. Ditën e hëne, e enjte, e shtune, festave, gjysmë festa, në Rësh Hodesh dhe me rastin e agjërimeve, pas lutjes së mëngjesit; të shtunave, gjatë festave, ditën e Jom Kipurit dhe agjërimeve si dhe pas lutjeve të pasdites, bëhet leximi publik i Tevratit. Në leximin e mëngjesit, në shabat ka shtatë lexime, ditën e Jom Kipurit gjashtë, gjatë festave pesë, në Rosh Hodesh dhe gjysmë feste katër - kurse të hënën dhe të enjten, dhe të agjërimeve si dhe në Hanuk dhe Purim - tre. Gjatë leximit të pasdites gjithmonë lexojnë tre veta. (shumësi: alijot).

**Alijat Ko(h)en:** (hebr.): hyrje e Kohenit në leximin e Tevratit. (H)alaha është që me leximin publik të Tevratit të niset me shkallën e përgatitjes së leximit - do të thotë më i dijsmi së pari, tjetri sipas aftësisë pas tij e kështu me radhë. Nëse të gjithë janë të një niveli (të dijes apo mos dijes), atëherë në leximin e Tevratit dilet sipas meritës së baballarëve. Kështu, themi, Ko(h)animi si pasardhës të teologut Aronit dalin të parët, Levitët, pjesëtarë të fisit Levi, që nuk kanë marrë pjesë në ndërtimin e viçit prej ari - për atë kanë qenë të zgjedhur në udhëheqjen e shërbesave jo-fetare në Tempull) dalin të dytët - kurse të gjitha tjerat alijot janë në dispozicion të çdo hebrenj - që quhen me emrin e përbashkët *Izrael*.

**Alijat Levi** (hebr.) hyrje e Levit në leximin e Tevratit, sipas (H)alahut Levi është në rendin e dytë vetëm nëse të gjithë janë të njëjtë nivel. Në rast se në mesin e të pranishmëve ka njerëz të niveleve të ndryshme, së pari lexon ai që është më i dituri, i dyti ai që ka më pak njohuri - më tepër se të tjerët - e kështu me radhë.

**Alijat maftir** (hebr.): shtesë në hyrje të leximit të Tevratit ( e shtuna e tetë, në Jom Kipurin e shtatë, në festën e gjashtë, në Tisha be-Av, si dhe ditën e Jom Kipurit pas ditën e katërt).

**Alijat mashlim** (hebr.): hyrje përfundimtare në leximin e Teveratit.

**Alijat shelishi** (hebr.): hyrja e tretë në leximin e Teveratit.

**Alijat shishi** (hebr.): hyrja e gjashtë në leximin e Teveratit.

**Amida** - shih: tefila.

**Aninut** (hebr.): periudhë pikëllimi prej vdekjes së të ndjerit e deri te varrimi. Të afërmit e të vdekurit prej momentit të vdekjes e deri në varrosjen e tij quhen 'onenim' (të pikëlluar) dhe kanë status të veçantë. Ata janë të liruar nga shumë obligime - si për shembull lutjeve, vendosjes së tefelinit e të ngjashme.

**Anus** (hebr.): tekstualisht: i shtrënguar, i detyruar - në aspektin teologjik ky termin ka kuptimin e konvertimit me dhunë të çifutëve. (shumësi: anusim)

**Anjo** - shih: anju.

**Anju**: përvjetori i vdekjes së anëtarit të familjes, e cila shënohet me vizitën e varrit si dhe me përkujtimin e përbashkët (në shtëpi apo në sinagogë), e cila quhet *meldadu* apo *limud*, në përfundim të së cilës thuhet *kadish derabanan*. (shumësi: anjus).

**Arba kosot** (hebr): tekstualisht: katër gota, ka të bëjë me katër gota verë, të cilat pihen gjatë mbrëmjes, si kujtim për katër folje të ndryshme, të cilat i përmend Teverati, duke përshkruar daljen. Të gjithë të pranishmit (meshkujt dhe gratë) janë të obliguar gjatë mbrëmjes të pinë nga katër gota verë (apo lëng rrushi).

**Aron (h)a-kodesh** (hebr.): tekstualisht: 'arkivol i shenjtë' - orman apo dollap në mur ku vendosen fletët e Teveratit. Aron (h)kodesh shikon në drejtim të Jerusalemit në drejtim të cilit kthehen të gjithë çifutët e botës gjatë lutjeve. (shumësi: aronot (h)a-kodesh).

**Aron(h)a-metim** (hebr.): tabuti (sënduku) i të vdekurit. Sënduku i të vdekurit bëhet prej dërrasave të rrafshëta, të papërpunuara, pa zburime dhe pa përdorur gozhda të metalta.

**Arvit** (hebr.): darkë e përbashkët falënderimi apo lutje e mbrëmjes të individëve - nga fjala hebreje erev - mbrëmje.

**Ashkava** - shih: (h)ashkava.

**Av bet din** (hebr.): kryetar i këshillit gjyqësor prej tre anëtarësh.

**Avdala** - shih: (h)avdala

**Avel** (hebr.) : i përmortshëm, i (e) përzitur. (shumësi: avelim).

**Avot melahot** (hebr.) tekstualisht: prototip (gjërat e ndaluara - tridhjetë e nëntë kategori veprimesh, të cilat janë të ndaluara të punohen ditën e shtunë me tekstet nga Teverati:

1. lëvrimi,
2. mbjellja,
3. korrja,
4. lidhja e duajve,
5. shirja e grurit,
6. shirja
7. selektimi
8. thërrmimi, grimcimi.
9. shoshitja, të situarit,
10. përzierja,
11. pjekja,
12. këputje
13. lyerja me gëlqere,
14. lnorja e leshit,
15. ngjyrosja,
16. të treturit të fijes,
17. mbarimi i diçkahit,

18. vendosja e kornizës.
19. endja e pëlhurës,
20. shprishjen shthurje,
21. lidhje,
22. shqepje,
23. qepje,
24. nxehje,
25. ndërtimi,
26. prishje,
27. kryerja e punës duke mëshuar me çekiç,
28. gjuetia,
29. prerja,
30. regjia e lëkurës,
31. shtrirja,
32. heqja e qimeve prej lëkurës,
33. prerja e lëkurës,
34. shkrimi,
35. shlyerja e asaj që është shkruar,
36. tërheqja e vijave në lëkurë ose pergamenteve,
37. ndezja e zjarrit,
38. fikja e zjarrit,
39. bartja nga një qëllim në tjetrin.

**Atikva** - shih: (h)a-Tikva

**Avelut** (hebr.): pikëllim, rregullat e pikëllimit.

Aveluti fillon prej momentit kur i ndjeri i është varrosur dhe kur xhenazja është e mbuluar. Personi në pikëllim quhet avel, kurse shumësi është avelim. Tevrati parasheh katër periudha të pikëllimit.

**Beca** (hebr.) ve, në liturgji, është fjala për vet q paraqiten në tavolinën solemne.

**Beriha** (hebr.) falënderim, formulë e shkurt liturgjike e cila përdoret para dhe pas ngrënies së çfarëdo ushqimi, si dhe para kryerjes së

çfarëdo rituali (si për shembull larjes së duarve, ndezjes së qiriut të ditës së shtune etj.). (shumësi: berahot).

**Berit** (hebr.)- lidhje. Termini ka të bëjë me të gjitha llojet lidhjeve. (shumësi:beritot).

**Berit mila** (hebr.) - tekstualisht: lidhje e synetisë. Të gjithë fëmijët meshkujt bëhen synet ditën e tetë të lindjes. Mashkulli, i cili nuk është lindur në traditën jevreje - i cili dëshiron të pranojë Tevratin dhe t'i bashkëngjitet popullit hebrenj, patjetër duhet të bëhet synet. Sipas perspektivës metafizike, shkaku i udhëzimit hyjnor që synetia e djemve të bëhet ditën e tetë të lindjes së tyre, duhet kërkuar në të vërtetën e thjeshtë se dhënia e këtyre urdhrave Ibrahimit a.s., se tërë njerëzimi e kanë obligim shtat urdhra për bijtë e Nuhit a.s. Me këtë urdhër është formua një shoqëri e re, e cila ka krijuar lidhje të veçantë me Zotin, duke pranuar në këtë mënyrë edhe një urdhër të tetë. Nga ky nukleus do të zhvillohet më vonë Izraeli - bashkësia e cila ka krijuar me Zotin lidhje e mbështetur në përmajtje të e gjashqind e trembëdhjetë urdhrave.

**Besamim** (hebr.): erëza. Njëra prej katër uratave, të cilat përdoren në (h)avdall është edhe bekimi ndaj erëzave “Baruh Ata Adonaj, Elo(h)enu Meleh (h)olam, bore mine besamim” (I falënderuar je Ti Zot i ynë, Mbret i botëve, që je krijues i lloj-lloj erëzave ‘.

**Bet Din** - shih: Bet (h)a-Din.

**Bet (h)a-almin** (hebr.): tekstualisht ‘Shtëpia e përjetshme- varrezat. Shih: bet (h)akevarot. (shumësi bate almin).

**Bet (h)a-Din** (hebr.): gjyq lokal hebre, i cili përbëhet së paku prej tre dajanim. Shumësi: Bate Din).

**Bet (h)a-hajim** (hebr.) tekstualisht: Shtëpia e të gjallëve - varrezat. Shih: bet(h)a-kevarot.

**Bet(h)a-keneset** (hebr.): sinagogë. Kur në vitin 586 para erës së re është rrënuar tempulli i parë, çifutët skllav në Babiloni janë tubuar që të mësojnë librat e shenjtë, i kanë festuar festat dhe u janë përmbytur traditave. Këto tubime janë quajtur kneset (parlament). Në fillim janë tubuar nëpër shtëpi, pastaj filluan të ndërtojnë ndërtesa të veçanta, të cilat janë quajtur *bet(h)a-keneset* (vend tubimi). Fjala greke sinagogë ka të njëjtin kuptim. Hebrenjtë e kthyer nga robëria e Babilonit në vitin 536 para erës së re përsëri ngritën tempullin, por gjithkund jashtë Izraelit vazhdojnë të ndërtojnë sinagoga. (shumësi: bate kneset).

**Bet(h)a-kevarot** (hebr.: varreza. Gjuha hebreje me terminin *bet(h)a-kevarot* njeh disa emra përshkrues për varrezat si *bet olam* apo *bet almin* - shtëpia e përjetësisë, *bet(h)a-hajim* - shtëpi e jetës, *bet moed le-hol haj* - shtëpi e takimit për çdo send që është i gjallë e të ngjashme që ka të bëjë me besimin se njerëzit në këtë botë janë përkohësisht - kurse qëndrimi i vërtetë dhe i përhershëm është në botën tjetër. Është traditë që në varreza nuk duhet të hyhet pa kapelë, nuk duhet të pihet duhani, të mos hahet e të mos pihet. Dije-tarët e Talmudit nuk preferojnë vizitën e shpeshtë të varrezave. (shumësi: *bate(h)a-kevarot*)

**Bet (h)a- Mikdash** (hebr.): tempulli i Jerusalemit, vendi i vetëm ku mund të kryhet lutja, ashtu siç urdhëron Tivrati me kurbane publik dhe individual. Jashtë tempullit të Jerusalemit nuk mund të prehen kurban. (shumësi: *Bate(h)a-Mikdash*).

**Bet moed lehol haj** (hebr.): tekstualisht: shtëpia e takimit për çdo send që është e gjallë) - varrezat. Shh: *bet (h)a-kevarot*.

**Bet olam** (hebr.): tekstualisht: shtëpia e amshueshmërisë - varrezat. Shih: *bet (h)a -kevarot*.

**Bikur holim** (hebr.): vizita e të sëmurëve.

**Bima** (hebr.): vendi i ngritur në mes të sinagogës prej ku lexohet Tivrati. (shumësi: bimot)..

**Birkat (h)a-mazon** (hebr.): tekstualisht: lutja e ushqimit - falënderimi, i cili thuhet pas ngrënies. Lutja apo falënderimi pas ushqimit është urdhër pozitiv biblik - ashtu siç është thënë (Libri i i Pestë i Mojsiut 8:10): ‘Do të hash e do të ngopesh, do ta falënderosh Zotin tënd për tokën e pëlleshme që të dhuroi’. Tivrati nuk e ka përshkruar formën e lutjes, por atë ia ka lënë inspirimit të çdo individi.

**Birkat (h)a-mazon** citohet vetëm me rastin e ngrënies së bukës në një masë që tejkalon sasinë e një ulliri, ose pas ngrënies së një shujte, por jo edhe pas kafjalli, i cili përbëhet prej brumeve.

**Birkat (h)a-mazon** citohet në vendin ku është ngrënë dhe atë duke qëndruar në këmbë. Nëse dikush e ka harruar lutjen e ushqimit dhe e ka lëshuar vendin e ngrënies së ushqimit duhet ta citoj atë duke qëndruar në këmbë ku iu ka kujtuar lëshimi, para të cilit, normalisht, duhet të bëjë *majim aharonim* (t'i lajë duart pas ngrënies së ushqimit). Nëse dikush me qëllim e lëshon vendin e ngrënies pa e bërë lutjen Birkat (h)a-mazon, pastaj pendohet dhe vendos ta bëjë lutjen, ai duhet të kthehet në vendin e ngrënies së ushqimit dhe atje ta bëjë lutjen. Por, nëse i përmenduri citon lutjen në vendin ku është penduar për shkak të lëshimit, llogaritet se ai e ka krye obligimin. Lutja e ushqimit Birkat (h)a-mazon nuk guxon të ndërpritet për të biseduar.

**Cadik** (hebr.): i drejtë, personi i respektuar në popull për shkak të virtyeteve të tija të larta morale si dhe devotshmërisë së tij të madhe. Në mesin e të drejtëve termini *cadik* ka për qëllim rabinin. (shumësi: cadikim).

**Cedaka** (hebr.): lëmoshë; mëshirë; përdëllim. (shumësi: cedakot).

**Cion** (hebr.): emër kodre mbi Jerusalemin biblik, i cili mbeti shpresë kthimi në tokën e të parëve, sipas të cilit është emërtuar Sionizmi.

**Sionizmi** - lëvizje politike, është themeluar në Evropë në fund të shekullit njëzet, qëllimi i të cilit ishte formimi i shtetit hebreit në atdheun e vjetër.

**Com** (hebr.): agjërim. (shumësi: comot).

**Com Gedalja** (hebr.): agjërim i Gedles, dita e tretë e muajit Tishri - agjërim gjysmë ditor (prej lindjes e deri në perëndim të diellit ndalohej nga ngrënia apo pirja), në shenjë përkujtimi të vrasjes së Gedales të birit të Ahikamit, me të cilin është shkatërruar edhe gjurma e fundit e vetëqeverisjes në Izrael të ndërmarr nga mbreti i Babilonit Navukodnosorit me dekretin e të cilit është përmbysllur dëbimi i tërë popullit.

**Dajan** (hebr.): gjykatës i gjyqit hebreit. (shumësi: dajanim).

**Din** (hebr.): dispozitë, rregull ; urdhër; normë. (shumësi: dinim).

**El male rahamin** - ‘Zot me plotë mëshirë’, fillim i fjalëve të tekstit liturgjik, i cili shekujve të fundit është përhapur në mesin e hebrenjve ashkinaz - me anë të cilit kërkohet mëshira e Zotit mbi anëtarët e vdekur të familjes.

**Erev shabat** (hebr.): paradarka e së shtunës. E shtuna fillon me perëndimin e diellit ditën e premte. Disa minuta para perëndimit të diellit zonja e shtëpisë ndez qiriun e së shtunës me lutjen: ‘Baruh Ata Adonaj Elo(h)enu Meleh (h)a-olam asher kideshanu bemicvotav vecivanu le(h)adlik ner shel shabat’, (I bekuar je ti Zoti ynë, mbret i botëve, që na ke ndriçua neve me urdhrat Tua, na ke urdhëruar neve ta ndezim qiriun e së shtunës’.

**Galut** (hebr.): dëbimi, diaspora. (shumësi: galujot).

**Gemilut hasadim** (hebr.): bamirësi, dashuri, njerëzi, bërja mirë pa prituri shpërblim apo kundër shërbim. Veprimet e *gemilut hasadim*, përfshijnë shumë më tepër se termi *cedaka* (lëmoshë), i cili ka të bëjë me ndihmën materiale të varfërve (ushqimi, rrobat e të ngjashme) - si për shembull: mikpritja, bikur holim (vizita e të sëmurëve), ruajtja e të vdekurve, përgatitja e të vdekurve, i cili nuk ka të afërm etj.

**Geniza** (hebr.): vend në varrezë ku vendosen librat e përdorur me tematikë të Tevratit. Përmendorja zakonisht shënohet me gdhendjen apo skulpturën e e librit të hapur. (shumësi: genizot).

**Goses** (hebr.): person në agoni. Personi që është para vdekjes nuk duhet lënë vetëm. Qëndrimi në shoqëri të pesonit që është para vdekjes shpërblim i madh. Personin që është para vdekjes nuk duhet lënë vet që ai të mendojë për vdekjen. Është zakon që në momentin e vdekjes, djali ose dikush nga anëtarët e familjes, me kujdes t’ia mbyll sytë dhe gojën e të ndjerit. Me vdekjen e pesonit trupi lëshohet në tokë dhe mbulohet me çarshaf, kurse në afërsi të kokës ndizet një qiri. (shumësi: gosesim).

**(H)a lahma anja** (aramite): ‘Kjo është bukë e të mjerëve’. Fillojnë fjalët e paragrafit të (H)agades.

**Haci kadish** - tekstualisht: ‘gjysma e kadishit’, kadishi i shkurt i cili thuhet para darkës dhe pas ditës *amida*, para mbrëmjes dhe mëngjesit, *Kerijat shema*. Shih: kadish.

**Hag (h)a-Asirim** (hebr.): ‘Dita e ‘ - festa e hebrenjve të Sarajevës, që festohet në shenjë përkujtimi të çlirimit hahamit (rabinit) të Sarajevës Moshe Danonit si dhe të personaliteteve tjera të komunës hebreje të Sarajevës nga burgu, të cilët në muajin tetor 1820 i kishte arrestuar vali Ruzhdi Pasha, nën pretekstin se ishin shkaktar për vdekjen e Mosha Havijes, i cili kishte kaluar në Islam dhe ishte bërë dervish Ahmeti, duke i kërcënuar se do ti vrasë nëse

komuna hebrenjve e Sarajevës nuk ia paguan 500.000 grosh (në variantin e parë kishte kërkuar vetëm 50,000), mirëpo kishte ndryshuar mendimin dhe kishte dhjetëfishuar shumën) si dëmshtëpërbim për jetën e dervish Ahmetit.

**Haham** (hebr.): i urt, i mençur, mendimtar, dijetar, i ditur, i ditshëm. Emërtim për rabinin në komunat safaride. (shumësi: hahamim).

**Haham-bashi** (hebrejo-turke): haham (hebr.) i mençur, bash (tur). koka, haham-bashi - koka e të mençurve - apo rabini kryesor i komunës hebreje në qendrat e qyteteve të provincave të Perandorisë turke.

**(H)aftara** (hebr.): pjesë nga parathënia që lexohet pas së shtunës apo festës së Kerijat (h)a-Tore.

**(H)alaha** (hebr.): E drejta hebreje, poashtu emërtim për ndonjë ligj të drejtës hebreje. (shumësi: ((h)alahot).

**(H)a-maftir** (hebr.): personi që lexon (h)aftaren. (shumësi: (h)a-maftarim).

**Hamishoshi** - shih: Hamisha Asar bi-shvat

**Hamisha Asar bi-shvat** (hebr.): dita e pesëmbëdhjetë e muajit shevat, dita e parë e vitit tatimor për dhënien e të dhjetave nga frytet e pemëve.

**(H)ashkava** (hebr.): tekst liturgjik, i cili shekujve të fundit është rrënjësor në mes hebrenjve safarid - me anë të cilit kërkohet mëshira e Zotit ndaj të vdekurve nga anëtarët e familjes.

**Hanuka** (hebr.): pushim tetë ditor, në të cilin festohet fitorja e kryengritja e makabejve ndaj pushtuesve helenë, qeverisë marionete, të cilën e kishte vendosur në Judeja si dhe të lëvizjes helene, i cili përkrahte okupimin dhe helenizimin e Judejës. Mbreti Seleudik

Antihous Epifanes i katërti me dekret mbretëror kishte ndaluar predikimin e Tevratit në Judeja.

**Hanukat (h)a-bajit** (hebr.): manifestim me rastin hyrjes në shtëpi apo banesë të re.

**Hanukija** (hebr.): qiri që përdoret për ndezjen e qirinjve të hanukes.

**Hasid mot (h)a-olam** (hebr.): gjykatës i popullit të botës. Sipas mësimëve të Tevratit i tërë njerëzimi para ardhjes së Tevratit ka qenë e obliguar t'i përmbahet shtatë urdhrave për djemtë e Nuhit, më pranimin e Tevratit, hebrenjtë u obliguan t'u përmbahen 613 urdhrave. Pjesa tjetër e njerëzimit mbet i obliguar t'i përmbahet shtatë urdhrave të bijve të Nuhit.

**Hatan** (hebr.): dhëndër. (shumësi: hatanim).

**(H)avdala** (hebr.): tekstualisht: ndarje - formulë liturgjike me anë të së cilës shënohet fundi i shabatit dhe fillim i javës së punës. (H)avdala përbëhet prej katër bekimeve; bekimi mbi verën, besamim me qiri dhe llojllojshmërinë e botës. (shumësi: (h)avdalot).

**Hazan** (hebr.): paraprijës, udhëheqës i lutjeve në sinagogë - kantar. (shumësi: hazanim).

**Heder** - tekstualisht: dhoma, emërtimi i shkollës fillore hebreje e njohur më mesin e hebrenjve ashkinazit. (shumësi: hadarim)

**(H)ehal** (hebr.) tekstualisht: Pallati, burimisht, ndërtesa e tempullit, e cila është shenjtëri mbi shenjtëritë.

**(H)eseba** (hebr.): tekstualisht: shtrirje, zgjataratje.

**Hevra Kadish** (aramite): tekstualisht: 'shoqëri e shenjtë' - shoqëri për përgatitjen e të vdekurve, shoqëri e cila merret me larjen dhe varrimin e xhenazës. Anëtarët e kësaj shoqërie vizitojnë të sëmurët, i ngushëllojnë ata, të varfërve u sigurojnë mjekimin dhe barnat fa-



miljes së piklluar u sigurojnë drekën e parë, pas varrimit e të ngjashme..

**Hupa** - burimisht: shtëpia apo dhoma në të cilën jetojnë të porsamar-tuarit.

**Izijara** - nga arabishtja *zijara* (tur.zijaret) - vizita e varrezave të njerë-zve të drejtë.

**Jad** (hebr.): dora.

**Jarcajt** ose **jorcajt** (Jidish): tekstualisht, viti, koha, viti i vdekjes së anëtarit të familjes, e cila shënohet duke vizituar varrin e tij.

**Jeshiva** (hebr.): në Telmud: thirrja për mbajtjen e Gjyqit Suprem në egzil; sot; universiteti, akademia në të cilën mësohet Bibla dhe ko-mentet biblike, doktrina fetare, (H)alaha, filozofia e të ngjashme. (shumësi: jeshivot).

**Jidish** - gjuha e hebrenjve të Evropës Lindore dhe të Mesme.

**Jizikor** - 'Përkujtoje Zotin', fjalët nismëtare të tekstit liturgjik, i cili në shekujt e fundit është bërë traditë në mesin e hebrenjve ashki-nazit - me të cilin thirret mëshira e Zotit mbi të vdekurit e familj-es. Në mesin e hebrenjve safarid për të njëjtin qëllim është krijuar teksti liturgjik, i cili quhet (*H*)*ashkava*.

**Jom (h)a-Kipurim** (hebr.): tekstualisht: Dita e pajtimit, dita e dhjetë e muajit tishri sipas kalendarit çifut, agjërimi më i rreptë, dita e pranimit të gjitha lëshimeve, mëkateve dhe gabimeve. Jom (h)a-Kipurim është ditë e pendimit për të gjithë: për individin dhe për shoqërinë - paraqet përfundimin e procesit të faljes dhe pajtimit të Izraelit. Për këtë të gjithë janë të obliguar që të pendohen dhe t'i pranojnë gabimet e veta ditën e Jom (h)a-Kipurim.

**Jom (h)-Shoa** - shih: Jom (h)-Shoa ve(h)a-Gevura.

**Jom (h)-Shoa ve(h)a-Gevura** (hebr.): Dita (e përkujtimit të vikti-mave) Holokaustit dhe (dita) e heroizmit.

**Jom Kipur** - shih: Jom (h)a-Kipurim.

**Jom-Tov** (hebr.): festa e dhjetë urdhrave (porosive). Emërtimi i për-bashkët për dhjetë festat e Tevratit. (Dita e parë Pesaha, dita e Shtatë Pesaha. Dita e parë Sukota, dita e tetë sukota. Shuvout dhe dita Rosh(h)a-shana në të cilin është e ndaluar kryerja e çfarëdo pune.

**Jontef** (Jidish): heberizmi i jidishiizuar Jom - Tov - festë.

(vijon)

## RECENSIONE

## AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHAK-së, në mbledhjen e tij të datës 24. 09. 2004, na caktoi referues për të dhënë mendimin për **prof. dr. Muhamed Mufakun**, i cili, po në atë mbledhje nga Seksioni i Shkencave Shoqërore u propozua për anëtar të jashtëm të ASHAK-së

### A. Të dhënat personale

Dr. Muhamed Mufaku (versioni siri-  
an Muhamed Mufak Arnaut) u lind në Damask të Sirisë, në vitin 1952, në një familje shqiptare të shpërngulur nga Kosova (babai nga Peja, ndërsa e ëma nga Vrella e Istogut). Në Damask ka kryer shkollën fillore, të mesmen dhe Fakultetin - Degën e Gjuhës dhe letërsisë arabe. Në Prishtinë ka kryer studimet pasuniversitare nga historia e popullit shqiptar, në vitin 1977, pastaj doktoroi në shkencat filologjike në

Universitetin e Prishtinës, më 1981. Në vitin 1986 dr. Mufaku mbrojti edhe doktoratën e dytë në shkencat historike, po ashtu në Universitetin e Prishtinës.

Në degën e Orientalistikës të Fakultetit Filologjik të Prishtinës punoi si lektor i gjuhës arabe, që nga viti 1975 deri më 1987. Pas kësaj kohe shkoi në Siri dhe më 1988 veprroi si bashkëpunëtor i lirë i "Enciklopedisë së madhe Arabe" në Damask, kurse në vitet 1989-1994 u zgjodh docent, e nga viti 1994-1995 profesor inordinar në Degën e Historisë të Universitetit Jarmuk në Jordani. Nga viti 1995-2004 dr. Mufaku punon si profesor inordinar në Degën e Historisë të Universitetit Al Al-Bajt, po ashtu në Jordani. Që nga viti 1995 dhe tani dr. Mufaku është drejtor i Institutit "Bajt al-Hikma", që vepron në kuadër të Universitetit Al-u-l-Bejt, në Mafrak - Jordani.

Dr. Mufaku është anëtar me korrespondencë i Akademisë Shkencore Arabe (Damask), nga viti 2001, anëtar i Shoqatës së Orientalistëve të Kosovës, anëtar i Shoqatës së Studimeve dhe Gjurmimeve (Lidhja e Shkrimtarëve) të Sirisë, anëtar i Senatës të Universitetit Al Al-Bajt, anëtar i Këshillit të Dekanëve të Universitetit Al Al-Bajt, anëtar i Redaksisë "Prilozi za orijentalnu filologiju" (Sarajevë), dhe anëtar i redaksisë "Studime orientale" (Prishtinë).

### B. Veprimtaria shkencore

Dr. Muhamed Mufaku ka botuar një varg veprash nga historia dhe filologjia në gjuhën shqipe dhe në gjuhën arabe. Pos veprave, studimeve dhe artikujve është marrë edhe me përkthime. Ka përkthyer nga gjuha arabe në gjuhën shqipe dhe nga gjuha shqipe në gjuhën arabe. Në botën arabe dr. Mufaku konsiderohet njohësi më i mirë i problemeve të Ballkanit. Do t'i cekim titujt e kumtesave dhe punimeve të tij:

#### a) Kumtesa në konferencat rajonale ndërkombëtare

**"Dy qëndrime lidhur me islamizimin e shqiptarëve"**, kumtesë e paraqitur në Konferencën e X të mendimit islam (Algjer, 1976)

**"Një alfabet i përdorur te shqiptarët e Sirisë pas Lidhjes së Prizrenit"**, kumtesë e paraqitur në

simpoziumin kushtuar 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (Prishtinë, 1978)

**"Pjesëmarrja e shqiptarëve të Sirisë në Rilindjen Kombëtare të vendit"**, kumtesë e paraqitur në Seminarin e V të kulturës shqiptare për të huaj (Prishtinë, 1978)

**"Motivet algjeriane në poezinë shqipe"**, kumtesë e paraqitur në simpozium "Revolucioni algjerianë në letërsinë botërore" (Algjer, 1988)

**"Të dhënat e dokumenteve të vakëfit lidhur me përhapjen e islamit në Evropën Juglindore"**, kumtesë e paraqitur në Konferencën e I të historisë në Universitetin e Kajros, (Kajro 3-5 mars 1991)

**"Roli i vakëfit në ngritjen e qyteteve - dy shembuj nga Ballkani e Levanti: Kaçaniku e Kutajfa"**, kumtesë e paraqitur në Kongresin e V ndërkombëtar për studimet osmane, (Tunizi 25-29 shkurt 1992)

**"Pjesëmarrja e shqiptarëve në ushtrinë e Mehmet Aliut të dërguar në Arabi"**, kumtesë e paraqitur në Konferencën e V të historisë në Universitetin e Kajros, (Kajro 3-5 prill 1993)

**"Kryengritja e Kosovës dhe Kriza e Halepit"**, kumtesë e paraqitur në konferencën "Kosova nëpër histori" në Universitetin e Tiranës, (Tiranë 15-16 prill 1993)

**"Monumentet e Mehmet pashë Dukagjinit"**, kumtesë e paraqitur në konferencën ndërkombëtare "Halepi dhe rruga e mëndafshit", (Halep 25-30 shtator 1994)

**“Maqedonia si simbol i dezintegritetit dhe integritetit rajonal”,** kumtesë e paraqitur në konferencën shkencore “Pavarësia kombëtare dhe integriteti rajonal” (në Universitetin Al Al-Bajt 30 prill 1997)

**“Evropa e Islami: konfrontim ose koekzistencë-përvoja e shqiptareve”,** kumtesë e paraqitur në kongresin e dytë ndërkombëtar **“Evropa e Islami”,** (Universiteti Al Al-Bajt 10-13 qershor 1998)

**“Një paralele midis dy përkthimeve (serbe e shqiptare) të Kuranit”,** kumtesë e paraqitur në Konferencën ndërkombëtare “Përkthimet e Kuranit”, (Al Al-Bajt 18-21 maj 1998)

**“Bashkëjetesa fetare në Ballkan: llaramanët shqiptarë si shembull”,** kumtesë e paraqitur në konferencën shkencore të Institutit francez të Kajros, (Kajro 28-30 prill 2002)

**“Letërsia shqipe e shek. XX në botën arabe”,** kumtesë e paraqitur në Seminarin e XXI të Gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, (Prishtinë, 2002)

**“Një relaksim i Ibn Tigri Burdit”,** kumtesë e paraqitur në Konferencën shkencore të Institutit francez të Damaskut, (Damask 10-12 dhjetor 2003)

**“Prania shqiptare në klasën sunduese të Egjiptit në gjysmën e dytë të shek. XV”,** kumtesë e paraqitur në Seminarin XXIII të Gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, (Prishtinë 2004).

## b. Studime dhe artikuj në revista

**“Zhvillimi i lëvizjes demokratike në Shqipëri 1924-1939”,** (revista “Dirasat arabija” vol. X, no. 11, Bejrut 1974)

**“Historia e lëvizjes marksiste në Shqipëri dhe konfliktet interne”,** (revista “Dirasat arabija”, vol. X, no. 12, Bejrut 1974)

**“Një kthim të Maruf Arnauti”,** (revista “al-Bajan”, nr. 124, Kuvajt 1976)

**“Panoramë e poezisë shqipe në Jugosllavi”,** (revista “al-Bajan”, nr. 129, Kuvajt 1976)

**“Bektashizmi”,** (revista “al-Arabi” nr. 220, Kuvajt 1977)

**“Roli i Mehmet Ali pashës në paraqitjen e arabizmit”,** (revista “Përparimi”, nr. 5, Prishtinë, 1977)

**“Motive arabe në tregimet popullore shqiptare”,** (revista “al-Marifa” nr. 191-192, Damask 1978)

**“Feja dhe çështja fetare në Shqipëri”,** (revista “al-Arabi”, nr. 239, Kuvajt 1978)

**“Ymer Lutfi Paçarizi”,** (revista “al-Arabi”, nr. 242, Kuvajt, 1979)

**“Erveheja arabe dhe Erveheja shqiptare”,** (revista “al-Marifa” nr. 213, Damask 1979)

**“Një faqe e panjohur në jetën e poetit Ahmed Rami”,** (revista “al-Arabi” nr. 260, Kuvajt 1980)

**“Qerbelaja në letërsinë shqipe”,** (revista “al-Marifa” nr. 218, Damask 1980)

**“Lidhje luftarake midis Shqipërisë e Jemenit”,** (revista “al-Arabi”, nr. 263, Kuvajt 1980)

**“Një hyrje në letërsinë shqipe”,** (revista “al-Turath al-Arabi” nr. 3, Damask 1980)

**“Familjet e zgjeruara në Kosovë-Evropë”,** (revista “al-Arabi” nr. 266, Kuvajt 1981)

**“Motivet egjiptiane në letërsinë shqipe”,** (revista “al-Arabi” nr. 276, Kuvajt 1981)

**“Tarikati kaderi në Jugosllavi”,** (revista “al-Arabi” nr. 285, Kuvajt 1982)

**“Dorëshkrimet arabe në jug të Jugosllavisë”,** (revista e Institutit për dorëshkrimet arabe, vol. 26, nr. 2, Kuvajt 1982)

**“Skënderbeu shqiptar,** (revista “al-Arabi” nr. 292, Kuvajt 1983)

**“Shkrimi me shkronjat arabe te jo-arabët”,** (revista “al-Arabi” nr. 299, Kuvajt 1983)

**“Sinan Hasani prej fesë në politikë nëpërmjet letërsisë”,** (revista “al-Arabi” nr. 341, Kuvajt 1987)

**“Domethënia e arabizmave në romanin e Sinan Hasanit “Kur rrushika nis m’u pjek”,** (revista “al-Maukif al-adabi” nr. 196, Damask 1987)

**“Shqiptarët: ca etnonime për një komb”** (revista e Akademisë shkencore arabe, vol. 63, nr. 4, Damask 1988)

**“Nëna Tereze-Një poete që kishte emrin Gonxhe Bojaxhiu”,** (revista “al-Xhil”, vol. 10, nr. 2, Bejrut 1989)

**“Vdekja e dytë e Titos”,** (revista “al-Xhil” vol. 10, nr. 6, Bejrut 1989)

**“Adem Demaçi Mandela i Evropës”,** (revista “al-Muxhtama” nr. 10, Kuvajt 1989)

**“Motivet palestineze në letërsinë shqipe”,** (revista “al-Katib al-filistini” nr. 5, Damask 1989)

**“Trashëgimia popullore e myslimanëve në jug të Jugosllavisë”,** (revista “Funun” nr. 11-12, Amman 1992)

**“Dorëshkrimet arabe në Shqipëri”,** (revista “Jarmuk” nr. 40, Irbid 1993)

**“Islami dhe nacionalitetet në Ballkan”,** (revista “Dirasat tarihiya” nr. 47-48, Damask 1993)

**“Kujtimet e Ismail Qemalit për kundërrevolucionin e vitit 1913 në Stamboll”,** (revista “al-Muxhalla al-tarihiya al-arabija li al-dirasat al-othmanija” nr. 7-8, Tunis 1993)

**“Tirana - qyteti që u zhvillua rreth një xhamie”,** (revista “al-xhil” vol. 14, nr. 10, Bejrut 1993)

**“Kontributi i al-Asadit në prezantimin e arabizmave në gjuhët ballkanike”,** (revista e Akademisë shkencore arabe të Jordanisë, nr. 48, Amman 1995)

**“Organizimi i ri institucional i myslimanëve në Republikën e Maqedonisë”,** (revista “al-Nadua” vol. 7, nr. 3, Amman 1996)

**“Hasan Kaleshi si orientalist”,** (revista “al-Bajan” vol. 1, nr. 1, Mafrak 1997)

**“Kosova në vitet e dilemave midis Jugosllavisë e Shqipërisë 1918-**

- 1948**", (revista "al-Nadua" vol. 9, nr. 1, Amman 1998)
- "Arabizmat në gjuhën shqipe-një shikim në kontributin e Tahir Dizdarit"**, (revista "al-Turath al-ara-bi" nr. 37, Damask 1998)
- "Tri Kosova të ndryshme në shek. XX"**, (revista "al-Adab", nr. 7-8, Bejrut 1999)
- "Beteja e Kosovës pas gjashtë shekujsh"**, (revista "al-Fikr al-sijasi", nr. 6, Damask 1999)
- "Arabët e zinj në letërsinë popullo-re ballkanike"**, (revista "al-Bajan" vol. 2, nr. 3, Mafrak 1999)
- "Miroljub Jevtić prej Bosnjës në Kosovë"** (revista "al-Xhil" nr. 5, Bejrut 2000)
- "Figura shqiptare nga shek. XVI te al-Nahravali"**, (revista "Studime orientale" nr. 1, Prishtinë 2001)
- "Politizimi i orientalistikës në Jugosllavi"**, (revista "Kadaja istarati-xhija" nr. 8, Damask 2001).

### c. Artikuj në shtyp

Mbi 100 artikuj lidhur me Kosovën e shqiptarët në gazetatat "al-Hajat", "al-Mustakbal", "al-Raj" etj.

### ç. Vështrim libra

Afro 50 vështrime të librave të botuara në shqip, serbisht e anglisht lidhur me Kosovën dhe shqiptarët, të botuara në revista e gazeta "al-Arabi", "al-Hajat", "al-Mustakbal", "al-Raj" etj.

### d. Libra

- Antologjia e poezisë së re arabe**, Prishtinë 1979
- Palestina shqiptare (panorama e poezisë shqipe me motive palestinezë)**, Damask 1979
- Prapa natës**, poezi e shqiptarëve të Sirisë, Prishtinë 1980
- Antologjia e poezisë shqipe në Kosovë**, Damask 1981
- Tregime siriane** (zgjedhje, parathënie me përkthim), Prishtinë 1982
- Deti në shkretëtirë** (zgjedhje, parathënie me përkthim), Prishtinë 1983
- Letërsia shqipe me shkronja arabe**, Kuvajt 1983
- Svinga e gjallë** (përkthim i veprës së Rexhep Qosjes me parathënie), Kuvajt 1984
- Në brendi një botë tjetër** (zgjedhje e parathënie), Prishtinë 1985
- Era dhe lisi** (përkthim i romanit të S. Hasanit me parathënie), Bejrut 1986
- Historia e Beogradit oriental**, Kuvajt 1987
- Tregime popullore rome të Kosovës** (përkthim e Parathënie), Damask 1989
- Shqiptarët në botën arabe**, Prishtinë 1990
- Ana tjetër e Ittihad ve Terekki** (përkthim i studimit të H. Kaleshit mbi Ibrahim Temon me parathënie), Irbid 1990
- Studime mbi Devshermen** (zgjedhje studime të përkthyer me parathënie), Irbid 1991

- Historia e librit** (përkthim i veprës së A. Stipçeviqit me parathënie), Kuvajt 1993
- Islami në Jugosllavi**, Amman 1993
- Të dhëna për Damaskun e Sirinë Jugore në fund të shek. XVI/Va-këfnamja e Sinan pashës**, Damask 1993
- Studime në historinë kulturore të Sirisë gjatë shek. XVI**, Damask 1995
- Studime në historinë kulturore të islamit në Ballkan**, Dubaj-Tunis 1996
- Kosova - epiqendra e konfliktit shqiptaro-serb në shek. XX**, Kajro 1998
- Evropa dhe islami** (koautor e koeditor), Mafrak 1998
- Përkthimet e kuranit** (koautor e editor), Mafrak 1998
- Ndërlidhje arabe-ballkanike**, Damask 2000
- Roli i vakëfit në shoqëritë myslimane**, Damask 2000
- Kosova 1989-1999**, Amman 2000
- Studime mbi vakëfin e parave**, Tunis 2001
- Perandoria osmane** (koautor e koeditor), Mafrak 2001
- Revizionimi i orientalistikës: Jugosllavia si shembull**, Bejrut 2002
- Historia e Perandorisë osmane** (përkthim i veprës së Halil Inalxhikut me parathënie), Bejrut 2002
- Prej Islamistanit në atdhe e prej atdhetarizmit në nacionalizëm**, Bejrut 2004.

Dr. Mufaku si anëtar i jashtëm i ASHAK-së do të përfaqësojë vendet lindore të botës arabe. Ai këtu punoi disa vite dhe i dha dy teza të doktoratës. Nga shënime biografike shihet se mori pjesë aktive në tubime të shumta shkencore e profesionale. Merret me një lëmë me të cilën më së shumti u kontribuoi shkencave albanologjike, sidomos historisë së shqiptarëve në vendet arabe. Merita e tij e madhe është se popullarizoi literaturën në gjuhën shqipe si dhe personalitetet e dalluara shqiptare në fushën e shkencës, posaçërisht në periodikun arab. Dr. Mufaku pos Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë etj., ka një vepër po ashtu me vlerë të lartë shkencore, me titull: **"Tarihu Belgradi-l-islamijjati"** (Historia e Beogradit islam, Kuvajt, 1987).

Nga sa u tha më lart, kemi nderin dhe kënaqësinë që Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK-së dhe Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës t'u propozojmë që dr. Muhamed Mufaku me kualitetet e arritura në punën shkencore e profesionale i plotëson kushtet për t'u zgjedhur anëtar i jashtëm i ASHAK-së.

Prishtinë, më 7.10. 2004

Referues:

**1. Akademik Jashar Rexhepagiq**

**2. Akademik Ekrem Murteza**

## RECENSIONE

**Fet'hullah Hulejf**

### ANALIZË LIBRIT “EL-BIDAJETU” TË IMAM SABUNIT<sup>1</sup> DHE PIKËPAMJEVE TË TIJ AKAIÐORE<sup>2</sup>

#### I

Libri “*El-Bidajetu*” është një libër nga fusha e “*tevhidit*” apo e “*usulid-dinit*” (shkenca e Kelamit) sipas medh’hebit të Imam Ebu Mensur El-Maturidiut, dijetar i ehlu’s-sunnetit vel xhematit në pjesën e Transoksianisë dhe themelues i medh’hebit “*El-Maturidij*”, në të cilin o formësua Imam Sabuni. Si shkak i kësaj, në librin “*El-Bidajetu*” emri i imam Maturidiut frekuenton në më shumë se një vend, sikurse që në të interferojnë shumë prej terminologjive, të cilat i ka përdorur Maturidiu në librin e tij “*Kitabu’t-tevhid*”. Meqë kam hulumtuar shumë shkrime të Maturidiut dhe sho-

këve të tij, qofshin ato dorëshkrime apo të botuara,<sup>3</sup> kam vërejtur se Maturidiu bashkë me shokët e tij kanë terminologjitë e veta të veçanta në fushën e shkencës së Kelamit.

Sabuni nuk ndryshon nga Maturidiu në asnjë çështje të parimeve të medh’hebit. Këtë ai e dëshmon duke e prezantuar medh’hebin përmes një parathënie (hyrje) rreth mundësive të dijes (إمكان العلم) dhe të një studimi rreth “njohjes” dhe shkaqeve të saj. Te Imam Sabuni, shkaqet e njohjes apo rrugët që çojnë te dija ndaj realitetit të gjërave, janë të ngjashme me ato që janë te Maturidiu.<sup>4</sup> Ato janë tri:

- **shqisa** (الحس),
- **lajmi** (الخبر); dhe
- **vrojtimi** (النظر).

Sa i përket shqisës ajo nuk gabon, nëse shqisa është e shëndoshë dhe përdoret secila shqisë në veçorinë e vet.

Lajmi apo dëshmia e tjetrit: (شهادة الغير) që transmetohet në mënyrë gojore është dy llojesh:

1. *Lajmi mutevatir* (الخبر المواتر), i cili është mjeti jonë deri te dija për ndodhitë e kaluara dhe gjithçka tjetër që nuk kemi mundësi ta shohim personalisht. Ky lloj lajmi, për ta fituar bindjen e sigurt, është e domosdoshme të ekzaminohet.

2. *Lajmi i mbështetur në muxhizet e pejgamberëve*:

(الخبر المؤيد بالمعجزة من الأنبياء). Ky lloj lajmi është rrugë për dije, por është e domosdoshme, që t’i nënshtrohet vrojtimit dhe argumentimit, në mënyrë që të dallohen qartë pejgamberët prej magjistarëve dhe pretenduesve të pejgamberisë.

Vrojtimi i arsyes (نظر العقل) është dy llojesh:

1. *Aksiomatik* (بديهي), dhe
2. *Argumentues* (استدلالي).

Definicioni i lajmit aksiomatik, sipas Sabunit është ky: ajo çka arrihet nga shikimi i parë, pa pasur nevojë për observim dhe vrojtim:

ما يحصل بأول النظر من غير تأمل و تفكير<sup>5</sup>  
sikurse është dija se, tërësia është më e madhe prej secilës pjesë nga pjesët e saj.

Ndërsa definicioni i lajmit argumentues është ky: “ajo që arrihet pas ob-

servimit dhe vrojtimet me anë të medimit dhe arsyes:

ما يحدث بعد تأمل و النظر و أعمال الفكر و العقل

Nganjëherë arsyeja mund të gabojë në argumentimet e veta, qoftë kjo për shkak të pafuqisë që të arrijë shkallën e vrojtimit (النظر) ose për shkak të kufizimit (shkurtimit) në zbatimin e kushteve të medimit (الفكر). Për këtë arsye ndryshojnë normat e arsyes (أحكام العقل), por nuk sfidohen.

#### II

Në fakt konkludimet e arsyes mund të ndryshojnë sipas cilësisë së vrojtimit në zbatimin të kushteve të medimit, porse potenciali esencial i arsyes me të cilin njeriu është i pajisur, i mjafton atij për ta njohur Krijuesin e vet dhe ekzistencën e Allahut:

(يكفي لمعرفة خالقه و وجود صانعه) Për nga aspekti i argumentimit (التدليل) të ekzistimit të Krijuesit, Sabuni nuk ndryshon nga Maturidiu dhe as nga dijetarët e mirëfilltë të Kelamit, qofshin ata prej mutezilëve apo të Ehlus-sunnetit. Të gjithë ata ndjekin një metodë (المسلك) të vetme rreth argumentimit të ekzistimit të Krijuesit nëpërmjet vërtetimit të krijimit të gjithësisë (بحدوث العالم)<sup>6</sup>

Gjithësia është *substanca* (أعيان) dhe *aksidenca* (أعراض). Substancat nuk ndahen nga aksidencat, ndërsa aksidencat mund të jenë që lëvizin ose

që nuk lëvizin, të bashkuara ose të ndara dhe si të tilla janë të krijuara (حادثة). Krijimi i tyre vërtetohet me shqisa dhe dëshmi. Gjithçka që nuk mund të ndahet nga e krijuara, ajo është e krijuar, ndërsa e krijuara lejohet të ekzistojë apo të mos ekzistojë (و الحادث جائر الوجود و العدم), dhe në kontekstin racional, mundësia e ekzistimit dhe e mosekzistimit të saj (إمكان وجوده و عدمه). është e barabartë. Për t'i dhënë përparësi ekzistencës së saj kundrejt mosekzistimit, kjo pa tjetër duhet të mbështetet te një mbizotërues (مرجح), porse është absurde (يستحيل) që ai mbizotërues të jetë ekzistim i lejueshëm vetvetiu (جائر وجود لذاته) dhe të jetë e nevojshme për një mbizotërues tjetër (مرجح آخر) dhe kështu të futemi në një proces që është i pamundur. Prandaj, domosdoshmërisht përfundojmë në konstatimin se “mbizotëruesi” duhet të jetë ekzistim i domosdoshëm vetvetiu, i përhershëm pa fillim, e Ai është Allahu i Lartmadhëruar:

فيلزم أن تنتهي إلى القول بمرجح واجب الوجود  
لذاته، قدم و هو الله جل جلاله

### III

Allahu i Madhëruar është Një i vetëm, i pa shok, për dallim nga dualistët, mexhusët, të krishterët, ithtarët e idesë për ekzistimin e katër natyrave (الطبايع الأربعة) dhe të idesë së shtatë orbitave (الأفلاك السبعة).

Sabuni i kundërshton pretendimet e këtyre fraksioneve dhe sjell argumente të qarta rreth Njëshmërisë së Allahut, që nuk ndryshojnë nga argumentet, të cilat i gjejmë të detajizuar te Esh'ariu dhe në mënyrë të përgjithshme te Maturidui. Mbase, Sabuni në këtë aspekt gati se nuk shtonë asnjë fjalë më shumë se ajo që e ka thënë Esh'ariu.

Sabuni thotë: “Sikur të ishin dy Krijues, do të paraqitej konflikti i interesit. Kur njëri dëshiron ta krijojë jetën (gjallërinë) në ndonjë trup, kurse tjetri dëshiron ta krijojë vdekjen në po të njëjtin trup, atëherë vjen në pyetje se cilit do t'i realizohet dëshira, të dyve, apo njërit prej tyre. Realizimi i të dy vullneteve është i pamundur (محال). Nga ana tjetër, nëse realizohet vullneti i njërit, e i tjetrit jo, ai të cilit nuk i realizohet do të konsiderohej i detyruar (مقهور), ndërsa i detyruari (المقهور) nuk mund të jetë Zot...”<sup>8</sup>

Në librin “*El-Luma*” të Esh'ariut lexojmë: “Nëse dikush thotë: përse thoni se Krijuesi i çdo gjëje është Një i vetëm? Atij i thuhet: sepse planifikimi i të dyve nuk mund të aplikohet në krijim e as nuk mund të jetë unik në dispozitë. Pa tjetër që t'i mvishet dobësia ose të dyve ose njërit prej tyre, sepse kur njëri nga ta dëshiron t'ia vazhdojë jetën një njeri, kurse tjetri e dëshiron të kundërtën, nuk ka mundësi që të manifestohet vullneti i të dyve bashkërisht, por mund të realizohet

vetëm vullneti i njërit prej tyre. Është absurde që të realizohet vullneti i të dyve bashkërisht, sepse është e pamundur që në të njëjtën kohë, një trup i njëjtë të jetë edhe i gjallë edhe i vdekur. Nëse kjo nuk realizohet, atëherë pashmangshëm konstatohet dobësia e tyre. Ndërsa i dobëti (العاجز) nuk mund të jetë Zot e as i pa fillim. Por, nëse realizohet vullneti i njërit prej tyre, e tjetrit jo, obligohet dobësia e atij, të cilit nuk i është realizuar dëshira e tij. Ndërsa i dobëti nuk mund të jetë Zot e as i Përhershëm. Prandaj, kjo argumenton atë që e thamë se Krijuesi i çdo gjëje është Një i Vetëm.”<sup>9</sup>

Këto argumente në mënyrë të përgjithësuar (مجملا) i gjejmë edhe te Maturidui, i cili në “*kitabut-tevhid*” thotë:

“Asgjë nuk mund të ekzistojë, derisa njëri e dëshiron atë kurse tjetri e mohon atë. Po ashtu, nuk mund të dëshirojë ndonjëri nga ta ekzistimin e një gjëje, derisa tjetri e dëshiron mosekzistimin e të njëjtës. Faktikisht kjo paraqet edhe vazhdimin e jetës (الإبقاء), po edhe shkatërrimin e saj (الإفناء) njëkohësisht, sepse ekziston edhe kundërshtimi dhe mohimi...”<sup>10</sup>

### IV

Gjithashtu Sabuni nuk ndryshon nga i gjithë ‘*ehlus-sunneti vel xhemati*’, nga Maturidinjtë<sup>11</sup> dhe esh'arinjtë rreth vërtetimit të cilësive *Qeniesore* (المعاني) apo kuptimore (الذاتية) të

Allahut. Sipas Imam Sabunit, Allahu cilësohet me të gjitha ato me të cilat e ka cilësuar Vetën e Tij, sikurse janë jeta (الحياة), dija (العلم) fuqia (القدرة), dëgjimi (السمع) shikimi (البصر) vullneti (الإرادة) dhe të folurit (الكلام). Të gjitha këto cilësi janë të përhershme pa fillim (أزلية) dhe të gjithmonshme pa fund (أبدية), që vetekzistojnë nga vetvetiu i Qenies. Ato nuk janë të ndara nga Qenia dhe as tjetër nga Ajo (لا هي عين ذاته و لا غيرها) dhe se nuk ngjasojnë me cilësitë e krijësive nga asnjë aspekt.

Ndërsa cilësitë e veprimt (صفات الفعل), sikurse janë: krijimi nga asgjëja (التكوين), furnizimi (الرزق), të dhënit (الإماتة), të dhënit vdekje (الإحياء), dhe të tjera prej cilësive që ndërlidhen me veprimet, ato janë te Sabuni ashtu sikurse janë te maturidinjtë, të përhershme pa fillim që vetekzistojnë nga vetvetiu i Qenies (قديمة قائمة بذات الله), përderisa te esh'arinjtë janë cilësi relative të krijuara (نسبية حادثة)<sup>12</sup>

### V

Allahu i madhëruar posedon cilësinë e të folurit (الكلام), e cila është cilësi unike dhe e pa fillim. Të folurit e Tij ekziston nga vetvetiu i Qenies dhe nuk është as nga lloji i shkronjave e as nga lloji i tingujve; as nuk ndahet në pjesë e as në tërësi:

ليس من جنس الحروف و الأصوات،  
لا يتجزأ و لا يتبعض.

Sabuni këtu bën dallim, sikurse e bëjnë këtë i gjithë eh-lus-sunneti vel xhemati nga maturidinjtë dhe esharianjtë, ndërmjet të folurit të brendshëm (الكلام النفسي) dhe shprehjeve, fjalëve dhe shkronjave që e dëftojnë atë.

Të folurit e brendshëm (الكلام النفسي) është cilësi unike, e përhershme e pa fillim dhe ekziston nga vetvetiu i Qenies. Ndërsa sa i përket shprehjeve (العبارات), fjalëve (الألفاظ) dhe shkronjave të ndara (الحروف), që e dëftojnë atë, ato janë të krijuara (حادثه).

Prandaj, Kur'ani Kerim për nga shprehja e tij si 'mus'haf' (koleksion) i tubuar ndërmjet kopertinave dhe që lexohet, pa dyshim se është i krijuar. Apo me fjalë të tjera, fjalët e fjalitë, periudhat dhe ajetet e shkruara në mus'haf dhe ato që dalin nga gjuhët tona me rastin e leximit të Kur'anit, që të gjitha janë të krijuara.

Ndërsa sa i përket të folurit të brendshëm, i cili përbën esencën (أصل) e të 'folurit', nuk është i shkruar askund prej koleksioneve, dhe si i tillë, është cilësi e Allahut i përhershëm pa fillim që ekziston nga vetvetiu i Qenies. Rreth këtij koncepti të ndarjes së të folurit: në të brendshëm dhe fjalëve dhe shkronjave që e dëftojnë atë, ekziston konsensusi i plotë (الإجماع), ndërmjet eh-lus-sunnetit vel xhematit<sup>13</sup>.

Mirëpo, eh-lus-sunneti vel xhemati, kanë mendime të ndryshme rreth

asaj se, a lejohet të dëgjohet të folurit e brendshëm?

Sabuni e parashtron këtë papajtueshmëri e thotë: "Pastaj, eh-lus-sunneti vel xhemaati kanë mendime të ndryshme nëse Fjala e Allahut potencialisht është e dëgjueshme (مسموع) apo absolutisht e padëgjueshme (غير مسموع). Esh'ariu e ka zgjedhur mendimin se çdo gjë që ekziston, ashtu sikurse lejohet të shihet, lejohet edhe të dëgjohet:

(كما يجوز أن يري، يجوز أن يسمع). Ibni Fevreki ka thënë: e dëgjua me rastin e leximit të lexuesit implikon dy çështje: zërin e lexuesit dhe Fjalën e Allahut të Madhëruar. Ebu Beker El-Bakilani ka thënë: nuk është e zakonshme, por lejohet që Allahu t'ia mundësojë të dëgjuarit e të folurit të Tij, atij që dëshiron prej krijesave të Tij, po qoftë kjo edhe në kundërshtim me atë që është e zakonshme. Te këta, Musa a.s. e ka dëgjuar Fjalën e Allahut të Madhëruar pa ndërmjetësues të zërit dhe shkronjave.

Ebu Is'hak El-Isfirajini dhe ata që e pasojnë atë ka thënë: në parim (esencë), fjala e Zotit është e padëgjueshme (غير مسموع), dhe ky është mendimi i dijetarit, Imamit, kryetarit të 'eh-lus-sunnetit vel xhemaatit Ebu Mensur El-Maturidij.

Sa i përket fjalës së Allahut në ajetin:

حَتَّى يَسْمَعَ كَلَامَ اللَّهِ

"që t'i dëgjojë fjalët e Allahut (Kur'anin)" (Kur'ani, Et-Tevbe: 6); me të synohet: "derisa ta dëgjojë atë që e dëfton fjalën e Zotit": (حتى يسمع ما يدل علي كلام الله), sikurse thuhet: سمعت علم فلان – e kam dëgjuar diturinë e filanit, do të thotë, e kam dëgjuar atë që e dëfton diturinë e tij, ose sikurse thuhet: أنظر إلي قدرة الله – shiko në fuqinë e Zotit!, do të thotë, në atë që e dëfton fuqinë e Tij. Ndërsa te këta, Musa a.s. e ka dëgjuar një zë që e dëfton të folurit e Allahut të Madhëruar, përveçse ai nuk ka pasur ndërmjetësim të librit e as të melekut, prandaj edhe për këtë është quajtur "kelimull-ilahi teala" - i bashkëbiseduari i Allahut të Lartësuar.<sup>14</sup>

Ne, në këtë parashtrim të Imam Sabunit kemi disa vërejtje:

**E para:** Siç duket, Sabuni nuk është shumë i saktë në parashtrimin e këtij mospajtimi (ihtilaf), sepse ne nuk kemi gjetur ndonjë indikacion në librin "Kitabut-tevhid", që dëfton se El-Maturidiu e konsideron si të pamundur absolutisht të dëgjuarit e të folurit të brendshëm (elkelamun-nefsij).

**E dyta:** kjo mesele nuk është subjekt mospajtimi ndërmjet esh'arinjve dhe maturidinjve, por është subjekt mospajtimi ndërmjet vetë maturidinjve. Ka prej pasuesve të imam Maturidiut, që e lejojnë të dëgjuarit e të

folurit të brendshëm, kurse ai (Sabuni) e ka konsideruar këtë si të pamundur (mustehiil), sepse sipas tyre Allahu është i plotfuqishëm që të krijojë fuqi dëgjuese që mund ta arrijë të folurit e brendshëm. Por, padyshim ka edhe të tjerë prej tyre, që e konsiderojnë si absurde të dëgjuarit e të folurit të brendshëm të Allahut, duke e kushtëzuar këtë me atë se ajo nuk përbëhet nga tingujt dhe shkronjat. Duket qartë se Sabuni është prej grupit të fundit.<sup>15</sup>

**E treta:** disa prej shokëve të Esh'ariut, sikurse është Imam Ebi Is'hak El-Isfirajini dhe ata që e pasojnë atë, nuk janë të një mendimi me Eshariun në këtë çështje dhe e kanë përkrahur mendimin e pasuesve të Maturidiut, të cilët e konsiderojnë absurde dëgjimin e të folurit të brendshëm. Kjo e përforcon atë që ne e kemi mbështetur gjithmonë se kjo papajtueshmëri (el-ihtilaf) ndërmjet dy shkollave të eh-lus-sunnetit në këtë çështje dytësore (الفرعية) nuk është e prerë.<sup>16</sup>

## VI

Allahu është i pastër nga çdo aspekt i përngjasimit të Tij me krijesat. Ai nuk është trup (جسم), as nuk ka formë (صورة), as nuk ka anë (جهة) e as vend (مكان). Sa u përket ajeteve dhe haditheve që në aparencë dëftojnë trupëzimin (التجسيم) përngjasimin (التشبيه), duke i atribuar anë apo vend, Sabuni në këto çështje ndalet në qëndrimin e

përbashkët të ehilus-sunetit. Ndërsa, ehilus-sunneti në këto çështje ndjekin dy rrugë:

1. Pranimi, dorëzimi dhe besimi ndaj tyre ashtu sikurse kanë ardhur, pa e hulumtuar përmbytjen e tyre (min gajri bahthin), kurse interpretimin e tyre e mbështetim (tefviid) tek Allahu, duke zhveshur Allahun nga çdo përngjasim. Ky është qëndrimi i gjeneratave të para (selefit<sup>17</sup>) ndaj teksteve të Kur'anit dhe Hadithit që nuk janë krejtësisht të qarta (muteshabihateve); dhe

2. Pranimi i tyre dhe hulumtimi i komentimit të tyre sipas aspektit që i takon Qenies së Allahut të Lartësuar, që është e vërtetuar nga arsyeja dhe që është në pajtim të plotë me përdorimet e gjuhëtarëve. Krahas kësaj, me këtë nuk ndërpritet prerazi se ky interpretim është synimi i Allahut të Madhëruar (مراد الله تعالى). Ky është qëndrimi i gjeneratave të mëvonshme (halefit<sup>18</sup>). Ndërsa te Sabuni, rruga e selefit është dorëzimi (أسلم), ndërsa rruga e halefit është gjykimi (أحكم).

## VII

Të shikuarit në Allahun është një obligim nga dëgjimi (واجبة سمعا). Besimtarët do ta shohin Allahun e Madhëruar në botën tjetër, jashtë çdo përngjasimi, anë dhe pozitë ballë për ballë. Mund të themi se Sabuni nuk ndryshon nga El-Maturidiu rreth inter-

pretimit të ajeteve, me të cilat argumentohet vërtetimi i shikimit në Allahun (الرؤية), mirëpo ndryshon rreth argumentimit të lejimit të shikimit në Allahun nga aspekti i arsyes (عقلا). Imam Maturidiu beson në “shikim”, pa hyrë në komentim të teksteve (بدون تفسير),<sup>19</sup> duke konsistuar në atë se, ne nuk kemi mundësi ta argumentojmë shikimin përmes argumenteve të arsyes:

لا نستطيع أن نثبت الرؤية بدليل عقلي

Ndërsa Sabuni rreth argumentimit të kësaj çështjeje, i frekuenton argumentet e Esh'ariut, të cilat kelamistët i quajnë argumentet e ekzistimit (دليل الوجود). Ai thotë: Vërtetojmë se mundësia e shikimit në botën fenomenale, ndodh nga aspekti i ekzistencës e jo nga ndonjë aspekt tjetër. Atëherë, Allahu i Madhëruar ekziston, andaj lejohet që të shihet (والله تعالى موجود، فيجوز أن يري). Argumenti i kësaj është ai, se ne shohim në botën fenomenale gjëra me të vërteta të ndryshme sikurse janë substancat (الجواهر), trupat (الأجسام), pastaj ngjyrat e kundërta siç është e bardha me të zezën, dhe ekzistenca të ndryshme sikurse janë lëvizja (الحركة) dhe palëvizja (السكون), të cilat e kundërshtojnë të zezën dhe të bardhën. Aksidencat (el a'rad) me tërësinë e tyre janë e kundërta e trupave dhe substancave. Prandaj, është e domosdoshme që të bëhet një cilësim i pë-

gjithshëm që e përmban tërësinë dhe e pamundëson shikimin në atë cilësim, për të cilin nuk ekziston as shkaku e as e kundërta, dhe e tillë nuk mund të jetë, përpos ekzistenca (الوجود).<sup>20</sup>

Ky është argumenti, të cilin edhe në shprehje edhe në përmbytje e gjejmë te Esh'arinjtë. Imam Rraziu (që është prej dijetarëve Esh'arij) thotë: “dije se shumica e dijetarëve tanë janë bazuar në aplikimin e argumentit, sipas të cilit, i Lartmadhërishtmi është e drejtë që të shihet, ngase Ai ekziston... Më tej (Esh'arinjtë) kanë thënë: është e vërtetuar se substancat lejohet të shihen, po ashtu edhe ngjyrat. Substancat dhe ngjyrat bashkërisht rezultojnë realitetin e shikimit (صحة الرؤية). Kjo e vërtetë (صحة) e ka dispozitën e të krijuarës, andaj patjetër që ajo ta ketë një shkak. Nga ana tjetër, dispozita e përbashkët obligon shkaktimin e saj nga një shkak i përbashkët, në mënyrë që të mohohet shkaktimi i dispozitës së njëjtë përmes shkaqeve të ndryshme. I përbashkëti nga substancat dhe aksidencat ose është i ngjarë (الحدوث) ose është ekzistencë e domosdoshme (الوجود). Nuk është e mundur që shkaku i kësaj të vërtete (الصحة) të jetë ‘i krijuari’ (الحدوث), ngase ‘el-huduth’ është shprehje për një ekzistencë të ndodhur (وجود حاصل) dhe që i ka paraprirë inekzistenca (عدم سابق), ndërsa inekzistenca (العدم) nuk lejohet që të jetë pjesë e të domosdoshmit,

kur eliminohet inekzistenca nga kategoria e idesë, nuk mbetet tjetër përpos ekzistenca, ndërsa ekzistenca bashkon në vete edhe realitetin e **hapur** edhe të **fshehur**. Prandaj, ekzistimi i Allahut është shkak i shëndoshë për realitetin e shikimit në Atë:

(فإذن وجود الله علة صالحة لصحة رؤيته).<sup>21</sup>

Po ashtu ka ndodhur një diskutim ndërmjet Rraziut dhe Sabunit rreth këtij argumenti<sup>22</sup>, dhe ne e kemi pa se si Rraziu e përkrah drejtpërdrejt mendimin e Maturidiut kur thotë: medhhebi jonë në këtë mesele është ai që e ka zgjedhur shejh Ebu Mensur El-Maturidij Es-Samarkandi, sipas të cilit ne nuk mund ta argumentojmë të vërtetën e shikimit në Allahun e Madhëruar përmes argumentit të arsyes, por ne në këtë mesele i përmbahemi prerazi aparcës së ajeteve të Kur'anit dhe haditheve:

بل نتمسك في هذه المسئلة بظواهر القرآن و الأحاديث,<sup>23</sup>

kundrejt Sabunit, i cili e zgjedh anën e Esh'ariut dhe se dijetarët më të mëdhenj të esharinjve janë me vërtetimin e të vërtetës së shikimit përmes argumentit të arsyes.

## VIII

Allahu i Madhëruar e ka krijuar njeriun dhe i ka krijuar të gjitha veprimet e tij dhe veprat e tij, sipas fjalës së të Lartmadhërishtmit:



وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ وَمَا تَعْمَلُونَ

**“Allahu u krijoi juve dhe atë që punoni”** (Kur’ani, Es-Saffat:96)

Veprat e njeriut, që krijohen nga ana e Allahut të Lartësuar janë dy lloje:

Një lloj, të cilat Allahu i krijon pa pjesëmarrjen e fuqisë së njeriut dhe të zgjedhjes së tij, sikurse është lëvizja e gjallërisë, dhe

Një lloj të cilin Allahu i Lartësuar i krijon me pjesëmarrjen e vullnetit të njeriut dhe të fuqisë së tij, siç janë lëvizjet që njeriu i vepron me zgjedhjen e tij të lirë (الحركات الاختيارية).

Lloji i dytë është ai që quhet ‘fitimi’ (الكسب). Ky fitim është baza në të cilën bazohet shpërblimi, ndëshkimi dhe përgjegjësia e njeriut për veprimet e tij. Sepse njeriu kur e synon veprimin e së keqes, Allahu në atë moment ia krijon fuqinë për ta bërë atë të keqe. Pra, njeriu si shkak i këtij ‘synimi’ i bën dëm vetvetes, ngase potencialisht ka mundësi ta veprojë veprën e mirë duke iu shmangur synimit të veprës së keqe.

Kështu që vepra realizohet nga ana e Allahut dhe e njeriut. Kur mbështet tek Allahu, ajo quhet krijim (خلقا), ndërsa kur mbështet te njeriu ajo quhet fitim (كسب). Sabuni bën dallim ndërmjet ‘krijimit’ dhe ‘fitimit’, duke thënë se krijimi është ajo çka ndodh pa ndihmën e mjeteve, ose që lejohet

të ndodhë vetëm nga i Plotfuqishmi, ndërsa fitimi është ajo që ndodhë me ndihmën e mjeteve ose që nuk lejohet të realizohet vetëm nga i Plotfuqishmit. Andaj, Allahu i Lartmadhëruar, pasi që krijon pa ndihmën e mjeteve, ai këtë e bën në mënyrën më të lehtë të mundshme, pra, vetëm me thënien e Tij “kun” - ‘bëhu’!, me një fjalë që përbëhet nga dy shkronja. Edhe kjo mjafton për ta dëftuar madhësitë e Krijuesit.

## IX

Besimtari nuk del nga imani për shkak të mëkatit të madh që e bën, sepse veprat nuk hyjnë në të vërtetën e imanit (في حقيقة الإيمان). E vërteta e imanit është besimi i plotë me zemër (التصديق بالقلب), kurse deklarimi me gjuhë është indikacion i tij (أمانة عليه). Deklarimi është kusht për aplikimin e dispozitave të fesë:

و الإقرار شرط إجراء الأحكام, sepse tasdiki është çështje e fshehtë dhe nuk mund të aplikohen dispozitat ndaj tij derisa njeriu nuk e deklaroi atë edhe me gjuhë. Për këtë arsye, njeriu që e deklaroi me gjuhën e tij dëshminë e shehadetit, kurse në zemrën e tij e fsheh kufrin, ndaj tij aplikohen të gjitha dispozitat të cilat aplikohen edhe për të gjithë myslimanët në këtë botë. Por, ai është kafir tek Allahu në botën tjetër. Pejgamberi a.s. ka thënë:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَمَرْتُ أَنْ أُقَاتِلَ النَّاسَ حَتَّى يَقُولُوا لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ فَمَنْ قَالَ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ فَقَدْ عَصَمَ مِنِّي مَالَهُ وَنَفْسَهُ إِلَّا بِحَقِّهِ وَحِسَابِهِ عَلَى اللَّهِ

*“Më është urdhëruar që t’i luftoj njerëzit derisa të thonë la ilahe il-lall-llah - nuk ka zot tjetër pos Allahut. Kush e thotë këtë, ai e ka siguruar prej meje pasurinë dhe jetën e tij, përveç nëse shkel ndonjë dispozitë islame, për të cilën tek Allahu do të japë llogari”*<sup>24</sup>

## X

Këto janë disa prej parimeve më të rëndësishme të medhhebit (hanefi - maturidi) te Sabuni. Ato në mënyrë subjektive janë parime të medh’hebit të Maturidiut dhe maturidinje në përgjithësi sikurse janë Ebi’l-Muin En-Nesefij ku Sabuni ishte bërë nxënës i “Tebisrit” të tij dhe Imam Omer En-Nesefij, i cili ka ardhur pas Sabunit dhe ka shkruar librin e njohur “El-Akaidun-nesefijjetu”. Vepra “Et-Tebsir” e Ebi’l-Muin En-Nesefiut, “El-Bidajetu” e Nurud-din Es-Sabunit dhe “El-Akaidu” i Omer En-Nesefiut, konsiderohen prej burimeve më të rëndësishme të shkollës maturidite të eh-lus-sunnetit vel xhemaatit në pjesën e Transoksanisë.

Praktikisht, Sabuni ishte zhvilluar si nxënës i “Tebisrit” të Imam Nesefiut, përveçse ai nuk e kishte pasuar autorin e “Tebisrit” në armiqësinë e tij të ashpër ndaj eh-lus-sunnetit vel xhemaatit të krahut esh’arij. Gjithherë kur e lexon në “El-Bidajetu” shprehjen “eh-lul hak-ki” dhe shprehjen “eh-lus-sunneti” me të ekskluzivisht synohen esh’arinjtë dhe maturidinjtë. Kështu që Sabuni, nuk e ka neglizhuar përmendjen e emrit të Maturidiut në El-Bidajetu, sikurse këtë e ka bërë autori i “El-Akaidun-nesefijjetu”.

Nga gjuha arabe:

**Orhan Bislimaj**

<sup>1</sup> Imam Sabuni është ndër dijetarët e mëdhenj të maturidizmit. Emri i plotë i imam Sabunit është: “Ahmed bin Muhamed bin Bekr Es-Sabuni, Ebu Muhamed Muhamed me pseudonimin Nurud-din. Imam dhe autor i veprës “El-Bidajetu fi usulid-din”. Ka vdekur, në kohën e namazit të akshamit në natën e ditës së mërkurë më 16 sefer të vitit 580 h. (1184 m.) është varrosur në varrezat “El-Kud-datus-seb’atu” në Buhara. Fikhun e ka mësuar nga dielli i Imamëve Muhamed El-Kerderij, Allahu i mëshiroftë.” (Shih: Ebi’l-Vefa El-Kurejshi “El-xhevahiru’l-mudijjetu fi tabekati’l-hanefijjeti”, boton ‘darul kutubil misrij-jeh’ Beirut, botimi i parë, 2005/1426, fq. 85). (Përkthyesi).

<sup>2</sup> Ky punim është një njësi e shkëputur nga libri i përkthyer, por ende i pabotuar: *Esh-Shejh’ul Imam Nurud-din Es-Sabuni “Kitabu’l-bidajeti mine’l-kifajeti fi’l-hidajeti fi usulid-din”, tahkik dr. Fet’hullah Hulejff, boton ‘darul mearif’ Egjipt, 1969, fq. 15-24. (Përkthyesi).*

<sup>3</sup> Krahaso psh.: El-Maturidij “*Kitabut-tevhid*” dorëshkrim në Kembrixh nr. 3651, add.; “*Kitabut-te’vilati ehliis-sunneti*” dorëshkrim në ‘darul kutubil misrijjeti’ nr. 873, tefsir; Ebul Muin En-Nesefij “*Tebsiretu’l-edil-leti*”, dorëshkrim i ‘darul kutubil misrijjeti’ nr. 42, tevhid; Omer En-Nesefij “*El-Akaidun-Nesefijjetu*”, botim i Kajros, 1326 h.; Alij El-Kari “*Sherhu’l-Fikhi’l-ekber*” botimi i Kajros, 1323 h.

<sup>4</sup> Shih: El-Maturidij “*Kitabut-tevhid*”, fleta 3-5, dorëshkrimi i Kembrixhit nr. 3651, add.

<sup>5</sup> Citat nga teksti i librit “*Kitabul bidajeti*” fq. 30.

<sup>6</sup> Shih për shembull: El-Maturidij “*Kitabut-tevhid*” fleta 5-9, el-hijat; “*Kitabu’l-intisari*” fq. 46-48 me tahkik të dr. Nibrixhit, botimi i Kajros, 1925.

<sup>7</sup> “*Katër natyrat*” te njerëzit e periudhave antike kanë qenë këto: nxehtësia, ftohtësia, njomësia dhe thatësia (shih: Ibrahim Mustafa, Hamid Abdul Kadir, Ahmed Hasan eZ-Zijat, Muhamed Alij Nexhar, ‘*El-Mu’xhemu’l-Vesit*’ - ½, boton Darud-da’veti, Stamboll, Turqi, 1989/1410, fq. 550 - **Përkthyesi**).

<sup>8</sup> Teskti i “*Kitabu’l-bidajeti*...”, fq. 40.

<sup>9</sup> “*Kitabu’l-lum’a*”, fq. 8, tahkik El-Ebu Mekarithi, Beirut, 1953.

<sup>10</sup> “*Kitabut-tevhid*”, fleta 9.

<sup>11</sup> Shih për shembull:

Prej shkrimeve të Maturidiut dhe maturidinjeve: El-Maturidij “*Kitabut-tevhid*” fleta 21-24; “*Kitabut-te’vilati ehliis-sunneti*” dorëshkrim i ‘darul kutubil misrijjeti’, nr. 378, tefsir; Ebul Muin En-Nesefij “*Tebsiretu’l-edil-leti*”, dorëshkrim i ‘darul kutubil misrijjeti’, nr. 42, tevhid; Omer En-Nesefi “*El-Akaidun-Nesefijjetu*” botimi i Kajros 1326 h.

Prej shkrimeve të El-Eshariut dhe esharinjve p.sh.: El-Esharij “*Kitabul-lum’a*” tahkik El-Ebu Mekarithi, botimi i Bejrutit, 1953; “*Mekalatu’l-islamij-jin*” tahkik i Rihterit, botimi i Stanbollit 1929; El-Bakilaniu “*Kitabu’t-temhid*” me tahkik të El-Ebu Mekarithi botimi i Bejrutit 1957; Er-Rrazi “*Kitabu’l-erbeine fi*

*usulid-din*” botimi i Hajdar Abadit, 1535 h.; El-Ixhi “*Kitabu’l-mevakifi*” botimi i Kajros, 1292 h.

<sup>12</sup> Shih librin tonë: Kholeif, “*A study on Fakhr Al-Din Al Razi*”, pp. 89-104.

<sup>13</sup> Shih: El-Bejadi “*Isharatu’l-meram min ibarati’l-imam*”, fq. 138-144, botimi i Kaijros, 1949.

<sup>14</sup> “*Kitabu’l-bidajeti*”, fq. 66

<sup>15</sup> Shih: Shejhu Zade “*nadhmu’l-feraidi*”, fq. 16, botimi i Kajros, 1317 h.

<sup>16</sup> Shih librin tonë: Kholeif, “*A study on Fakhr Al-Din Al Razi*”, pp. 4, 105, 113, 118 – 130.

<sup>17</sup> Me ‘*Selef*’ - synohen dijetarët e mëdhenj, që kanë jetuar deri në fund të qindvjeçarit (shekullit) të tretë, sipas kalendarit hixhrij – lunar. **(Përkthyesi)**.

<sup>18</sup> Me ‘*Halef*’ - synohen dijetarët e mëdhenj, që kanë ardhur pas qindvjeçarit (shekullit) të tretë. **(Përkthyesi)**.

<sup>19</sup> El-Maturidi, “*Kitabut-tevhid*”, fleta 37.

<sup>20</sup> “*Kitabu’l-bidajeti*”, fq. 78.

<sup>21</sup> Er-Rrazi, “*Kitabu’l-erbeine fi usulid-din*”, fq. 191, botimi i Hajdar Abadit, 1353 h.

<sup>22</sup> Kholeif, “*A study on Fakhr Al-Din Al Razi*”, fq. 118-130, po ashtu shih: “*Nas-su munadherati Fahrid-din er-rrazi fi biladi ma verae’n-nehri*”, fq. 16.

<sup>23</sup> Er-Rrazi, “*Kitabu’l-erbeine fi usulid-din*”, fq. 198, botimi i Hajdar Abadit, 1353 h.

<sup>24</sup> Hadithin e transmeton Ebu Hurejra r.a.. shih: *Sahihu’l-Muslim*, kitabu’l imani, kapitulli: el-emru bikitali’n-nasi hat-ta jekulu la ilahe il-lall-llah..., nr. 29. **(Përkthyesi)**.

## KRONIKË

## VDIQ GJENIU I NOVELËS ARABE TAJIB SALIH (1929-2009)



“Vdiq në Veri, “ku ishte shpërngulur”, ashtu sikur heroi i tij Mustafa Seidi, mirëpo, koha e shpërnguljes së tij vazhdoi gjatë, derisa ajo u bë një jetë e tërë. Ai ndërroi jetë në moshën tetëdhjetë vjeçare, duke lënë pas veti tri romane, disa përmbledhje tregim-

esh si dhe një numër të madh të artikujve gazetaresk e letrar. Letërsia arabe humbi dje njërin prej simboleve të saj më të njohura të shekullit njëzet”, kështu shkruante shkrimtari sudanez Muhamed Sheir për kolegun e tij Tajib Salih, në një artikull me titull: “Lamtumirë Zorba i Sudanit”, për të përditshmen e Hartumit “al-Akhbar”.

Më 17 shkurt, në Londër, vdiq shkrimtari sudanez, Tajib Salih, i cili u afirmua me romanin e tij “Koha e shpërnguljes në veri”, që ishte botuar për herë të parë në Bejrut në vitin 1966, me të cilin ishte kandiduar për çmimin Nobel për letërsi.

Vdekja e novelistit më të njohur arab u prit me një dhembje të madhe në të gjitha mediat arabe, sepse “anglezi i zi nga brigjet e lumit Nil”, ashtu siç e quanin disa kritikë arabë, shkrimtarin Tajib Salih, deri më tash ishte i

pzavendësues në letërsinë bashkëkohore arabe në fushën e novelës.

Tajib Salih, u lind në vitin 1929 në fshatin Kermkol, në provincën Merevi në veri të Sudanit. Pas studimeve në Universitetin e Hartumit, në vitin 1953 vazhdon studimet në Britani të Madhe. Një kohë punoi në Shërbimin BBC, programi në gjuhën arabe ku arriti të jetë drejtor i sektorit të dramës. Punoi në Katar si këshilltar në Ministrinë e Informimit, pastaj edhe drejtor rajonal i UNESCO-së për vendet i Gjirit.

Fama dhe afirmimi i Tajib Salihut u bë fal romanit të tij të njohur “Koha e shpërnguljes në veri”, shkrimit të cilit e filloi në vitin 1962, gjatë pushimeve në jug të Francës. Pastaj kishte pasur një ndërprerje prej afër katër viteve. Në vitin 1966 e kishte përfunduar dhe fillimisht e kishte botuar në revistën “Hivar” (Dialogu), Pastaj ishte ribotuar në Bejrut dhe në Kajro. Romani objekt shqyrtimi ka konfliktin midis Lindjes dhe Perëndimit, nëpërmes personalitetit të Mustafa Seidit, studentin e parë sudanez të dërguar në Londër, i cili bëhet ligjërues i shkencave ekonomike. Shumë kritikë letrare mendojnë se Tajib Salih i parapriu teorisë së politologut amerikan, Samuel Hantingtonit lidhur me temën e konfliktit të civilizimeve.

Romani në botën arabe, por edhe më gjerë, është lexuar dhe përjetuar në

mënyra të ndryshme, nga një herë edhe si literaturë pornografike, gjë që ka shkaktua ndalimin e tij në shumë vende arabe, por edhe në vendlindjen e autorit, në Sudan në vitet e nëntëdhjeta. Njëra prej leximeve të mundshme të këtij romani është aspekti postkolonialist i cili imponohet si esenca përmbajtësore e këtij romani. Romani “Koha e shpërnguljes në veri” është vlerësuar lartë nga kritika letrare. Ai është vlerësuar “romani më i çmuar i shekullit njëzet” nga Akademia e Letërsisë Arabe e Damaskut. Sipas një liste të përgatitur nga, gazeta The Guardian, në vitin 2002, është zgjedhur në mesin e 100 romaneve më të mira të të gjitha kohërave. Ky roman është përkthyer në më shumë se 35 gjuhë të botës.

Tajib Salih, nuk shkruante shumë. Ai la pas veti vetëm tre romane: “Dasma e Zejnes”, 1964, të cilin regjisor i kuvajtian Halid Siddik e ktheu në dramë më 1977, “Koha e shpërnguljes në veri” (1966), si dhe “Bandar Shah” në dy pjesë më 1987, si dhe një përmbledhje tregimesh nën titullin “Palma vad Hamidit” më 1984. Ai botoi poashtu një numër të konsiderueshëm artikujsh, të cilët i botoi nën përmbledhjen me titull “Kopshti i kryetarit” në pesë vëllime më 2005. Vlen të theksohet se për Tajib Salih, janë shkruar disa studime dhe libra kritikë, prej tyre po përmendim: “Tajib Salih, gjeni i novelës

arabe” i botuar në Bejrut, ku marrin pjesë një numër i konsideruar i kritikëve, në mesin e të cilëve Muhidin Subhi, Rexha Nekkash dhe Ali err-Rrai. Kurse kritiku Ahmed Bedevi e veçoi me një vepër” “Tajib Salih, biografi e një shkrimtari dhe teksti”, që u botua në Kajro. Në vitin 2005 fitoi shpërblimin “Takimi i tretë i Kajros për krijimtari letrare. Disa herë ishte kandiduar për të marrë çmimin Nobel për letërsi.

Me këtë rast vlen të theksojmë, se pjesë të romanit të shkrimtarit sudanez, Tajib Salih, “Koha e shpërnguljes në veri”, janë botuar në revistën e

“Edukata Islame”, organ i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, kurse këto ditë pritet që libri të del si tërësi. Romani është i përkthyer nga gjuha arabe. Me këtë rast edhe gjuha shqipe do të radhitet në mesin e atyre gjuhëve botërore në të cilën do të jetë i përkthyer romani më i njohur deri më tash i shkruar në gjuhën arabe.

Tajib Salih ishte i martuar me një britaneze, me të cilin kishte tri vajza, Zejneben, Semiren dhe Saren.

**Q. M.**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                          |                   |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| <i>Qemajl Morina</i><br><b><i>Ruajtja e disa dorëshkrimeve të vjetra të Kur'anit.....</i></b>                                            | <b><i>5</i></b>   |
| <i>James Pavlin</i><br><b><i>Kelami sunnit dhe kontraverset teologjike .....</i></b>                                                     | <b><i>11</i></b>  |
| <i>Nehat Krasniqi</i><br><b><i>Tahir efendi Boshnjaku – Gjakova.....</i></b>                                                             | <b><i>31</i></b>  |
| <i>Abdullah Rexhepi</i><br><b><i>Letërsia mistike islame dhe Mevlana Rumi .....</i></b>                                                  | <b><i>61</i></b>  |
| <i>Filip K. Hiti</i><br><b><i>Ndërrimi i roleve - ndikimi i perëndimit.....</i></b>                                                      | <b><i>83</i></b>  |
| <i>Salah Zaimeche</i><br><b><i>Sicilia .....</i></b>                                                                                     | <b><i>99</i></b>  |
| <i>Abbas Husein Ali</i><br><b><i>Natyra e psikës njerëzore: kontributi i gazaliut<br/>në konceptin islam të personalitetit .....</i></b> | <b><i>131</i></b> |
| <i>Dr. Zakir Naik</i><br><b><i>Thirrja (da'veti) në Islam është një përgjegjësi e madhe - (2).....</i></b>                               | <b><i>151</i></b> |
| <i>Avni Aliu</i><br><b><i>Jetën planifikoje edhe për atë që ndodh përtej varrit.....</i></b>                                             | <b><i>167</i></b> |
| <i>Tajib Salih</i><br><b><i>Koha e shpërnguljes në veri - (5).....</i></b>                                                               | <b><i>193</i></b> |
| <i>Qemajl Morina</i><br><b><i>Glosari çifut.....</i></b>                                                                                 | <b><i>213</i></b> |
| <b><i>Akademisë së shkencave dhe të arteve të Kosovës .....</i></b>                                                                      | <b><i>227</i></b> |
| <i>Fet'hullah Hulejj</i><br><b><i>Analizë librit "El-Bidajetu" të Imam Sabunit<br/>dhe pikëpamjeve të tij akaidore.....</i></b>          | <b><i>233</i></b> |
| <b><i>Vdiq gjeniu i novelës arabe Tajib Salih.....</i></b>                                                                               | <b><i>245</i></b> |
| <b><i>Përmbajtja.....</i></b>                                                                                                            | <b><i>249</i></b> |